RAPORT PËRFUNDIMTAR

"AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE"
NË
INSTITUTIN E INTEGRIMIT TË ISH TË PËRNDJEKURVE POLITIK
DHE
INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT

TIRANË, JANAR 2023

PËRMBAJTJA:

Nr.	Titulli	Faqe
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3-12**
1	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-7
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-12
II	**HYRJA**	**13-15**
1	Objektivat e auditimit	13
2	Qëllimi i auditimit	13
3	Identifikimi i çështjes	13
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13-14
5	Përgjegjësitë e audituesve	14
6	Kriteret e vlerësimit	14
7	Standardet e auditimit	15
8	Metodat e auditimit	15
9	Dokumentimi i auditimit	15
III	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**16-129**
III.1	**Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**	16
III.2	**Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit**	16-129
2.1	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm	16-22
2.2	Auditim mbi përputhshmërinë me aktet ligjor, nënligjore dhe rregullatore të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm të IIPP dhe Sektorëve përbërës të tij, për periudhën objekt auditimi.	22-34
2.3	Auditimi mbi përputhshmërinë me aktet ligjor, nënligjore dhe rregullatore të veprimtarisë së Bordit Drejtues të ISKK	34-45
2.4	Vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit dhe funksionimit të sistemeve të kontrollit në Auditimi mbi përputhshmërinë me aktet ligjor, nënligjore dhe rregullatore të veprimtarisë së Drejtorit Ekzekutiv, Drejtorive dhe Sektorëve të ISKK	45-48
2.5	Auditim mbi programimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit për IIPP dhe për ISKK	49-77
2.6	Auditimi mbi shpenzimet e kryera nëpërmjet procedurave të prokurimit publik për IIPP dhe për ISKK	77-123
2.7	Mbi menaxhimin dhe administrimin e marrëdhënieve të punës në IIPP dhe në ISKK	123-129
IV	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**130-139**
V	**ANEKSE**	**140-155**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 811/3 prot., datë 09.09.2022 "Mbi përputhshmërinë", miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 15.09.2022 deri në datë 03.11.2022, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2018 deri në 30.06.2022, në subjektin Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë (IIPP) dhe Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) u krye auditimi mbi përputhshmërinë e aktivitetit nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. H. S., Përgjegjës Grupi
2. Xh. Xh., Audituese
3. Xh. N., Audituese
4. E. C., Audituese

Auditimi u krye me bazë risku, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucioneve, duke përfshirë saktësinë e paraqitjes së të ardhurat dhe shpenzimet, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë dhe Instituti i Studimeve për Krime dhe Pasojat e Komunizmit, etj.

Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit për auditimin e zhvilluar në Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politik janë mbajtur 4 akt konstatime, ndërsa për auditimin e zhvilluar në Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit është mbajtur 1 akt verifikim dhe 4 akt konstatime, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit përkatës, brenda afatit të periudhës së auditimit në terren.
Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e bëra nga subjektet e audituar, mbi aktet e konstatimit dhe Projekt Raportin e Auditimit dhe janë marrë në konsideratë observacionet, të cilat janë të mbështetur në bazë ligjore, apo janë paraqitur dokumentacion argumentues shtesë. Problematikat e evidentuara sipas çështjeve të auditimit gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjekteve me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes. Mbështetur në punën audituese në terren, evidencat e marra ,të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese, mbështetur në Projekt Raportin e Auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

2.1. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve për Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politik

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi i bazës ligjore dhe nënligjore që rregullon veprimtarinë e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politik është konstatuar se ende nuk janë bërë përditësimet përkatëse në ligj lidhur me varësinë e institucionit, si dhe ende nuk është miratuar rregullorja e re funksionale pas ndryshimit të ligjit të institutit në 2014 dhe strukturës organizative, duke rezultuar në një institucion varësi e një ministrie që nuk ekziston më (ish Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë) dhe pa një rregullim të detyrave funksionale të punonjësve në përputhje dhe koherencë me ndryshimet e bëra për një hark kohor prej 20 vitesh, nga miratimi i rregullores së fundit, aktualisht në fuqi.	Fq 22-34	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm të ngrejë grupin e punës për hartimin e një rregulloreje të re për funksionimin e institucionit me objektiva konkret e të matshëm sipas pozicioneve dhe ta përcjell në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për miratim, së bashku me propozimet për përditësimin e ligjit nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", lidhur me varësinë e institucionit.
2	Nga auditimi i veprimtarisë për shpërndarjen e fondit të ndihmave në IIPP është konstatuar se në asnjë akt administrativ nuk përcaktohen procedurat: a. për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të shpërndarjes së fondeve dhe monitorimit të tyre; b. për veprimtarinë e komisionit të shpërndarje së ndihmave në shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave; c. për veprimtarinë e komisionit të monitorimit si dhe dokumentacionin justifikues të domosdoshëm mbi të cilën do bazohet monitorimi; d. si dhe format kërkesa tip të miratuara për ndihmë ekonomike të hartuara nga sektorët përkatës.	Fq 22-34	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm të ngrejë grupin e punës për hartimin e një rregulloreje të re, në plotësim të rregullores nr. 356, datë 12.04.2018 "Për funksionimin e komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" në të cilën të përcaktohet qartësisht procedura administrative e shqyrtimit, miratimit dhe monitorimit të kërkesave për ndihma dhe financim që duhet të ndjekë komisioni i shpërndarjes dhe komisioni i monitorimit të fondit, dokumentacioni i domosdoshëm dhe ai i nevojshëm në këto procedura, përbërja e komisioneve, duke shmangur konfliktin në vendimmarrje sipas pozicionit, si dhe të miratojë format kërkesat tip për ndihmë ekonomike të hartuara nga sektorët përkatës.
3	Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit me Shoqatat u konstatua se, nuk është bërë një studim i nevojave imediate dhe të perspektivës, si dhe një raport për gjendjen e të përndjekurve politik sikurse përcaktohet në rregulloren nr. 601, datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP", Kreu V, pika III.1 dhe 2.	Fq 22-34	E lartë	Sektori i Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit me Shoqatat të marrë masa për studimin e nevojave imediate dhe të perspektivës, identifikimin e tyre sipas kategorive dhe nën kategorive, trendit ndër vite dhe atij aktual, të dokumentojë këtë veprimtari nëpërmjet hartimit të raportit përcaktuar në rregullore, t'ia përcjell për miratim Drejtorit të Përgjithshëm dhe ta publikojë në ẃebsite-n zyrtar për publikun.
4	Nga auditimi i dosjeve të ndihmës ekonomike dhe atyre me informacion për personat e zhdukur është konstatuar se, kërkesat e dorëzuara sipas formateve tip për ndihmë ekonomike dhe për informacion mbi familjarët, bazuar në të cilat nisin procedurat respektive administrative në institucion, nuk janë protokolluar dhe regjistruar nga zyra e protokoll-arkivës, duke cënuar plotësinë e evidencës dhe gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.	Fq 22-34	E lartë	Sektori i Financës dhe Zyra e protokoll-arkivës të marrin masa për regjistrimin dhe evidentimin në protokoll të të gjitha kërkesave për ndihmë ekonomike, informacionit për personat e zhdukur dhe çfarë do lloj kërkese tjetër, në bazë të së cilës institucioni nis një procedurë administrative në vijim.
5	Nga auditimi rezulton se për periudhën 2018-2021, Komisioni i Monitorimit nuk ka administruar dokumentacion të mjaftueshëm justifikues mbi shpenzimin e kryer nga përfituesit e projekteve. Gjithashtu konstatohet se Komisioni i Monitorimit nuk i ka të organizuar apo të grumbulluar në një dokument të gjithë informacionin për të dhënat e përfituesve, duke sjellë për pasojë mungesë evidencash të mjaftueshme mbi përdorimin e fondit.	Fq 34-45	E lartë	Komisioni i monitorimit të marrë masa për plotësimin e praktikës me dokumente të mjaftueshëm, me qëllim justifikimin e shpenzimit të bërë nga përfituesit e ndihmës ekonomike, si edhe të krijojë një sistem për të menaxhuar informacionin e të dhënave mbi përfituesit e fondeve (databasë).
6	Nga auditimi rezulton se prej vitit 2019 e në vijim, IIPP çdo vit kryen procedurën e prokurimit me objekt "Marrje me qira e	Fq 77-123	E lartë	Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politik të marrë masa për paraqitjen,

	automjetit", për të cilin janë lidhur dhe likuiduar kontratat në vlerën totale 3,274,800 lekë. Konstatohet se, institucioni në PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022, ka planifikuar blerjen e një makinë tip fouristrade, në vlerën 4,000,000 lekë, e cila nuk rezulton të jetë pjesë e listës shoqëruese të investimeve për miratimin në projekt buxhetet e viteve përkatëse, ndërsa në PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, institucioni nuk ka planifikuar fonde për blerje automjeti.			argumentimin dhe planifikimin në PBA të nevojës për blerjen e një automjeti, me qëllim uljen e shpenzimeve për marrje me qira dhe menaxhimin me eficencë, efektivet dhe ekonomicitet të fondeve publike.
7	Gjatë vitit 2018, AKSHI ka lidhur 4 kontrata, për procedurën e prokurimit "Blerje pajisje kompjuterike" në vlerën totale 1,099,670 lekë, të ndarë në lote. Rezulton se AK, nuk e ka parashikuar këtë procedurë prokurimi në regjistrin e parashikimit si dhe nuk e ka deklaruar në regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit, në kundërshtim me pikën 1, neni 4 si dhe pikat 1, 2, 5, neni 7 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Gjithashtu, konstatohet se pavarësisht se me AN nr. 1, datë 26.07.2018, IIPP-së i janë shkurtuar fondet për shpenzime kapitale, AKSHI ka filluar procedurën e prokurimit për blerjen e pajisjeve kompjuterike dhe ka lidhur kontratat, duke marre angazhime pa fonde buxhetore dhe krijuar detyrime të prapambetura në vlerën totale 1,099,670 lekë.	Fq 77-123	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për marrjen e angazhimeve pa pasur fonde në dispozicion, si dhe të shmangë praktikat e financimit të projekteve të investimit pa kaluar fazat e menaxhimit të investimeve publike.

2.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve për Institutin e Studimeve për Krime dhe Pasojat e Komunizmit

GJETJA	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi ka rezultuar se, nuk ka një procedurë të miratuar për përzgjedhjen e drejtorit ekzekutiv, ku të përfshihet detajimi i procedurës, si dhe kriteret që duhen plotësuar nga aplikantët. Në procedurën e parë të ndjekur, nuk rezulton të ketë patur shpallje, por është vijuar me shprehjen e anëtarëve *pro – kundra* për rizgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv, ndërkohë që në procedurën e dytë të ndjekur, është kryer votim për të gjithë kandidatët që kishin aplikuar. Duke qenë se në Rregulloren e Brendshme të ISKK, Kreu III "Struktura organizative", nuk përcaktohet një procedurë të qartë të zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv nga ana e Bordit Drejtues, procesi i zgjedhjes ka rezultuar kompleks dhe i diskutueshëm, duke bërë që të humbasë transparenca dhe potencialisht të konsiderohet si proces me mangësi. Referuar Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri", neni 11 përcakton se *"Bordi Drejtues zgjedh, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, drejtorin ekzekutiv të Institutit",* nen i cili nuk detajon në mënyrë të qartë kriteret që duhet të plotësojë kandidati, si dhe procedurën e votimit deri në shpalljen e fituesit.	Fq 34-45	E lartë	Bordi Drejtues të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti të veçantë, duke përcaktuar procedurën e emërimit të Drejtorit Ekzekutiv, përcaktimin e kritereve që duhet të plotësojnë aplikantët, procedurën e votimit dhe deri në shpalljen e fituesit, për të garantuar një proces transparent, të barabartë dhe efektiv.
2	Referuar Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Shkencor të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, KSHI ka për detyrë të shqyrtojë dhe vlerësojë punimet e paraqitura për botim, bazuar në metodologjinë e miratuar paraprakisht prej tij dhe të konfirmuar nga Bordi Drejtues. Nga auditimi rezultoi që KSHI nuk e ka miratuar këtë metodologji, në kundërshtim me kërkesat e nenit 5 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KSHI, miratuar në vitin 2018 dhe nenit 6 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KSHI, miratuar në vitin 2021. Për periudhën 2018-2022 nuk ka një databazë të plotë mbi procedurat e dorëzimit të dorëshkrimeve për botim, e cila të specifikojë aplikimet në thirrje, veprat e përzgjedhura dhe vlerat që kanë përfituar autorët, në mospërputhje me pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.	Fq 34-45	E lartë	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në bashkëpunim me Këshillin Shkencor të marrin masa për standardizimin dhe formalizimin e procesit të botimit, duke paracaktuar metodologjinë për vlerësimin e punimeve të paraqitura për botim dhe të gjithë procesin që nga shpallja deri në botimin e veprave dhe miratimin e saj nga Bordi Drejtues, si dhe të krijojë dhe administrojë një databaze të plotë në lidhje me botimet, me qëllim dokumentimin e plotë të procesit.
3	Nga auditimi konstatohet se për mënyrën e organizimit të konferencave ISKK nuk ka një akt nënligjor ku të bazohet ky proces, nuk ka një metodologji për vlerësimin e artikujve të	Fq 34-45	E lartë	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti

	dorëzuar për pjesëmarrje në konferencë dhe botim, kjo me qëllim garantimin e barazisë, drejtësisë dhe transparencës së procesit. Përgjatë periudhës së audituar konstatohet se, nuk ka patur një praktikë fikse të shpalljes së konferencave nga Drejtoria e Studimit me qëllim shpalljen publike, përcaktimin e anëtarëve të grupit të punës, ndarjen e detyrave të tyre, e në vijim deri në përfundim të shpërblimit të kumtesave, veprime jo në përputhje me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 "Aktivitetet e Kontrollit". Referuar procedurës së dorëzimit të abstrakteve për pjesëmarrje në konferencë, në asnjë nga vitet objekt auditimi nuk ka një databazë të plotë, e cila të specifikojë aplikimet në thirrje, kumtesat e përzgjedhura dhe vlerat që kanë përfituar autorët, veprime jo në përputhje me pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 "Aktivitetet e kontrollit".			nënligjor që detajon hollësisht procedurën e organizimit të konferencave, ku të përfshihet procedura e ndjekur për përcaktimin e temave, shpallja, mënyra e aplikimit, metodologjia e vlerësimit, pagesa e pjesëmarrësve, si dhe çdo hallkë tjetër që do ta bënte më transparent procesin, si dhe krijimin dhe administrimin e një databaze të plotë në lidhje me konferencat, ku për secilën thirrje të mëtejshme të evidentohen aplikimet me të dhënat përkatëse të nevojshme.
4	Nga auditimi u konstatua se, thirrjet për botime/ konferenca nuk trajtoheshin si praktika në vetvete, duke bërë kështu të vështirë ndjekjen e praktikës nga fillimi (vendimmarrja për thirrjen) e deri në përfundim të praktikës, kjo referuar nenit 19 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Sa më sipër, do të mundësonte ndjekjen me rrjedhë kronologjike të procedurave kryesore të veprimtarisë së ISKK, sikurse janë botimet dhe konferencat, duke nisur me urdhrin e titullarit për fillimin e punës për hartimin e shpalljes, e duke vijuar progresivisht me fraksion çdo dokumentacion i lidhur me atë shpallje, në çdo formë hyrëse në institucion (përfshirë dokumentet që hyjnë elektronikisht), deri në mbylljen e praktikës me vendimmarrjen përfundimtare me shpalljen e fituesve.	Fq 45-48	E lartë	Titullari i ISKK të marrë masa mbi ngarkimin e njësisë përgjegjëse për regjistrimin e dokumenteve që formojnë një praktikë duke vijuar me të njëjtin numër rendor progresivisht me fraksion për çdo dokumentacion hyrës në institucion deri në mbylljen e praktikës me vendimmarrjen përfundimtare, si dhe përcaktimin e kësaj njësie për sa më sipër në aktet nënligjore që përcaktojnë detyrat funksionale të punonjësve të ISKK.
5	Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua se në 3 raste, në vlerën totale 464,900 lekë pa TVSH, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në urdhrin e prokurimit dhe në ftesën për ofertë, konkretisht: - Në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi interneti 40 mps i dedikuar dhe simetrik", me vlerë kontrate 130,000 lekë pa TVSH, operatori ekonomik i shpallur fitues "K...," nuk ka dorëzuar dokument që vërteton se nuk është në proces falimenti, si dhe ka paraqitur licencën lëshuar nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit nr. 992/0408, datë 16.04.2008, e cila në periudhën e zhvillimit të tenderit nuk ka qenë e vlefshme. - Në procedurën e prokurimit me objekt "Realizmi i performancës publike (ekspozitë) "Komunizmi shqiptar: Propaganda dhe realiteti", me vlerë kontrate 150,000 lekë pa TVSH, operatori ekonomik i shpallur fitues "E." nuk ka paraqitur dokumente që vërtetojnë se ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, nuk ka provuar përvojën 2 vjeçare, si dhe nuk ka paraqitur projekt ide. Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar se në 2 raste, për procedurën "Blerje karburanti për vitin 2020" dhe procedurën "Realizmi ekspozite", urdhri i prokurimit ka dalë para llogaritjes së fondit limit; në procedurat "Blerje pajise kompjuterike për vitin 2021" dhe "Shërbim interneti për vitin 2019" nuk është mbajtur procesverbal për kalimin te operatori tjetër; në procedurën "Realizim ekspozite" ftesa për ofertë nuk i është dërguar të paktën 5 operatorëve ekonomikë; në procedurën e prokurimit "Shtypshkrimi i kolanës për vitin 2020" nuk janë argumentuar specifikimet teknike; në procedurën e prokurimit mirëmbajtje dhe pastrim zyrash për	Fq 77-123	E lartë	Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme për hartimin e regjistrit të parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit brenda afateve kohore, në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e ISKK, me qëllim parashikimin e saktë të nevojave të institucionit, si dhe trajnimin e zyrtarëve të prokurimit për eliminimin e praktikave të konstatuara në shkelje të legjislacionit.

	vitin 2022 nuk është hedhur shorti midis operatorëve ekonomikë që kanë paraqitur të njëjtën vlerë oferte. Ndërsa, për zbatimin e kontratës "Shtypshkrimi i kolanës për vitin 2020" rezulton se operatori ekonomik "I." ka dorëzuar me vonesë, pas datës 10.03.2021 sasinë e mallit dhe AK nuk i ka llogaritur penalitetet, konkretisht janë dorëzuar 3,100 kopje më datë 11.03.2021, 1,000 kopje më datë 15.03.2022 dhe 1,000 kopje më datë 16.03.2021.			
6	Nga auditimi konstatohet se ISKK e zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në Rregulloren e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Studimit të Krimeve të Komunizmit", miratuar me Vendimin e Bordit Drejtues nr. 615/1, datë 08.05.2018, e cila është e pa përditësuar duke qenë se Instituti i Studimeve për Studimet dhe Pasojat e Komunizmit ka kalur në proces ristrukturimi. Gjithashtu konstatohet se nuk janë kryer vlerësimet e rezultateve në punë për punonjësit e Drejtorisë së Studimeve, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil".	Fq 123-129	E lartë	Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masat për rishikimin e rregullores së institucionit, ku të përcaktohen qartë, struktura organizative, funksionet dhe përshkrimi i punës për çdo pozicion pune me qëllim rritjen e performancës institucionale, si dhe të merren masa për vlerësimin e rezultateve në punë të të gjithë nëpunësve civil.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

3.1 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit për Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politik

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë në Institutin e Integrimit të Ish të Përndjekurve Politikë (IIPP), në lidhje me shkallën e zbatueshmërisë së ligjit nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", i ndryshuar, si dhe ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore e rregullatore mbi të cilët ushtron veprimtarinë IIPP për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2018 deri më 30.06.2022. Gjatë auditimit në terren janë marrë evidenca, informacione dhe të dhëna të mjaftueshme, të besueshme dhe të përshtatshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit të auditimit.

Opinion i modifikuar/kualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë[1]

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e IIPP-së janë evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe cilësore por jo të përhapura dhe që justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për opinion e auditimit

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë", Manualin e auditimit të përputhshmërisë, Rregulloren e procedurave të auditimit në KLSH, kërkesat e kodit të etikës etj.

Ne jemi të pavarur nga IIPP, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së.

[1] **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materiale por jo të përhapura****.*

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e kërkuara dhe të vëna në dispozicion për veprimtarinë e IIPP, rezultoi se:
- Për bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon veprimtarinë e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politik ende nuk janë bërë përditësimet përkatëse në ligj lidhur me varësinë e institucionit, si dhe ende nuk është miratuar rregullorja e re funksionale pas ndryshimit të ligjit në 2014 dhe strukturave të një pas njëshme. Kjo pasi rezulton një institucion në varësi të një ministrie që nuk ekziston më ish MMSR dhe pa një rregullim të detyrave funksionale të punonjësve në përputhje dhe koherencë me ndryshimet e bëra për një hark kohor prej 20 vitesh, nga miratimi i rregullores së fundit, aktualisht në fuqi.
- Nuk janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm kërkesat tip për financim dhe ndihmë ekonomike të hartuara nga sektorët përkatës.
- Nuk ka një procedurë të përcaktuar në akte administrative për: ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të shpërndarjes së fondeve dhe monitorimit të tyre; veprimtarinë e komisionit të shpërndarje së ndihmave në shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave; veprimtarinë e komisionit të monitorimit, si dhe dokumentacionin justifikues të domosdoshëm mbi të cilën do bazohet monitorimi.
- Nuk janë miratuar planet vjetore të punës, si dhe raportet e veprimtarisë së institucionit.
- Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit me Shoqatat u konstatua se nuk është bërë një studim i nevojave imediate dhe të perspektivës.
- Nga auditimi i dosjeve të ndihmës ekonomike dhe atyre me informacion për personat e zhdukur u konstatua se, kërkesat e dorëzuara sipas formateve tip për ndihmë ekonomike dhe për informacion mbi familjarët, bazuar në të cilat nisin procedurat respektive administrative në institucion, nuk janë protokolluar dhe regjistruar nga zyra e protokoll-arkivës, duke cenuar plotësinë e evidencës dhe gjurmën e auditimit.
- Komisioni i Monitorimit nuk ka përfshirë në monitorim dokumentacion të mjaftueshëm justifikues mbi shpenzimin e kryer mbi përdorimin e fondeve të dhëna.
- Në lidhje me procedurat e prokurimit është konstatuar se për periudhën 2018-2022 regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë miratuar jashtë afateve kohore, ndërsa regjistrat e realizimit të prokurimit janë dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë afatit kohor.
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua se në 5 raste, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në urdhrin e prokurimit dhe në ftesën për ofertë.
Po ashtu, në procedurat e prokurimit blerje kancelari për vitin 2018, 2019, 2020, 2021; blerje karburanti dhe marrje e makinës me qira për vitin 2019 nuk është përcaktuar fondi limit; në 3 procedurat e prokurimit për blerje tonera dhe kancelari në ftesën për ofertë nuk janë vendosur kriteret dhe specifikimet teknike.
Gjithashtu, në procedurën blerje tonera dhe kancelari për vitin 2019 nuk është mbajtur procesverbal për kalimin te operatori ekonomik i radhës; në 3 procedurat e prokurimit për blerje karburanti vlerësimi i ofertave është bërë në bazë të çmimit të pandryshuar përgjatë zbatimit të kontratës; në 4 raste për procedurat e marrjes së makinës me qira komisioni nuk ka argumentuar specifikimet teknike.

Nga auditimi është konstatuar se në të gjitha komisionet e prokurimit me vlerë të vogël, për periudhën objekt auditimi, ka qenë kryetare e komisionit Përgjegjësja e Financës dhe Shërbimeve, njëkohësisht nëpunësi zbatues i institucionit.
- Për periudhën 2018-2020, Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politik ka kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën totale 4,311,922 lekë, e cila përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të IIPP-së:
Strukturat drejtuese të IIPP, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore në përputhje me politikat, ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues dhe personeli i IIPP ka përgjegjësi menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin e tij.
Drejtuesit e të gjitha niveleve janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë, si dhe për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Gjithashtu, ata janë përgjegjës për t'i siguruar grupit të auditimit të KLSH dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:
Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e IIPP është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit.
Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.
Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të raportimit të treguesve fiskalë janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.
Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

3.2 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, në lidhje me shkallën e zbatueshmërisë së ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, si dhe ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore mbi të cilët ushtron veprimtarinë ISKK, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2018 deri më 30.06.2022. Gjatë auditimit në terren janë marrë evidenca, informacione dhe të dhëna të mjaftueshme, të besueshme dhe të përshtatshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i modifikuar/ kualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë[2]

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e ISKK-së janë evidentuar devijime të vogla nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë të karakterit të materialitetit cilësor jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për opinion e auditimit

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, kërkesat e Kodit të Etikës etj.

Ne jemi të pavarur nga ISKK, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së.

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e ISKK, kanë rezultuar:

- Mungesë qartësie në procesin e përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv dhe mangësi ~~mungesë~~ të akteve ligjore/nënligjore që detajojnë këtë proces.
- Mungesa e akteve administrative që përcaktojnë proceset kryesore të ISKK, siç janë botimet dhe konferencat.

[2] **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materiale por jo të përhapura****.*

- Këshilli Shkencor i Institutit nuk ka hartuar dhe miratuar metodologjinë për vlerësimin e punimeve, nuk ka mundësuar ruajtjen e dokumentacionit mbi procesin e botimeve, si dhe nuk ka një databazë të plotë mbi procedurat e dorëzimit të dorëshkrimeve për botim, e cila të specifikojë aplikimet në thirrje, veprat e përzgjedhura dhe vlerat që kanë përfituar autorët.
- Bordi Drejtues i ISKK nuk ka hartuar dhe miratuar një akt administrativ për të evidentuar procedurën e ndjekur për organizimin e konferencave, ku të përfshihen çështjet për përcaktimin e temave, shpallja, mënyra e aplikimit, metodologjia e vlerësimit e deri te pagesa e pjesëmarrësve.
- Administrim në kundërshtim me përcaktimet e normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor të evidencave në procedurat e botimeve dhe konferencave.
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar se në 3 raste urdhri i prokurimit ka dalë para llogaritjes së fondit limit; në 3 raste nuk është mbajtur procesverbal për kalimin te operatori tjetër; në 1 rast ftesa për ofertë nuk i është dërguar të paktën 5 operatorëve ekonomik; në 1 rast nuk janë argumentuar specifikimet teknike të vendosura; në 3 raste në urdhrat e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit; në 1 rast nuk është hedhur shorti midis operatorëve ekonomik që kanë paraqitur të njëjtën vlerë oferte; në 3 raste operatori ekonomi i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në urdhrin e prokurimit dhe në ftesën për ofertë dhe në 1 rast nuk janë llogaritur penalitetet për dorëzimin me vonesë të mallit.
- Rregullorja e brendshme e veprimtarisë së ISKK është e pa përditësuar.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të ISKK-së:
Strukturat drejtuese të I, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore në përputhje me politikat, ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues dhe personeli i ISKK ka përgjegjësi menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin e tij.
Drejtuesit e të gjitha niveleve janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë, si dhe për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Gjithashtu, ata janë përgjegjës për t'i siguruar grupit të auditimit të KLSH dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:
Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e ISKK është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit.
Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme

e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të ISKK.

Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të raportimit të treguesve fiskalë janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

1. Objektivat e auditimit

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivi kryesore i veprimtarisë audituese është vlerësimin i përputhshmërisë dhe dhënia e opinionit mbi procedurat e ndjekura nga Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politik dhe Instituti i Studimeve për Krime dhe Pasojat e Komunizmit, gjatë procesit të realizimit të aktivitetit të tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, në lidhje me: shkallën e ndjekjes të rregullave mbi organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese; programimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, vlerësimin e procedurave të prokurimeve publike e përputhshmërisë së transaksioneve që lidhen me to; vlerësimin e marrëdhënieve të punës dhe pagave, etj.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi i auditimit është vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura dhe procedurave të ndjekura nga Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë dhe Instituti i Studimeve për Krime dhe Pasojat e Komunizmit gjatë procesit të realizimit të objektivave të tyre, në përputhje me legjislacionin, vlerësimi me objektivitet, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit, vlerësimi e evidentimi i shkeljeve si dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e përgjegjësisë institucionale.

3. Identifikimi i çështjes

Instituti Integrimit të Ish të Përndjekurve Politikë (IIPP) harton programet dhe zhvillon politikat e integrimit të ish të përndjekurve politikë të regjimit komunist në jetën shoqërore të vendit në përputhje me programin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.
IIPP është institucion buxhetor, që sipas VKM-së nr. 508, datë 13.09.2017 "Për caktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" varet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR).
IIPP përpunon dhe trajton çështjet themelore që kanë të bëjnë me ish të Përndjekurve politikë nga regjimi komunist, në bashkëpunim me shoqatat kombëtare të ish të përndjekurve politikë, që kanë shtrirje në të gjithë Shqipërinë.

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, është institucion publik qendror dhe i pavarur, që gëzon statusin e personit juridik, i cili financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera. Sipas ligjit nr. 10242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, fusha kryesore e veprimtarisë së ISKK është studimi dhe vlerësimi objektiv i krimeve dhe dëmeve të shkaktuara nga komunizmi në Shqipëri, zbardhja dhe dëshmimi i tyre në mënyrë të dokumentuar dhe të pakontestueshme.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Është detyrimi i drejtuesve të Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politik, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të zbatimit të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin për integrimin e ish të përndjekurve politik në shoqëri.

Është detyrimi i drejtuesve të Institutit të Studimeve dhe Pasoajve të Komunizimit, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të zbatimit të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin për studimin e pasojave të shkaktuara nga komunizmi.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i zhvilluar dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, i cili shprehet nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinioni. ISSAI 4000 përcakton se, audituesit publikë duhet të përgatisin raportin e auditimit bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, afatit, saktësisë dhe kundërshtimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave të nevojshme për të siguruar dëshmi e evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të mbështetur konkluzionin tonë. Procedurat e kryera janë bazuar në gjykimin profesional të audituesve publikë, duke përfshirë vlerësimin e riskut të mospërputhjeve materiale, qofshin këto për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ne besojmë se provat e mbledhura të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur konkluzionin tonë.

Audituesit e KLSH janë të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 30 "Kodi Etik", apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin.

6. Kriteret e vlerësimit

- Standardet e Auditimit:
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, date 23.06.2020;
- Akte ligjore:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10242, datë 25.02.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri";
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;.
- Rregullore mbi funksionimin e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politik;
- Rregullore mbi funksionimin e Institutit të Studimeve për Krime dhe Pasojat e Komunizmit".

Të tjera akte ligjore dhe nënligjore rregullative që lidhen me objektin e veprimtarisë së njësisë së audituar.

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës

Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, Rregulloren "Për Procedurat e Auditimit", miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 63, datë 22.06.2020 dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Nga grupi i auditimit është siguruar dokumentimi i gjetjeve të auditimit, duke u bazuar kryesisht në evidenca të plota, të sakta, të besuara, të mjaftueshme, etj.

8. Metodat e auditimit

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efiçencës së auditimit, duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit.
Për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë (përputhshmërisë), u gjykua të verifikohen disa transaksione, të përdoren raporte dhe informacione, teknikat me ndihmën e kompjuterit si dhe teknika e kampionimit dhe zgjedhjes rastësore.

9. Dokumentimi i auditimit

Auditimi është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë ISSAI 4000, si edhe Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë ISSAI 400-499. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e planifikimit dhe auditim në terren, si dhe janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

III.1 Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Instituti Integrimit të Ish të Përndjekurve Politik (në vijim IIPP) harton programet dhe zhvillon politikat e integrimit të ish të përndjekurve politik të regjimit komunist në jetën shoqërore të vendit në përputhje me programin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.
IIPP përpunon dhe trajton çështjet themelore që kanë të bëjnë me ish të Përndjekurve politik nga regjimi komunist, në bashkëpunim me shoqatat kombëtare të ish të përndjekurve politik, që kanë shtrirje në të gjithë Shqipërinë.
Në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore dhe me shoqatat e ish të përndjekurve politik, duhet të marrë masa për ndërtimin e programe për realizimin e të gjitha të drejtave të ish të përndjekurve politik nga regjimi komunist në zbatim të Ligjit nr. 7748 datë 29.07.1993, "Për statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politik nga sistemi komunist", që burojnë nga Ligji nr. 7514 datë 30.09.1991 "Për Pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politik", si dhe Ligji nr. 9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të Përndjekurve Politik nga regjimi komunist".

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (në vijim ISKK) është institucion publik, qendror, i pavarur, me financim nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera, veprimtaria e të cilit përcaktohet në ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri". Bazuar në këtë ligj, detyrat e tij shtrihen kryesisht në studimin, analizimin dhe vlerësimin e krimit dhe pasojave të komunizmit në Shqipëri, duke publikuar dhe përhapur materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe duke organizuar ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në vendin tonë. Organet drejtuese të institutit janë Bordi Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.

III.2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve:

III.2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer auditimi përputhshmërie në Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për periudhën nga 01.01.2018 deri më datë 30.05.2019, për të cilin ka dal Vendimi i Kryetarit të KLSH-së nr. 51, datë 21.08.2019. Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 360/7 prot., datë 21.08.2019, protokolluar në Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit me nr. 217/2, datë 23.08.2019, ka kërkuar zbatimin e rekomandimeve për 1 "Masë për përmirësim ligjor" dhe 10 "Masa organizative".

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit me shkresën nr. 217/4, datë 10.09.2019 ka dërguar programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna, **brenda afatit 20 ditë**, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Në mbështetje të realizimit të planit të veprimit, Drejtori Ekzekutiv ka nxjerrë Urdhrin nr. 28, datë 09.09.2019, protokolluar me nr. 217/5, datë 30.09.2019, me të cilin ngarkon strukturat përgjegjëse të varësisë të marrin masa për zbatimin e planit të veprimit.

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit nuk ka raportuar për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për

organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku citohet se: *"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".*
Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë lënë gjithsej 11 rekomandime statusi i të cilave paraqitet si më poshtë:

a. **1 masë për ndryshim apo përmirësim ligjor,** e cila është pranuar dhe është zbatuar plotësisht.
b. **10 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar 10 masa organizative, 1 masë organizative rezulton e pazbatuar, 4 masa organizative rezultojnë të zbatuara pjesërisht, 4 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht dhe 1 masë organizative rezulton në proces zbatimi.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmbledhur ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve.

Tabela nr. 1: Ndjekja dhe zbatimi rekomandimeve të dhëna nga KLSH.

Rekomandimi	Nr.	Pa pranuar	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Përmirësim ligjor	1	-	1	1			
Masa Organizative	10	-	10	4	4	1	1
Totali	**10**	**-**	**11**	**5**	**4**	**1**	**1**

Burimi: *Grupi i auditimit, KLSH.*

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH rezultoi si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME TË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1 Rekomandimi: Në këto kushte rekomandojmë, që ISKPK t'i drejtohet Kuvendit për **shfuqizimin e**:
- pikës 2 të nenit 19 të e Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 *"Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri" i cili parashikon se: "Struktura, organika dhe niveli i pagave të punonjësve të institutit miratohen me VKM"*; dhe
-nenit 20 të po të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "*Ngarkohet KM të miratojë strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të nëpunësve e punonjësve të tjerë të Institutit dhe të shpërblimeve brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 12 dhe 19 të këtij ligji*".
Nga auditimi rezultoi se, me shkresën nr. 280, datë 15.10.20219, ISKK i ka kërkuar Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, shfuqizimin e pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr. 10242 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri".
Me ligjin nr. 129/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10242, datë 25.02.2010 "Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri", është ndryshuar neni 19, pika 2. Kuvendi i Shqipërisë ka marrë Vendimin nr. 11/2021, datë 01.02.2021 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri (ISKK)".
Ky rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Me qëllim menaxhimin efektiv të fondeve buxhetore, nevojitet planifikim aktiv, dhe monitorim i kujdesshëm i buxhetit, konkretisht:

- Planifikimi duhet të nisë nga nevojat e secilës drejtori/sektor, duke u planifikuar me kujdes, aktivitetet e nevojshme, produktet mbi të cilat këto aktivitete do të ngrihen e zhvillohen, në sasi dhe vlerë, me qëllim garantimin se objektivat respektive të njësive dhe si pasojë të vetë institucionit, do të përmbushen në kohën dhe masën e duhur.
- Nevojitet monitorim i kujdesshëm ndaj realizimit të produkteve në përputhje me planet e parashikuara me qëllim ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për vitit 2019 janë realizuar në masën 71.2%, ose 26,000 mijë lekë nga 36,537 mijë lekë të planifikuara. Për vitin 2020, rezulton se shpenzimet buxhetore janë realizuar në masën 72.4%, ose 22,802 mijë lekë nga 31,500 mijë lekë të planifikuara. Për vitin 2021, shpenzimet buxhetore për vitit 2021 janë realizuar në masën 91%, ose 30,402 mijë lekë nga 33,100 mijë lekë të planifikuara.

Rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

2.1 Rekomandimi: Të merren masa që të bëhet veprimi korrigjues duke evidentuar çregjistrimin e 175 librave, me vlerë kontabël 169,450 lekë nga llogaria 312107 "Libra dhe Publikime Profesionale", dhe regjistrimi i tyre në llogarinë 2120112 "Krijimi Fond Biblioteke".

Nga auditimi rezultoi se me fletën kontabël nr. 31, datë 26.09.2019, janë çregjistruar 175 libra me vlerë kontabël 169,450 lekë nga llogaria 312107 "Libra dhe Publikime Profesionale" dhe janë regjistruar në llogarinë 2120112 "Krijimi Fond Biblioteke. Gjithashtu është debituar llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe është kredituar llogaria 8423 "Transferim për ndryshim gjendjeje" në shumën 169,450 lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

3.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues (NA) të marr masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të automjetit, me qëllim që mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, të bëhet vlerësimi i tij. Në përfundim të procesit, komisioni i vlerësimit duhet të argumentojë nëse aktivi është/nuk është më i nevojshëm për veprimtarinë e njësisë dhe mundësitë potenciale për përdorimin e tij nga njësi të tjera, apo tjetër. Në varësi të konkluzionit të komisionit të vlerësimit, NA duhet të marr masa për ngritjen e komisionit për nxjerrjet jashtë përdorimit/ose tjetërsimin e aktivit, me qëllim: ose transferimin pa pagese të tij në një njësi tjetër publike (konfirmimi zyrtar nga njësia përfituese vërteton përfundimin e transaksionit); ose shitjen e automjetit në ankand.

Nga auditimi rezultoi se nëpunësi zbatues me shkresën nr. 281, datë 16.10.2019 ka kërkuar fillimin e procedurës për nxjerrje nga përdorimi të automjetit "H.", me targë TR.....F me numër shasie KM.....5. Me Urdhrin nr. 43, datë 16.10.2019, Drejtori Ekzekutiv ka ngritur komisionin e inventarizimit të pjesshëm të pasurisë së ISKK (për automjetin). Me shkresën nr. 281/2, datë 17.10.2019 është bërë kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, për pjesëmarrjen e 2 inxhinjereve mekanikë, në Komisionin e Vlerësimit të Aktiveve për Automjetin. Nga Komisioni i Inventarizimit është mbajtur proces verbali me nr. 281/4, datë 22.10.2019, për inventarizimin e automjetit si dhe është hartuar relacioni nr. 281/6, datë 22.10.2019 për inventarizimin e pjesshëm të pasurisë. Drejtori Ekzekutiv ka nxjerrë Urdhrin nr. 46, datë 25.10.2019 për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Pasurisë së Pjesshme të ISKK". Ky komision ende nuk e ka përfunduar dhe miratuar relacionin për gjendjen fizike dhe teknike të autoveturës, për shkak të largimit nga puna të inxhinierëve. ISSK me shkresën nr. 154, datë 10.10.2022 i ka

kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, 2 inxhinierë mekanikë me qëllim pjesëmarrjen në Komisionin e Vlerësimit të Aktiveve.
Rekomandimi rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

4.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues (NZ) të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me qëllim zbatimin e disiplinës financiare për përputhshmërinë e llogarive sintetike me ato analitike (në rastin konkret, regjistrin e aktiveve).
Nga auditimi ka rezultuar se NZ në ISKK ka krijuar regjistrin kontabël të aktiveve.
Rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

5.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues (NZ) të marrë masa që në vijim të mos përllogarisë amortizim për këtë kategori aktivesh si dhe të kryejë veprimet korrigjuese për amortizimin e përllogaritur deri tani si vijon:
*- për amortizimin e librave, fond i bibliotekës së ISKPK, për shumën prej **36,953 lekë**, të debitojë llogarinë e AAGJ - 2120112 dhe kreditojë llogarinë "Shtesa e Fondit Bazë" -1011;*
*- për amortizimin e 4 pikturave, për shumën prej **180,843** lekë të debitojë llogarinë "Të tjera pajisje zyre" - 2187 dhe kreditojë llogarinë "Shtesa e Fondit Bazë" - 1011 ;*
*- për amortizimin e emblemës së ISKPK, për shumën prej **181,646 lekë** të debitojë llogarinë "Mobilje zyre" - 2181dhe kreditojë llogarinë "Shtesa e Fondit Bazë" -1011.*
Nga auditimi konstatohet se Nëpunësi Zbatues me fletën kontabël nr. 32, datë 26.09.2019 ka kryer veprimet korrigjuese, konkretisht: për amortizimin e librave, fondi i bibliotekës së ISKK, ka debituar me minus llogarinë 2192 "amortizime krijimi i fondit të bibliotekës" dhe ka kredituar llogarinë 1011 "Shtesa e fondit bazë", për shumën 36,953 lekë; për amortizimin e 4 pikturave ka debituar me minus llogarinë 2198 "amortizimi i inventarit ekonomik" dhe ka kredituar llogarinë 1011 "shtesa e fondit bazë", për shumën 180,843 lekë; për amortizimin e emblemës ka debituar me minus llogarinë 2198 "amortizimi i inventarit ekonomik" dhe ka kredituar llogarinë 1011 "shtesa e fondit bazë", për shumën 181,646 lekë.
Rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

6.1 Rekomandimi: Në të gjitha procedurat e prokurimit që do të kryhen në të ardhmen, Njësia e Prokurimit të marra masa që të hartojë dhe miratojë Dokumentet të Tenderit, në përputhje me Dokumentet Standarde të Tenderit për kontratat e furnizimeve (mallrave).
Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi ka rezultuar se ISKK ka realizuar 1 procedurë prokurimi "Kërkesë me propozim". Njësia e prokurimit ka hartuar Dokumentet Standarde të Tenderit, të cilat rezultojnë të pa firmosura.
Rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

7.1 Rekomandim: Për të gjitha rastet e shërbimeve të kësaj natyre, që lidhen me blerjen, zhvillimin, prodhimin, bashkëprodhimin e programeve ose të reklamave, ISKPK të procedojë në zbatim të VKM nr.1195, datë 05.08.2008 "Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në mediat e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore", dhe jo në zbatim të ligjit për prokurimin Publik dhe akteve të dala në zbatim të tij
Nga auditimi rezulton se për periudhën objekt auditimi është kryer 1 procedurë për shërbimin e

realizimit të video produksionit "Muzeu Virtual i Kampit të Maliqit, pjesa e parë me fond limit 800,000 lekë pa TVSH. Kjo procedurë është zhvilluar në mbështetje të pikës b, neni 7, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2003 "Për prokurimin publik", i ndryshuar si dhe VKK nr. 1195, datë 05.08.2008 *"Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në mediat e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore".*

Rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

8.1 Rekomandimi: a. Titullari i ISKPK-së të marrë masa për miratimin e programeve specifike për trajnimin e punonjësve.

b. Titullari i njësisë publike të marr masa për hartimin e Strategjisë së Riskut të ISKPK-së , me qëllim mirë funksionimin e kontrolleve të brendshme. Të ngrihen grupet e punës për miratimin e regjistrave të riskut.

c. Në çdo rast, GMS të marr masa për të përgatitur një raport vjetor me qëllim kontrollin se si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike.

d. Të merren masat që të plotësohen vlerësimet për 6 mujorin e vitit 2019 sipas të gjithë proceseve që dikton ligji baza ligjore në fuqi.

Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk janë miratuar programe për trajnimin e punonjësve.

Nëpunësi zbatues ka hartuar, çdo vit Strategjinë e Riskut të ISKK, por nuk janë ngritur grupe punë për miratim.

Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka përgatitur raporte vjetore për të kontrolluar se si janë menaxhuar risqet brenda njësisë.

Rezulton se për vitin 2019, vlerësimi i punonjëse është bërë për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, jo i ndarë në 2 gjashtëmujorë.

Rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

9.1 Rekomandimi: Nga sa më sipër nevojitet që Bordi të marrë masat që të miratojë procedurat e marrjes në punë të punonjësve të rinj, ku ndër të tjera të përfshijë:

- Miratimin e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, sipas nevojës;
- Krijimin e Komitetit të Përhershëm të Pranimit;
- Përcaktimin e qartë të procedurave të rekrutimit në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", ku të parashikohen qartë fazat nëpër të cilat do të zhvillohet rekrutimi.
-Të bëhet shpallja e procedurës së pranimit në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në stendat e informimit të publikut, si dhe në faqen e internetit.
- Shpallja e procedurës së pranimit të botohet të paktën 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit;
-Shpallja në faqen zyrtare të DAP-it apo të vetë institucionit të përmbajë të dhënat që kërkon ligjit nr. 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive".

Procedurat e rekrutimit të miratuara nga Bordi, të behën pjesë e Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Institutit. Nga auditimi është konstatuar se është miratuar Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Me urdhrin nr. 11, datë 29.04.2021 është ngritur Komiteti i Përhershëm

Pranimit. Me Urdhrin nr. 27, datë 09.09.2022 është ngritur Komiteti i Pranimit (për pranimin nga jashtë shërbimit civil). Për rekrutimet e reja është bërë shpallja e vendit vakant. Procedurat e rekrutimit të miratuara nga Bordi, nuk janë bërë pjesë e Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Institutit, pasi nuk është hartuar dhe miratuar Rregullore e re.

Rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

10.1 Rekomandimi: Rekomandojmë që, në përputhje me kërkesat e Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e ISKPK", korrespondenca e protokolluar, pasi t'i bashkëlidhet me kartelën shoqëruese, t'i përcillet Titullarit, për dhënien e udhëzimeve mbi trajtimin e secilës praktikë. Edhe në rastet kur një shkresë nuk i drejtohet Titullarit, korrespondenca duhet të ndjek po të njëjtën rrugë administrative. Sipas shënimeve për mënyrën e trajtimit, të bëra nga titullari, korrespondenca t'u dërgohet funksionarëve të caktuar për ndjekjen e tyre, nëpërmjet sekretarisë.
Nga auditimi me zgjedhje rezultoi se korrespondencës së protokolluar nuk i bashkëlidhet kartelë shoqëruese.

Rekomandimi rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

Titulli i gjetjes:	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH-së.
Situata:	ISKK me shkresën nr. 217/4 prot., datë 10.09.2019 ka dërguar programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna, brenda afatit 20 ditë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Në mbështetje të realizimit të planit të veprimit, Drejtori Ekzekutiv ka nxjerrë Urdhrin nr. 28, datë 09.09.2019, protokolluar me nr. 217/5, datë 30.09.2019, me të cilin ngarkon strukturat përgjegjëse të varësisë të marrin masa për zbatimin e planit të veprimit. ISKK nuk ka raportuar për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë lënë gjithsej 11 rekomandime statusi i të cilave paraqitet si më poshtë: - 1 masë për ndryshim apo përmirësim ligjor, e cila është pranuar dhe është zbatuar plotësisht. -10 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 10 masa organizative, 1 masë organizative rezulton e pazbatuar, 4 masa organizative rezultojnë të zbatuara pjesërisht, 4 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht dhe 1 masë organizative rezulton në proces zbatimi.
Kriteri:	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, 30 dhe 31;
Ndikimi:	Rekomandimet e pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht ndikojnë në performancën e institucionit, duke frenuar përmirësimin e situatës së menaxhimit të fondeve dhe pasurisë publike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Drejtori Ekzekutiv i ISKK të marrë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të të gjitha rekomandimeve të konstatuara të pa zbatuara dhe të

	zbatuara pjesërisht, si dhe të përshpejtojë realizimin e atyre në proces zbatimi, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike dhe pasurisë publike.

III.2.2 <u>Auditim mbi përputhshmërinë me aktet ligjor, nënligjore dhe rregullatore të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm të IIPP dhe Sektorëve përbërës të tij, për periudhën objekt auditimi.</u>

Me ligjin nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", i ndryshuar, është krijuar pranë Këshillit të Ministrave kjo strukturë shtetërore me qëllim marrjen e të gjitha masave për ndjekjen e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist. Kjo njësi sipas ligjit nr. 23/2014, datë 20.03.2014 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8246, datë 01.10.1997 për IIPP" është në varësi të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministri kjo e cila nuk ekziston më që prej ristrukturimit të kabinetit qeveritar në vitin 2017. Sa më sipër konstatohet se ende nuk janë bërë përditësimet përkatëse të ligjit nr.8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", i ndryshuar, për të qënë në koherencë me ndryshimet në strukturën e ministrive.

Bazuar në nenin 3 të ligjit nr.8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", të ndryshuar, struktura dhe organika e IIP-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ndërsa rregullorja e funksionimit të institutit miratohet nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Instituti Integrimit të ish të Përndjekurve Politik funksionin sipas strukturës së miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 104, datë 27.06.2022 për 'Disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 244, datë 06.10.2014, të Kryeministrit, për miratimin e strukturës dhe organikës së IIPP', e cila ka pësuar ndryshime edhe në vitin 2018 me urdhrin nr.162, datë 01.11.2018.

Nga auditimi është konstatuar se IIPP zhvillon veprimtarinë ende bazuar në VKM nr. 601, datë 04.12.2002 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të IIP", pra nuk është miratuar një rregullore e re funksionimi të institucionit edhe pse ligji ka ndryshuar 2 herë, sikurse edhe varësia e institucionit, struktura dhe pozicionet e punë, si dhe veprimtaria e volumi i përditshëm i punës së tij.

Sa më sipër është konstatuar se IIPP ka përcjellë pranë ish Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me shkresën nr.5, datë 07.01.2015 dhe pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresat nr. 282, datë 19.06.2020 dhe nr. 361, datë 12.09.2022 draft rregulloren e re, mbetur ende pa një trajtim nga MSHMS.

Nga auditimi i draft rregullores së propozuar është konstatuar se nuk ka një grup pune të ngritur për hartimin dhe draftimin e saj dhe propozimi është bërë nga përgjegjësi i sektorit të ligjshmërisë dhe statusit, duke rezultuar në një draft rregullore të propozuar jo të plotë dhe me mangësi për secilin pozicion dhe sektor.

IIPP funksionon sipas strukturës së miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 244, datë 06.10.2014, i ndryshuar me Urdhërin nr. 162, datë 01.11.2018 dhe urdhërin nr. 104, datë 27.06.2022, sipas të cilit instituti ka gjithsej një staf prej 24 punonjësish dhe përbëhet nga 4 sektor, të cilët janë: -Sektori i ligjshmërisë dhe statusit; -Sektori i çështjeve sociale dhe koordinimit të projekteve; -Sektori i gjetjes së të zhdukurve nga krimet e komunizmit; -Sektori i financës dhe shërbimeve.

Burimet e financimit të veprimtarisë së IIPP janë përcaktuar në ligjin nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish të dënuarit e të përndjekurit politikë", që janë: -shuma që caktohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin e shtetit; - shuma prej 1% mbi fondin e pagave, që do të derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore; -vlefta e një pjese të ndihmave humanitare për popullin shqiptar, që do të përcaktohen për çdo rast nga Këshilli i Ministrave; -vlefta e ndihmave

humanitare që japin institucionet bamirëse dhe personat fizikë e juridikë, shqiptarë ose të huaj, të caktuar për ish të dënuarit e të përndjekurit politikë.
Në VKM nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 1.9.1992 për ish të dënuarit dhe ish të përndjekurit politik", është përcaktuar se për plotësimin e kërkesave me karakter emergjent të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politik, fondi i veçantë monetar, i krijuar sipas ligjit, të administrohet nga Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë, sipas kritereve:
a) 50 për qind e këtij fondi për të ndihmuar, ekonomikisht e materialisht, familjet e përndjekura, për nevoja urgjente, për integrimin e tyre shoqëror;
b) 50 për qind për të financuar shoqatat e ish–të përndjekurve politikë. Financimi i shoqatave të veçanta do të bëhet në përpjestim me numrin e anëtarëve të tyre.
Në zbatim të këtij akti është hartuar dhe miratuar rregullorja nr.356, datë 12.07.2018 "Për funksionim e komisionit të trajtimit të ndihmave" bazuar në të cilën zhvillon veprimtarinë komisioni për shpërndarjen dhe monitorimin e fondit 1%, i ngritur çdo vit me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

<u>Veprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm të IIPP 2018-2022</u>

Grupi i auditimit ka kërkuar t'i vendosen në dispozicion planet vjetore të punës të miratuara si dhe raportet vjetore të veprimtarisë të miratuara nga titullari dhe janë vendosur në dispozicion format plane pune dhe raportesh të pa miratuar nga titullari, të pa sigluar dhe të pa protokolluar, përmbajtja e të cilëve konsiston më tepër në një përshkrim të misionit dhe objektivave të përgjithshme të institucionit, dhe jo në veprimtari konkrete, të matshme dhe identifikueshme sipas produkteve.
Sa më sipër është konstatuar se nuk janë miratuar nga titullari planet vjetore të punës së institucionit, si dhe raportet vjetore të veprimtarisë së institucionit në kundërshtim me pikën 'II.11' të rregullores nr. 601, datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP" e cila përcakton se 'DP përcakton objektivat dhe përparësitë, harton planet e punës tremujor apo një vjeçare' dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 8, germa 'a' në të cilën përcaktohet se "*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a. miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan veprimeve për arritjen e objektivave*" dhe nenin 9, i cili përcakton se "*4.Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a.propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi; b.hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësisë publike*".
Nga auditimi është konstatuar se nuk janë miratuar të plota gjurmët e auditimit lidhur me procedurën e aplikimit, miratimit dhe monitorimit të fondit të ndihmës ekonomike për individët dhe financimit të shoqatave në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 16, pika 2, e cila përcakton se *"Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit",* ku sikurse përcakton neni 4, pika 19 *"Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në*

përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve."

Nga auditmi është konstatuar se nuk janë përcaktuar në aktet e brendshme veprimtaritë e kontrollit sikurse përcakton ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 22, pika 1 dhe 3 "*Titullarët e njësive publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: procedurat për raportimin, mbikëqyrjen, vlerësimin e efiçencës dhe të efektivitetit të veprimtarive; procedurat e monitorimit."*

Nga auditmi është konstatuar se mungon një sistem informacioni dhe komunikimi që të sigurojë dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve nëpërmjet dokumentimit dhe qarkullimit të dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve sikurse përcaktohet në nenin 23, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Bazuar në përcaktimet e rregullores nr. 601, datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP" nga auditimi u konstatua se është lidhur në datë 15.01.2020 "Marrëveshja e Bashkëpunimit nr.12" me Autoritetin për Informimin mbi ish dokumentet e ish sigurimit të shtetit.

Gjatë auditimit grupi i auditimit ka kërkuar dhe i janë vendosur në dispozicion urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm për periudhën objekt auditimi në total 748, të cilat janë përmbledhur më poshtë.

Gjatë vitit 2018 janë nxjerrë 140 urdhëra të brendshëm nga titullari, ku 8 janë për krijim komisionesh, 1 është për likuidim faturash, 36 janë për mbledhje dhe zbatim vendimesh të komisionit, 23 janë për burimet njerëzore, 12 janë për likuidime gjyqësore, 4 janë për prokurime, 40 janë për likuidime shoqatash dhe 16 për likuidime rikonstruksionesh.

Gjatë vitit 2019 janë nxjerrë 222 urdhëra të brendshëm nga titullari, ku 22 janë për krijim komisionesh, 3 për janë për likuidim faturash, 30 janë për mbledhje dhe zbatim vendimesh të komisionit, 22 janë për burimet njerëzore, 6 janë për likuidime gjyqësore, 7 janë për prokurime, 85 janë për likuidime shoqatash dhe 47 për likuidime rikonstruksionesh.

Gjatë vitit 2020 janë nxjerrë 165 urdhëra të brendshëm nga titullari, ku 5 janë për krijim komisionesh, 12 për janë për likuidim faturash, 28 janë për mbledhje dhe zbatim vendimesh të komisionit, 13 janë për burimet njerëzore, 4 janë për likuidime gjyqësore, 11 janë për prokurime, 35 janë për likuidime shoqatash dhe 57 për likuidime rikonstruksionesh.

Gjatë vitit 2021 janë nxjerrë 179 urdhëra të brendshëm nga titullari, ku 16 janë për krijim komisionesh, 12 për janë për likujdim faturash, 32 janë për mbledhje dhe zbatim vendimesh të komisionit, 14 janë për burimet njerëzore, 3 janë për likuidime gjyqësore, 8 janë për prokurime, 43 janë për likuidime shoqatash dhe 51 për likuidime rikonstruksionesh.

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2022 janë nxjerrë 42 urdhëra të brendshëm nga titullari, ku 3 janë për krijim komisionesh, 15 për janë për likujdim faturash, 5 janë për mbledhje dhe zbatim vendimesh të komisionit, 10 janë për burimet njerëzore, 1 është për likuidime gjyqësore, 7 janë për prokurime dhe 1 për likuidime shoqatash.

Nga auditimi i urdhërave të Drejtorit të Përgjithshëm është konstatuar si më poshtë.

- Në të gjithë urdhërat e titullarit lidhur me ekzekutimin e vendimeve të komisionit të shpërndarjes së fondit për fondet që i janë akorduar shoqatave, si dhe ato të rikonstruksioneve të banesave, nuk citohet vendimi i komisionit mbi të cilin shpërndahet vlera apo kësti specifik i një projekti, duke krijuar kështu paqartësi në ndjekjen e vendimmarrjes pasi një shoqatë apo individ gjendet në disa vendim-marrje të komisionit gjatë vitit.

- Në urdhërat për ngritjen e komisioneve përbërja e komisionit të monitorimit është e ngjashme me atë të komisionit të shpërndarjes së ndihmave dhe konkretisht dy nga tre anëtarët e tij janë të njëjtët persona vendimmarrës për shpërndarjen e ndihmës, duke e ekspozuar vendimmarrjen e këtyre punonjësve ndaj riskut të konfliktit në vendimmarrje për përfshirje të dyfishtë.
- Nuk ka një urdhër për miratimin e kërkesave dhe deklaratës tip të hartuara nga sektorët përkatës dhe të përdorura nga strukturat, si për ndihmën ekonomike edhe për gjetjen e eshtrave, për sa kohë këto dokumente janë hartuar nga sektorët përkatës për t'i ardhur në ndihmë procesit të punës dhe përdoren nga to. Në kuadër të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 8, pika '8.ë' dhe neni 9, pika '4.a', titullari institucionit nuk ka arsye për të mos i standardizuar dhe bërë pjesë të akteve rregullative të veprimtarisë së institucionit këto dokumente.
- Edhe pse me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 05.01.2022 janë miratuar modelet standarde të dokumenteve administrative, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", ky urdhër nuk është zbatuar gjatë vitit 2022 dhe urdhërat e DP rezultojnë të jenë hartuar në formate të ndryshme pa përmbajtur të gjithë elementët e domosdoshëm identifikues si numër urdhëri, struktura hartuese etj.

Veprimtaria e Sektorit të Ligjshmërisë dhe Statusit

Bazuar në përcaktimet e rregullores nr. 601, datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP" nga auditimi u konstatua se Sektori i Ligjshmërisë dhe Statusit ka hartuar, përditësuar dhe krijuar një sistem të dhënash statistikore mbi numrin e përgjithshëm të ish të përndjekurve politik sipas grupeve të përndjekjes të sistemuara në dosje.

Gjithashtu ka mbajtur korrespoondencë të rregullt me institucionet e tjera shtetërore dhe publikun, duke hartuar shkresa për dhënie informacioni ose pajisje me status, shkresa drejtuar gjykatave, prokurorive apo institucioneve të vuajtjes së dënimit, shkresa me kthim përgjigje për ish të përndjekurit dhe trashëgimtarët mbi problematika të ndryshme, shkresa për MFE dhe MD lidhur me dëmshpërblimet sipas kërkesave të ish të përndjekurve etj., si dhe janë pritur në institut dhe sqaruar qytetarët sipas kërkesave specifike, hapur dosjet e në arkivë etj.

Sektori i Ligjshmërisë dhe Statusit ka raportuar në mënyrë periodike mujore veprimtarinë e tij pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

Nga auditimi është konstatuar se mungon një propozim nga sektori pranë strukturave kompetente për përditësimet ligjore të domosdoshme konstatuar më sipër për ligjin nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", lidhur me varësinë e IIPP nga MSHMS.

Veprimtaria e Sektorit të Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit me Shoqatat Bazuar në përcaktimet e rregullores nr. 601, datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP" nga auditimi u konstatua se Sektorit i Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit në periudhën objekt auditimi ka organizuar aktivitete të ndryshme për rehabilitimin dhe lartësimin e vlerave morale dhe shoqërore të ish të përndjekurve politik.

Ky sektor ka mbështetur në mënyrë të përhershme veprimtarinë e komisionit për shpërndarjen dhe monitorimin e fondit 1%, si dhe pajisur me dokumentacionet e nevojshme.

Ka hartuar një format tip "Kërkesë për ndihmë ekonomike", i cili ka ndihmuar në standardizimin e punës së sektorit, por me disa mangësi në përmbajtje si arsyeja specifike e kërkesës dhe vlera e ndihmës së kërkuar.

Nga auditimi është konstatuar se nuk është bërë një studim i nevojave imediate dhe të perspektivës, si dhe një raport për gjendjen e të përndjekurve politik sikurse përcaktohet në rregulloren nr.601 datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP", Kreu V, pika III.1 dhe 2.

Veprimtaria e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Financës

Bazuar në përcaktimet e rregullores nr. 601, datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP" nga auditimi u konstatua se Sektorit i Burimeve Njerëzore dhe Financës ka hartuar të gjitha kërkesat buxhetore brenda afateve dhe tavaneve të miratuara, si dhe ka ndjekur ecurinë e buxhetit që nga faza e hartimit të PBA deri në mbylljen e pasqyrave financiare vjetore të institucionit.

Ky sektor ka ndjekur veprimtarinë financiare të IIPP që nga miratimi i buxhetit, detajimi në fillim të vitit, hartimi i regjistrave të parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimeve, ka rakorduar me degën e thesarit për të ardhurat jashtë limitit dhe shpenzimet dhe ka ndjekur të gjitha procedurat e emërimeve dhe largimeve nga puna dhe lëvizjet paralele në bashkëpunim me DAP-in.

Është raportuar periodikisht çdo muaj në MSHMS për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe janë hartuar dhe dërguar brenda afatit pasqyrat financiare të miratuara.

Pjesë e kësaj strukturë është edhe protokoll arkiva, nga auditimi i dokumentacionit të së cilës u konstatua se kërkesat për ndihmë ekonomike nuk janë protokolluar në libër. Për pasojë mungon siguria e arsyeshme në identifikimin e numrit të saktë të kërkesave për ndihmë ekonomike, po ashtu edhe kërkesat për mbledhjen e informacionin për personat e zhdukur, dhe grupi i auditimit nuk mund të shprehet për numrin e tyre në total apo sa prej tyre janë financuar nga IIPP, pasi ato gjenden vetëm në dosjet e aplikimit të pa protokolluara nga instituti.

Veprimtaria e Sektorit të së Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit

Sektorit i të Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit është një strukturë e ngritur në vitin 2014 dhe për pasojë veprimtaria e tij nuk gjen formulim në rregulloren funksionale në fuqi nr. 601, datë 04.12.2002.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se ky sektor ka ndjekur, monitoruar dhe verifikuar procesin e kërkimit dhe zhvarrosjes së viktimave të ish të përndjekurve politikë duke bashkëpunuar me institucionet e tjera përgjegjëse.

Gjithashtu, ka mbledhur dëshmi reale nga të mbijetuarit e diktaturës komuniste për ekzekutimet me ose pa gjyq, të vdekur në burgjet e diktaturës, të vrarë në hetuesi ose spitale psikiatrike, të groposur në varre kolektive si dhe të vrarë në kufi në tentativë arratisjeje gjatë periudhës 29.11.1944 – 01.10.1991, si dhe akumuluar dokumente arkivore, audiovizive dhe materiale të të mbijetuarve nga diktatura.

Sektorit i të Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit ka krijuar dhe përditësuar një databazë me persona të zhdukur bazuar në kërkesat e paraqitura në institucion mbi të zhdukurit, të ekzekutuarit dhe të vdekurit në burgjet e komunizmit, kampet e internimit dhe qendrat e tortures, duke bashkëpunuar për këtë qëllim edhe me institucionet qëndrore dhe lokale, si dhe ka bashkëpunuar me institucionet që kanë arkiva për gjetjen e të zhdukurve dhe me institucione të huaja të specializuara në funksion të marrjes së ndihmës tekniko ligjore për procesin e zhvarrimit dhe identifikimit të kufomave.

Gjithashtu ka krijuar edhe një databazë prej 107 rekordesh me vend-varrime të mundshme të pa verifikuara ende, të raportuara nga familjarët për personat të cilët rezultojnë të zhdukur gjatë periudhës 1944 -1991.

Ka qënë pjesë e grupeve të punës mbi përgatitjen e raportit për zhdukjet me forcë për të pasqyruar të dhënat në Ministrinë e Jashtme.

Ka hartuar një format tip "Kërkesë" për mbledhjen e të dhënave për personat e zhdukur dhe një format tip "Deklaratë" për përdorimin e të dhënave të paraqitura për palët e treta që ndihmojnë procesin e gjetjes së të zhdukurve.

Veprimtaria e Komisionit për shpërndarjen dhe monitorimin e fondit 1%

Bazuar në "Rregulloren e funksionimit të komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" nr. 356, datë 12.04.2018 ka ushtruar veprimtarinë "Komisioni për shpërndarjen e fondit 1%" me 5 (pesë) anëtarë, i ngritur me urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm, konkretisht urdhëri nr.2, datë 03.01.2018, urdhëri nr.2, datë 03.01.2019, urdhëri nr.2, datë 06.01.2020, urdhëri nr.3, datë 06.01.2021, urdhëri nr.1, datë 05.01.2022 dhe urdhëri nr.166, datë 09.05.2022.

Gjithashtu, bazuar në "Rregulloren e funksionimit të komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" nr.356, datë 12.04.2018, Drejtori i Përgjithshëm ka ngritur Komisionin e Monitorimit me tre anëtarë në përbërje me urdhërat nr. 44/1, datë 18.01.2018 , nr. 54, datë 01.02.2019, nr. 13, datë 15.01.2020, nr. 2, datë 05.01.2021 dhe nr. 167, datë 09.05.2022.

Nga auditmi u konstatua se ngritja, përbërja dhe mënyra e funksionimit të këtyre dy komisioneve nuk është përfshirë në "Rregulloren e funksionimit të komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" nr. 356, datë 12.04.2018.

Nga auditimi u konstatua së në këtë rregullore nuk është përcaktuar:

- procedura administrative që duhet të ndjek komisioni në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për ndihma;
- procedura administrative që rregullon veprimtarinë e komisionit të monitorimit si dhe dokumentacioni justifikues i domosdoshëm mbi të cilën do bazohet monitorimi;
- dokumentacioni i listuar për përfitim ndihme është minimalisht dhe i pamjaftueshëm për një vlerësim të saktë dhe të drejtë të komisionit.

Gjatë periudhës 2018 deri në qershor 2022 komisioni i shpërndarjes së ndihmave ekonomike ka marrë në total 67 vendime detajuar sipas tabelës më poshtë me vlerat përkatëse.

Tabela nr. 2: Vendimet e komisionit të shpërndarjes së ndihmës ekonomike 2018-2022

Periudha	Numri Vendimeve	Vlera në lekë			
		Individë	Shoqata	Rikonstruksione/ Sponsorizime	Total
2018	19	6,040,000	15,060,000	12,282,500	33,382,500
2019	15	7,480,000	36,540,000	32,107,900	76,127,900
2020	14	4,800,000	34,130,000	38,604,500	77,534,500
2021	16	4,345,000	37,330,000	34,490,000	76,165,000
31.06.2022	3	1,174,000	270,000	584,000	2,028,000
Totali	**67**	**24,100,000**	**123,330,000**	**118,068,900**	**265,237,900**

Burimi: Të dhëna të IIPP të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Vlera e ndihmës ekonomike që komisioni ka shpërndarë në vite ka variuar nga vlera 5,000 lekë në 100,000 lekë sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3: Ndihmat e individëve grupuar sipas vlerave të shpërndara

2018		2019		2020		2021		2022	
Vlera	Përfitues	Vlera	Përfitues	Vlera	Përfitues	Vlera	Përfitues	Vlera	Përfitues
100,000	1	60,000	1	50,000	1	100,000	1	40,000	8
50,000	4	50,000	14	40,000	23	50,000	5	30,000	13
40,000	5	40,000	34	30,000	22	40,000	10	10,000	49
30,000	49	35,000	2	20,000	16	30,000	25	5,000	47
25,000	5	30,000	47	10,000	63	20,000	13	-	-
20,000	28	25,000	6	5,000	442	15,000	1	-	-

15,000	2	20,000	42	-	-	10,000	149	-	-
10,000	132	10,000	173	-	-	5,000	216	-	-
5,000	250	5,000	213	-	-	-	-	-	-
Total	**476**	**Total**	**532**	**Total**	**567**	**Total**	**420**	**Total**	**117**

Burimi: *Të dhëna të IIPP të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH*

Sikurse evidentohet në mënyrë të detajuar edhe në tabelat e mësipërme, rezulton se miratimi i vlerës së ndihmës ekonomike për individët, vlerës së financimit të shoqatave, vlerës së rikonstruksioneve apo aktiviteteve të tjera në funksion të qëllimit të institutit përcaktohet nga vet komisioni pa u mbështetur në një manual, udhëzim, urdhër apo vendim në të cilin të përshkruhen format e mbështetjes financiare dhe vlerat sipas nevojës brenda një intervali të përcaktuar.

Subjekti i audituar, konkretisht, z. B.K., zj. D.Ll., zj. E.M., zj. R.B., zj. E.C., z. N.K., z. A.H., z. B.S., zj. V.E., z. E.A., zj. M.M. kanë paraqitur observacionet për Projekt Raportin me nr. 471/2 prot., datë 21.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 811/10, datë 22.12.2022.

Pretendimi i subjektit:

Për ndryshimet dhe përditësimet përkatëse të ligjit nr. 8246 datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të Ish të përndjekurve Politike", bëjmë me dije se fusha e veprimtarisë së institucionit tonë përcaktohet qartë ne programin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Social me Vendim Nr. 508, Datë 13.9.2017 "Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale".

IIPP-ja sqaron se, institucioni përgjegjës për të ndërmarrë ndryshimet e kërkuara ligjore është MSHMS. Theksojmë se kemi bërë përpjekje të vazhdueshme dhe kemi përpiluar kërkesa zyrtare me shkresat nr. 5 prot date 07.01.2015 dhe nr. 282 prot date 19.06.2020 gjithashtu nr.361 prot date 12.09.2022, për miratimin e rregullores së re.

Në zbatim të ligjit nr. 8246, datë 1.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve Politikë" dhe VKM-së nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, date 1.9.1992 "për ish të dënuarit dhe ish të përndjekurit politikë", IIPP-ja ka hartuar një rregullore të brendshme, nr. 356 prot. Datë 12.04.2018 "Rregullore e funksionimit të Komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomikë: ne te cilen, specifikohen qartë :

Përbërja dhe detyrat e komisionit, kriteret e përgjithshme te përdorimit të këtij fondi si dhe dokumentacioni i cili do të plotësohen për përfitimin e këtij fondi.

Gjithashtu komisioni i monitorimit ka ndjekur në terren të gjitha aktivitetet e zhvilluara në bashkëpunim me shoqatat përfaqësuese të kësaj shtrese ne proces-verbale përkatëse dhe kontroll fizik të te gjithë dokumentacionit paraqitur nga shoqatat për aktivitete përkatëse.

Referuar formatit te kërkesave tip sqarojmë se: Në procedurën e ndjekur nga institucioni ynë për dhënien e ndihmave ekonomike, është përdorur vijimësisht ky format orientues, për t'i ardhur në ndihmë vendimmarrjes së komisionit për administrim mbi specifikimin e dokumenteve bashkëlidhur kësaj kërkese, ndaj nuk është vlerësuar e nevojshme për miratim zyrtar nga titullari, por vetëm si dokumentacion orientues, jo detyrues apo përjashtues.

Në fillim të cdo viti të ri kalendarik, çdo sektor paraqet pranë titullarit planet vjetore dhe raportet vjetore të veprimtarisë të cilat janë zbatuar nga sektorët, bazuar në hapësirat ligjore dhe detyrat e përcaktuara nga përshkrimi i punës dhe nevojshmërive të paraqitura në vite të ndryshme. Ka vijuar puna me efektivitet si dhe janë bërë vlerësimet e punonjësve sipas VKM nr 109 datë 26.02.2014 (i ndryshuar) mbi çdo objektiv të përcaktuar në keto plane pune vjetore.

Në kuadër të adresimit të zgjidhjes së këtyre problematikave IIPP ka në databazën e tij të gjithë punën e kryer, gjithashtu ka krijuar një kalendar mbi ngjarje të rëndësishme përkujtimore për figurat dhe momentet më të rëndësishme kundër regjimit komunist i cili është i publikuar edhe në ëeb-site tonë tek programi i transparencës. IIPP-ja në bashkëpunim me kërkesat e shoqatave ka depozituara kërkesa, në institucionin tonë përgjegjës MSHMS, Presidentit të Republikës të Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë gjithashtu dhe në Kryeministri. Kemi kërkuar që personave me status të ish të dëuarve politikë t'u

*sigurohet **abone udhëtimi falas** në shërbimin e transportit urban, tu sigurohen **trajtime shëndetësore falas.** Në fushën e punësimit ka ndërrmarrë një sërë masash dhe ka propozuar disa ndryshime ligjore ndër vite, për të garantuar të drejtat që gezojnë ish të përndjekurit politike.*
IIPP ka qënë përkrah të përndjekurve politikë për çdo nevojshmëri të tyre sociale. Kemi ndërmjetësuar përfitimin e përjashtimit nga tarifa e shkollimit të studentëve me prindër të dënuar. Ndërmjetësuar me bashkitë për trajtimin me prioritet të ish të përndjekurve politikë në programet e bonusit social, kredive të buta duke lehtësuar rrugëtimin e tyre drejt strehimit. Kemi kërkuar trajtimin me prioritet për punësim çdo ish të përndjekur politikë.
Në procedurën e ndjekur nga institucioni ynë për dhënien e ndihmave ekonomike dhe gjetjen e eshtrave të zhdukurve nga krimet e komunizmit, është përdorur format – kërkesa tip e hartuar nga IIPP-ja. Të dyja këto tip kërkesash kanë një numër rendor dhe datën e marrjes në dorëzim nga specialisti i institucionit.
Duke qenë se procesi i gjetjes së eshtrave është dinamik dhe sensitiv. Kërkesat që paraqiten mund të jenë sipas 1) formatit orientues të përpiluar nga IIPP ose 2) të thjeshta me shkrim dore nga i interesuari. Si rrjedhojë nuk është parë e nevojshme të miratohet një format tip detyrues.
Përsa i përket sektorit social, në procedurën e ndjekur institucioni ynë ka përdorur vijimësisht këtë format orientues për ti ardhur në ndihmë vendimmarrjes së komisionit për administrim dhe specifikim të dokumenteve bashkëlidhur.
Në të dyja rastet e sipërpërmendura formularët e kërkesave nuk janë të detyrueshme, ndaj nuk është menduar e nevojshme për miratim zyrtar nga titullari kjo kërkesë, por vetëm si dokumentacion orientues, jo detyrues apo përjashtues.
Qëndrimi i Grupit të auditimit: Problematikat e trajtuar janë me përmbajtje pothuajse të njëjtë me atë të paraqitur në observacionin e mëparshëm, në të cilin nuk ka argumente shtesë dhe dokumentacione të pa disponuara më parë. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Gjetje 1:	Nuk janë bërë përditësimet në ligjin e IIPP lidhur me varësinë e institucionit, si dhe nuk është miratuar rregullorja e re funksionale pas ndryshimit të ligjit në 2014 dhe strukturës organizative.
Situata:	-Me ligjin nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve" u krijua pranë Këshillit të Ministrave struktura shtetërore me qëllim marrjen e të gjitha masave për ndjekjen e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, njësi e cila aktualisht sipas ligjit nr. 23/2014, datë 20.03.2014 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8246 datë 01.10.1997 për IIP" rezulton varësi të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministri kjo e cila nuk ekziston më që prej ristrukturimit të kabinetit qeveritar në vitin 2017. Sa më sipër është konstatuar se ende nuk janë bërë përditësimet përkatëse të ligjit nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", për të qënë në koherencë me varësinë aktuale të institucionit. -Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve" , të ndryshuar, struktura dhe organika e IIP-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ndërsa rregullorja e funksionimit të institutit miratohet nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Nga auditimi është konstatuar se IIPP zhvillon veprimtarinë ende bazuar në VKM nr. 601, datë 04.12.2002 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të IIP", pra ende sot nuk është miratuar një rregullore e re funksionimi të institucionit edhe pse ligji ka ndryshuar 2 herë,

	sikurse edhe varësia e institucionit, si dhe veprimtaria dhe volumi i përditshëm i punës së tij. IIPP ka përcjellë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresat nr. 361, datë 12.09.2022 dhe nr. 282, datë 19.06.2020, si dhe ish Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me shkresën nr. 5, datë 07.01.2015 draft rregulloren e re, mbetur ende pa një trajtim nga MSHMS. Nga auditimi i draft rregullores së propozuar është konstatuar se nuk ka një grup pune të ngritur për hartimin dhe draftimin e saj dhe propozimi është bërë nga përgjegjësi i sektorit të ligjshmërisë dhe statusit. Gjithashtu kjo draft rregullore e propozuar ka nevojë të plotësohet me objektiva dhe veprimtari konkrete dhe të matshme për të gjithë sektorët.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, nenet 8 dhe 9.
Impakti:	Detyra të pa përcaktuara qartësisht, mungesë efektiviteti, eficence dhe koherence nga ana e IIPP.
Shkaku:	MSHMB nuk ka miratuar draft rregulloren e përcjellë nga IIPP për miratim, por edhe vet përmbajtja e këtij drafti nuk është e plotë, gjithë përfshirëse dhe shteruese.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm të ngrejë grupin e punës për hartimin e një rregulloreje të re për funksionimin e institucionit me objektiva konkret e të matshëm sipas pozicioneve dhe ta përcjell në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për miratim, së bashku me propozimet për përditësimin e ligjit nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", lidhur me varësinë e institucionit.

Gjetje 2:	Nuk ka një procedurë të përcaktuar në akte administrative për ngritjen, përbërjen, funksionimin dhe vendimmarrjen e komisioneve të shpërndarjes së fondeve dhe monitorimit të tyre.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se ngritja, përbërja dhe mënyra e funksionimit të këtyre dy komisioneve është e pa përcaktuar në "Rregulloren e funksionimit të komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" nr. 356, datë 12.04.2018. Nga auditimi u konstatua së në këtë rregullore nuk është përcaktuar: -procedura administrative që duhet të ndjek komisioni në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për ndihma; -procedura administrative që rregullon veprimtarinë e komisionit të monitorimit si dhe dokumentacioni justifikues i domosdoshëm mbi të cilën do bazohet monitorimi; -dokumentacioni i listuar për përfitim ndihme është minimalisht dhe i pamjaftueshëm për një vlerësim të saktë dhe të drejtë të komisionit; -ngritja, përbërja dhe mënyra e funksionimit të dy komisioneve, duke shmangur konfliktin në vendimmarrje sipas pozicionit, lidhur me të cilin nga auditimi është konstatuar se në urdhërat për ngritjen e komisioneve përbërja e komisionit të monitorimit është e ngjashme me atë të komisionit të

	shpërndarjes së ndihmave dhe konkretisht dy nga tre anëtarët e tij janë të njëjtët persona vendimmarrës për shpërndarjen e ndihmës. -Gjithashtu miratimi i vlerës së ndihmës ekonomike për individët, vlerës së financimit të shoqatave, vlerës së rikonstruksioneve apo aktiviteteve të tjera në funksion të qëllimit të institutit përcaktohet nga vet komisioni pa u mbështetur në një manual, udhëzim, urdhër apo vendim në të cilin të përshkruhen format e mbështetjes financiare dhe vlerat sipas nevojës brenda një variance të përcaktuar, bazuar në studimin e Sektorit të Çështjeve Sociale mbi nevojat imediate dhe të perspektivës. -Nuk janë miratuar kërkesat tip të hartuara nga sektorët përkatës dhe të përdorura nga strukturat si për ndihmën ekonomike edhe për gjetjen e eshtrave.
Kriteri:	- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 16, 22 dhe 23; - Ligji nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politik', neni 5, pika 2. - Rregullorja nr. 601, datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP", kreu IV, pika 2 dhe 5.
Impakti:	Mungesë efektiviteti dhe monitorimi, gjurmë auditi dhe transparence, i cili mund te shkaktoje trajtim jo te barabartë te përfituesve.
Shkaku:	Nuk janë përcaktuar procedurat për shpërndarje ndihme, monitorimi, përbërje komisionesh, vlera financimesh dhe komunikimi me publikun, duke mos u vlerësuar në proporcion me rëndësinë kjo veprimtari financiare.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm të ngrejë grupin e punës për hartimin e një rregulloreje të re, në plotësim të rregullores nr. 356, datë 12.04.2018 "Për funksionimin e komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" në të cilën të përcaktohet qartësisht procedura administrative e shqyrtimit, miratimit dhe monitorimit të kërkesave për ndihma dhe financim që duhet të ndjekë komisioni i shpërndarjes dhe komisioni i monitorimit të fondit, dokumentacioni i domosdoshëm dhe ai i nevojshëm në këto procedura, përbërja e komisioneve, duke shmangur konfliktin në vendimmarrje sipas pozicionit, si dhe të miratojë format kërkesat tip për ndihmë ekonomike të hartuara nga sektorët përkatës.

Gjetje 3:	Në IIPP ka rezultuar se nuk janë miratuar planet vjetore të punës si dhe raportet e veprimtarisë së institucionit për 4 vite (2018-2022).
Situata:	Grupi i auditimit ka kërkuar t'i vendosen në dispozicion planet vjetore të punës të miratuara si dhe raportet vjetore të veprimtarisë të miratuara nga titullari dhe janë vendosur në dispozicion format plane pune dhe raportesh të pa miratuar nga titullari, të pa sigluar dhe të pa protokolluar, përmbajtja e të cilëve konsiston më tepër në një përshkrim të misionit dhe objektivave të përgjithshme të institucionit, dhe jo në veprimtari konkrete, të matshme dhe identifikueshme sipas produkteve. Sa më sipër është konstatuar se nuk janë miratuar nga titullari planet vjetore të punës si dhe raportet vjetore të veprimtarisë në kundërshtim me ligjin nr.

	10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 8, pika 'a' në të cilën përcaktohet se: "*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a. miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan veprimeve për arritjen e objektivave*" dhe nenin 9, i cili përcakton se "*4.Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a.propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi; b.hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësisë publike*".
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, nenet 8 dhe 9.
Impakti:	Mungon dokumentimi zyrtar i planeve të punës dhe raporteve të zbatimit të tyre, gjurma e auditimit, performancë jo e plotë e punonjësve.
Shkaku:	Mos miratim i planeve dhe raporteve të punës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm të kërkoje nga sektorët hartimin e planeve të punës dhe ti miratojë në vijim, të cilët duhet të përmbajnë objektiva dhe veprimtari konkrete dhe të matshme për secilin pozicion pune, si dhe raportet e veprimtarisë vjetore në zbatim të tyre.

Gjetje 4:	Urdhërat e DP rezultojnë të jenë hartuar në formate të ndryshme pa përmbajtur të gjithë elementët e domosdoshëm identifikues, si dhe bazën ligjore të plotë e shteruese dhe aktet në zbatim të të cilëve hartohen urdhërat.
Situata:	Grupi i auditimit ka kërkuar t'i vendosen në dispozicion urdhërat e titullarit, nga auditimi i të cilave u konstatua se: -Në të gjithë urdhërat e titullarit lidhur me ekzekutimin e vendimeve të komisionit të shpërndarjes së fondit për fondet që i janë akorduar shoqatave si dhe ato të rikonstruksioneve të banesave, nuk citohet vendimi i komisionit mbi të cilin shpërndahet vlera apo kësti specifik i një projekti, duke krijuar kështu paqartësi në ndjekjen e vendimmarrjes pasi një shoqatë apo individ gjendet në disa vendimmarrje të komisionit gjatë vitit. -Edhe pse me Urdhërin nr. 3, datë 05.01.2022 janë miratuar modelet standarde të dokumenteve administrative në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", ky urdhër nuk është zbatuar gjatë vitit dhe urdhërat e DP rezultojnë të jenë hartuar në formate të ndryshme pa përmbajtur të gjithë elementët e domosdoshëm identifikues.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, nenet 8 dhe 9.
Impakti:	Nuk jepet siguri për plotësinë e evidencës si dhe mungon gjurma auditimit.
Shkaku:	Urdhrat nuk përmbajnë të gjithë elementët e domosdoshëm evidentues dhe përshkrues.

Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm të analizojë situatën në hartimin e dokumenteve administrative dhe së bashku me gjithë strukturat të marrin masa për hartimin dhe përpilimin e urdhrave me përmbajtje të të gjithë elementëve identifikues dhe bazës ligjore të akteve mbështetës të urdhrit të plotë.

Gjetje 5:	Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit me Shoqatat u konstatua se nuk është bërë një studim i nevojave imediate dhe të perspektivës, si dhe një raport për gjendjen e të përndjekurve politik sikurse përcaktohet në rregullore.
Situata:	Bazuar në përcaktimet e rregullores nr. 601, datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP" nga auditimi u konstatua se Sektorit i Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit në periudhën objekt auditimi ka organizuar aktivitete të ndryshme për rehabilitimin dhe lartësimin e vlerave morale dhe shoqërore të ish të përndjekurve politik. Nga auditimi është konstatuar se nuk është bërë një studim i nevojave imediate dhe të perspektivës, si dhe një raport për gjendjen e të përndjekurve politik sikurse përcaktohet në rregullore. Ky sektor në ka mbështetur në mënyrë të përhershme veprimtarinë e komisionit për shpërndarjen dhe monitorimin e fondit 1%, si dhe pajisur me dokumentacionet e nevojshme.
Kriteri:	Rregullorja nr. 601, datë 04.12.2002 për "Funksionimin e IIPP".
Impakti:	Mungesë eficence, efektiviteti dhe transparence.
Shkaku:	Mos zbatim i plotë i detyrave funksionale.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit me Shoqatat të marrë masa për studimin e nevojave imediate dhe të perspektivës, identifikimin e tyre sipas kategorive dhe nën kategorive, trendit ndër vite dhe atij aktual, të dokumentojë këtë veprimtari nëpërmjet hartimit të raportit përcaktuar në rregullore, t'ia përcjell për miratim Drejtorit të Përgjithshëm dhe ta publikojë në ẃebsite-n zyrtar për publikun.

Gjetje 6:	Kërkesat e dorëzuara sipas formateve tip për ndihmë ekonomike dhe për informacion mbi familjarët nuk janë protokolluar dhe regjistruar nga zyra e protokoll-arkivës, duke cënuar plotësinë e evidencës dhe gjurmën e auditimit.
Situata:	Nga auditmi i dokumentacionit në dosjet e ndihmave ekonomike dhe sektorit të gjetjes së eshtrave u konstatua se kërkesat e dorëzuara sipas formateve tip për ndihmë ekonomike dhe për informacion mbi familjarët, bazuar në të cilat nisin procedurat respektive administrative në institucion, nuk janë protokolluar dhe regjistruar nga zyra e protokoll arkivës, duke cënuar plotësinë e evidencës dhe gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 10296,datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i cili përcakton se '2.*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë*

	formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.3.Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.' Për pasojë mungon siguria e arsyeshme në identifikimin e numrit të saktë të kërkesave për ndihmë ekonomike, po ashtu edhe kërkesat për mbledhjen e informacionit për personat e zhdukur, dhe grupi i auditimit nuk mund të shprehet për numrin e tyre në total apo sa prej tyre janë financuar nga IIPP, pasi ato gjenden vetëm në dosjet e aplikimit të pa protokolluara nga instituti.
Kriteri:	-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, nenet 8, 9 dhe 16; -Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat".
Impakti:	Nuk jepet siguri për plotësinë e evidencës si dhe mungon gjurma auditimit.
Shkaku:	Nuk evidentohen në regjistër me numër referencë të protokolluara kërkesa të cilat iniciojnë procedura administrative të institucionit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Financës dhe Zyra e protokoll-arkivës të marrin masa për regjistrimin dhe evidentimin në protokoll të të gjitha kërkesave për ndihmë ekonomike, informacionit për personat e zhdukur dhe çfarë do lloj kërkese tjetër, në bazë të së cilës institucioni nis një procedurë administrative në vijim.

III.2.3 Auditimi mbi përputhshmërinë me aktet ligjor, nënligjore dhe rregullatore të veprimtarisë së bordit drejtues të ISKK.

Instituti i Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit (në vijim ISKK) është institucion publik, qendror, i pavarur, me financim nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera. Organet drejtuese të institutit janë Bordi Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.

Për këto çështje të auditimit është vlerësuar përputhshmëria e veprimtarisë së ISKK në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, si më poshtë:

- Ligji nr. 10242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar;
- Ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to";
- VKM nr. 120/1997 "Për shpërblimin e autorëve të veprave shkollore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor";
- Vendimet për përcaktimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të ISKK;
- Vendimet e Bordit Drejtues të ISKK;
- Rregullorja e Brendshme për funksionimin e ISKK, Bordit Drejtues, Këshillit Shkencor të Institutit, si dhe të Botimeve;
- Kodi i Etikës së ISKK-së.

Përbërja e bordit drejtues

Bordi Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë, në përputhje me përcaktimet e nenit nr. 8 të Ligjit nr. nr. 10242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri", të cilët emërohen dhe lirohen nga Kuvendi. Për periudhën 2018-2022, emërimet e anëtarëve të Bordit Drejtues rezultojnë, si në vijim:

1. Z. G.P, me Vendimin nr. 24/2018 të Kuvendit, datë 26.02.2018;
2. Znj. E.Sh., me Vendimin nr. 25/2018 të Kuvendit, datë 26.02.2018;

3. Znj. J.G., me Vendimin nr. 26/2018 të Kuvendit, datë 26.02.2018;
4. Z. V.T., me Vendimin nr. 27/2018 të Kuvendit, datë 26.02.2018;
5. Znj. E.P., me Vendimin nr. 28/2018 të Kuvendit, datë 26.02.2018;
6. Z. K.T., me Vendimin nr. 29/2018 të Kuvendit, datë 26.02.2018;
7. Z. U.B., me Vendimin nr. 39/2018 të Kuvendit, datë 05.03.2018.

Në mbledhjen e datës 18.02.2019 të Bordit Drejtues, është prezantuar anëtari i ri, z. A.L., i përcaktuar me anë të Vendimit nr. 106/2018 të Kuvendit, datë 11.10.2018, për të zëvendësuar ish-anëtarin z. K.T..

Vendimmarrja e bordit drejtues

Referuar nenit 8 "Bordi i institutit" të Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri", Bordi i institutit është organi më i lartë drejtues. Neni 11 i këtij ligji përcakton detyrat kryesore të Bordit, ku ndër të tjera, specifikohen:

- Zgjedhja e drejtorit ekzekutiv;
- Miratimi i rregullores së funksionimit të institutit;
- Miratimi i planit vjetor të botimeve, publikimeve, dokumentarëve dhe veprimtarive të tjera përkujtimore;
- Miratimi i përbërjes së Këshillit Shkencor të Institutit, si organ këshillimor i bordit;
- Miratimi i raportit vjetor etj.

Rregullorja për funksionimin e Bordit Drejtues është miratuar me anë të Vendimin nr. 4/2021 të Bordit Drejtues, datë 04.09.2021. Para datës së miratimit që kësaj rregulloreje, Bordi Drejtues ka operuar pa një rregullore funksionimi.

Sa i përket proceseve vendimmarrëse dhe mbledhjeve të Bordit Drejtues dhe atyre të Këshillit Shkencor të Institutit, grupi i auditimit auditoi 100% të procedurave përgjatë periudhës së auditimit. Në tabelën e mëposhtme jepen të statistikat e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ISKK dhe të shqyrtuar nga grupi i auditimit, informacion i cili jepet më i hollësishëm në aneksin bashkëlidhur.

Tabela nr. 4: Përmbledhje e shifrave të aktivitetit të Bordit Drejtues dhe KSHI në ISKK

	2018	**2019**	**2020**	**2021**	**Deri më 30.06.2022**
Mbledhje të Bordit Drejtues	6	6	6	9	4
Vendime të Bordit Drejtues	7	5	6	8	2
Mbledhje të KSHI	2	2	7	4	4
Vendime/propozime të KSHI	2	1	-	-	-
Propozime nga Drejtori Ekzekutiv	-	-	-	6	5
Relacione nga Drejtori Ekzekutiv	-	-	-	7	5

Burimi: Dosjet e dorëzuara nga ISKK. Shqyrtuar nga KLSH

Lidhur me aktivitetin e Bordit Drejtues, KSHI dhe Drejtorit Ekzekutiv, rezulton se jo në të gjithë rastet mbledhjet e Bordit Drejtues apo KSHI kanë rezultuar në vendime. Për këto mbledhje janë mbajtur procesverbalet respektive, por jo në të gjitha rastet kanë rezultuar në një vendimmarrje.
Disa nga vendimmarrjet kryesore, si dhe parregullsitë e konstatuara, rezultuan, si më poshtë vijon:

<u>Mbi zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv</u>

- **Vendimi nr. 1/2018 –** zgjedhja e Drejtorit Ekzekutiv **z. A. T..**

Në mbledhjen e Bordit më datë 15.03.2018 është votuar për Kryetarin z. U.B. me 6 vota pro, nga 7 pjesëmarrës, ku 5 prej tyre kanë marrë pjesë fizikisht, 1 anëtar në lidhje Skype dhe 1 anëtar përmes lidhjes telefonike. Gjithashtu në të njëjtën mbledhje është zgjedhur nënkryetari i Bordit znj. J.G. me 4 vota pro, si dhe Drejtori Ekzekutiv i ISKK-së z. A.T. me 7 vota pro (kandidaturë e vetme).
Këto vendimmarrje të Bordit Drejtues janë zbardhur me Vendimin nr. 1/2018 "Për zgjedhjen e Kryetarit, Nënkryetarit dhe Drejtorit Ekzekutiv të ISKK-së".
Procesverbali i mbledhjes nuk paraqet përmbledhje të diskutimeve të kryera, si dhe formën e votimit të kryer, në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

- **Vendimi nr. 6/2019** – zgjedhja e Drejtorit Ekzekutiv **z. Ç.H.**

Bordi Drejtues është mbledhur në datën 03.12.2019, ku ka pranuar dorëheqjen e z. A.T., pas paraqitjes së letrës së dorëheqjes të datës 02.12.2019, si dhe ka diskutuar mbi komandimin e përkohshëm të zv. Drejtorit Ekzekutiv, z. Ç.H., deri në zgjedhjen e Drejtorit të ri.
Duke qenë se në rregulloren e brendshme të ISKK-së, nuk është e përcaktuar procedura për zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv, anëtari i Bordit Drejtues, z. V.T., ka propozuar përmes shkresës nr. 488 prot., datë 13.12.2019, miratimin e një dokumenti, i cili duhet të përfshijë kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të ISKK-së, duke përcjellë dhe një draft-dokument.
Bordi Drejtues ka dalë me njoftimin mbi kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv, edhe pse grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion një procesverbal për mbledhjen e datës 13 dhjetor 2019, në të cilën u miratuan këto kritere, procedura, si dhe vendimi për shpalljen e njoftimit.
Pas njoftimit të Bordit, 5 kandidatë kanë dorëzuar dosjet e tyre pranë ISKK-së, të cilat përmbajnë:

1. Kërkesë për kandidim;
2. Vizioni për drejtimin e ISKK-së në 4 vitet e ardhshme;
3. CV e kandidatit;
4. Formularët për verifikim të figurës dhe për dekriminalizimin.

Pranë ISKK, janë administruar dosjet e aplikimeve të mëposhtme:

1. Shkresa nr. 311 Prot., datë 10.12.2019 nga kandidati E.K.;
2. Shkresa nr. 312 Prot., datë 10.12.2019 nga kandidati Ç.H.;
3. Shkresa nr. 316 Prot., datë 13.12.2019 nga kandidati L.N.;
4. Shkresa nr. 318 Prot., datë 17.12.2019 nga kandidati R.P.;
5. Shkresa pa numër, nga kandidati M.H..

Në datën 23.12.2019, Bordi Drejtues është mbledhur për të zgjedhur Drejtorin Ekzekutiv të ISKK ku ka patur 5 kandidatura. Sipas procesverbalit të zbardhur të kësaj mbledhje, pas dëgjesave të platformës dhe prezantimit të secilit prej kandidatëve, Bordi Drejtues ka ngritur Komisionin e administrimit të procesit të votimit me anëtarë znj. J.G.; znj. E.Sh. znj, J.I. (sekretare). Bordi ka vendosur për votim të fshehtë, si dhe ka miratuar formatin e fletës së votimit. Është votuar sipas rendit alfabetik. Komisioni verifikon vlefshmërinë e fletëve dhe numëron votat. Në fund, komisioni ka shpallur fitues z. Ç.H. me 4 vota pro, ndërsa z. E.K. ka marrë 3 vota pro.
Neni 13 i Ligjit nr. 8840, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shtetërore dhe enteve publike*" citon se vendimet merren me votim të hapur, përveç rasteve kur dispozitat ligjore parashikojnë ndryshe. Në rastin e votimit për Drejtorin Ekzekutiv, asnjë dispozitë ligjore nuk parashikon ndryshe, dhe përzgjedhja e votimit të fshehtë si formë e votimit konsiderohet e pabazuar në ligj.

Nga auditimi u konstatua se, referuar procesverbalit të mbledhjes, kanë qenë të pranishëm fizikisht vetëm 6 anëtarë të Bordit dhe njëri prej tyre në lidhje online, ndërkohë që në dosjen e administruar nga grupi i auditimit gjenden 7 vota fizike. Sipas e-mail të datës 20.10.2022 të anëtarit i cili nuk ka qenë i pranishëm fizikisht në votim, z. G.P. ka deklaruar se, në pamundësi për të qenë i pranishëm fizikisht për shkaqe shëndetësore, ka autorizuar znj. J.G. për të votuar në emër dhe llogari të tij në mbledhjen e datës 23.12.2019, duke përcaktuar edhe votën e tij. Gjithashtu, edhe nga takimet e zhvilluara pranë zyrave të ISKK-së ndërmjet grupit të auditimit dhe dy anëtarëve të Komisionit të Administrimit të procesit të votimi, znj. J.G. dhe znj. E.Sh., është konfirmuar delegimi i votës nga z. G.P. tek znj. J.G. Ky "delegim" nuk është zbardhur në procesverbalin e mbledhjes së votimit, si dhe nuk ka asnjë gjurmë të komunikimit të dy anëtarëve, ku të shprehet qartë vullneti i z. P., që gëzonte të drejtën e njërës prej shtatë votave të Bordit, në momentin e kryerjes së votimit.
Delegimi i votës së fshehtë është një veprim i pabazuar në asnjë akt ligjor ose nënligjor të Republikës së Shqipërisë, pasi znj. G., ka votuar 2 herë, 1 herë në emrin e saj dhe 1 herë në emrin e anëtarit z. P., veprim i cili është pranuar më tej edhe nga Komisioni i administrimit të procesit të votimit, në të cilin znj. G. bënte pjesë sërish.
Nga sa më sipër, konstatohet se procedura e votimit ka qenë komplekse me mundësi të parregullsive, për më tepër që, vota "e deleguar" nuk gjen mbështetje në ligj, si dhe diferenca mes kandidatëve ka qenë me vetëm 1 votë, potencialisht determinuese. Referuar pikës 2 të nenit 15 të Ligjit nr. 8840, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike*", në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, do të kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do të shtyhet për mbledhjen tjetër. Nqs në votimin e parë të mbledhjes tjetër do të kemi përsëri një barazi votash, atëherë do të kryhet votim i hapur.

Titulli i gjetjes:	**Parregullsi në procedurën e përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv**
Situata:	Nga auditimi ka rezultuar se nuk ka një procedurë të miratuar për përzgjedhjen e drejtorit ekzekutiv, ku të përfshihet detajimi i procedurës, si dhe kriteret që duhen plotësuar nga aplikantët. Në procedurën e parë të ndjekur, nuk rezulton të ketë patur shpallje, por është vijuar me shprehjen e anëtarëve *pro – kundra* për rizgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv, ndërkohë që në procedurën e dytë të ndjekur, është kryer votim për të gjithë aplikantët që kishin aplikuar. Referuar Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri", neni 11 përcakton se *"Bordi Drejtues zgjedh, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, drejtorin ekzekutiv të Institutit".* Ky nen nuk përcakton në mënyrë të qartë kriteret që duhet të plotësojë kandidati, si dhe procedurën e votimit deri në shpalljen e fituesit. Në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 "Aktivitetet e Kontrollit" përcakton se *"Procedurat për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike. ... Dokumentimi duhet të jetë i plotë, i saktë dhe në kohën e duhur."*
Kriteri:	- Ligji nr. 10242, datë 25.02.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri*", neni 11;

	- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Pika 3.3 "Aktivitetet e Kontrollit".
Ndikimi/Efekti:	Duke qenë se në Rregulloren e Brendshme të ISKK, Kreu III "Struktura organizative", apo në Rregulloren e Funksionimit të Bordit Drejtues nuk përcaktohet një procedurë të qartë të zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv nga ana e Bordit, procesi i zgjedhjes ka rezultuar kompleks dhe i diskutueshëm, duke bërë që të humbasë transparenca dhe potencialisht të konsiderohet si proces me mangësi.
Shkaku:	Në Rregulloren e Brendshme të ISKK dhe në Rregulloren e Funksionimit të Bordit Drejtues nuk ekziston një procedurë e detajuar emërimi dhe kritere të qarta për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Bordi Drejtues të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti të veçantë, duke përcaktuar procedurën e emërimit të Drejtorit Ekzekutiv, përcaktimin e kritereve që duhet të plotësojnë aplikantët, procedurën e votimit dhe deri në shpalljen e fituesit, për të garantuar një proces transparent, të barabartë dhe efektiv.

Parregullsi të tjera të konstatuara referuar vendimmarrjeve të Bordit Drejtues

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, nga grupi i auditimit janë vërejtur parregullsi të tjera lidhur me:

- Mungesën e firmave në procesverbalet e mbledhjeve të Bordit Drejtues në thuajse 98% të rasteve;
- Prezenca përmes platformës Skype e anëtarit të Bordit Drejtues, z. G.P., duke mos qenë i pranishëm fizikisht edhe në vendimmarrje të rëndësishme si: zgjedhja e Drejtorit Ekzekutiv të ISKK, votimi i anëtarëve të KSHI, miratimi i kolanës së botimeve për secilin prej viteve, etj, qysh në periudhën përpara vitit 2020, ku për arsye të pandemisë Covid-19, mbledhjet online nisën të bëheshin praktikë pune në shumë institucione.
- Shumica e dokumentacionit hyrës në ISKK nuk është i vulosur në protokoll, por i protokolluar thjesht me numër dhe datë hyrëse në kundërshtim me pikën 1.7 të Rregullores së Brendshme të ISKK-së, ku citohet se *"Të gjitha shkresat zyrtare, letrat e dërguar nga populli, informacionet dhe mesazhet e ndryshme që drejtohen dhe hyjnë në Institucion, pavarësisht nga mënyra e dërgimit të tyre, dorëzohen për regjistrim pranë Sekretarisë. Sekretarja/ri, pasi verifikon që dokumentacioni i depozituar është firmosur, vendos vulën e hyrjes ku pasqyrohet numri i protokollit dhe data."*

Mbi miratimin e anëtarëve të Këshillit Shkencor të Institutit

Referuar Nenit 14 të Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri", Këshilli Shkencor i Institutit (KSHI) është organ këshillimor i Bordit të Institutit dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, studiues të njohur nga bota akademike dhe shoqëria civile.

Në mbledhjen datës 08.05.2018, Bordi Drejtues ka miratuar anëtarët e Këshillit Shkencor të Institutit si në vijim, propozuar nga Kryetari i Bordit Drejtues:

1. Znj. V.K.;
2. Z. V.G.;
3. Znj. A.H.;

4. Z. A.B.;
5. Z. K.D.;
6. Z. I.I.;
7. Z. E.K..

Kandidatët e mësipërm janë votuar me shumicë absolute votash. Procesverbali i mbledhjes nuk paraqet formën e votimit të kryer, në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*".

Ndërkohë, kryetari i Këshillit Shkencor të Institutit, përzgjidhet me votat e anëtarëve të KSHI, sipas përcaktimeve të Nenit 3 të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e KSHI ku citohet "*KSHI drejtohet nga Kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e KSHI, mes kandidaturave të propozuara në mbledhjen konstituuese dhe konfirmohet nga bordi i ISKK. Kryetar zgjidhet ai anëtar që merr shumicën e votave të anëtarëve të KSHI. Kandidat për kryetar të KSHI, mund të jetë çdo anëtar i KSHI, që propozohet nga një anëtar tjetër*". Në mbledhjen e datës 29.06.2018, është zgjedhur kryetar i KSHI z. E.K. me të gjitha votat pro dhe konfirmohet nga Bordi Drejtues. Si në rastin e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv, edhe në rastin e zgjedhjes së Kryetarit të KSHI nuk ka një procedurë të mirë përcaktuar në Rregullore.

Gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se KSHI ka kryer procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së veprave për botim dhe artikujve të konferencave pa u mbështetur në një metodologji në kundërshtimi me nenin 5 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KSHI të vitit 2018 dhe nenin 6 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KSHI të vitit 2021.

Mbi botimet

Botimet përbëjnë një aspekt mjaft të rëndësishëm të aktivitetit të ISKK, në përmbushjen e misionit të tij, në zbatim të Ligjit nr. 10242, datë 25.2.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri*".

Me anë të Vendimit nr. 7/2018, me nr. 615/1 Prot., datë 08.05.2018 është miratuar Rregullorja e Botimit të ISKK, e cila është shfuqizuar pas miratimit të Rregullorjes së Veprimtarisë Botuese e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, miratuar me Vendimin e Bordit të ISKK nr. 7/2021, 07.09.2021.

Në këto rregullore specifikohet se ISKK mund të botojë libra në këto gjini:

- Studime shkencore që trajtojnë tema që lidhen me krimet e regjimit komunist në Shqipëri;
- Kujtimet e të dënuarve politikë;
- Krijimtari të pabotuar të autorëve të dënuar politikë nga regjimi komunist;
- Albume fotografike, antologji, tekste shkollore, etj.;
- Revistë periodike vjetore, me përmbledhje me referatet e konferencave shkencore të organizuara prej vetë institutit, recensione, artikuj studimore, ese dhe dokumente;
- Katalogë, fletëpalosje dhe materiale të tjera promovuese të aktivitetit të ISKK.

Referuar nenit 3 të Rregullores së Botimit (2021), veprat duhet t'i nënshtrohen një analize nga Këshilli Shkencor i ISKK, i cili duhet të garantojë kontributin e padyshimtë shkencor, dokumentues, dëshmues apo letrar dhe, më tej, këto vlerësime i kalojnë Bordit Drejtues për shqyrtim dhe vendim përfundimtar, për t'u botuar më tej nga ISKK, i cili ka entin e tij botues. Një nga kriteret e përcaktuar në këtë rregullore është që çdo vepër studimore duhet të ketë elementët e një botimi shkencor, në formë dhe përmbajtje. Referuar materialeve të vëna në dispozicion, KSHI nuk disponon një metodologji vlerësimi për veprat e dorëzuara.

Referuar nenit 4 të po kësaj rregulloreje, dorëshkrimet për botim dorëzohen fizikisht ose në rrugë elektronike, në përgjigje të thirrjeve për dorëshkrime për botime, të cilat botohen në kategorinë "njoftime" në faqen zyrtare elektronike të ISKK.
Përgjatë periudhës së auditimit, ISKK ka publikuar thirrjet për botim, të cilat kanë filluar të bëhen rregullisht që nga viti 2020, si më poshtë:

1. Njoftim për dorëshkrime për botim – ditare, shënime, dokumente autentike;
2. Thirrje për dorëshkrim për botim për vitin 2021;
3. Thirrje për dorëshkrim për botim për vitin 2022;
4. Thirrje për dorëshkrim për botim për vitin 2023.

Viti 2018

Përmes Vendimit nr. 8/2018 të Bordit Drejtues, "Për miratimin e listës së librave të kolanës që do të botohen me fondet e ISKK për vitin 2018", është miratuar lista me 11 libra për botim. Ndërkohë, me një Vendim pa numër të Bordit Drejtues, më datë 01.10.2018, është vendosur si jo e ngutshme botimi i dy veprave të cilat konsiderohen si artistike, duke qenë se ISKK, me Vendimin pa numër të Bordit Drejtues më datë 01.10.2018 "Për natyrën e botimeve", kanë pasur përparësi dëshmitë, memuaristika, albume, studime arkivore, dëshmuese, duke shtyrë botimet e librave të zhanrit "fiction".
Nga kryqëzimi i informacionit mes Vendimit të Bordit Drejtues për miratimin e kolanës së librave për vitin 2018 si dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës të autorëve të jashtëm, dhe Rregullores së Brendshme të ISKK e cila ka qenë në fuqi në vitin 2018, nuk ka një metodë të paracaktuar mbi përcaktimin e shpërblimit të autorëve. Vendimi për shpërblimin e autorëve merret nga Bordi Drejtues bazuar në buxhetin dhe metodologjinë që ata mendojnë se është e përshtatshme.

Tabela nr. 5: Veprat e miratuara nga Bordi Drejtues për shpërblim, viti 2018

Autori dhe vepra	***Shpërblimi honorifik (në lekë)***
Sh.A– Spaçi	100,000
L.T. - Grabiani midis K.ve	100,000
T.K. - Krimet e komunizmit: një histori e plotë për Mirditën 1944-1950	100,000
N.L. - Dom Shtjefën Kurti	100,000
F.S. - Saga e Dhimbjes	100,000
K.T. - Një jetë me brenga	-
R.K. - Mos harroni, jemi dhe ne	100,000
L.N. - Komiteti ushtarak i Delvinës	-
Zërat e Kujtesës V	-
K.D. - Histori të retushuara të komunizmit	100,000
A.L. - Krahë të këputur (II)	-
Total	**800,000**

Burimi: Të dhënat nga ISKK. Përpunuar nga KLSH

Viti 2019 dhe 2020

Për vitin 2019, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ka patur thirrje për botim, megjithatë janë dorëzuar dorëshkrime për botim nga autorë të ndryshëm. Bordi Drejtues përmes Vendimit nr. 4/2019 të datës 18.10.2019, ka miratuar kolanën e botimeve për vitin 2019, e cila përmban 15 vepra. Këshilli Shkencor i Institutit, përmes shkresës nr. 243/4 Prot., datë 23.10.2019, i ka propozuar Bordit Drejtues masën e shpërblimit të autorëve të jashtëm duke përdorur metodologjinë e vlerësimit më shumë të librave studimorë në varësi të hulumtimit dhe sasisë së përmbajtjes.

Në vitin 2019, procesi i botimit të veprave nuk është realizuar duke u shtyrë në vitin 2020. Lidhur me mënyrën e shpërblimit të autorëve të jashtëm, Drejtori Ekzekutiv i ISKK, z. Ç.H. ka propozuar në mbledhjen e datës 16.07.2020 të Bordit Drejtues një metodologji të shpërblimit të autorëve bazuar në Ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri*", Ligji nr. 35/2016 "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*", si dhe VKM nr. 120/1997 "*Për shpërblimin e autorëve të veprave shkollore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor*". Këto shpërblime paraqiten, si më poshtë:

Tabela nr. 6: Shpërblime për veprat

Nr. i faqeve	Botimet shkencore (lekë)	Prozë e lirë (lekë)	Albume (lekë)
Mbi 400	100,000	90,000	75,000
300-400	90,000	80,000	
200-300	80,000	70,000	
100-200	70,000	60,000	
deri në 100	60,000	50,000	

Burimi: Të dhënat nga ISKK. Përpunuar nga KLSH.

Gjithashtu, propozohet që, në skemën e honorareve të përfshihen autorët punonjës të ISKK kur vërtetojnë që është realizuar jashtë orarit të punës. Kjo metodologji nuk rezulton të jetë e miratuar nga Bordi Drejtues.

Në vitin 2020, Bordi Drejtues ka miratuar kolanën përfundimtare të botimit përmes Vendimit nr. 4 të Bordit Drejtues më datë 17.07.2020. Gjithashtu ky vendim ka ngarkuar Drejtorin Ekzekutiv në mbështetje të nenit 13, pika 4 të Rregullores për përcaktimin e ndarjes së honorarit/dëmshpërblimit të autorëve. Kjo listë përbëhet nga veprat e miratuara qysh në vitin 2019 dhe paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 7: Veprat e miratuara nga Bordi Drejtues për shpërblim, viti 2020

Autori dhe vepra	**Shpërblimi i propozuar nga KSHI në vitin 2019 (në lekë)**	**Shpërblimi honorifik i akorduar nga Bordi Drejtues në vitin 2020 (në lekë)**
R. K. - Mos harroni, jemi dhe ne, vëll. II	70,000	-
D. G.- Suzana Biçaku Maliqi, Gjineshtra në vullkanin e kuq	70,000	57,692
V. Z. - Panteoni i nëndheshëm	100,000	-
I. S. - Karuseli i totalitarizmit	70,000	57,692
V. B. - Ramize Gjebrea, një jetë për një tjetër kohë	100,000	57,692
Zërat e Kujtesës Vëll. VI	-	-
K. D. - Doracak termash të diktaturës komuniste	-	57,692
N. L. N. K., A. D. – I lumi Dom Shtjefën Kurti, Dëshmitar i Kishës Martire, vëll. II	100,000	57,692
K. T. - Unë dhe 8 të dënuarit e familjes sime	80,000	57,692
L. D. - Partia Komuniste Shqiptare gjatë Luftës së II Botërore	100,000	57,692
Xh. C. – Kryengritja e Zhapokikë – Luftinjës	70,000	57,692
S. R. - Në kërkim të ditëve premtuese	-	57,692
E. M. – H.Sh., luftëtari antifashist që ra nga plumbat e komunistëve	70,000	57,692
Q. V. - S. H., një jetë e burgosur	70,000	57,692
Fjalor i shtjelluem e gjuhës shqipe, At Benedikt Dema, vëll. III	-	-
Katalogu i botimeve të ISKK 2011-2018 (foto)	-	-
Total		**634,612**

Burimi: Të dhënat nga ISKK. Përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi rezultoi se nga kjo kolanë e miratuar kanë marrë shpërblim vetëm 13 autorë të jashtëm. Në total, nga të dhënat e audituara edhe përmes Urdhër-shpenzimeve, rezulton se shuma totale e paguar për autorët është 634,612 lekë.

Viti 2021

Në vitin 2021 është hapur thirrja për dorëshkrime, përmes shkresës së Drejtorisë së Studimeve nr. 65 Prot., datë 07.05.2021, ku autorë të jashtëm kanë dorëzuar dorëshkrimet e tyre. Nga procesverbalet e mbledhjeve të KSHI, rezulton se KSHI ka realizuar rishikimin e dorëshkrimeve dhe vlerësimin e tyre. Përmes Vendimit nr. 7 të Bordit Drejtues më datë 07.09.2021, Bordi Drejtues ka miratuar kolanën e botimit me 10 vepra.

Tabela nr. 8: Veprat e miratuara nga Bordi Drejtues për shpërblim, viti 2021

Autori dhe vepra	Shpërblimi honorifik (në lekë)
A. S. - Dokumente mbi cënimin e pronës në periudhën komuniste 1944-1946	100,000
F. G, - Dromca kujtimesh	100,000
K. H. - Tokë e bukur, kohë e shëmtuar	100,000
I. P. - Jeta e një fëmije "kulaku" në diktaturë	100,000
Xh. S. – Z.V., intelektual i madh nga një qytet i vogël	100,000
Y. T. – Arratisja	100,000
L. N. – N.D., mes përkthimit dhe përndjekjes	-
L. Ll.- Zërat e Kujtesës	-
ISKK - Revista shkencore: Studime për krimet e komunizmit	-
L. Ll. - Përmbledhje aktesh të konferencës shkencore "Ligjshmëria gjatë regjimit komunist 1944-1990"	-
Total	**600,000**

Burimi: Të dhënat nga ISKK. Përpunuar nga KLSH.

Në vitin 2021, rezultojnë se janë paguar 6 autorë të jashtëm sipas vlerës respektive 100,000 lekë.

Viti 2022

Në vitin 2022 është hapur thirrja për botim, ku autorë të jashtëm kanë dorëzuar dorëshkrimet e tyre. KSHI deri në datën 30.06.2022 është marrë me shqyrtimin dhe vlerësimin e 13 dorëshkrimeve të dorëzuara.

Titulli i gjetjes	**Parregullsi në procedurat e botimeve**
Situata	1. Referuar Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Shkencor të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, KSHI ka për detyrë të shqyrtojë dhe vlerësojë punimet e paraqitura për botim, bazuar në metodologjinë e miratuar paraprakisht prej tij dhe të konfirmuar nga Bordi Drejtues. Nga auditimi rezultoi se KSHI nuk e ka miratuar këtë metodologji, në kundërshtim me kërkesat e Nenit 5 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KSHI, miratuar në vitin 2018; dhe Nenit 6 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KSHI, miratuar në vitin 2021 ku përcaktohet se "*KSHI shqyrton dhe vlerëson punimet e paraqitura për botim, bazuar në metodologjinë e miratuar paraprakisht prej tij dhe të konfirmuar nga Bordi*". 2. Në asnjërin nga vitet 2018-2022 nuk ka një databazë të plotë mbi procedurat e dorëzimit të dorëshkrimeve për botim, e cila të specifikojë

	aplikimet në thirrje, veprat e përzgjedhura dhe vlerat që kanë përfituar autorët. Gjithashtu, vlerësimi i veprave nga ana e KSHI është përcjellë përmes e-mail dhe në protokoll nuk ka dokumenta të protokolluar mbi këto vlerësime të realizuara, duke cënuar ruajtjen e gjurmës audituese për procesin. Referuar Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3. citon se *"Procedurat e dokumentimit përfshijnë procedurat që lidhen me qarkullimin e dokumentacionit, të cilat përmbajnë urdhrin për qarkullimin dhe përdorimin e dokumenteve të prodhuara dhe të marra. Procedurat e dokumentimit duhet të mundësojnë ndjekjen e çdo dokumenti, veprimi, apo proçesi në njësi ku të tregohet saktësisht se kush ka kryer çfarë, kur dhe ku, qëllimin dhe llojin e aktit/dokumentit që është lëshuar me këtë rast."*
Kriteri	Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Shkencor të Institutit, miratuar në vitin 2018, neni 5; Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Shkencor të Institutit, miratuar në vitin 2021, neni 6; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 "Aktivitetet e Kontrollit".
Ndikimi/Efekti	Mungesa e dokumentimit të rrjedhës së informacionit mbi veprat e dorëzuara për botim, duke marrë parasysh edhe faktin që nuk ka një metodologji të miratuar për vlerësimin e punimeve, cënojnë parimin e transparencës në këtë proces, duke shtuar riskun për përzgjedhje subjektive dhe jo të mbështetur në kritere specifike.
Shkaku	KSHI nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit "Detyrat e KSHI" të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KSHI. Gjithashtu, ISKK nuk ka zbatuar përcaktimet e pikës 3.3 të Manualit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit për të mundësuar ruajtjen e dokumentacionit mbi procesin e botimeve.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në bashkëpunim me Këshillin Shkencor të marrin masa për standardizimin dhe formalizimin e procesit të botimit, duke paracaktuar metodologjinë për vlerësimin e punimeve të paraqitura për botim dhe të gjithë procesin që nga shpallja deri në botimin e veprave dhe miratimin e saj nga Bordi Drejtues, si dhe të krijojë dhe administrojë një databaze të plotë në lidhje me botimet, me qëllim dokumentimin e plotë të procesit.

Mbi konferencat

Përgjatë periudhës së auditimit, ISKK ka publikuar thirrjet për pjesëmarrje në konferenca shkencore, si më poshtë:

1. Konferenca shkencore 2019, ku kanë marrë pjesë 10 studiues;
2. Konferenca shkencore 2020, ku kanë marrë pjesë 17 studiues dhe janë botuar 13 artikuj;
3. Konferenca shkencore 2021, ku kanë marrë pjesë 13 studiues dhe janë botuar 10 artikuj (shpallur përmes shkresës nr. 66 Prot., datë 07.09.2021;
4. Konferenca shkencore 2022 – në proces.

Kumtesat e mbajtura në konferencat shkencore të ISKK, në rastin e përzgjedhjes nga KSHI si artikull që plotëson kriteret e një vepre shkencore, vlerësim ky në mungesë të një metodologjie, janë paguar referuar VKM nr. 120/1997 "*Për shpërblimin e autorëve të veprave shkollore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor*". Mes autorit të kumtesës dhe ISKK lidhet një kontratë ku ISKK specifikon se paguan deri në 1 (një) fletë tipografike për kumtesat. Sipas VKM nr. 120/1997, një pagesë e tillë varion nga 22,000-24,000 lekë. Për vitet 2019-2021 janë paguar autorët si në vijim në vlera bruto:

Tabela nr. 9: Pagesat e autorëve të kumtesave të konferencave për periudhën 2019-2021

2019		**2020**		**2021**	
Autorët e kumtesave	**Pagesa për kumtesën**	**Autorët e kumtesave**	**Pagesa për kumtesën**	**Autorët e kumtesave**	**Pagesa për kumtesën**
Nuk rezultojnë të dhëna nga informacioni i vënë në dispozicion		Xh. S.	14,217	A. S.	11,525
		H. S.	18,843	L. D.	24,000
		A. K.	15,852	K. K.	24,000
		K. K.	24,000	Xh. S.	48,000
		F. J.	28,235	M. Sh.	4,000
		A. B.	6,596	A. S.	23,881
		E. D.	28,235	E. L.	24,000
		M. Sh.	6,596	A. B.	4,000
		A. E.	24,000	A. B.	4,000
		F. Z.	24,000	P. M.	11,525
		E. M.	24,000	L. M.	24,000
		E. L.	16,418		
		E. B.	24,000		
		H. B.	8,231		
		A. H.	24,000		
		A. B.	5,607		
		Total	**292,830**	**Total**	**202,931**

Burimi: Sektori i Financës në ISKK. Përpunuar nga KLSH.

Ndërkohë, nga të dhënat e tabelës, vihet re se autori Xh. S. i cili është paguar 48,000 lekë, ka dorëzuar dy artikuj për pagesë, një në aktet e konferencës së vitit 2021 dhe një në revistën shkencore Memorja nr. 2, 2022.

Titulli i gjetjes	**Parregullsi në procedurat e konferencave**
Situata	1. Lidhur me mënyrën e organizimit të konferencave nuk ka një akt nënligjor ku të bazohet ky proces. Për vlerësimin e artikujve të dorëzuara për pjesëmarrje në konferencë dhe botim, nuk ekziston një metodologji, me qëllim garantimin e barazisë, drejtësisë dhe transparencës së procesit. Përgjatë periudhës së audituar konstatohet se nuk ka patur një praktikë fikse e shpalljes së konferencave nga Drejtoria e Studimit me qëllim shpalljen publike, përcaktimin e anëtarëve të grupit të punës, ndarjen e detyrave të tyre, e në vijim deri në përfundim të shpërblimit të kumtesave. Referuar manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 "Aktivitetet e Kontrollit" citon se *"Njësitë publike, në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të tyre në mënyrën e duhur duhet të mbështeten në akte ligjore dhe nënligjore specifike për proceset dhe procedurat përkatëse. ... Mbështetja në këto procedura të shkruara do të ndihmojë njësinë në realizimin e objektivave dhe përdorimin e fondeve buxhetore në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe efiçiente."*

	2.Referuar procedurës së dorëzimit të abstrakteve për pjesëmarrje në konferencë, në asnjërin nga vitet nuk ka një databazë të plotë, e cila të specifikojë aplikimet në thirrje, kumtesat e përzgjedhura dhe vlerat që kanë përfituar autorët. Sipas Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 "Aktivitetet e kontrollit", citon se "*Dokumentimi përfshin hartimin e provave të shkruara për vendimet e marra, ngjarjet e ndodhura, veprimet dhe transaksionet e kryera, etj. ... Procedurat e dokumentimit përfshijnë procedurat që lidhen me qarkullimin e dokumentacionit, të cilat përmbajnë urdhrin për qarkullimin dhe përdorimin e dokumenteve të prodhuara dhe të marra."*
Kriteri	Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 "Aktivitetet e Kontrollit".
Ndikimi/Efekti	Duke marrë shkas nga fakti që procedura e ndjekur nuk bazohet në një akt të miratuar, vlerësimi i punimeve të paraqitura është bërë pa u bazuar në një metodologji të mirë përcaktuar, mungesa e një databazë të plotë me të dhëna mbi konferencat, si dhe mungesa e ruajtjes së dokumentacionit lidhur me vlerësimin e realizuar të kumtesave nga ana e KSHI, konkludohet se në këtë proces cënohet parimi i transparencës, barazisë dhe drejtësisë.
Shkaku	Bordi Drejtues i ISKK nuk ka marrë masa për të zbatuar përcaktimet e pikës 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të hartuar dhe miratuar një akt nënligjor ku të evidentohet hollësisht procedurën e ndjekur për organizimin e konferencave, dhe të përfshihet procedura e ndjekur për përcaktimin e temave, shpallja, mënyra e aplikimit, metodologjia e vlerësimit e deri te pagesa e pjesëmarrësve.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti nënligjor që detajon hollësisht procedurën e organizimit të konferencave, ku të përfshihet procedura e ndjekur për përcaktimin e temave, shpallja, mënyra e aplikimit, metodologjia e vlerësimit, pagesa e pjesëmarrësve, si dhe çdo hallkë tjetër që do ta bënte më transparent procesin, si dhe krijimin dhe administrimin e një databaze të plotë në lidhje me konferencat, ku për secilën thirrje të mëtejshme të evidentohen aplikimet me të dhënat përkatëse të nevojshme.

III.2.4. Auditimi mbi përputhshmërinë me aktet ligjor, nënligjore dhe rregullatore të veprimtarisë së drejtorit ekzekutiv, drejtorive dhe sektorëve të ISKK.

Drejtori Ekzekutiv

Referuar nenit 13 "*Drejtori ekzekutiv*" të Ligjit nr. 10242, datë 25.2.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri*", instituti drejtohet nga drejtori ekzekutiv. Ndër detyrat e drejtorit ekzekutiv, në këtë nen, specifikohen, ndër të tjera:

- Përgatitja e materialeve për shqyrtim nga bordi dhe zbatimi i vendimeve të bordit;
- Propozimi i datës së mbledhjeve dhe rendit të ditës;
- Nënshkrimi i akteve të bashkëpunimit etj.

Përgjatë periudhës së audituar, Drejtori Ekzekutiv në vitet 2018 dhe 2019 nuk rezulton të ketë inicuar mbledhje apo të ketë hartuar relacione dhe propozime për Bordin Drejtues. Në vitin 2020,

2021 dhe deri më 30.06.2022, Drejtori Ekzekutiv ka inicuar në disa raste mbledhje të Bordit Drejtues, ka propozuar metodologji pagese/shpërblimi të autorëve, si dhe ka përgatitur relacione për Bordin Drejtues dhe aktivitetin e ISKK.
Referuar nenit 17 "*Raportimi dhe konfidencialiteti*", Drejtori ekzekutiv i institutit i dërgon bordit, çdo gjashtë muaj, një raport dhe përgatit shpjegime, që ndihmojnë bordin për monitorimin dhe vlerësimin e sigurisë së aksesit në dokumentet dhe materialet arkivore. Duke qenë se ISKK nuk zotëron dokumente sekrete, por vetëm kopje dokumentesh nga arkiva të tjera në formë elektronike, një raportim i tillë nuk ka qenë i nevojshëm.

Mbi planet e punës dhe raportet vjetore

Për periudhën e shqyrtuar, ISKK ka miratuar planet dhe raportet vjetore të punës, të cilat janë përgatitur nga secila Drejtori dhe më pas janë bashkuar në materialin përfundimtar vjetor, për shkak të numrit të vogël të punonjësve të institucionit. Raportet vjetore janë përgatitur bashkërisht nga Drejtoritë dhe në protokoll është depozituar raporti përfundimtar, pas miratimit nga Bordi Drejtues. Bën përjashtim sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, më vonë e kthyer në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, i cili ka dorëzuar raportin në protokoll në vijimësi. Për vitin 2022, ka dorëzuar në protokoll planin vjetor edhe Drejtoria e Arkivës.
Për sa i përket planeve dhe raporteve të punës, ato miratohen në mbledhjet e Bordit Drejtues me vendimet përkatëse si në vijim.

- Plani Vjetor 2019, miratuar me anë të Vendimit nr. 2/2019 të BD, datë 21.03.2019;
- Plani Vjetor 2020, miratuar me anë të Vendimit nr. 1/2020 të BD, datë 13.01.2020;
- Plani Vjetor 2021, miratuar me anë të Vendimit nr. 2/2021 të BD, datë 01.02.2021;
- Raporti Vjetor 2018, miratuar me anë të Vendimit nr. 1/2019 të BD, datë 18.02.2019;
- Raporti Vjetor 2019, miratuar me anë të Vendimit nr. 2/2020 të BD, datë 28.02.2020;
- Raporti Vjetor 2020, miratuar me anë të Vendimit nr. 3/2021 të BD, datë 16.03.2021;
- Raporti Vjetor 2021, miratuar me anë të Vendimit nr. 2/2022 të BD, datë 28.03.2022.

Gjithashtu, në përmbushje të një prej rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për ISKK në vitin 2021, ishte përgatitja e një plani strategjik për vitet në vijim. Qëllimet strategjike të vendosura që në origjinë të ISKK janë:
1. Identifikimi i viktimave të regjimit komunist, si elementi kryesor në vërtetimin e ekzistencës së veprimtarisë kriminale të kryer gjatë regjimit komunist.
2. Mbledhja e informacionit për krimet e komunizmit nga burime parësore, dëshmitarët okularë, të cilat nuk gjenden ne dokumente zyrtare.
3. Analizimi i vlerësimit të krimeve të regjimit komunist përmes studimeve shkencore të thelluara
4. Informimi i publikut.
Lidhur me Planin Strategjik të ISKK 2022-2025, nga Drejtori Ekzekutiv është përgatitur një relacion me nr. 12/2-2 prot., datë 27.03.2022.
Planet vjetore janë hartuar referuar misionit dhe objektivave të ISKK parashikuar në ligjin organik të institutit. Në to parashikohet realizimi i një sërë projektesh të ndryshme. Sikurse përcaktuar, në themel janë veprimtaritë dhe projektet e vazhdueshme si: Enciklopedia, konferenca shkencore, kolana e librave, seria Zërat e Kujtesës dhe muzetë virtualë të kampeve të punës.
Raportet Vjetore të ISKK paraqesin një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të zhvilluara përgjatë vitit përkatës, veprave të botuara, konferencave të realizuara, përmbledhje e situatës financiare dhe buxhetore të ISKK, si dhe aktivitete të ndryshme të zhvilluara në kuadër të misionit të institucionit.

ISKK përbëhet nga drejtoritë e mëposhtme për periudhën 01.01.2018 – 21.04.2021 (deri në procesin e ristrukturimit):

1. Drejtoria e Arkivës
2. Drejtoria e Studimeve
3. Sektori i buxhetit, financës dhe shërbimeve mbështetëse

Ndërkohë, pas ristrukturimit të institucionit, ISKK ka në strukturën e saj drejtoritë si në vijim:

1. Drejtoria e Arkivës
2. Drejtoria e Studimeve
3. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria e Arkivës

Titulli i gjetjes	**Parregullsi në regjistrimin e dokumentacionit**
Situata	Nga auditimi u konstatua se thirrjet për botime/ konferenca nuk trajtoheshin si praktika në vetvete, duke bërë kështu të vështirë ndjekjen e praktikës nga fillimi (vendimmarrja për thirrjen) e deri në përfundim të praktikës. Referuar nenit 19 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Sa më sipër, do të mundësonte ndjekjen me rrjedhë kronologjike të procedurave kryesore të veprimtarisë së ISKK, sikurse janë botimet dhe konferencat, duke nisur me Urdhrin e titullarit për fillimin e punës për hartimin e shpalljes, e duke vijuar progresivisht me fraksion çdo dokumentacion i lidhur me atë shpallje, në çdo formë hyrëse në institucion (përfshirë dokumentet që hyjnë elektronikisht), deri në mbylljen e praktikës me vendimmarrjen përfundimtare me shpalljen e fituesve.
Kriteri	Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19.
Ndikimi/Efekti	Mosrespektimi i normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor mund të bëhen shkak për rritjen e riskut të mosruajtjes së gjurmës audituese, duke mos vërtetuar objektivisht hyrjen e materialeve në institucion dhe gjurmimin e tyre dhe duke cënuar kështu parimin e transparencës për këtë proces.
Shkaku	Neglizhencë në zbatimin e normave teknike të arkivimit nga ana e personave përgjegjës për këtë proces.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	Titullari i ISKK të marrë masa mbi ngarkimin e njësisë përgjegjëse për regjistrimin e dokumenteve që formojnë një praktikë duke vijuar me të njëjtin numër rendor progresivisht me fraksion për çdo dokumentacion hyrës në institucion deri në mbylljen e praktikës me vendimmarrjen

	përfundimtare, si dhe përcaktimin e kësaj njësie për sa më sipër në aktet nënligjore që përcaktojnë detyrat funksionale të punonjësve të ISKK.

Drejtoria e Studimit

Drejtoria e Studimit në ISKK është përgjegjëse për produktin studimor dhe planifikimin vjetor, afatmesëm dhe afatgjatë të punës studimore të Institutit. Kryesisht merret me:

- Mbledhjen e dorëshkrimeve dhe dokumenteve arkivore për studime;
- Mbledhjen e dorëshkrimeve të librave të rrallë dhe përgatitjes së tyre për shtyp;
- Analizimin e teksteve dhe kurrikulave shkollore;
- Përgatitjen e paketave me informacion shkencor dhe dëshmues për faqen zyrtare të ISKK, etj.

Në Rregulloren e Brendshme të vitit 2021, detyrat e kësaj Drejtorie janë përcaktuar më qartë duke u detajuar në:

- Realizimin e një serie projektesh kërkimore, studimore, të cilat përputhen me misionin e ISKK-së.
- Krijimin e një video-arkive më dëshmi të të mbijetuarve nga burgjet dhe kampet komuniste.
- Transkiptimin, përgatitjen për botim të këtyre dëshmive si pjesë e kolanës së botimeve të titulluar "Zërat e kujtesës".
- Realizimin e projekteve informuese, edukuese nëpër shkollat e të gjitha niveleve në bashkëpunim me Drejtorinë e Arkivës dhe Shërbimet Mbështetëse.
- Realizimin e konferencave vjetore në bashkëpunim me Drejtorinë e Arkivës dhe Shërbimet Mbështetëse dhe pjesëmarrjen në konferenca apo aktivitete të tjera shkencore jashtë ISKK- së, të cilat përkojnë me misionin e këtij Instituti.
- Përditësimin e faqes elektronike të ISKK- së dhe marrëdhënien e këtij institucioni me publikun etj.

Për periudhën e shqyrtuar, Drejtoria e Studimit është angazhuar në detyrat e mësipërme të cilat kanë konkluduar me zhvillimin e konferencave shkencore, botimin e serive "Zërat e Kujtesës", botimin e almanakut me kumtesat e konferencave shkencore etj. Megjithatë, ashtu si është sqaruar edhe në çështjet përkatëse të mësipërme, nuk ka patur një procedurë standarde të zhvillimit të konferencave shkencore ndër vite. Vetëm për vitin 2021, rezulton shpallja e protokolluar, e cila ka dalë nga Drejtoria e Studimit për zhvillimin e konferencës shkencore 2021.

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Deri në vitin 2021, përpara miratimit të strukturës së re të ISKK-së, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ishte në nivel sektori. Ndër detyrat kryesore listohen:

- Menaxhimin e fondeve buxhetore të miratuara për ISKK-në, për sigurimin e përdorimit me efektivitet dhe ne përputhje me legjislacionin ne fuqi te fondeve publike;
- Detajimin e fondeve buxhetore të miratuara me ligj për ISKK-në dhe hartimin e përmbledhëses e Detajimit të shpenzimeve korente e kapitale;
- Përgatitja e parashikimit të limitit mujor te shpenzimeve për ISKK;
- Hartimi i PBA afatmesme në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera; etj.

Për periudhën 2018-2022, ky Sektor, i shndërruar më pas në Drejtori në vitin 2021, ka përgatitur planet vjetore të punës të cilat janë integruar në Planin Vjetor të ISKK. Përgjatë viteve janë përgatitur PBA, në raportet vjetore është shprehur situata financiare dhe buxhetore e institutit, janë përgatitur Urdhër-shpenzimet për pagesat e shpërblimit të autorëve, pagesat e kumtesave, në vijim të Vendimeve të Bordit Drejtues.

III.2.5 AUDITIM MBI PROGRAMIMIN, ZBATIMIN DHE RAPORTIMIN E BUXHETIT

2.5.1 Mbi programimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit për Instituti Integrimit të Ish të Përndjekurve Politikë

Për të siguruar veprimtarinë e tij, IIP-ja mbështetet në një fond buxhetor, i cili është miratuar si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për 2018, dhe nga viti 2019 e në vijim në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në programin 01190 "Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik".

Për të ndihmuar ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë në plotësimin e kërkesave të tyre është krijuar një fond i veçantë në buxhetin e shteti bazuar në ligjin nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijim e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politik". Ky fond përbëhet nga:

a) shuma që caktohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin e shtetit;

b) shuma prej një për qind mbi fondin e pagave, që do të derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore;

c) vlefta e një pjese të ndihmave humanitare për popullin shqiptar, që do të përcaktohen për çdo rast nga Këshilli i Ministrave;

ç) vlefta e ndihmave humanitare që japin institucionet bamirëse dhe personat fizikë e juridikë, shqiptarë ose të huaj, të caktuar për ish- të dënuarit e të përndjekurit politikë.

Administrimi i fondit të veçantë monetarë bazohet në vendimin e Kryeministrit nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetarë", administrimi i fondit do të bëhet sipas kritereve;

a) 50 përqind e këtij fondi për të ndihmuar ekonomikisht e materialisht, familjet e përndjekura për nevoja urgjente, për integrimin e tyre shoqëror;
b) 50 përqind për të financuar shoqatat e ish-të përndjekurve politik. Financimi i shoqatave të veçanta do të bëhet në përpjesëtim me numrin e anëtarëve.

Për administrimin e fondit IIPP ka ngritur Komisionin e Trajtimit dhe shpërndarjes së fondeve që mblidhen, i cili funksionin bazuar në rregulloren e brendshme nr.356 prot., datë 12.04.2018.

- Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2018-qershor 2022).

PBA 2018 - 2020

Me shkresë nr. 466 prot, datë 24.07.2017 IIPP ka dërguar Projekt Buxhetin për vitin 2018-2020 pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 10, datë 28.02.2017 të MF "Për përgatitjen e PBA 2018-2020", në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", si dhe në zbatim të tavaneve përgatitore të PBA-së, miratuar me VKM nr. 197, datë 15.03.2017.

Tabela nr. 10: PBA 2018-2020 në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
600	Paga	20,500	20,500	20,500
601	Sigurime Shoq. Shënd	3,400	3,400	3,400
602	Mallra dhe Shërbime	15,000	15,000	15,000
604	Të tjera Transf. Korrente të brëndshme	5,000	5,000	5,000
231	Shpenzime kapitale të trupezuara	8,800	2,000	2,000
	Totali	**52,700**	**45,900**	**45,900**

Burimi: IIPP

Tabela nr. 11: Detajimi i projekteve PBA 2018-2020 në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi i projektit	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
231	Blerje makine tip fouristrade	4,000		
231	Blerje Pajisje elektronike	1,000	1,000	1,000
231	Blerje mobilje zyrash	1,000	1,000	1,000
231	Kosto totale (Europa per Qytetaret)	2,800		
	Totali	**8,800**	**2,000**	**2,000**

Burimi: IIPP

Shpenzimet kapitale janë parashikuar në vlerën 8,800 mije lekë. Konstatohet se kërkesat janë bëre duke respektuar udhëzimin plotësues nr.10/3 prot., datë 13.07.2017 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020" dhe ligjin nr.109, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018" dhe tavanet e miratuara me VKM nr. 197, datë 15.03.2017.

PBA 2019-2021

Me shkresë nr. 532 prot, datë 20.08.2018 IIPP ka dërguar Projekt Buxhetin për vitin 2019-2021 pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të Udhëzimit nr. 7/2, datë 09.07.2018 të MF "Për përgatitjen e PBA 2019-2021", në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar, si dhe në zbatim të tavaneve të miratuara, miratuar me VKM nr. 476/2018.

Tabela nr. 12: PBA 2019-2021 në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
600	Paga	30,800	30,800	30,800
601	Sigurime Shoq. Shënd	5,500	5,500	5,500
602	Mallra dhe Shërbime	8,000	8,000	8,000
604	Të tjera Transf. Korrente të brëndshme	3,000	3,000	3,000
231	Shpenzime kapitale të trupezuara	4,000	4,000	4,000
	Totali	**51,300**	**51,300**	**51,300**

Burimi: IIPP

Tabela nr. 13: Detajimi i projekteve PBA 2019-2021 në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi i projektit	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021	Vlera e plotë e projektit
231	Blerje makine tip fouristrade	4,000			4,000
231	Rikonstruksion Ndertese		4,000		4,000
231	Blerje Pajisje elektronike			2,000	2,000
231	Blerje mobilje zyrash			2,000	2,000
	Totali	**4,000**	**4,000**	**4,000**	**12,000**

Burimi: IIPP

Shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën totale 47,300 mijë lekë, të cilat përdoren për shpenzime page dhe shpenzime administrative. Shpenzime kapitale për periudhën 2019-2021 janë planifikuar në vlerën 12,000 mijë lekë, për 4 projekte "Blerje makine", "Rikonstruksion ndërtese", "Blerje pajisje elektronike" dhe "Blerje mobilje zyrash". Konstatohet se kërkesat buxhetore janë bërë duke respektuar udhëzimin plotësues nr. 7/1 prot., datë 28.02.2018 "Për përgatitjen PBA 2019-2021 "dhe tavanet e miratuara me VKM nr. 476/2018.

PBA 2020-2022

Me shkresë nr. 516 prot, datë 18.07.2019, IIPP ka dërguar Projekt Buxhetin për vitin 2020-2022 pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të Udhëzimit nr. 21, datë 10.07.2019 të MF "Për përgatitjen e PBA 2020-2022", në përputhje me ligjin nr. 9936, datë

26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, si dhe në zbatim të tavaneve të miratuara, miratuar me VKM nr. 117 datë 13.03.2019 .

Tabela nr. 14: PBA 2020-2022 në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021	Parashikimi 2022
600	Paga	22,000	22,000	22,000
601	Sigurime Shoq. Shënd	3,600	3,600	3,600
602	Mallra dhe Shërbime	8,000	15,000	15,000
604	Të tjera Transf. Korrente të brëndshme	3,000	5,000	5,000
231	Shpenzime kapitale	4,000	1,000	1,000
	Totali	**40,600**	**46,600**	**46,600**

Burimi: IIPP

Tabela nr. 15: Shpenzimet kapitale në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi i projektit	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021	Parashikimi 2022	Vlera total e projektit
231	Blerje makine tip fouristrade	4,000			4,000
231	Blerje Pajisje zyre		1,000		1,000
231	Blerje Pajisje elektronike			1,000	1,000
	Totali	**4,000**	**1,000**	**1,000**	**6,000**

Burimi: IIPP

Shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën totale 36,600 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet për personelin në vlerën 25,600 mijë lekë dhe shpenzimet për artikullin 602 “Mallra dhe Shërbime” 8,000 mijë lekë. Shpenzime kapitale janë planifikuar në vlerën 6,000 mijë lekë, për 3 projekte “Blerje makine”, “Blerje pajisje elektronike” dhe “Blerje mobilje zyrash”. Konstatohet se kërkesat buxhetore janë bërë në zbatim të Udhëzimit nr. 21, datë 10.07.2019 të MF “Për përgatitjen e PBA 2020-2022”, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, si dhe në zbatim të tavaneve të miratuara, miratuar me VKM nr. 117 datë 13.03.2019.

PBA 2021-2023

Me shkresë nr. 369 prot, datë 18.08.2020, IIPP ka dërguar Projekt Buxhetin për vitin 2021-2023 në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të Udhëzimit nr. 28, datë 10.07.2020 të MF “Për përgatitjen e PBA 2021-2023”, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, si dhe në zbatim të tavaneve të miratuara, miratuar me VKM nr. 577/2020.

Tabela nr. 16: PBA 2021-2023 në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi	Parashikimi 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023
600	Paga	20,000	21,000	22,000
601	Sigurime Shoq. Shënd	3,500	3,500	3,700
602	Mallra dhe Shërbime	16,500	15,000	15,000
604	Të tjera Transf. Korrente të brëndshme	10,000	10,500	9,300
	Totali	**50,000**	**50,000**	**50,000**

Burimi: IIPP

Tabela nr. 17: Shpenzimeve kapitale në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi i projektit	Parashikimi 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Vlera totale e projektit
231	Rikonstruksion ndërtese	8,100			8,100
	Totali	**8,100**	**0**	**0**	**8,100**

Burimi: IIPP

Janë planifikuar shpenzimet sipas artikujve ekonomik për vitin 2021:

- Për artikullin ekonomik 600-601, janë planifikuar 24 punonjës me një fond page 20,000 mijë lekë dhe sigurime shoqërore prej 3,500 mijë lekë.
- Për artikullin ekonomik 602, kostoja e politikës ekzistuese e gjithë produktit për këtë artikull është 16,500 mijë lekë, ku përfshihen shpenzimet kancelarie, materiale pastrimi, shpenzime transporti si edhe detyrimet dhe kompensimet për shpenzimet gjyqësore.
- Për artikullin ekonomik 231, është planifikuar projektin "Rikonstruksion Ndërtese" në vlerën 8,100 mijë lekë.

Konstatohet se kërkesat janë bëre duke respektuar Udhëzimin nr. 28, datë 10.07.2020 të MF "Për përgatitjen e PBA 2021-2023", në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar, si dhe në zbatim të tavaneve të miratuara me VKM nr. 577/2020.

PBA 2022-2024

Me shkresë nr. 400 prot, datë 30.07.2021, IIPP ka dërguar Projekt Buxhetin për vitin 2022-2024 në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të Udhëzimit nr. 19, datë 09.07.2021 të MF "Për përgatitjen e PBA 2022-2024", në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar, si dhe në zbatim të tavaneve të miratuara me VKM nr. 440, datë 20.07.2021 .

Tabela nr. 18: PBA 2022-2024 në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
600	Paga	19,000	22,000	22,000
601	Sigurime Shoq. Shënd	3,200	3,500	3,500
602	Mallra dhe Shërbime	9,800	12,000	15,000
604	Të tjera Transf. Korrente të brëndshme	3,000	10,000	10,000
606	Transferta për buxhetin e familjarëve			
231	Shpenzime kapitale të trupezuara	9,100	1,500	1,500
	Totali	**44,100**	**49,000**	**52,000**

Burimi: IIPP

Tabela nr.19: Shpenzimet kapitale në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi i projektit	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024	Vlera totale
231	Rikonstruksion i zyrave	8,100			8,100
231	Blerje Pajisje elektronike	1,000			1,000
231	Blerje Pajisje zyre		1,500	1,500	3,000
	Totali	**9,100**	**1,500**	**1,500**	**11,100**

Burimi: IIPP

Janë planifikuar shpenzimet sipas artikujve ekonomik për vitin 2022:
- Për artikullin ekonomik 600-601, janë planifikuar 24 punonjës me një fond page 19,000 mijë lekë dhe sigurime shoqërore prej 3,200 mijë lekë.
- Për artikullin ekonomik 602, kostoja e politikës ekzistuese të produktit për këtë artikull është planfikuar 9,800 mijë lekë, ku përfshihen shpenzimet kancelarie, materiale pastrimi, shpenzime transporti si edhe detyrimet dhe kompensimet për shpenzimet gjyqësore.
- Për artikullin ekonomik 231, janë planifikuar 2 projekte, "Rikonstruksion Ndërtese", "Blerje pajisje zyre" me një kosto 9,100 mijë lekë.

Konstatohet se kërkesat për buxhet në lidhje me afatin dhe formatin e përdorur janë bërë duke respektuar Udhëzimin nr. 19, datë 09.07.2021 të MF "Për përgatitjen e PBA 2022-2024", në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar, si dhe në zbatim të tavaneve të miratuara, miratuar me VKM nr. 440 datë 20.07.2021.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore si dhe planin përfundimtar.
Detajimi i buxheti të vitit 2018 për IIIP është bërë me shkresën nr.5602/4 prot., datë 22.01.2018, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Tabela nr. 20: Shpenzimet korrente në mijë lekë

Programi	Llog.Ekon.	Emërtimi	Buxheti
01190	600	Paga	30,800
01190	601	Sigurime Shoqërore	5,500
01190	602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	8,000
01190	604	Transferta Korrente të brendshme	3,000
	Totali I Shpenzimeve		**47,300**

Burimi: IIPP

Ndërsa me shkresën nr. 201/3 prot, datë 15.02.2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar shkresën për çeljen e buxhetit për shpenzime kapitale (art.230,231).

- Mbi transferimin e fondeve buxhetore

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar shkresën nr. 4773/4, datë 10.09.2018, nr. 4773/4 prot., pranë IIPP-së, mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 1 datë 26.07.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018".

Tabela nr. 21: Transferim fondi në mijë lekë

Programi	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Pakësohet	Debiti
01190	600	Paga	Pakësohet	444
01190	601	Sigurime Shoqërore	Pakësohet	56
	Totali			**5,000**

Burimi: IIPP

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shkresën nr. 7204/1, datë 24.12.2018, mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 2, datë 19.12.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018".

Tabela nr. 22: AN nr. 2, datë 19.12.2018 në mijë lekë

Programi	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Pakësohet	Debiti
01190	600	Paga	Pakësohet	12,000
01190	601	Sigurime Shoqërore	Pakësohet	2,000
	Totali			**14,000**

Burimi: IIPP

Me ndryshimin, llogaria e pagave 600 behet 18,356 leke dhe Llogaria 601 bëhet 3,440 lekë.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka dërguar shkresën nr. 4773/8, datë 21.09.2018, mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 1 datë 26.07.2018.

Tabela nr. 23: Transferim fondi në mijë lekë

Programi	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Pakësohet	Debiti
01190	231	Fond i ngrire	Pakesohet	1,200
	Totali			**1,200**

Burimi: IIPP

Konstatohet se nuk është çelur fond për artikullin ekonomik 231 për vitin 2018 sipas kërkesës së bërë nga IIPP në PBA II me vlerën 4,000 mijë lekë për produktin " Blerje makine".

- Auditimi mbi realizimin e planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Për vitin buxhetor 2018, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatimi të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore". Situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit IIPP për vitin 2018 paraqitet si në tabelën me poshtë:

Tabela nr. 24: Detajimi i zërave buxhetor në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Plani vjetor 2018	Plani i rishikuar 2018	Fakti 12 mujori	Realizimi%	Pesha e art. ekonomik
600	Shpenzime page	30,800	18,356	15,728	86%	56 %
601	Sigurime shoqerore	5,500	3,444	2,942	85%	11 %
602	Mallra dhe shërbime	8,000	8,000	8,000	100%	24 %
604	Të Tjera Transfer.Korrente Brendshm	3,000	3,000	2,999	100%	9 %
	Totali i shpenzimeve buxhetore	**48,500**	**32,800**	**29,669**	**90%**	**100%**
604	Transfer.Korrente Brendshm nga jo buxhetoret	103,447	103,447	30,384	29%	
Totali	**Totali i shpenzimeve**	**151,947**	**136,247**	**60,053**	**44%**	**100 %**
	Numri i punonjësve	**23**	**23**	**20**	**87%**	

Burimi: IIPP, përpunim nga grupi audites

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për vitit 2018 janë realizuar në masën 90 %, ose 29,669 mijë lekë nga 32,800 mije lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit. Për sa i përket shpërndarjes së të ardhurave në vlerën 103,447 mijë lekë, vetëm 29% e tyre janë shpërndare si ndihma ekonomike, ose 73,063 mije lekë nuk janë shpërndarë si fonde tek të përndjekurit ose shoqatat. Këto fonde janë trashëguar për vitin 2019. Bazuar në dokumentacionin venë në dispozicion, detyrimet e prapambetura për vitin 2018 janë 12,884 mije lekë, nga llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" dhe detyrimet për muajin dhjetor, për paga punonjësish, sigurimet shoqërore, detyrim ndaj shtetit për tatim taksa të cilat janë shlyer në janar të vitit pasardhës. Si edhe detyrimin për blerjen e pajisjeve kompjuterike në vlerën 1,099 mijë lekë, prokurim i kryer nga AKSHI, nuk është likuiduar pasi është shkurtuar fondi bazuar ne Aktin Normative nr.1 , date 26.07.2018, vlerë është likuiduar në vitin 2020.

- Të ardhurat e IIPP për vitin 2018 që derdhen nga ndërmarrjet jobuxhetore sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 pika b) *shuma prej një për qind mbi fondin e pagave, që do të derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore* janë të rregjistruara në artikullin ekonomik 604 "Transferta korrente brendshme" dhe mbahet si zë i ndarë nga artk. ekonomik 604, shuma që përcaktohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin e shtetit . Edhe në rakordimet me thesarin art. ekonomik 604 paraqiten në dy rreshta të ndryshëm.

Totali i të ardhurave që IIPP ka për vitin 2018 është 106,447 mijë lekë, nga të cilat 103,447 mijë lekë nga ndërmarrjet jo buxhetore dhe 3,000 mije lekë nga buxheti i shtetit. Ky fond shpërndahet sipas vendimit nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetarë". Nga auditimi konstatohet se shpërndarja e fondit është bërë duke respektuar limitin e përcaktuar në këtë vendim. Në tabelën e mëposhtme jepen në mënyrë të detajuar fondet nga ndërmarrjet shtetërore jo buxhetore.

Tabela nr. 25: Të ardhurat për vitin 2018 në mijë

Viti	Të trashëguara	Të ardhura në 2018	Totali i të ardhurave 2018	Përdorur gjate vitit 2018	Gjëndja në fund te vitit 2018
2018	**38,300**	**65,146**	**103,447**	**30,384**	**73,063**

Burimi: IIPP

Për vitin 2018, referuar të dhënave në INSAT, rezultojnë 16 ndërmarrje publike jo buxhetore. Konstatohet se 7 ndërmarrjen kanë paguar shumën prej 1% mbi fondin e pagave. Ndërmarrjet që nuk kanë paguar kanë vepruar në kundërshtim me ligjin sipas ligjit nr. 7598 , datë 01.09.1992 pika b) *shuma prej një për qind mbi fondin e pagave, që do të derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore."*

Tabela nr. 26: Subjektet që kanë derdhur 1% mijë lekë

Nr.	Subjektet që kanë derdhur 1%	Vlera totale, 2018
1	A.K.	4,700
2	P.Sh.	3,000
3	A.P.D	4,863
4	U.K.L.	200
5	P.V.	756
6	O..E	39,723
7	U.K. T.	11,903
	Totali	**65,146**

Burimi: IIPP

Gjatë viti 2018 janë shpërndarë 33,384 mijë lekë fonde, pra vetëm 31% e totalit të fondit prej 106,447 mijë lekësh, ku janë marrë 20 vendime nga komisioni i administrimit të ndihmave ekonomike për shpërndarjen e fondit. Konstatohet se 55% e totalit të fondit të shpërndarë e zënë ndihmat ekonomike, ndërsa 45% të totalit të ardhurave e zë fondi i shpërndarë për Shoqatat. *(Trajtuar në tabelën nr.1 në aneks).*

Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimi i Projekteve mban një databasë vjetore me emër dhe mbiemër të personave që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Janë shpërndarë 476 ndihmat ekonomike tek 302 persona në vlerën 6,040 mijë. Gjatë vitit është shpërndarë vetëm një ndihmë ekonomike në rast emergjent në vlerën 100 mijë lekë. Nga shqyrtimi i dosjes për këtë rast, rezulton se janë respektuar kriteret e përcaktuara për përfitimin e ndihmës ekonomike në rast emergjent sipas rregullores "Rregullore e funksionimit të komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" Kreu B, nr.1, gërma a.

Nga auditimi me zgjedhje rezultoi se sektori i financës i ka mbajtur saktë dokumentet justifikues financiar bashkëlidhur urdhër shpenzimit.

Në lidhje me sponsor, gjatë vitit janë shpërndarë fonde për të realizuar 10 aktivitete në vlerën 1,532 mije lekë. Janë realizuar 7 aktivitet përkujtimore në vlerën 832 mijë lekë ndaj ish të përndjekurve politik, 2 sponsorizime për botim libri në vlerë totale 550 mijë lekë dhe 1 dokumentar në vlerën 150 mijë lekë.

Janë shpërndare fonde tek 16 persona në vlerë 10,750 mijë lekë për rikonstruksion shtëpie sipas rregullores kreu B, gërma c dhe kreu D, gërma c.

Janë shpërndarë fonde për 9 shoqata në vlerë totale 15,060 mijë lekë, për të realizuar projekte "Trajnim profesional" si edhe për projekti "Rikonstruksion shtëpie" .

Nga shqyrtimi i dosjeve me zgjedhje i berë nga grupi auditimit rezultoi se janë respektuar kriteret e përgjithshme për shpërndarjen e fondit sipas rregullores nr. 356 prot, datë 12.04.2018.

Sipas llogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit në bazë të informacionit të vënë në dispozicion, frekuenca e shpërndarjes së fondit për ndihma ekonomike për individë, gjatë vitit 2018 rezulton si në vijim: 207 individë kanë marrë 1 herë ndihmë ekonomike; 49 individë kanë marrë 2 herë ndihmë ekonomike; 23 individë kanë marrë 3 herë ndihmë ekonomike; 16 individë kanë marrë 4 herë ndihmë ekonomike; 4 individë kanë marrë 5 herë ndihmë ekonomike; 3 individë kanë marrë 6 herë ndihmë ekonomike.

Ndërsa shpërndarja e fondeve paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela nr. 27: Shpërndarja e fondit për Shoqatat Në mijë lekë

Shoqatat	Frekuenca	Shuma
Sh. I.....	13	8
Sh. T.....P....	6	2,400
Sh... K.....e D.....	5	2,500
U.....M.....	5	670
Sh..... A....e P.....P.....	2	1
Sh..... M.....P.....P.....	2	200
Sh..... P.....P..... të Sh..... në Sh.....	2	140
Sh..... e ish të P..... Pol. të	1	70
Sh..... P..... P.....K.....	1	50
Totali	38	15,060

Burimi: IIPP

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2019. Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente dhe kapitale për IIPP është bërë me shkresën e Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.294 prot., datë 16.01.2019 "Mbi planin e buxhetit për vitin 2019".

Tabela nr. 28: Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2019 Në mijë lekë

Programi	Llog.Ekon.	Emërtimi	Buxheti
01190	600	Paga	31,000
01190	601	Sigurime Shoqërore	5,300
01190	602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	8,000
01190	604	Transferta Korrente të brendshme	3,000
	Totali i Shpenzimeve		**47,300**

Burimi: IIPP

Konstatohet se nuk është çelur fond për artikullin ekonomik 231sipas kërkesës së bërë nga IIPP në PBA II, për produktin "Blerje makine" me vlerën 4 mijë lekë.

Mbi transferimin e fondeve buxhetore 2019

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 11, datë 24.12.2019, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar shkresën me nr. 5965/140 prot., datë 26.12.2019 për detajimin e ndryshimit të planit buxhetor për IIPP.

Tabela nr. 29: Mbi ndryshimin e fondeve, AN nr. 11, datë 24.12.2019 Në mijë lekë

Artikulli	Emertimi	Shtesa	Pakesime
600	Shpenzime page		10,000
Totali	**Totali**		10,000

Burimi:IIPP

Auditimi mbi nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

Për vitin buxhetor 2019, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Situata buxhetore me treguesit e realizimit te buxhetit IIPP, për vitin 2019, paraqitet si në tabelën me poshtë:

Tabela nr. 30: Detajimi i zërave buxhetor Në mijë lekë

Artikulli	Emertimi	Plani vjetor 2019	Plani i rishikuar 2019	Fakti 12 mujori	Realizimi %	Pesha e art. ekonomik
600	Shpenzime page	31,000	21,000	16,102	77 %	56 %
601	Sigurime shoqerore	5,300	5,300	2,650	50 %	14 %
602	Mallra dhe shërbime	8,000	8,000	8,000	100 %	21 %
604	Transfer.Korrente Brendshm	3,000	3,000	2,987	97%	8 %
	Shpenzimet buxhetore	**47,300**	**37,300**	**29,653**	**79 %**	**100 %**
604	Transfer.Korrente Brendshm nga jo buxhetoret	130,529	130,529	73,140	56%	
Totali	**Totali i shpenzimeve**	**177,830**	**167,830**	**102,971**	**61 %**	
	Numri i punonjësve	**23**	**23**	**22**	**87 %**	

Burimi: IIPP, përpunim nga grupi audites

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për vitit 2019 janë realizuar në masën 79%, ose 29,653 mijë lekë nga 37,300 mije lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit. Artikulli ekonomik 604 "Tranferta korrente të brendshme nga ndërmarrjet jo buxhetore" është realizuar në masën 56% ose 57,389 mije lekë mbetën pa u shpërndarë. Janë shpërndarë të gjithë fondet e trashëguara nga vitit 2018 (73,063 mijë lekë) dhe 77 mijë lekë nga vitit 2019. Pjesa e pashpërndarë e fondit trashëgohet në vitin pasardhës. Bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion detyrimet e prapambetura për vitin 2019, janë në vlerën 10,303 mijë lekë.

Totali i të ardhurave të IIPP, për vitin 2019 është në vlerën 133,530 mijë lekë, nga të cilat 3,000 mijë lekë janë nga buxheti i shtetit dhe 103,447 mije lekë nga ndërmarrjet jo buxhetore për ti shpërndarë sipas vendimit nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetarë", 50% për shoqatat dhe 50% për ndihma ekonomike.

Tabela nr. 31: Të ardhurat nga ndërmjet jo buxhetore për vitin 2019 Në mijë lekë

Viti	Të trashëguara	Të ardhura në 2019	Totali i të ardhurave 2019	Përdorur gjate vitit 2019	Gjëndja në fund te vitit 2019
2019	**73,063**	**57,467**	**103,530**	**73,140**	**57,389**

Burimi: IIPP

Nga auditimi konstatohet se shpërndarja e fondit është bërë në zbatim të këtij vendimi .

Për vitin 2019, referuar të dhënave të INSAT, rezultojnë 16 ndërmarrje publike jo financiare. Konstatohet se vetëm 9 ndërmarrjen kanë paguar shumën prej 1% mbi fondin e pagave në vlerën totale 57,540 mijë lekë. Ndërsa ndërmarrjet e tjera që nuk kanë paguar, kanë vepruar në kundërshtim me ligjin sipas ligjit nr. 7598 , datë 01.09.1992 pika b) *shuma prej një për qind mbi fondin e pagave, që do të derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore."*

Ndërmarrjet shtetërore jo buxhetore që kanë paguar fondit prej 1% për vitin 2019, paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr. 32: Subjekte që kanë derdhur fondin Në mijë lekë

Nr.	**Subjektet qe kane derdhur 1%**	**Vlera totale 2019**
1	A.K.	7,797
2	P.Sh.	3
3	A...P..D	4,755
4	UK.L....	350
5	P.V....	750
6	O.....	38,787
7	UKT.....	1,722
8	E..K.i	303
9	N.....	73
	Totali	**57,540**

Burimi: IIPP

Gjatë vitit janë shpërndarë 76,140 mijë lekë fonde, ose 57% e totalit të fondit për vitin 2019. Kjo shpërndarje është bërë bazuar në 15 vendime të marra nga komisioni i administrimit të ndihmave ekonomike për shpërndarjen e fondit. *(Trajtuar në tabelën nr.2 në aneks).*

Nga llogaritja e të dhënave konstatohet se 52% e totalit të fondit të shpërndarë i zë ndihmat për individë dhe 48 % të totalit të fondit fondet e shpërndarë për shoqatat.

Bazuar në databasën e mbajtur nga Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimi i Projekteve rezulton se janë shpërndarë 532 ndihmat ekonomike, tek 297 persona në vlerën 7,480 mijë.

Gjatë vitit 2019 nuk është shpërndarë ndihmë ekonomike për rast emergjent. Në lidhje me sponsorizimet, janë shpërndarë fonde për të realizuar 3 aktivitete në vlerën 410 mije lekë si dhe 1 sponsorizim për botim libri në vlerë totale 97 mijë lekë. Janë shpërndare fonde për rikonstruksion shtëpie në vlerën 31,600 mijë sipas rregullores Kreu B, gërma c dhe Kreu D, gërma c. Konstatohet se mungon një databasë me të dhënat e personave përfitues se ndihmëse ekonomike për rikonstruksion shtëpie. Janë shpërndarë fonde për 10 shoqata, në vlerë totale 36,540 mijë lekë për të realizuar projekte për trajnimin profesional dhe ndihma ekonomike. Nga auditimi me zgjedhje rezultoi se sektori i financës i ka mbajtur saktë dokumentet justifikues financiar të bashkëngjitur me urdhër shpenzimin përkatës.

Sipas llogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit në bazë të informacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, frekuenca e shpërndarjes së fondit gjatë vitit 2019, për ndihma ekonomike për individë paraqitet si në vijim: 191 individë kanë marrë 1 herë ndihmë ekonomike; 49 individë kanë marrë 2 herë ndihmë ekonomike; 24 individë kanë marrë 3 herë ndihmë ekonomike; 11 individë kanë marrë 4 herë ndihmë ekonomike; 14 individë kanë marrë 5 herë ndihmë ekonomike; 4 individë kanë marrë 6 herë ndihmë ekonomike; 1 individ ka marrë 7 herë ndihmë ekonomike; 1 individ ka marrë 8 herë ndihmë ekonomike; 2 individë kanë marrë 9 herë ndihmë ekonomike.

Ndërsa frekuenca e shpërndarjes së fondit për shoqatat paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela nr. 33: Shoqatat përfituese nga fondi Në mijë lekë

Shoqatat	Frekuenca	Shuma
Sh..... A.....P.....	2	400
Sh.. B..... P.....	1	50
Sh.....T...B.....P..... P.....	10	5
Sh..... K.....D.....P.....P.....P.....	12	8
Sh.....K.....B.....P....Sh...	3	220
Sh...K.....T.....P.....P.....	1	70
Sh.....M.....e ish te B..... dhe te P....P.....te Sh.....	1	80
Sh.....I.....B..... P.....te Sh.....	12	12
Sh.....P.....A.....P.....P.....te Sh....	12	10
U.....M..... i I.....B..... P.....Sh.....	5	720
Totali	**59**	**36,540**

Burimi: IIPP

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2020. Detajimi i buxheti të vitit 2020, për IIPP është bërë me shkresën nr. 247/2 prot., datë 28.01.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shpenzimet korrente.

Tabela nr. 34: Çelja e shpenzimet korrente Në mijë lekë

Programi	Llog.Ekon.	Emërtimi	Buxheti
01190	600	Paga	19,500
01190	601	Sigurime Shoqërore	3,500
01190	602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	10,000
01190	604	Transferta Korrente të brendshme	3,000
	Totali i Shpenzimeve		**36,000**

Burimi: IIPP

Ndërsa shpenzimet kapitale janë çekur me shkresën nr. 307/3 prot., datë 28.02.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Tabela nr. 35: Shpenzimet kapitale Në mijë lekë

Programi	Llog. ekonomike	Kod Projekt	Emërtimi	Debiti
01190	231	18BA301	Pajisje kompjuterike-detyrim 2018	1,200
	Totali			**1,200**

Burimi: IIPP

Gjatë vitit 2020 nuk ka patur kërkesa për transferim apo alokim të fondit.

Mbi nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Për vitin buxhetor 2020, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Realizimi i zërave buxhetorë paraqitet si në tabelën me poshtë:

Tabela nr. 36: Realizimi i buxhetit, 2020 në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Plani vjetor	Plani i rishikuar	Fakti	Realizimi %	Pesha e art. ekonomik
600	Shpenzime page	19,500	19,500	16,757	86%	56 %
601	Sigurime shoqerore	3,500	3,500	2,751	79%	11 %
602	Mallra dhe sherbime	10	10	9,995	100%	24 %
604	Te Tjera Transfer.Korrente Brendshm	3,000	3,000	2,984	99%	9 %
231	Shpenzime kapitale	1,200	1,200	1,099	92 %	3.2%
	Totali i shpenzimeve buxhetore	**37,200**	**37,200**	**33,589**	**90 %**	
604	Transfer.Korrente Brendshm nga jo buxhetoret	116,854	116,854	74,550	29%	
231	Shpenzime per investime	0	0			
Totali	**Totali i shpenzimeve**	**154,154**	**154,154**	**108,188**	**71.2%**	**100 %**
	Numri i punonjesve	**23**	**23**	**20**	**87%**	

Burimi: *IIPP, përpunim nga grupi audites*

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për vitit 2020 janë realizuar në masën 90%, ose 33,589 mijë lekë nga 37,200 mije lekë të parashikuara. Artikulli ekonomik 604 "të ardhurat nga ndërmarrjen shtetërore jo buxhetore" është realizuar në masën 29% . Gjatë vitit 2020 janë përdorur të gjithë fondet e trashëguara nga vitit 2019 (57,390 mijë lekë) dhe 17,160 mijë lekë të fondi nga vitit 2020. Fondi i pashpërndarë prej 42,304 mijë lekë është trashëguar në vitin pasardhës. Artikulli ekonomik 231 "shpenzime kapitale", është realizuar në masën 92 %. Me këtë shpenzim është shlyer detyrimi i prapambetur për pajisjet kompjuterike të blera në vitin 2018.

Totali i të ardhurave të IIPP, për vitin 2020 është në vlerën 119,854 mijë lekë nga të cilat 3,000 mijë lekë janë nga buxheti i shtetit dhe 116,854 mije lekë nga ndërmarrjet jo buxhetore për ti shpërndarë sipas VKM nr.392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetarë".

Tabela nr. 37: Të ardhurat nga ndërmjet jo buxhetore për vitin 2020 Në mijë lekë

Viti	Të trashëguara	Të ardhura në 2020	Totali i të ardhurave 2020	Përdorur gjate vitit 2020	Gjëndja në fund te vitit 2020
2020	**57,390**	**59,464**	**116,854**	**74,550**	**42,304**

Burimi: IIPP

Për vitin 2020, referuar të dhënave në INSAT konstatohet se janë 26 ndërmarrje publike jo buxhetore. Rezulton se 8 ndërmarrjen shtetërore kanë paguar shumën prej 1% mbi fondin e pagave në vlerën totale 59,464 mijë lekë. Ndërsa ndërmarrjet e tjera që nuk kanë paguar, kanë vepruar në kundërshtim me ligjin sipas ligjit nr. 7598 , datë 01.09.1992 pika b) *shuma prej një për qind mbi fondin e pagave, që do të derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore."*

Tabela nr. 38: Subjekte që kanë derdhur fondin Në mijë lekë

Nr.	Subjektet që kanë derdhur 1%	Vlera totale 2020
1	A..K...	3,215
2	P..Sh....	3
3	A...	4,950
4	D.....	7,759
5	P...V....	700
6	O....	37,448
7	U. T..	1,628
8	E....K...	761
Totali		**59,464**

Burimi: IIPP

Gjatë vitit 2020 janë shpërndarë 77,534 mijë lekë fonde, ose 64 % e totalit të fondit të vitit prej 116,854 mijë lekë. Kjo shpërndarje është bërë bazuar në 14 vendime të marra nga komisioni i administrimit të ndihmave ekonomike për shpërndarjen e fondit. *(Trajtuar në tabelën nr. 3 në aneks).* Nga llogaritja e të dhënave, konstatohet se 56% e totalit të fondit i zënë ndihmat ekonomike, sponsorizimiet, rikonstruksionet e shtëpie dhe 44% të totalit të fondit janë shpërndarë për shoqatat.
Bazuar në databasën e mbajtur nga Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimi i Projekteve rezulton se janë shpërndarë 567 ndihmat ekonomike tek 271 persona përfitues, në vlerën 4,800 mijë. Gjatë vitit 2020 nuk është shpërndarë ndihmë ekonomike për rast emergjent. Në lidhje me sponsor, gjatë vitit janë shpërndarë fonde për të sponsorizuar botimin e 2 librave në vlerën 154 mije lekë, konkretisht: "H.M. midis legjendës dhe të vërtetës" dhe "Bukë e kripë e zemër".
Janë shpërndare fonde për rikonstruksion shtëpie, në vlerën 38,450 mijë sipas rregullores pika B, gërma c dhe pika D, gërma c. Mungon një databasë me të dhënat e personave përfitues se ndihmëse ekonomike për rikonstruksion shtëpie.
Janë shpërndarë fonde për 7 shoqata në vlerë totale 34,130 mijë lekë për të realizuar projekte për trajnimin profesional dhe ndihma ekonomike.
Nga auditimi me zgjedhje rezultoi se sektori i financës i ka mbajtur saktë dokumentet justifikues financiar të bashkëngjitur me urdhër shpenzimin përkatës.

Gjatë vitit 2020, sipas llogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit në bazë të informacionit të vënë në dispozicion, frekuenca e shpërndarjes së fondit për individët rezulton se: 135 individë kanë marrë 1 herë ndihmë ekonomike; 58 individë kanë marrë 2 herë ndihmë ekonomike; 29 individë kanë marrë 3 herë ndihmë ekonomike; 24 individë kanë marrë 4 herë ndihmë ekonomike; 20 individë kanë marrë 5 herë ndihmë ekonomike; 2 individë kanë marrë 6 herë ndihmë ekonomike dhe 3 individë kanë marrë 7 herë ndihmë ekonomike.

Ndërsa frekuenca e shoqatave që kanë përfituar fonde për vitin 2020, paraqitet si në vijim:
Tabela nr. 39: Shoqatat përfituese nga fondi i vitit 2020 Në mijë lekë

Shoqatat	Frekuenca	Shuma
A..... P.....P.....	1	550
T..... B.....P.....P.....	5	5
K.....e ish te D.....P.....P.....	11	9
K.... B.....P.....Sh.....	1	100
I.....B.....P.....P.....	11	10
Sh.....P.....A.....P.....P.....Sh.....	11	9
M.....I.....B..... P.....	2	480
Totali	**42**	**34,130**

Burimi: IIPP, përpunuar nga grupi auditues

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2021. Detajimi i buxheti të IIPP është bërë me shkresën nr. 320/1 prot., datë 20.01.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Tabela nr. 40: Shpenzimet korrente Në mijë lekë

Programi	Llog.Ekon.	Emërtimi	Buxheti
01190	600	Paga	19,500
01190	601	Sigurime Shoqërore	3,290
01190	602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	12,210
Totali i Shpenzimeve			**35**

Burimi: IIPP

Mbi transferimin e fondeve buxhetore

Me shkresë nr. 2702 prot., datë 04.06.2021 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka kërkuar transferim fondi me qëllim kompensimin e ish të përndjekurve politik në zbatim të VKM nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar të krijuar sipas ligjit nr.7598, datë 01.09.1999. Me shkresë nr. 10748/1 prot., datë 24.06.2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar kërkesën për transferim fondi .

Tabela nr. 41: Mbi ndryshimin e fondeve në mijë lekë

Artikulli	Emertimi	Shtesa	Pakesime
602	Mallra dhe Sherbime		3
604	Transferta te brendshme	3	
Totali	**Totali**	**3**	3

Burimi: IIPP

Me shkresën nr. 10159/1 prot., datë 01.10.2021 të MFE është dërgohet akordimi i fondit të veçantë, në vlerën 200 mijë lekë.

Auditimi mbi nivelet e realizimit të planit buxhetor.

Për vitin buxhetor 2021, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit IIPP për vitin 2021 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 42: Detajimi i zërave buxhetor në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Plani vjetor 2021	Plani i rishikuar 2021	Fakti 12 mujori	Realizimi%	Pesha e art. ekonomik
600	Shpenzime page	19,500	19,500	16,941	87%	55 %
601	Sigurime shoqerore	3,500	3,290	2,784	85%	9 %
602	Mallra dhe sherbime	12,210	9,210	9,209	100%	26 %
604	Te Tjera Transfer.Korrente Brendshm	0	3,000	3,000	100%	9 %
606	Fondi vecante	200	200	96	48%	1%
231	Shpenzime kapitale					
	Totali i shpenzimeve buxhetore	**35,200**	**35,200**	**32,032**	**91 %**	**100 %**
604	Transfer.Korrente Brendshm nga jo buxhetoret	76,754	76,754	73,165	95%	
231	Shpenzime per investime	0	0			
Totali	**Totali i shpenzimeve**	**111,954**	**111,954**	**105,196**	**71.2%**	**100 %**
	Numri i punonjësve	**23**	**23**	**20**	**87%**	

Burimi: IIPP, përpunim nga grupi auditues

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për vitit 2021 janë realizuar në masën 91%, ose 32,032 mijë lekë nga 35,200 mije lekë të planifikuara. Artikulli ekonomik 604 "Tranferta korrente të brendshme nga ndërmarrjet jo buxhetore" është realizuar në masën 95%, më i lartë krahasuar me vitet e kaluara. Janë shpërndarë 73,165 mije lekë nga të cilat 42,304 mijë lekë të trashëguara nga vitit 2020 dhe 30,860 mijë lekë të ardhura në vitin 2021.

Totali i të ardhurave të IIPP, për vitin 2021 është në vlerën 79,755 mijë lekë nga të cilat 3,000 mijë lekë janë nga buxheti i shtetit dhe 76,754 mije lekë nga ndërmarrjet jo buxhetore për t'i shpërndarë sipas vendimit nr.392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar".

Tabela nr. 43: Të ardhurat nga ndërmarrjet jo buxhetore për vitin 2021 në mijë lekë

Viti	Të trashëguara	Të ardhura në 2021	Totali i të ardhurave 2021	Përdorur gjate vitit 2021	Gjëndja në fund te vitit 2021
2021	**42,304**	**34,450**	**76,754**	**73,165**	**3,590**

Burimi: IIPP

Për vitin 2021, referuar të dhënave të INSAT rezultojnë 27 ndërmarrje publike jo financiare. Konstatohet se 5 ndërmarrjen shtetërore kanë paguar shumën prej 1% mbi fondin e pagave në vlerën totale 34,450 mijë lekë. Ndërsa ndërmarrjet që nuk kanë paguar kanë vepruar në kundërshtim me ligjin sipas ligjit nr. 7598 , datë 01.09.1992 pika b) *shuma prej një për qind mbi fondin e pagave, që do të derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore."*

Tabela nr. 44: Subjekte që kanë derdhur fondin në mijë lekë

Nr.	Subjektet qe kane derdhur 1%	Vlera totale, 2021
1	P.....S.	3
2	A.....	6,031
3	D.....D.....	9,777
4	U.....K.....T.....	15,100
5	E.....K.....i B.....	542
	Totali	**34,450**

Burimi: IIPP

Janë shpërndarë 76,165 mijë lekë fonde ose 95% e totalit të fondit prej 79,755 mijë lekë. Gjatë vitit 2021 janë marrë 16 vendime nga komisioni i administrimit të ndihmave ekonomike për shpërndarjen e fondit. *(Trajtuar në tabel*ën *nr. 4 n*ë *aneks*).

Nga llogaritja e të dhënave konstatohet se 51% e totalit të fondit e zënë: ndihmat ekonomike, sponsorizimet, rikonstruksionet e shtëpive dhe 49% të totalit të fondit janë shpërndarë për shoqatat. Bazuar në databasën e mbajtur nga Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimi i Projekteve janë shpërndarë 420 ndihmat ekonomike tek 307 persona përfitues në vlerën 4,345 mijë. Gjatë vitit 2021 është shpërndarë një ndihmë ekonomike për rast emergjent ne vlerën 100 mijë lekë. Nga auditimi i dosjes së përfituesit konstatojmë që është në përputhje me rregulloren "Rregullore e funksionimit të komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" Kreu B, nr.1, gërma a.

Në lidhje me sponsor, gjatë vitit janë shpërndarë fonde për të sponsorizuar një aktivitet në Tepelenë për "Ditën Ndërkombëtare të Zhdukurve" .

Janë shpërndare fonde për rikonstruksion shtëpie në vlerën 34,450 mijë sipas rregullores kreu B, gërma c dhe kreu D, gërma c. Janë shpërndarë fonde për 8 shoqata në vlerë totale 37,330 mijë lekë për të realizuar projekte për trajnimin profesional dhe ndihma ekonomike. Nga auditimi me zgjedhje rezultoi se sektori i financës i ka mbajtur saktë dokumentet justifikues financiar të bashkëngjitur me urdhër shpenzimin përkatës.

Sipas llogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit në bazë të informacionit të vënë në, frekuenca e shpërndarjes së fondit, gjatë vitit 2021, për individët, rezulton se: është si më poshtë: 250 individë kanë marrë 1 herë ndihmë ekonomike; 23 individë kanë marrë 2 herë ndihmë ekonomike; 18 individë kanë marrë 3 herë ndihmë ekonomike; 12 individë kanë marrë 4 herë ndihmë ekonomike; 2 individë kanë marrë 5 herë ndihmë ekonomike; 2 individë kanë marrë 6 herë ndihmë ekonomike.

Ndërsa shpërndarja e fondit për shoqatat sipas frekuencës, për vitin 2021 paraqitet si në vijim:

Tabela nr. 45: Shoqatat përfituese nga fondi i vitit 2021 Në mijë lekë

Shoqatat	Frekuenca	Shuma
I.....B.....P.....	13	12
K.....D..... P.....P.....	13	11
P....A.....P.....P.....Sh.....	13	11
Sh.....T.....B.....B.....P.....P.....	3	2,400
U.....M....I.....B.....P.....	3	400
A.....P.....P....	2	250
Sh.....K.....B.....P.....	2	140
Sh.....M..... P.....P.... P.....	1	140
Totali	**50**	**37,330**

Burimi: IIPP, përpunim nga grupi audituesi

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2022. Detajimi i buxheti të vitit 2022 për IIIP është bërë me shkresën nr. 5256/4 prot., datë 11.01.2022 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Tabela nr. 46: Shpenzimet korrente Në mijë lekë

Programi	Llog.Ekon.	Emërtimi	Buxheti
01190	600	Paga	18,664
01190	601	Sigurime Shoqërore	3,117
01190	602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	11,210
01190	605	Tranferta te brendshme	3
	Totali i Shpenzimeve		**35,991**

Burimi: IIPP

Me shkresë nr. 367/2 prot., datë 03.02.2022, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar pranë IIPP akordimin e fondit të veçantë për vitin 2022 për artikullin ekonomik 606 në vlerën 250 mijë lekë. Konstatohet se nuk ka çelje fondi për art. 231 .

Mbi transferimin e fondeve buxhetore

Me shkresë nr. 988/1 prot., datë 28.02.2022 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kërkuar rialokim fondi korent nga art.605 në art.604 për kompensim për ish të përndjekurit politik. Me shkresë nr. 4091/1 prot., datë 10.03.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar kërkesën për transferim fondi .Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar pranë IIPP shkresën me nr.988/2 prot., datë 23.03.2022 .

Tabela nr. 47: Mbi ndryshimin e fondeve Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Shtesa	Pakesime
605	Transferta korrente		3,000
604	Transferta te brendshme	3,000	
Totali		**3,000**	3,000

Burimi: IIPP

Me shkresë nr.1333/4 prot., datë 06.04.2022 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 12.03.2022, ka dërguar transferimin e fondeve pranë IIPP .

Tabela nr. 48: Mbi ndryshimin e fondeve Në mijë lekë

Artikulli	Emertimi	Pakesime
600	Paga	467
601	Sigurime shoqerore	78
602	Mallra dhe Sherbime	1,121
Totali		1,666

Burimi: IIPP

Auditimi mbi nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Për vitin buxhetor 2022, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, për 6-mujorin e parë të vitit 2022. Situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit IIPP për 6-mujorin e parë të vitit 2022 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 49: Detajimi i zërave buxhetor Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Plani vjetor 2022	Plani i rishikuar 2022	Fakti 6 mujori	Realizimi%	Pesha e art. ekonomik
600	Shpenzime page	18,664	18,197	8,591	47%	53 %
601	Sigurime shoqerore	3,117	3,039	1,430	47%	9 %
602	Mallra dhe sherbime	11,210	10,089	3,157	31%	29 %
604	Te Tjera Transfer.Korrente Brendshm	3,000	3,000	0	0%	9 %
606	Fondi vecante	250	250	57	23%	1%
	Totali i shpenzimeve buxhetore	**36,241**	**34,575**	**13,235**	**38 %**	**100 %**
604	Transfer.Korrente Brendshm nga jo buxhetoret	3,590	3,590	2,348	65%	

231	Shpenzime per investime					
Totali	**Totali i shpenzimeve**	**39,581**	**38,165**	**15,583**	**41%**	**100 %**
	Numri i punonjësve	**24**	**24**	**23**	**87%**	

Burimi: IIPP, përpunim nga grupi audites

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për 6-mujorin e parë të vitit 2022 janë realizuar në masën 38% ose 13,235 mijë lekë nga 36,241 mijë lekë të parashikuara.

Totali i të ardhurave të IIPP për 6-mujorin e parë të vitit 2022 është në vlerën 6,590 mijë lekë nga të cilat 3,000 mijë lekë janë nga buxheti i shtetit dhe 3,590 mije lekë nga ndërmarrjet jo buxhetore për ti shpërndarë sipas vendimit nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar".

Tabela nr. 50: Të ardhurat nga ndërmarrjet jo buxhetore për vitin 2022 në mijë

Viti	Të trashëguara	Të ardhura në 2022	Totali i të ardhurave 2022	Përdorur gjate vitit 2022	Gjëndja në 6-mujorin
2022	**3,590**	**7,500**	**11,090**	**2,348**	**9,742**

Burimi: IIPP

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2022 janë shpërndarë 3,799 bazuar në 4 vendime nga Komisioni i administrimit të ndihmave ekonomike për shpërndarjen e fondit. *(Trajtuar në tabelën nr. 5 në aneks).*

Nga llogaritja e të dhënave konstatohet se 60% e totalit të fondit e zënë ndihmat ekonomike, sposorizimet, rikonstruksion shtëpie dhe 40% të totalit të fondit janë shpërndarë për shoqatat.

Sipas llogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit në bazë të informacionit të vënë në dispozicion, frekuenca e shpërndarjes së fondit gjatë vitit 2022 është si më poshtë: 47 individë kanë marrë 1 herë ndihmë ekonomike; 26 individë kanë marrë 2 herë ndihmë ekonomike; 16 individë kanë marrë 3 herë ndihmë ekonomike; 13 individë kanë marrë 4 herë ndihmë ekonomike; 3 individë kanë marrë 5 herë ndihmë ekonomike; 2 individë kanë marrë 6 herë ndihmë ekonomike; 1 individ ka marrë 7 herë ndihmë ekonomike.

Ndërsa shpërndarja e fondit për shoqatat sipas frekuencës për vitin 2022, paraqitet si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 51: Shoqatat përfituese nga fondi i vitit 2022 në mijë

Shoqatat	**Frekuenca**	**Shuma**
K.....D.....P.....P.....	2	1,250
U.....M.....I.....B.....P.....	1	200
K..... B.....P.....	1	70
Totali	**4**	**1,520**

Burimi: IIPP, përpunim nga grupi audites

<u>Mbi monitorimin e fondit të veçantë</u>

Nga auditimi i dosjeve me zgjedhje rezultoi se gjatë periudhës 2018-2021 ka mangësi në dokumentacion në fazën kur behët kërkesa nga shoqata për alokim fondi për projekt ashtu edhe në fazën e monitorimit mbi përdorimin e fondeve nga komisioni i monitorimit. Kampion për testim janë dosjet e shoqatave që kanë përfituar disa herë fonde gjatë vitit, dosjet e individëve për rikonstruksion shtëpie dhe dosjet e individëve që kanë përfituar disa herë gjatë vitit ndihmë ose kanë përfituar ndihmën maksimale prej 100 mijë lekë.

Shoqata paraqet pranë komisionit të administrimit të ndihmave ekonomike kërkesën për përfitimin e fondeve mbi realizmin e projekti "Trajnim profesional" në fusha të ndryshme apo "Rikonstruksion shtëpie" për të përndjekurit në vështirësi ekonomike. Në rastin e projekteve

"Trajnim profesional" në fusha të ndryshme kjo kërkesë shoqërohet vetëm me dokumente: kartë identiteti të personave që do të marrin pjesë në trajnim, lista emërore dhe një preventiv. Konstatohet se të gjitha kërkesat që bëhen nga shoqatat për lëvrim fondi janë të aprovuara nga Komisioni i Administrimit të ndihmave ekonomike. Grupi i auditimit nuk konstatoi asnjë kërkesë të refuzuar gjatë periudhës së auditimit.
Monitorimi i përdorimit të fondeve bëhet nëpërmjet Komisionit të Monitorimit i cili është ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 44, datë 18.01.2018. Konstatohet se nuk ka një procedurë administrative për aktivitetin e tij monitorues .
Në përfundim të projektit, Komisioni i Monitorimit mban një procesverbal me kryetarin e shoqatës. Konstatohet se gjatë periudhës 2018-2021 ky proces-verbal nuk është protokolluar. Dokumentet justifikues që vendosen edhe në procesverbal mbi përdorimin e fondeve janë vetëm faturat që subjekti ka lëshuar për shoqatën për shërbimin e kryer dhe lista e pjesëmarrësve në trajnim. Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të vitit 2022 konstatohet se, komisioni i monitorimit ka marrë dokumente origjinal të mjaftueshëm që vërtetojnë kryerjen e shpenzimit, këto dokumente janë pjesë e dosjes së monitorimit. Evidentohet se edhe në vitin 2022 , ky komision nuk i ka të organizuar apo të grumbulluar në një dokument të gjithë informacionin për të dhënat e përfituesve. Konstatojmë se për vitet 2018-2022 mungon një databasë me të dhënat e individëve apo shoqatave që kanë përfituar ndihmë ekonomike.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë nga subjekti i audituar janë paraqitur observacionet me nr. 471/1 prot., datë 20.12.2022 "Observacion mbi Projekt Raportin" nga përfaqësuesit e Instituti Integrimit ish të përndjekurve politik, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Bazuar në ligjin Nr. 7598 datë 1.9.1992 "Per Krijimin e Fondit te Vecante Monetar per Ish te Denuarit e te Perndjekurit" dhe rregulloren nr. 356 prot. Datë 12.04.2018 "Rregullore e funksionimit te Komisionit te trajtimit të ndihmave eknomike: ku specifikohen qartë përbërja dhe detyrat e komisionit, kriteret e pergjithshme te perdorimit të këtij fondi, si dhe dokumentacioni i cili do të plotësohen për përfitimin e këtij fondi. Komisioni i monitorimit ka ndjekur në terren të gjitha aktivitetet e zhvilluara në bashkëpunim me shoqatat përfaqësuese të kësaj shtrese duke mbajtur proces-verbale përkatëse dhe duke kontrolluar të gjithë dokumentacionin e shoqatave. Nga viti 2022 komisioni ka shtuar dokumentacionin justifikues duke përmisuar proçedurat e monitorimit të aktiviteteve të zhvilluara. IIPP me miratimin e rregullores së re të funksionimit do të marre masa për shtimin e mekanizmave monitoruese si dhe krijimin e një database me të gjitha të dhënat e kriteret e përfituesve të këtyre fondeve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Pas shqyrtimit të observacionit grupi i auditimit thekson se nuk mjafton vetëm ndjekja ne terren e projekteve, por duhet që komisioni monitorues të ketë dokumentet justifikues mjaftueshem në dosjen e monitorimit që justifikojne shpenzimin e bërë nga përfituesi si edhe krijimi i një database mbi përfituesit e fondit.

Gjetja:	Problematika në monitorimin e projekteve gjatë periudhës 2018-2021.
Situata:	Nga auditimi rezulton se për periudhën 2018-2021, Komisioni i Monitorimit nuk ka administruar dokumentacion të mjaftueshëm justifikues mbi shpenzimin e kryer nga përfituesit e projekteve. Gjithashtu konstatohet se Komisioni i Monitorimit nuk i ka të organizuar apo të grumbulluar në një dokument të gjithë informacionin për të dhënat e përfituesve, duke sjellë për pasojë mungesë evidencash të mjaftueshme mbi përdorimin e fondit të veçantë.

Kriteri:	- Ligji nr.7598,datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish të përndjekurve politik", neni nr.1, shkronja b. - Ligji nr. 10296, date 08.07.2010 , "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 22 dhe neni 24.
Impakti:	Nuk ka siguri dhe transparencë që fondi i veçantë përdoret për qëllimin e dhënë.
Shkaku:	Mungesa e një procedure administrative që përcakton në mënyre të hollësishme veprimtarinë e komisionit të monitorimit si dhe dokumentacionin justifikues të domosdoshëm mbi të cilën do të bazohet monitorimi.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Komisioni i monitorimit të marrë për plotësimin e praktikës me dokumente të mjaftueshëm me qëllim justifikimin e shpenzimit të bërë nga përfituesit e ndihmës ekonomike si edhe të krijojë një sistem për të menaxhuar informacionin mbi përfituesit e fondeve.(databasë)

2.5.2 Mbi programimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit për Institutin e Studimeve për Krimet e Pasojat e Komunizmit (ISKK)

Instituti i Studimeve për Krimet e Pasojat e Komunizmit, në zbatimin e buxhetit të vitit 2019, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, "Për krijimin e ISKK".

PBA 2019-2021

ISKK, ka dërguar në Ministrinë e Financave me shkresë nr. 608, datë 27.04.2018, kërkesat buxhetore për PBA Faza I, në zbatim të shkresës nr. 3535/4 prot., datë 28.02.2018 si edhe Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 të MF "Për përgatitjen e PBA 2019-2021", në përputhje me tavanet e miratuara me VKM nr.128, datë 07.03.2018.

Rezulton një rritje me 2,000 lekë në shpenzimet kapitale për vitin 2019, e cila vjen si pasojë e rritjes së shpenzimeve për politika të reja dhe 1,000 mijë lekë për politikat ekzistuese. Për vitin 2019, ISKK ka parashikuar blerjen e një automjeti, me vlerë 2,000 mijë lekë.

Për politikat ekzistuese, për vitin 2019, ISKK ka planifikuar shumën 400 mijë lekë për blerje pajisje zyrash, kompjutera sipas kërkesave të diktuara nga AKSHI dhe shumën 600 mijë lekë për zgjerimin e rafteve të bibliotekës së institutit për ekspozimin e librave. Shpenzimet për paga janë planifikuar 18,330 mijë shpenzimet për sigurimet shoqërore janë planifikuar 2,970 mijë lekë.

Konstatohet se kërkesat buxhetore janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 7/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e PBA 2019-2021". Janë evidentuar dhe kostuar politikat ekzistuese si dhe kërkesa buxhetore janë miratuar brenda tavanit për ISKK të përcaktuar me VKM nr. 128, datë 07.03.2018.

Faza II: ISKK, ka dërguar në Ministrinë e Financave me shkresë nr. 640 , date 28.08.2018 kërkesat buxhetore për PBA 2019-2021 Faza II, në zbatim të shkresës nr. 3535/74 date 09.07.2018 , si edhe Udhëzimit plotësues nr.7/2 , datë 09.07.2018 te MF" për përgatitjen e PBA 2019-2021". Kostoja e politikave ekzistuese dhe atyre të reja paraqitet si më poshtë për PBA 2019-2021:

Për artikullin ekonomik 600-601: Janë planifikuar 19 punonjës me një fond pagë 18,770 mijë lekë dhe fonde për sigurime shoqërore në vlerën 2,970 mijë lekë .

Për artikullin ekonomik 602: Kosto e politikes ekzistuese e të gjithë produktit është 11,700 mijë lekë.

Për artikullin ekonomik 231: Kosto është planifikuar 3,000 mijë lekë. Konkretisht për produktin 1, "Zgjerim i rafteve për ekspozimin e librave" në shumën 400 mijë lekë; produkti 2, "Blerje pajisje kompjuterike" në shumën 600 mijë lekë. Kosto e politikes së re Produkti 3, "Blerje automjet i ri" është 2,000 mijë lekë.
Konstatohet se kërkesat buxhetore janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar.

Konstatohet se në fazën e dytë kërkesa buxhetore është mbi tavanin përfundimtare të alokuar për vitin 2019 dhe 2020 dhe 2021 konkretisht:

Tabela nr. 52: Kërkesa buxhetore

Nr i llogarise	Emërtimi	Faza II	Tavanet 2019	Diferenca	Tavanet 2020	Kerkesa 2020	Diferenca	Tavanet 2021	Kerkesa 2021	Diferenca
600-601	Paga dhe Sigurime	21,740	21,300	**440**	21,300	21,740	**440**	21,300	21,740	**440**
602	Mallra dhe Sherbime	11,700	11,700	0	11,700	12,200	**500**	11,700	12,700	**1,000**
230+231	Shpenzime kapitale	3,000	1,000	**2,000**	1,000	1,000	0	1,000	1,000	0
Totali		**36,440**	**34,000**	**2,440**	**34,000**	**34,940**	**940**	**34,000**	**35,440**	**1,440**

Burimi: ISKK

Shtesa prej 440 mijë lekë mbi tavanin e miratuar për vitet 2019, 2020 dhe 2021 vjen si pasojë e 4 punonjësve të rinj që janë planifikuar për t'u shtuar në organikën e ISKK dhe që janë miratuar nga Komisioni i Ligjeve në Kuvend. Në lidhje me shpenzimet korrente diferenca 500 mijë lekë vjen si pasojë e kërkesave në rritje për librat e botuar dhe dëshmitë e marra vizuale. Shtesa për shpenzimet kapitale është si pasojë e kërkesës për blerjen e një automjeti të ri në shumën 2,000 mijë lekë.

Faza III: IISKK ka dërguar me shkresë nr. 8 prot., datë 22.01.2019, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën buxhetore për Fazën e III-të në zbatim të shkresës nr. 471 prot., datë 14.01.2019. Kosto për artikullin 600-601 është 19,830 mijë lekë për fondin e pagave dhe 2,970 mije lekë për fondin e sigurimeve shoqërore.

Tabela nr. 53: Faza III në mijë lekë

Nr i llogarise	Emertimi	Faza III	Celja Buxhetore	Faza III 2020	Buxheti 2020	Faza III 2021	Buxheti 2021
600-601	Paga dhe Sigurime	22,800	22,800	22,800	22,800	22,800	22,800
602	Mallra dhe Sherbime	11,700	11,700	12,700	12,700	13,200	13,200
230+231	Shpenzime kapitale	2,000	2,000	1,000	1,000	1,000	1,000
Totali		**36,500**	**36,500**	**36,500**	**36,500**	**37,000**	**37,000**

Burimi: ISKK

Konstatohet se kërkesa buxhetore për Fazën III është në përputhje me tavanet e miratuara me ligjin nr. 99/2018 "Për buxhetin 2019"; shkresën nr. 22760/107 prot., datë 17.01.2019 "Mbi miratimin e detajimit të planit të buxhetit për vitet 2019-2021"; Shkresën dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nr. 22760/138 prot., datë 21.01.2019 "Detajimi i limit mujorë për vitin 2019".

PBA 2020-2022

Faza I: ISKK ka dërguar kërkesën buxhetore PBA 2020-2022 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë shkresën me nr. 171 prot., datë 26.04.2019, në përputhje me Tavaneve Përgatitore të PBA 2020-2022 të miratuara me VKM nr. 117, datë 13.03.2019.
Kosto për artikullin ekonomik 600-601 është planifikuar në vlerë totale 22,000 mijë lekë, nga të cilat 19,030 mijë lekë për pagat dhe në vlerën 2,970 mijë lekë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Kosto për artikullin ekonomik 602 është planifikuar në vlerën 13,500 mijë lekë për vitin 2020, 14,000 mije lekë për vitet 2021 dhe 2022. Kosto për artikullin ekonomik 231 është planifikuar në vlerën 1,000 mijë lekë për tre vite. Konkretisht për produktin 1, "Blerja e pajisjeve

të zyrës" në shumën prej 400 mijë lekë dhe produktin 2 "Blerja e pajisjeve kompjuterike" në shumën prej 600 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se për buxhetin e vitit 2019 planifikimi i shpenzimeve korrente është në vlerën 35,500 mijë lekë dhe i shpenzimeve kapitale është në vlerën 1,000 mijë lekë. Konstatohet se kërkesa buxhetore është dorëzuar brenda afateve, por nuk janë respektuar tavanet e miratuara me VKM nr. 117 date 13.03.2019 për shpenzimet korrent.

Tabela nr. 54: Tejkalimi i tavaneve Në mijë lekë

Zeri	Tavani 2020	Shtesa 2020	Tavani 2021	Shtesa 2021	Tavani 2021	Shtesa 2022
Shpenzime korrente	34,500	1,000	34,500	1,500	34,500	1,500
Totali	**34,500**	**1,000**	**34,500**	**1,500**	**34,500**	**1,500**

Burimi: ISKK

Rezulton tejkalim të shpenzimeve korrente në shumën 1,000 mijë lekë për vitin 2020 dhe rritje për artikullin ekonomik 602 në vlerën 1,500 mijë lekë për vitet 2021 dhe 2022.

Faza II: ISKK ka dërguar kërkesën buxhetore PBA 2020-2022 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën me nr. 233 prot., datë 28.08.2019. Nga dokumentet e venë në dispozicion rezulton planifikimin sipas zërave si më poshtë:

Për artikullin 600 dhe 601, për 19 punonjësit është planifikuar një fond page prej 19,030 mijë lekë dhe sigurime shoqërore prej 2,970 mijë lekë.

Për artikullin ekonomik 602, kostoja e politikës ekzistuese e gjithë produktit është 12,500 mijë l

Konstatojmë se kërkesat buxhetore për fazën e dytë janë dorëzua brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin plotësues nr. 21, datë 10.07.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022" dhe është brenda limiteve të tavanit të miratuar .

Faza III: Me shkresë nr.7 prot., datë 23.01.2020, ISKK ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përditësimin e formatit 2 të PBA 2020-2024 në përputhje me tavanet e miratuara me ligjin nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020".

Tabela nr. 55: Faza III

Nr i llogarisë	Emertimi	Faza III 2020	Buxheti 2020	Faza III 2021	Buxheti 2021	Faza III 2022	Buxheti 2022
600-601	Paga dhe Sigurime	22,000	22,000	22,000	22,000	22,000	22,000
602	Mallra dhe Sherbime	11,500	11,500	12,500	12,500	13,500	13,500
230+231	Shpenzime kapitale	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
Totali		**35,500**	**35,500**	**36,500**	**36,500**	**37,500**	**37,500**

Burimi: ISKK

Konstatohet se kërkesat buxhetore janë dërguar brenda afatit të kërkuar nga MFE dhe janë brenda limiteve të shpenzimeve të miratuara me ligjin nr.88/2019 "Për buxhetin 2020".

PBA 2021-2023

Faza I: ISKK nuk ka dërguar kërkesë buxhetore bazuar në Aktin Normativ nr.17, datë 22.04.2020 neni nr. 1, ku citohet se *"Përjashtimisht për vitin 2020, si pasojë e situatës epidemike të shkaktuar nga COVID-19, procedurat dhe afatet për përgatitjen e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nuk zbatohen"*.

Faza II: ISKK ka dërguar në Ministrinë e Financave me shkresë nr. 95, datë 31.08.2020 kërkesat buxhetore për Fazën teknike (Faza II) PBA 2021-2023 në zbatim të tavaneve të miratuara me VKM nr. 577/2020 "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të përgatitjes së programit Buxhetor

Afatmesëm 2021-2023" si edhe në mbështetje të Udhëzimit plotësues nr.28, datë 10.07.2020 " Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021- 2023".
Kostoja e politikave ekzistuese dhe atyre të reja për të gjitha vitet e PBA 2021-2023 është paraqitur si më poshtë: Për artikullin ekonomik 600 dhe 601 është planifikuar një fond page prej 19,100 mijë lekë dhe sigurime shoqërore prej 3,000 mijë lekë; Për artikullin ekonomik 602 , kosto e politikës ekzistuese e të gjithë produktit për këtë artikull është 12,900 mijë lekë; Për artikullin ekonomik 231, kosto e politikes ekzistuese për produktet është planifikuar 1,000 mije lekë .Konkretisht për produktin 1, "Blerje e pajisjeve të zyrës " në shumën 400 mijë lekë dhe produkti 2 "Blerje e pajisjeve kompjuterike" në shumën 600 mijë lekë.
Nga auditimi konstatohet se për buxhetin e vitit 2021, planifikimi i shpenzimeve korrente është në vlerën 35,000 mijë leke dhe i shpenzimeve kapitale është në vlerën 1,000 mijë lekë.

Tabela nr. 56: PBA 2021-2013 Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Tavani PBA 2021	Kërkesa 2021	Tavani PBA 2022	Kërkesa 2022	Tavani PBA 2023	Kërkesa 2023
Shpenzimet korrente	35,000	35,000	36,500	36,500	36,500	36,500
Shpenzime kapitale	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
Totali	**36,000**	**36,000**	**37,500**	**37,500**	**37,500**	**37,500**

Burimi: ISKK

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se kërkesat buxhetore për fazën e dytë janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 28, datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023". Institucioni ka respektuar tavanin e alokuar dhe shpërndarjen e tij sipas programit.

PBA 2022-2024

ISKK, ka dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 62, datë 29.04.2021, kërkesat buxhetore për Fazën strategjike (Faza I) në zbatim të shkresës nr. 4010/1 prot., datë 26.02.2021 si edhe Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 të MF "Për përgatitjen e PBA 2022-2024".
Për artikullin Ekonomik 600-601: Janë planifikuar 19 punonjës me një fond page 21,700 mijë lekë dhe fond për sigurime shoqërore prej 3,300 mijë lekë, brenda tavaneve të miratuara. Për artikullin ekonomik 602: Kosto e politikës ekzistuese është planifikuar 12,960 mijë lekë e shpërndarë për realizimin e produkteve, brenda tavanit të alokuar për vitin 2021. Për Artikullin Ekonomik 231: Kosto e politikës ekzistuese për produktet është planifikuar 1,000 mijë lekë, financuar brenda tavanit të miratuar për të gjitha vitet PBA 2022-2024. Konkretisht për produktin 1, "Blerja e pajisjeve të zyrës" dhe produkti i 2 "Blerja e pajisjeve kompjuterike" për arsyen e amortizimit .
Konstatohet se kërkesat buxhetore janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024". Janë evidentuar dhe kostuar politikat ekzistuese, si dhe kërkesa për buxhet është brenda tavaneve të miratuar.
Faza II: ISKK ka dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.115, datë 30.08.2021 kërkesat buxhetore për Fazën teknike (Faza II) në zbatim të shkresës nr. 12424 , datë 09.07.2021 si edhe Udhëzimit plotësues nr. 19, datë 09.07.2021 të MF "Për përgatitjen e PBA 2022-2024" dhe në përputhje me tavanet e miratuara me VKM nr. 440, datë 22.07.2021.

Tabela nr.57: PBA 2022-2024 Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Tavani PBA 2022	Kerkesa 2022	Tavani PBA 2023	Kerkesa 2023	Tavani PBA 2024	Kerkesa 2024
Shpenzimet korrente	37,960	37,960	37,960	37,960	39,238	39,238
Shpenzime kapitale	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
Totali	**38,960**	**38,960**	**38,960**	**38,960**	**40,238**	**40,238**

Burimi: ISKK

Konstatohet se kërkesa buxhetore për fazën e dytë është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin plotësues nr.19, datë 09.07.2021 "Për përgatitjen e PBA 2022-2024". Janë evidentuar dhe kostuar politikat ekzistuese si edhe kërkesat buxhetore janë brenda tavaneve të miratuara me VKM nr. 440/2021.

B. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestarë, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore si edhe plani.

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2019. Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente dhe kapitale është bërë me shkresën e Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr. 2270/107 prot., datë 17.01.2019. Detajimi i shpenzime korrente është miratuar me shkresë nr. 22760/138 prot., datë 21.01.2019. Detajimi i shpenzimeve kapitale është miratuar me shkresë nr.22760/31 prot., datë 18.02.2019. Ndërsa detajimi i fondit të veçante është miratuar me shkresë nr. 10059 prot., datë 28.05.2019 "Mbi miratimin e detajimit te fondit të veçantë për vitin 2019".

Tabela nr. 58: Çelja në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Çelja
600	19,830
601	2,970
602	11,700
231	2,000
Totali	**36,500**

Burimi: ISKK

Mbi transferimin e fondeve buxhetore

Nga auditimi u konstatua se përgjatë viti 2019 është kërkuar rialokim fondi ndërmjet art.600 dhe art. 602. Konkretisht ISKK ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë shkresën me nr. 238 prot., datë 06.09.2019. Kjo kërkesë është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE me shkresën nr. 15954/1 prot. datë 09.10.2019.

Tabela nr. 59: Mbi rialokimin e fondeve në mijë lekë

Artikulli	Emertimi	Shtesa	Pakesime
600	Shpenzime page		**625**
602	Mallra dhe shërbime	**625**	
Totali		**625**	**625**

Burimi: ISKK

Auditimi mbi nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Për vitin buxhetor 2019, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatimi të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4–mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr.151/1, datë 23.05.2019
- Raporti i monitorimit 8–mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr.270 prot., datë 01.10.2019.
- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit dërguar me shkresën nr.10/7 prot., date 29.01.2020.

- Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2019, shkresë nr.19/1 prot., datë 24.02.2020, në zbatim të shkresës nr. 21937 prot. date 03.12.2019 të dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Situata buxhetore me treguesit e realizimit te buxhetit ISKK për vitin 2019 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 60: Detajimi i zërave buxhetor në mijë lekë

Artikulli	Emertimi	Plani vjetor 2019	Plani i rishikuar 2019	Fakti 12 mujori	Realizimi%	Pesha e art. ekonomik
600	Shpenzime page	19,830	19,205	15,518	80.8%	52.6 %
601	Sigurime shoqerore	2,970	2,970	2,385	80.3%	8.1 %
602	Mallra dhe sherbime	11,700	12,362	6,201	50.2%	33.8 %
231	Shpenzime per investime	2,000	2,000	1,896	94.8%	5.7 %
Totali	**Totali i shpenzimeve**	**36,500**	**36,537**	**26,000**	**71.2%**	**100 %**
	Numri i punonjesve	**19**	**19**	**15**	**78.9%**	

Burimi: Raporti i monitorimit ISKK, përpunim nga grupi audites

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për vitit 2019 janë realizuar në masën 71.2%, ose 26,000 mijë lekë nga 36,537 mijë lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit. Rezulton një mosrealizim fondi në vlerën 10,536 mije lekë. Konstatohet që peshën më të madhe të shpenzimeve buxhetore e zë zëri "Shpenzime për paga" 60.6 % nga totali i zërave të buxhetit 2019. Shpenzimet " Paga dhe Sigurime shoqërore" janë realizuar në masën 80.8% ose 17,903 mijë lekë. Rezulton me mospërdorim i fondit prej 4,272 mije lekë si pasojë e mos plotësimit që nga fillimi i vitit të vendeve vakantë të planifikuar dhe miratuar për vitin 2019. Fondi i miratuar ishte për 19 punonjës por në fakt gjatë viti 2019 kanë qenë 15 punonjës.

Shpenzimet "Mallra dhe shërbime" janë realizuar në masën 50.2%. Ky shpenzim zë 33.8 % nga totali i zërave të buxhetit, rezulton me një realizim prej 6,201 mijë lekë nga 12,362 mijë leke i planifikuar. Rezulton me mospërdorim të fondit në vlerën 6,160 mijë lekë .

Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 94.8%. Ky shpenzim zë 5.7% nga totali i zërave të buxhetit, rezulton me një realizim prej 1,896 mijë lekë nga 2,000 mijë lekë të parashikuar në buxhet. Blerja e makinës që ishte planifikuar si produkt është realizuar.

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2020. Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente dhe kapitale për ISKK është bërë me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.24325/50 prot., datë 20.01.2020. Detajimi i shpenzimeve korrente është miratuar me shkresë nr.24325/67 prot., datë 21.01.2020, Detajimi i shpenzimeve kapitale është miratuar me shkresë nr.24325/122 prot., datë 28.01.2020.

Tabela nr. 61: Çelja Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Çelja
600	19,830
601	3,170
602	11,700
231	1,000
Totali	**35,500**

Burimi: ISKK

Detajimi i fondit të veçantë është miratuar me shkresë nr.4400 prot., datë 27.02.2020, në vlerën 100 mijë lekë.

Mbi transferimin e fondeve buxhetore 2020

Në zbatim te Aktit Normativ nr.15, datë 15.04.2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shkresën nr. 6865/140 prot., datë 15.05.2020 për detajimin e ndryshimit të planit buxhetor për vitin 2020.

Tabela nr. 62: Mbi ndryshimin e fondeve në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
600	Shpenzime page		1,000
602	Mallra dhe shërbime		3,000
Totali			4,000

Burimi: ISKK

Auditimi mbi nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Për vitin buxhetor 2020, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatimi të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", konkretisht:

- Raporti i monitorimit 8–mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr.132 prot., datë 25.11.2020.
- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit dërguar me shkresën nr.21 prot., date 01.02.2020.
- Pyetësori i Vetëvlerësimit, Deklarata, Raporti për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2020, shkresë nr.27 prot., date 24.02.2021, në zbatim të shkresës nr. 23796 prot. datë 22.12.2020 të dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit ISKK për vitin 2020 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 63: Detajimi i zërave buxhetor në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Plani vjetor 2020	Plani i rishikuar 2020	Fakti 12 mujori	Realizimi%	Pesha e art. ekonomik
600	Shpenzime page	19,830	18,830	14,249	75.5 %	60 %
601	Sigurime shoqërore	3,170	3,170	2,194	69.2 %	10 %
602	Mallra dhe shërbime	11,500	8,500	5,476	64.4 %	27 %
231	Shpenzime për investime	1,000	1,000	883	88.3 %	3 %
Totali	**Totali i shpenzimeve**	**35,500**	**31,500**	**22,802**	**72.4%**	**100 %**
	Numri i punonjësve	**19**	**19**	**15**	**78.9%**	

Burimi: ISKK, perpunim nga grupi audites

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për vitit 2020 janë realizuar në masën 72.4 %, ose 22,802 mije lekë nga 31,500 mijë lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit. Rezulton një mosrealizim fondi prej 8,698 mije lekë.

Shpenzimet "Paga dhe sigurime shoqërore" janë realizuar në masën 72 % ose 16,443 mijë lekë. Rezulton me mospërdorim të fondit prej 5,557 mijë lekë si pasojë e mos plotësimit që nga fillimi i vitit te vendeve vakante te planifikuar dhe miratuar. Fondi i miratuar ishte për 19 punonjës, por në fakt gjatë viti 2020 kanë qenë 15 punonjës.

Shpenzimet "Mallra dhe shërbime" janë realizuar në masën 64.4 %. Ky shpenzim zë 27 % te vlerës nga totali i zërave të buxhetit 2020, rezulton me një realizim vjetor prej 5,476 mijë lekë nga 8,500 mijë lekë i planifikuar. Rezulton me mospërdorim të fondit në vlerën 3,024 mijë lekë .

Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 88.3 %. Ky shpenzim zë 3% nga totali i zërave të buxhetit 2020.

Tabela nr. 64: Dieta gjatë vitit 2020 në mijë lekë

Nr	Data	Përshkrimi	Vlera	Urdher shpenzimi	Llog. ekonomike
1	25.02.2020	Likuidim udhëtime dieta(brenda)	30,500	20	602
2	29.12.2020	Likuidim udhëtime dieta(brenda)	20,000	195	602
	Totali		50,500		

Burimi: ISKK

Nga dokumentet e vënë në dispozicion u konstatuan në dy raste llogaritja e dietës për distanca në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës është bërë në kundërshtim me VKM nr.997, date 10.12.2010, pika 3, germa (i), "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar, ku citohet: *"Për shërbime në një largësi mbi 100 km, në rastin kur punonjësi kthehet brenda ditës trajtimi financiar do të jetë në vlerën 1,000 lekë".*

Konkretisht:

1. Bazuar në autorizimin nr.104, date 08.10.2020 , ku janë autorizuar 4 punonjës të shkojnë me shërbim ne Maliq , datë nisje 02.12.2020 dhe datë kthimi 02.12.2020 (brenda ditës).

Preventivi i shpenzimeve të llogaritura për 330 km është 4 persona * 2,500 lekë = 10,000 lekë. Sipas llogaritjeve janë paguar 6,000 mijë lekë më shumë seç është e parashikuar në VKM nr. 997/2010.

2. Bazuar në autorizimin nr.135, date 07.12.2020 , ku janë autorizuar 4 punonjës të shkojnë me shërbim në Maliq , datë nisje 11.12.2020 dhe datë kthimi 11.12.2020 (brenda ditës).

Preventivi i shpenzimeve të llogaritura për 330 km është 4 persona * 2,500 lekë= 10,000 lekë. Bazuar në dokumentet e vënë në dispozicion, ky shpenzim është paguar me Urdhër shpenzimi me nr.195, date 29.12.2020 në vlerën 20,000 lekë. Sipas llogaritjeve janë paguar 6,000 mijë lekë më shumë seç është parashikuar në VKM nr. 997/2020.

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2021. Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente dhe kapitale për ISKK është bërë me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.237424/69, datë 14.01.2021. Detajimi i shpenzive korrente është miratuar me shkresë nr.237424/135 prot., date 20.01.2021. Detajimi i shpenzimeve kapitale është miratuar me shkresë nr.237424/186 prot., date 28.01.2021.

Tabela nr. 65: Detajimi buxhetor, 2021 në mijë lekë

Llogaria ekonomike	**Çelja**
600	16,100
601	3,000
602	11,400
231	1,500
Totali	**32,000**

Burimi: ISKK

Detajimi i fondit të veçantë është miratuar me shkresë nr.23724/226 prot., datë 02.03.2021, në vlerën 100 mijë lekë.

Mbi transferimin e fondeve buxhetore 2021

ISKK ka kërkuar rialokim fondesh me shkresën nr.5472, datë 29.03.2021. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.6002/1 prot., datë 09.04.2021. Gjithashtu ISKK ka kërkuar rialokim fondesh me shkresën nr.139 prot., datë 23.09.2021, e cila është miratuar nga MFE me

shkresën nr.16333/1 prot., datë 04.10.2021, ku është pakësuar art. 602 në vlerën 2000 mijë lekë dhe është shtuar art. 600 në vlerën 2,000 mije lekë.

Tabela nr. 66: Mbi ndryshimin e fondeve në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Shtesa	Pakesime
606	Transferta per Buxhetet Familiare dhe Individet	230	
602	Mallra dhe shërbime		2,230
600	Paga	2,000	
Totali		**2,230**	**2,230**

Burimi: ISKK

Auditimi mbi nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Për vitin buxhetor 2021, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatimi të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", konkretisht:

- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit dërguar me shkresën nr.39/2 prot., date 25.02.2022.
- Pyetësori i Vetëvlerësimit, Deklarata, Raporti për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2021, shkresë nr.39/1 prot., datë 25.02.2022, në zbatim të shkresës nr.23/66 prot. datë 23.12.2021 të dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Situata buxhetore me treguesit e realizimit te buxhetit ISKK për vitin 2021 paraqitet si në tabelën me poshtë:

Tabela nr. 67: Detajimi i zërave buxhetor në mijë lekë

Artikulli	Emertimi	Plani vjetor 2021	Plani i rishikuar 2021	Fakti 12 mujori	Realizimi%	Pesha e art. ekonomik
600	Shpenzime page	16,100	18,100	17,375	96 %	55 %
601	Sigurime shoqerore	3,000	3,000	2,729	90 %	9 %
602	Mallra dhe sherbime	12,900	10,670	9,310	87 %	32 %
606		100	330	280	85 %	1 %
231	Shpenzime per investime	1,000	1,000	988	99%	3 %
Totali	**Totali i shpenzimeve**	**33,100**	**33,100**	**30,402**	**91 %**	**100 %**
	Numri i punonjesve	**19**	**19**	**19**	**100%**	

Burimi: ISKK, përpunim nga grupi audituesi

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për vitit 2021 janë realizuar në masën **91%,** ose 30,402 mijë lekë nga 33,100 mijë lekë që ishte parashikuar. Rezulton një mosrealizim fondi prej 2,698 mije lekë.

Tabela nr. 68: Dietat gjatë vitit 2021 në mijë lekë

Data	Përshkrimi	Vlera	Urdher shpenzimi	Llog. ekonomike
17.06.2021	Likuidim udhëtime dieta(jashtë)me makine	34,398	74	602
07.10.2021	Likuidim udhëtime dieta(jashtë) 6 dite	52,068	137	602
26.10.2021	Likuidim udhëtime dieta(jashtë) bileta e avionit	31,598	144	602
23.12.2021	Likuidim udhëtime dieta(jashtë)	15,519	193	602
17.02.2022	Likuidim udhëtime dieta(jashtë)	48,000	22, 23	602
Totali		181,583		

Burimi: ISKK

Nga dokumentacioni u konstatua se llogaritja e dietave është në përputhje me vendimin nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" dhe dokumentet justifikues janë të plotë sipas udhëzimit nr. 22, datë 10.07.2013.

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij per vitin 2022. Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente dhe kapitale për ISKK është bërë me shkresën e Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr.237424/69, datë 14.01.2022

Tabela nr. 69: Çelja e buxhetit Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Çelja
600	16,100
601	3,000
602	11,400
231	1,500
Totali	**32,000**

Burimi: ISKK

Detajimi i fondit te veçantë është miratuar me shkresë nr. 23724/226 prot., datë 02.03.2021, në vlerën 100 mijë lekë.

Mbi transferimin e fondeve buxhetore 2022

Me shkresën nr.4934/3 prot., datë 17.03.2022 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë pakësuar shpenzimet korrente në vlerën 34,743 mijë lekë.

Tabela nr. 70: Ndryshimi i fondeve Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Shtesa	Pakesime
601	Sig.Shoqerore		83
602	Mallra dhe shërbime		2,592
600	Paga		543
Totali	**Totali**		**3,218**

Burimi: ISKK

Auditimi mbi nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Në muajin qershor 2022, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit ISKK Për 6-mujorin e parë të vitit 2022 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 71: Detajimi i zërave buxhetor Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Plani vjetor 2022	Plani i rishikuar 2022	Fakti 6-mujori i I	Realizimi%	Pesha e art. ekonomik
600	Shpenzime page	21,700	21,157	9,997	47.1 %	59 %
601	Sigurime shoqerore	3,300	3,217	1,618	50 %	9 %
602	Mallra dhe sherbime	12,960	10,368	1,417	13.6 %	29 %
606	Transferua Për Buxhetet Familjarë dhe Individët	100	100	44	44 %	0.2 %
231	Shpenzime Për investime	1,000	1,000	0	0 %	3 %
Totali	**Totali i shpenzimeve**	**38,960**	**35,842**	**13,077**	**36.4 %**	**100 %**
	Numri i punonjësve	**19**	**19**	**19**	**100%**	

Burimi: ISKK, Përpunim nga grupi audites

Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për vitit 2022 janë realizuar në masën 36.4%, ose 13,077 mijë lekë nga 35,842 mijë lekë që ishte parashikuar. Bazuar në tabelën e mësipërme

konstatojmë që peshën më të madhe të shpenzimeve buxhetore e zë zëri "Shpenzime për paga" me 68% nga totali i zërave të buxhetit 2022.
Shpenzimet "Paga dhe Sigurime shoqërore" janë realizuar në masën 48% ose 11,615 mijë lekë. Rezulton me mospërdorim të fondit prej 12,759 mijë lekë.
Shpenzimet "Mallra dhe shërbime" janë realizuar në masën 13.6 %. Ky shpenzim ze 29 % te vlerës nga totali i zërave të buxhetit 2022, rezulton me një realizim vjetor prej 1,417 mijë lekë nga 10,368 mijë lekë i planifikuar. Rezulton me mospërdorim të fondit në vlerën 8,951 mijë lekë .
Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 0 %. Ky shpenzim zë 3 % nga totali i zërave të buxhetit 2022.

Tabela nr. 72: Dietat gjatë 6-mujorit të parë 2022 në mijë lekë

Data	Përshkrimi	Vlera	Urdhër shpenzimi	Llog. ekonomike
17.02.2022	Likuidim udhëtime dieta(jashtë)	48,000	22, 23	602
Totali		**48,000**		

Burimi: ISKK

Nga dokumentacioni u konstatua se llogaritja e dietave është në përputhje me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" dhe dokumentet justifikues janë të plotë sipas udhëzimit nr.22, datë 10.07.2013.

Gjetja	Mos planifikim i drejtë i shpenzimeve buxhetore
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit përkatës të vënë në dispozicion, rezulton se për periudhën objekt auditimi totali i shpenzimeve për vitin 2019 është realizuar në vlerën 26,001 mijë lekë, nga 36,537 mijë lekë të planifikuara, me një mosrealizim prej 10,536 mijë lekë ose realizuar në masën 71.2% kundrejt planit vjetor. Për vitin 2020, totali i shpenzimeve është realizuar në vlerën 22,802 mijë lekë, nga 31,700 mijë lekë të planifikuara ose realizuar në masën 72% kundrejt planit vjetor, me një mosrealizim prej 8,898 mijë lekë. Për vitin 2021, totali i shpenzimeve është realizuar në vlerën 30,402 mijë lekë, nga 33,100 mijë lekë të planifikuara ose realizuar në masën 91% kundrejt planit vjetor, me një mosrealizim prej 2,698 mijë lekë. Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për 6-mujorin e parë të vitit 2022 janë realizuar në masën 36.4 %**,** ose 13,077 mijë lekë nga 35,842 mijë lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit. Rezulton se peshën më të madhe e zë mos realizimi i shpenzimeve korrente, konkretisht zëri "Shpenzime personeli" dhe "Mallra dhe Shërbime", të cilat janë ndikuar nga disa faktorë si vonesa në miratimin e strukturës nga KM dhe mos realizim i konferencave dhe botimeve të planifikuara për shkak të kufizimeve nga situata pandemike.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", kreu nr. 4 "Procedura për përgatitjen e kërkesave buxhetore". Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësite e qeverisjes qendrore, kreu nr. 3 "Procedurat për procesin e monitorimit".

Impakti:	Performancë e ulët e realizimit të shpenzimeve buxhetore.
Shkaku:	Mos identifikimi korrekt i nevojave për shpenzime buxhetore dhe planifikim jo i saktë i zërave të buxhetit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masat e nevojshme për planifikimin sa më real, duke përfshirë identifikimin dhe argumentimin e nevojave të çdo drejtorie\sektori, si dhe monitorimin e kujdesshëm të buxhetit ndaj realizimit të produkteve në përputhje me planet e parashikuara, me qëllim ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese për alokimin e burimeve financiare.

III. 2. 6. Auditimi mbi shpenzimet e kryera nëpërmjet procedurave të prokurimit.

6.1 Auditimi mbi shpenzimet e kryera nëpërmjet procedurave të prokurimit për Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politik (IIPP)

Për auditimin e këtij drejtimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Regjistri i parashikimit dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2018, 2019, 2021 dhe regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitin 2022, si dhe procedurat e prokurimit të realizuara gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2022.
2. Planifikimi buxhetor i prokurimeve.
3. Dosjet e procedurave të prokurimeve.
4. Procedurat e prokurimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) në faqen e APP (http://www.app.gov.al/).

Për vitin 2018, Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) z. B. K., me shkresën nr. 82, datë 01.02.2018, ka përcaktuar Personat Përgjegjës për Prokurimin, jashtë afatit të përcaktuar në pikën 1, neni 57 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Regjistri i parashikimeve të prokurimeve për vitin 2018, është miratuar me shkresën nr. 74, datë 30.01.2018, jashtë afatit kohor, jo në përputhje me kërkesat e nenit 4, pikës 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ndërsa regjistri i realizimit të prokurimeve i është dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 3, datë 21.10.2019, jashtë afatit kohor, jo në përputhje me Kreun 2, pika 3 të Udhëzimit të APP-së nr. 1, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik".
Për vitin 2018, Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politik ka parashikuar gjithsej 12 procedura prokurimi në vlerën 3,550,000 lekë pa TVSH dhe ka realizuar 8 procedura prokurimi në vlerën 1,870,564 lekë pa TVSH, nga të cilat 1 blerje nën 100,000 lekë. IIPP nuk ka realizuar 4 procedura prokurimi, ose nuk ka realizuar 46% të vlerës totale të parashikuar.

Tabela nr. 73: "Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2018" *lekë*

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera pa TVSH	Numri	Vlera pa TVSH
1	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	1	50,000	1	36,511
2	Blerje me Vlerë të Vogël	11	3,500,000	7	1,834,053
SHUMA		**12**	**3,550,000**	**8**	**1,870,564**

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për IIPP

Gjatë vitit 2018, AKSHI ka lidhur 4 kontrata, për procedurën e prokurimit të ndarë në lote blerje pajisje kompjuterike në vlerën totale 1,099,670 lekë. Rezulton se AK, nuk e ka parashikuar këtë procedurë prokurimi në regjistrin e parashikimit si dhe nuk e ka deklaruar në regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit, në kundërshtim me pikën 1, neni 4 si dhe pikat 1, 2 dhe 5 të nenit 7 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Konstatohet se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i ka dërguar IIPP shkresën nr. 201/3, datë 15.02.2018 për çeljen e buxhetit për shpenzime kapitale, konkretisht çeljen e projektit me kod M130549 "Fond i ngrirë" në vlerën 1,200,000 lekë. Rezulton se këtij projekti, në zbatim të Aktit Normativ nr. 1, datë 26.07.2018 i janë shkurtuar fondet në vlerën 1,200,000 lekë. Sa më sipër rezulton se AKSHI ka filluar procedurën e prokurimit për blerjen e pajisjeve kompjuterike dhe ka lidhur kontratat pa pasur fond, duke marre angazhime pa fonde buxhetore dhe krijuar detyrime të prapambetura në vlerën totale 1,099,670 lekë.
Nga auditimi i pagesave konstatohet se me urdhër shpenzimin nr. 75, datë 13.05.2020 është paguar fatura nr. 80738173, datë 07.12.2018 (në zbatim të kontratës nr. 790, datë 06.12.2018), në vlerën 883,322 lekë. Me urdhër shpenzimin nr. 77, datë 13.05.2020 është paguar fatura nr. 2215, datë 09.11.2018 (në zbatim të kontratës nr. 5802, datë 09.11.2018), në vlerën 31,980 lekë. Me urdhër shpenzimin nr. 78, datë 13.05.2020 është paguar fatura nr. 1020, datë 15.11.2018 (në zbatim të kontratës nr. 5924, datë 26.10.2018), në vlerën 31,980 lekë.

Për vitin 2019, titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për caktimin e personave përgjegjës për prokurimit, në kundërshtim me pikën 1, neni 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet se: *"Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik".*
Regjistri i parashikimeve të prokurimeve, është miratuar me shkresën nr. 4, datë 21.01.2019, jashtë afateve kohore, jo në përputhje me kërkesat e nenit 4, pikës 1, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ndërsa regjistri i realizimit të prokurimeve i është dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 25/1, datë 27.01.2020, jashtë afatit kohor, në kundërshtim me Kreun 2, pika 3 të Udhëzimit të APP-së nr. 1, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik".

IIPP, për vitin 2019, ka parashikuar të zhvillojë 13 procedura prokurimi "Blerje me vlerë të vogël" në shumën totale 4,100,000 lekë pa TVSH dhe ka realizuar 9 procedura prokurimi në vlerën 1,758,288 lekë me TVSH. IIPP nuk ka realizuar 4 procedura prokurimi, ose nuk ka realizuar 57% të vlerës totale të parashikuar.
Tabela nr. 74: "Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2019" *lekë*

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera pa TVSH	Numri	Vlera me TVSH
1	Blerje me Vlerë të Vogël	13	4,100,000	9	1,758,288
SHUMA		**13**	**4,100,000**	**9**	**1,758,288**

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për IIPP

Për vitin 2020, titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për caktimin e personave përgjegjës për prokurimit, në kundërshtim me pikën 1, neni 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Regjistri i parashikimeve të prokurimeve, është miratuar me shkresën nr. 4, datë 27.01.2020, jashtë afateve kohore, të përcaktuara në nenin 4, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ndërsa regjistri i realizimit të prokurimeve i është dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 33/1 prot., datë 25.01.2021, jashtë afatit kohor, të përcaktuar në Kreun 2, pika 3 të Udhëzimit të APP-së nr. 1, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik".
IIPP, për vitin 2020, ka planifikuar të zhvillojë 9 procedura prokurimi "Blerje me vlerë të vogël" në shumën totale 3,400,000 lekë pa TVSH dhe ka realizuar 7 procedura prokurimi në vlerën 1,865,567 lekë pa TVSH. IIPP nuk ka realizuar 2 procedura prokurimi, ose nuk ka realizuar 45% të vlerës totale të parashikuar.

Tabela nr. 75: "Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2020" *lekë*

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera pa TVSH	Numri	Vlera me TVSH
1	Blerje me Vlerë të Vogël	9	3,400,000	7	1,865,567
SHUMA		**9**	**3,400,000**	**7**	**1,865,567**

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për IIPP

Për vitin 2021, titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për caktimin e personave përgjegjës për prokurimit, në kundërshtim me pikën 1, neni 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Regjistri i parashikimeve të prokurimeve është miratuar me shkresën nr. 33/1, datë 25.01.2021, jashtë afateve kohore, të përcaktuara në nenin 4, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ndërsa regjistri i realizimit të prokurimeve i është dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 12, datë 18.01.2022, jashtë afatit kohor, të përcaktuar në Kreun 2, pika 3 të Udhëzimit të APP-së nr. 4, datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik".
IIPP, për vitin 2021, ka parashikuar të zhvillojë 9 procedura prokurimi "Blerje me vlerë të vogël" në shumën totale 3,400,000 lekë pa TVSH dhe ka realizuar 4 procedura prokurimi në vlerën 1,248,243 lekë pa TVSH. IIPP nuk ka realizuar 5 procedura prokurimi ose nuk ka realizuar ose 36% të totalit të fondeve të planifikuara.

Tabela nr. 76: "Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2021" *lekë*

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera pa TVSH	Numri	Vlera me TVSH
1	Blerje me Vlerë të Vogël	9	3,400,000	4	1,248,243
SHUMA		**9**	**3,400,000**	**4**	**1,248,243**

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për IIPP

Për vitin 2022, Titullari Autoritetit Kontraktor, ka nxjerrë urdhrin e brendshme nr. 125/1, datë 04.04.2022, ku ka përcaktuar Personat Përgjegjës për Prokurimin.
Urdhri i mësipërm është nxjerrë jashtë afateve të përcaktuara në pikën 1, neni 74 të VKM-së nr. 285, 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Për vitin 2022, regjistri i parashikimeve të prokurimeve, është miratuar me shkresën nr. 45, datë 27.01.2022, jashtë afateve kohore, të përcaktuara në nenin 3, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Për vitin 2022, janë

planifikuar të realizohen 9 procedura prokurimi në vlerën totale 3,175,000 dhe deri në fund të gjashtë mujorit të parë të këtij viti janë realizuar 2 procedura prokurimi, në vlerën 1,488,000 lekë.

Shqyrtimi i disa procedurave të prokurimit

Për vitin 2018, u përzgjodhën për auditim 2 procedura prokurimi të zhvilluara nga IIPP, me vlerë totale të kontratave 1,370,185 lekë ose 46% të fondeve të përgjithshme të prokuruar.
Për vitin 2019, u përzgjodhën për auditim 3 procedura prokurimi, me vlerë totale të kontratave 1,656,000 ose 77% të fondeve të përgjithshme të prokuruar.
Për vitin 2020, u përzgjodhën për auditim 3 procedura prokurimi, me vlerë totale të kontratave 1,907,500 lekë ose 74% të fondeve të përgjithshme të prokuruar.
Për vitin 2021, u përzgjodhën për auditim 2 procedura prokurimi, me vlerë totale të kontratave 1,338,750 lekë ose 89% të fondeve të përgjithshme të prokuruar, ndërsa për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022, u përzgjodhën për auditim 2 procedura prokurimi me vlerë totale të kontratave 1,488,000 lekë ose 100% të fondeve të prokuruar për këtë periudhë.

Tabela nr. 77: "Procedura prokurimi të audituara" *lekë*

Viti	Procedura të Prokuruar			Procedura të Audituar			
	Numër	Fond limit	Vlerë kontrate	Numër	Fond limit	Vlerë	% e fondeve të audituara
2018	8	3,550,000	2,244,678	2	1,600,000	1,370,185	46%
2019	9	2,600,000	2,109,946	3	2,000,000	1,656,000	77%
2020	7	3,100,000	2,238,680	3	2,300,000	1,907,500	74%
2021	4	1,800,000	1,497,891	2	1,600,000	1,338,750	89%
30.06.2022	2	1,700,000	1,488,000	2	1,700,000	1,488,000	100%

Burimi: Grupi i auditimit

Në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara, u konstatua se numrat e protokollit të dokumenteve të procedurës së prokurimit, janë të ndryshëm nga njëri-tjetri, dhe nuk mbajnë numrin e protokollit të Urdhrit të Prokurimit me fraksionet përkatëse, në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1, ku citohet se: *"... Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespodencës (Mod. 1) një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidentohen me te njëjtin numër r progresivisht me fraksione deri në mbylljen e praktikës. Nuk lejohet evidenitimi në një numër i dy apo më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit*". Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi specialiste e protokoll-arkivë.

Nga auditimi rezulton se të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në kundërshtim me nenin 36 "Arkivat e numerizuar", të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".

Nga auditimi rezulton së në të gjitha komisionet e prokurimit me vlerë të vogël, për periudhën objekt auditimi ka qene kryetare e komisionit Përgjegjësja e Financës dhe Shërbimeve, njëkohësisht nëpunësi zbatues i institucionit, veprime në kundërshtim me nenin 12, pika 3, germa (e) dhe nenin 22, pika 3, grema (b) të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ku citohet se: *"Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave".*

Nga procedurat e përzgjedhura për auditim, është konstatuar si më poshtë vijon:

1. Procedura e prokurimit "Blerje tonera dhe kancelari", 2018

Urdhër Prokurimi Nr. 7, datë 30.10.2018, (nr. 691 prot, datë 30.10.2018)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 1, datë 03.01.2018 (nr. 5 prot, datë 03.01.2018) Zj. D.Ll. Zj. E.M. Zj. R.B.	Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 9056, datë 12.11.2018, në vlerën 556,000 lekë pa TVSH ose 667,200 lekë me TVSH
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 769,800 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "A." 556,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 213,800 lekë
Data e hapjes së tenderit: 01.11.2018	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 14 OE b) Skualifikuar : 0 OE c) Kualifikuar: 14 OE

Argumentimi i fondit limit. Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit nga komisionin i prokurimit me vlerë të vogël, më datë 30.10.2018 është mbajtur procesverbal për testimin e tregut, ku janë administruar oferta nga tre operatorë ekonomike dhe fondi limit është përcaktuar në vlerën 769,080 lekë pa TVSH.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 7, datë 30.10.2018, me objekt "Blerje tonera dhe kancelari". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, veprime në kundërshtim me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Ftesa për ofertë. Nga auditimi rezulton se në Ftesën për Ofertë nr. 692, datë 30.10.2018 nuk janë përcaktuar dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues, në kundërshtim me pikën me pikën 7/b të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, ku citohet se: *"Ftesa për ofertë përmban objektin e prokurimit, të dhënat teknike e sasiore të mallit/shërbimit/punës që po prokurohet, grafikun e ekzekutimit, afatin e paraqitjes si dhe dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues"*.
Konstatohet se në ftesën për ofertë është vendosur kusht për kualifikim e operatorëve ekonomik paraqitja dorazi e të gjithë mostrave të kërkuara, në kundërshtim me pikën 8 të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar, ku citohet se: *"Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël autoriteti kontraktues nuk duhet të kërkojë paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi, pasi verifikimi i cilësisë së mallit bëhet në momentin e marrjes në dorëzim të mallit, objekt prokurimi"*.
Nga auditimi i dosjes së prokurimit dhe sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatoreve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikës 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 14 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 14 operatorë.

Tabela nr. 78: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	E.G....	250,000
2	E..O.....	519,800
3	E.....	532,370
4	A.....	556,000
5	E..... Q.....	560,029
6	I.....S..... O.....	561,300
7	A.....B....	562,660
8	C....C.....C.....	576,858
9	P....C.... S....	590,000
10	M.....B....	593,700
11	R.....	595,000
12	J.....	750,000
13	Sh.....K.....	759,999
14	T.....K.....	800,000

Nga auditimi rezulton se dy operatorë ekonomikë (E.....G.....dhe E.....O.....) janë tërhequr nga procedura pasi janë shpallur fitues. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk ka mbajtur procesverbal për kalimin te operatori tjetër ekonomik, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, ku citohet se: *"Kur ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor e përcaktuar në ftesën për ofertë, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listë.... Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim...."*
Komisioni i prokurimit ka mbajtur proverbialin nr. 741, datë 06.11.2018, mbi verifikim e mostrave të paraqitura nga operatori "E....." SHA, sipas të cilit, tonerat e sjella nuk ishin origjinalë sipas kriterit të përcaktuar në Ftesën për Ofertë dhe për këtë arsye është skualifikuar nga komisioni.
Titullari i AK me shkresën nr. 755, datë 09.11.2018 ka njoftuar operatorin ekonomik "A." SHPK se është shpallur fitues.
Sa trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me vlerë të Vogël.

Zbatimi i kontratës. Fatura tatimore nr. 9056, datë 12.11.2018, e lëshuar nga operatori ekonomik në vlerën 667,200 lekë është paguar me urdhër shpenzimin nr. 239, datë 22.11.2018 në vlerën e plotë, brenda afatit 30 ditor.

2. Procedura e prokurimit "Blerje karburanti", 2018

Urdhër Prokurimi Nr. 142 prot., datë 19.02.2018 **Lloji i Procedurës së Prokurimit** " Blerje me vlerë të vogël"	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 1, datë 03.01.2018 (nr. 5 prot, datë 03.01.2018) Zj. D.Ll. Zj. E.M. Zj. R.B.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 7, datë 26.02.2018 (nr. 163 prot, datë 26.02.2018, në vlerën 585,822 lekë pa TV
Fondi Limit (pa tvsh) 585,822 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "D.O.", marzh fitimi 8%	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 0 lekë
Data e hapjes së tenderit: 21.02.2018	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 5 OE b) Skualifikuar : 0 OE c) Kualifikuar: 5 OE

Argumentimi i fondit limit. Nga auditimi u konstatua se komisionin i prokurimit me vlerë të vogël më datë 19.02.2018 ka mbajtur procesverbal nr. 141, datë 19.02.2018, për llogaritjen e vlerës limit ku është bazuar në mesataren e kontratave të lidhura për vitin 2015, 2016 dhe 2017.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 142, datë 19.02.2018, me objekt "Blerje karburant (benzinë)", me fond limit 585,822 lekë pa TVSH. Urdhri i prokurimit është hartuar sipas formatit nr. 2 bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Ftesa për ofertë. Sipas të dhënave të sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatorëve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 5 operatorë.

Tabela nr. 79: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike
1	D...O...	8
2	G.....C....G...	12
3	D..... J.....	14
4	A..... T.....	134
5	Sh..... K.....	585,000

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues

Në ftesën për ofertë është përcaktuar si kritere kualifikimi paraqitja e dokumentit që vërteton shlyerjen e faturës së energjisë elektrike për muajin Dhjetor 2017. Nga auditimi rezulton se operatori ekonomik "D..... O..." nuk ka dorëzuar vërtetim të pagesë së energjisë elektrike për muajin Dhjetor 2017, por ka paraqitur dokumentin nr. 28010/1, datë 03.01.2018, për vërtetimin e pagesës së muajit Nëntor 2017. Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriterin për kualifikim të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, me përbërje, zj. D.Ll., zj. E.M. dhe zj. R.B.

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur Kontratën e Furnizimit nr. 1, datë 26.02.2018 (nr. 163 prot., datë 26.02.2018) me operatorin ekonomik "D...O..." në vlerën totale 585,822 lekë pa TVSH, me afat deri më datë 31.12.2018. Nga auditimi rezulton se fatura tatimore nr. 4, datë 23.02.2018 e lëshuar nga operatori ekonomik, në vlerën 702,985 lekë është paguar me urdhër shpenzimin nr. 138, datë 21.06.2018, jashtë afatit 30 ditor, në kundërshtim me nenin 3, pika 3.2 të Kontratës ku citohet se: *"Pagesa e mallit duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e pranimit të faturës".* Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi nëpunësi zbatues, zj. D.Ll..

3. Procedura e prokurimit "Blerje karburanti (benzinë), 2019"

Urdhër Prokurimi Nr. 1, datë 28.01.2019,(nr. 13, prot, datë 28.01.2019)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 1, datë 03.01.2019 (nr. 1 prot, datë 03.01.2019)	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 1, datë 04.02.2019, në vlerën 700,833 lekë pa TVSH
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"	Zj. D.Ll. Zj. E.C. Zj. R...B.	

Fondi Limit (pa tvsh) 768,500 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "A. T." 700,833 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 67,667 lekë
Data e hapjes së tenderit: 30.01.2019	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 5 OE b) Skualifikuar : 0 OE c) Kualifikuar: 5 OE

Argumentimi i fondit limit. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 11, datë 25.01.2019 "Për krijimin e komisionit për llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburant (benzinë) 2019", me përbërje z. N.K., z. A.H., z. B.A.. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 12, datë 28.01.2019, ku janë përcaktuar specifikimet teknike dhe fondi limit në vlerën 768,500 lekë pa TVSH. Për përcaktimin e fondit limit janë administruar oferta nga 3 operatorë ekonomik.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 1, datë 28.01.2019, me objekt "Blerje karburant (Benzinë)". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, në kundërshtim me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Ftesa për ofertë. Sipas të dhënave të sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatorëve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018. Në ftesën për ofertë nuk është cilësuar se si duhet të ofertojnë operatorët ekonomik (me çmim për njësi, vlerë absolute apo marzh fitimi).

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 5 operatorë.

Tabela nr. 80: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	A...T.....	700,833
2	D..... O.....	727,900
3	O..... M.....	768,500
4	K.....	794,600
5	D.....J.....	799,820

Nga auditimi rezulton se për vlerësimin e ofertave është përdorur oferta ekonomik e paraqitur nga operatorët ekonomik për 5,800 litra benzinë me çmimin të pa ndryshuar përgjatë zbatimit të kontratës, në kundërshtim me nenin 31, pika 3 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku citohet se: *"Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në: a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni; c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje".*
Me shkresën nr. 20, datë 01.02.2019 Titullari i Autoritetit Kontraktor i ka dërguar operatorit ekonomi të renditur i pari "A..... T.....", formularin e njoftimit të fituesit. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, me përbërje, zj. D.Ll., zj. E.M. dhe zj. R.B..

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Nga auditimi rezulton se për përmbushjen e kriterit "...duhet të vërtetojë që ka pika furnizimi në të gjitha qytetet e Shqipërisë", operatori ekonomik fitues ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit nr. 1176 Rep., nr. 309 Kol., datë 11.05.2018, lidhur midis "A. T." SHA ka dhe shoqërisë "O." SHPK sipas të cilës, shoqëria "O." SHPK merr përsipër të pranojë dhe të kthejë në lëng tollonat/kartat elektronike B. O. të shitura nga shoqëria "A. T." SHA në të gjithë stacionet e furnizimit me karburant me logo B. O. ku ushtron aktivitete.

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur Kontratën e Furnizimit nr. 1, datë 04.02.2019 (nr. 59 prot, datë 04.02.2019) me operatorin ekonomik "A. T." SHA në vlerën 700,833 lekë pa TVSH. Me urdhër shpenzimin nr. 25, datë 15.02.2019 është paguar fatura tatimore nr. 450, datë 05.02.2019, në vlerën 841,000 lekë, brenda afatit 30 ditor.

4. Procedura e prokurimit "Marrje makine me qera për vitin 2019"

Urdhër Prokurimi Nr. 352, datë 14.05.2019, (nr. 352, datë 14.05.2019)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 1, datë 03.01.2019 (nr. 1 prot, datë 03.01.2019) Zj. D.Ll. Zj. E.C. Zj. R.B.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 377, datë 20.05.2019, Fatura tatimore nr.2303, datë 22.05.2019 në vlerën 466,800 lekë me TVSH
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 397,777 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "G. A. A." SHPK 389,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 8,777 lekë
Data e hapjes së tenderit: 16.05.2019	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 4 OE b) Skualifikuar : 1 OE c) Kualifikuar: 3 OE

Argumentimi i fondit limit. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 348, datë 13.05.2019 "Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës, si dhe llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Marrje makine me qera për vitin 2019", me përbërje z. N.K., z. A.H., z. B.S.. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 349, datë 13.05.2019, ku ka hartuar specifikimet teknike si dhe ka llogaritur fondi limit, për të cilin janë administruar oferta nga tre operatorë ekonomik dhe fondi është përcaktuar në vlerë 397,777 lekë pa TVSH. Nga auditimi rezulton se nuk ka asnjë argumentim për vendosjen e specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 2, neni 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku citohet se: *"Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre".* Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni për hartimin e specifikimeve teknike.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 352, datë 14.05.2019, me objekt "Marrje makine me qera për vitin 2019". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, jo në përputhje me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Ftesa për ofertë. Sipas të dhënave të sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatorëve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë

29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 3 operatorë dhe 1 operator është skualifikuar pasi në fushën e veprimtarisë nuk ka pasur të përfshirë objektin e procedurës së prokurimit.

Tabela nr. 81: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	G. A.. A.	389,000
2	A. C. R.	574,000
3	A.	800,000

Titullari i AK me shkresën nr. 375, datë 17.05.2019 ka njoftuar operatorin ekonomik "G. A. A." SHPK për shpalljen fitues.

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Në ftesën për ofertë është përcaktuar si kritere kualifikimi paraqitja e dokumentit që vërteton se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Nga auditimi rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nr. 19364, datë 19.04.2019, ku citohet se subjekti nuk ka detyrime të P.guara për sigurimet shoqërore dhe shëndetësorë, por ka detyrimet të P.guara në tatimin mbi fitimin dhe tatimin e mbajtur në burim në vlerën 180,149 lekë. Konstatohet se sipas këtij vërtetimin, nuk përmbushet kriteri i pagesë së të gjithë detyrimeve tatimore, të përcaktuar në pikën 4 të Kritereve për Kualifikim të Ftesës për Ofertë nr. 371, datë 15.05.2019.
Gjithashtu në pikën 6 dh) të Ftesës për Ofertë është përcaktuar se ofertuesi duhet të dorëzojë vërtetim për konfirmon shlyerjen e të gjithë detyrimeve të matura të energjisë elektrike të kontratave të energjisë. Nga auditimi i dokumenteve rezulton se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka paraqitur asnjë dokument për të verifikuar shlyerjen e detyrimeve për energji elektrike. Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriterin për kualifikim nr. 4 dhe 6 dh) të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar. Sa trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, me përbërje: zj. D.Ll. , zj. E.C., zj. R.B..

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur kontratën për marrje automjeti me qera nr. 377 prot., datë 20.05.2019 me operatorin ekonomik "G. A. A." SHPK në vlerën 466,800 lekë me TVSH, me afat 8 muaj. Me urdhër shpenzimin nr. 119, datë 24.05.2019 është paguar fatura tatimore nr. 2303, datë 22.05.2019, në vlerën 466,800 lekë, brenda afatit 30 ditor.

5. Procedura e prokurimit "Blerje tonera dhe kancelari", 2019

Urdhër Prokurimi Nr. 6, datë 8.10.2019, (nr. 660 prot, datë 08.10.2019)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 1, datë 03.01.2019 (nr. 1 prot, datë 03.01.2019) Zj. D.Ll. Zj. E.C. Zj. R.B.	Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 9193, datë 24.10.2019, në vlerën 680,400 lekë me TVSH
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 602,717 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "A." SHPK 567,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**

		35,717 lekë
Data e hapjes së tenderit: 09.10.2019	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 25 OE b) Skualifikuar : 0 OE c) Kualifikuar: 25 OE

Argumentimi i fondit limit. Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit nga komisionin i prokurimit me vlerë të vogël, më datë 01.10.2019 është mbajtur procesverbal për testimin e tregut, ku janë administruar oferta nga tre operatorë ekonomike dhe fondi limit është përcaktuar në vlerën 602,717 lekë pa TVSH.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 6, datë 08.10.2019, me objekt "Blerje tonera dhe kancelari". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, në kundërshtim me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Ftesa për ofertë. Nga auditimi rezulton se në Ftesën për Ofertë nr. 661, datë 08.10.2019, nuk janë përcaktuar dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues, në kundërshtim me pikën me pikën 7/b të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, ku citohet se: *"Ftesa për ofertë përmban objektin e prokurimit, të dhënat teknike e sasiore të mallit/shërbimit/punës që po prokurohet, grafikun e ekzekutimit, afatin e paraqitjes si dhe dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues."*
Konstatohet se në ftesën për ofertë është vendosur kusht për kualifikim e operatorëve ekonomik paraqitja dorazi e të gjithë mostrave të kërkuara, në kundërshtim me pikën 8 të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar, ku citohet se: *"Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël autoriteti kontraktues nuk duhet të kërkojë paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi, pasi verifikimi i cilësisë së mallit bëhet në momentin e marrjes në dorëzim të mallit, objekt prokurimi"*.
Nga auditimi i dosjes së prokurimit dhe sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatoreve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikës 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar.
Sa trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 25 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 25 operatorë.

Tabela nr. 82: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	A....K.....	227,800
2	E....L.....	244,890
3	A.....	334,000
4	P....O.....	336,350
5	E..... G....	350,000
6	L.....D.....	429,999
7	B..... T.....	462,250
8	E.... Q....	551,254
9	E..... H.....	564,000
10	A.....	567,000
11	C..... C..... C.....	570,250
12	R.....	598,000
13	A..... B.....	598,500

14	Sh.....K.....	598,999
15	T..... K.....	599,999
16	E.....A.....	601,000
17	K... N...	608,500
18	E...O.....	632,000
19	Sig.....	650,000
20	I..... O.....	666,000
21	IT.....	724,000
22	Ju.....	725,000
23	H...G..... C.....	739,000
24	A.....	769,000
25	O... T.....	770,000

Nga auditimi rezulton se 6 operatorë ekonomikë janë tërhequr nga procedura pasi janë shpallur fitues, 4 operatorë janë skualifikuar pasi mostrave e paraqitura nuk ishte sipas kritereve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël në çdo rast ka mbajtur procesverbal për kalimin te operatori tjetër ekonomik, në përputhje me pikën 17 të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.
Titullari i AK me shkresën nr. 724, datë 22.10.2019 ka njoftuar operatorin ekonomik "A." SHPK për shpalljen fitues.

Zbatimi i kontratës. Fatura tatimore nr. 9193, datë 24.10.2019, e lëshuar nga operatori ekonomik në vlerën 680,400 lekë është paguar me urdhër shpenzimin nr. 251, datë 04.11.2019 në vlerën e plotë, brenda afatit 30 ditor. Mallrat janë dorëzuar më datë 24.10.2019 dhe janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 3, datë 24.10.2019.

6. Procedura e prokurimit "Marrje makine me qera për vitin 2020"

Urdhër Prokurimi Nr. 2, datë 03.02.2020, (nr. 42, datë 03.02.2020)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 1, datë 06.01.2020 (nr. 1 prot, datë 06.01.2020) Zj. D.Ll. Zj. E.C. Zj. R.B.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 45, datë 05.02.2020, në vlerën 936,000 lekë me TVSH
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 787,333 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "G. A. A." SHPK 780,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 7,333 lekë
Data e hapjes së tenderit: 04.02.2020	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 7 OE b) Skualifikuar: 3 OE c) Kualifikuar: 4 OE

Argumentimi i fondit limit. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 2, datë 30.01.2020 "Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës, si dhe llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Marrje makine me qera për vitin 2020", me përbërje z. N.K., z. A.H., z. B.S.. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 41, datë 03.02.2020, ku ka hartuar specifikimet teknike si dhe ka llogaritur fondin limit, për të cilin janë administruar oferta nga tre operatorë ekonomik dhe fondi është përcaktuar në vlerë 787,333 lekë pa TVSH.
Për këtë objekt prokurimi në vitin 2019 është lidhur kontrata nr. 377, datë 20.05.2019 në vlerën 389,000 lekë pa TVSH ose 466,800 lekë me TVSH, me afat 8 muaj, pra 48,625 lekë në muaj. Ndërsa për vitin 2020, fondi limit është llogaritur 787,333 lekë pa TVSH ose 65,611 lekë në muaj. Në neni 59, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 citohet se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave si: çmimet e

botuara nga INSTAT; dhe/ose çmimet e tregut; dhe/ose, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë apo nga autoritetet të tjera; dhe/ose çmime ndërkombëtare të botuara. Sa më sipër, komision ka zgjedhur të bazohet vetëm te metoda e studimit të tregut, duke rritur fondin limit në masën 26% krahasuar me vitin e mëparshëm.
Nga auditimi rezulton se nuk ka asnjë argumentim për vendosjen e specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 2, neni 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku citohet se: *"Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre".* Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni i hartimit të specifikimeve teknike.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 42, datë 03.02.2020, me objekt "Marrje makine me qera për vitin 2020". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, jo në përputhje me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Ftesa për ofertë. Sipas të dhënave të sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatorëve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018., i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 4 operatorë ndërsa 3 operatorë nuk janë kualifikuar, nga të cilët 1 operator ka ofertuar mbi fondin limit ndërsa 2 operatorë nuk kanë pasur objektin e prokurimit në fushën e veprimtarisë.

Tabela nr. 83: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	A..... M.....	697,800
2	G..... A..... A.....	780,000
3	E....A...	780,000
4	J.....	797,000

Rezulton se operatori ekonomik i renditur i pari është tërhequr nga procedura e prokurimit pasi nuk mund të plotësojë afatet e lëvrimit të mallit. Komisioni i prokurimit ka mbajtur procesverbalin nr. 45/1, datë 05.02.2020 për kalimin te operatori tjetër ekonomik "G..... A..... A.....", pasi operatori tjetër "E.A.", i cili ka ofertuar në vlerë të njëjtën vlerë nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Sa më sipër mos skualifikim automatik dhe klasifikimi i ofertës së operatorit "E.A." është në kundërshtim me pikën 14 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, ku citohet se: "*Anëtarët e komisionit të prokurimet me vlerë të vogël pas hapjes së ofertave në orën dhe datën e caktuar, fillimisht do të verifikojë fushën e veprimtarisë së të gjithë ofertuesve pjesëmarrës në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Nëse pas verifikimit rezulton se, ndonjë nga operatorët ekonomik nuk ka si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, oferta e tyre do të refuzohet automatikisht*".

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Në ftesën për ofertë është përcaktuar si kritere kualifikimi paraqitja e dokumentit që vërteton se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Nga auditimi rezulton se operatori

ekonomik ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nr. T01792828, datë 05.02.2020 për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore. Konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e detyrimeve të tjera tatimore, të përcaktuar në pikën 4 të Kritereve për Kualifikim të Ftesës për Ofertë nr. 45, datë 05.02.2020.
Gjithashtu në pikën 6 dh) të Ftesës për ofertë është përcaktuar se ofertuesi duhet të dorëzojë vërtetim për konfirmon shlyerjen e të gjithë detyrimeve të matura të energjisë elektrike të kontratave të energjisë. Nga auditimi i dokumenteve rezulton se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka paraqitur asnjë dokument për të verifikuar shlyerjen e detyrimeve për energji elektrike. Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriterin për kualifikim nr. 4 dhe 6 dh) të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.
Sa trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, me përbërje zj. D.Ll., zj. E.C., zj. R.B..

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur kontratën për merrje automjeti me qera nr. 45 prot., datë 05.02.2020 me operatorin ekonomik "G. A. A." SHPK në vlerën 936,000 lekë me TVSH, me afat 12 muaj. Me urdhër shpenzimin nr. 119, datë 24.05.2019 është paguar fatura tatimore nr. 1888, datë 06.02.2020, në vlerën e plotë, lekë, jashtë afatit 30 ditor.

7. Procedura e prokurimit "Blerje tonera dhe kancelari", 2020

Urdhër Prokurimi Nr. 4, datë 13.10.2020, (nr. 468 prot, datë 13.10.2020)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 1, datë 06.01.2020 (nr. 1 prot, datë 06.01.2020) Zj. D.Ll. Zj. E.C. Zj. R.B.	-Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 3691, datë 23.10.2020, në vlerën 588,000 lekë me TVSH
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 585,333 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "E.XH." 490,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 95,333 lekë
Data e hapjes së tenderit: 14.10.2020	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 24 OE b) Skualifikuar : 1 OE c) Kualifikuar: 23 OE

Argumentimi i fondit limit. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 467, datë 13.10.2020 për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit, me përbërje zj. D.Ll., zj. E.C., zj. R.B.. Komisionin, më datë 12.10.2020 ka mbajtur procesverbal, sipas të cilit për përllogaritjen e fondit limit është marrë mesatarja e 3 kontratave të mëparshme për këtë objekt prokurimi. Konstatohet se data e procesverbalit është më e hershme se data e daljes së urdhrit për ngritjen e komisionit.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 4, datë 13.10.2020, me objekt "Blerje tonera dhe kancelari". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, jo në përputhje me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Ftesa për ofertë. Nga auditimi rezulton se në Ftesën për Ofertë nr. 469, datë 13.10.2020 nuk janë përcaktuar dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues, në kundërshtim me pikën me pikën 7/b të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, ku citohet se: *"Ftesa për ofertë përmban objektin e prokurimit, të dhënat teknike e sasiore të mallit/shërbimit/punës që po prokurohet, grafikun e ekzekutimit, afatin e paraqitjes si dhe dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues."*
Konstatohet se në ftesën për ofertë është vendosur kusht për kualifikim e operatorëve ekonomik paraqitja dorazi e të gjithë mostrave të kërkuara, në kundërshtim me pikën 8 të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar, ku citohet se: *"Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël autoriteti kontraktues nuk duhet të kërkojë paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi, pasi verifikimi i cilësisë së mallit bëhet në momentin e marrjes në dorëzim të mallit, objekt prokurimi"*.
Nga auditimi i dosjes së prokurimit dhe sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatoreve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikës 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar.
Sa trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 24 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 23 operatorë, ndërsa 1 operator është skualifikuar për shkak të ofertës anomalish të ulët.

Tabela nr. 84: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	E. Q.	216,175
2	L.D.	232,900
3	B. T.	395,710
4	A K..	448,900
5	E.XH.	490,000
6	I..S. O.	511,000
7	E.L.	544,000
8	P.C. S.	569,000
9	M. B.	573,700
10	T.K..	583,000
11	A.....	586,000
12	M....	588,000
13	R....	614,000
14	O.T.	616,667
15	A...D.	633,333
16	O..H..	642,200
17	AD.....	644,990
18	K.F.	646,000
19	M.M.	648,000
20	J.G.	650,000
21	E.O.	660,300
22	J.....	666,666
23	I.O.	737,039

Nga auditimi rezulton se 2 operatorë ekonomikë janë tërhequr nga procedura pasi janë shpallur fitues dhe 4 operatorë janë skualifikuar pasi mostrat e paraqitura nuk ishte sipas kritereve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël në çdo rast ka mbajtur procesverbal për kalimin te operatori tjetër ekonomik, në përputhje me pikën 17 të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Titullari i AK me shkresën nr. 489 datë 23.10.2020 ka njoftuar operatorin ekonomik "E.XH." për shpalljen fitues.

Zbatimi i kontratës. Fatura tatimore nr. 3691, datë 23.10.2020, e lëshuar nga operatori ekonomik në vlerën 588,000 lekë është paguar me urdhër shpenzimin nr. 229, datë 26.10.2020 në vlerën e plotë, brenda afatit 30 ditor. Mallrat janë dorëzuar më datë 24.10.2019 dhe janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 2, datë 23.10.2020, nr.3, datë 23.10.2020, nr. 4, datë 23.10.2020.

8. Procedura e prokurimit "Blerje karburanti (naftë) 2020"

<table>
<tr><td>Urdhër Prokurimi
Nr. 3, datë 12.02.2020,(nr. 76, prot, datë 28.01.2019)</td><td rowspan="2">Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël
Urdhër nr. 1, datë 06.01.2020 (nr. 1 prot, datë 06.01.2020)
Zj. D.Ll.
Zj. E.C.
Zj. R.B.</td><td rowspan="2">-Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 85, datë 17.02.2020, në vlerën 765,000 lekë me TVSH</td></tr>
<tr><td>Lloji i Procedurës së Prokurimit
" Blerje me vlerë të vogël"</td></tr>
<tr><td>Fondi Limit (pa tvsh)
700,000 lekë</td><td>Oferta fituese (pa tvsh)
"A. T." 637,500 lekë</td><td>Diferenca me fondin limit (pa tvsh)
62,500 lekë</td></tr>
<tr><td>Data e hapjes së tenderit:
13.02.2020</td><td>Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>Operatoret Ekonomike
Pjesëmarrës në tender: 7 OE
b) Skualifikuar : 0 OE
c) Kualifikuar: 7 OE</td></tr>
</table>

Argumentimi i fondit limit. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 74, datë 11.02.2020 "Për krijimin e komisionit për llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburant (naftë) 2020", me përbërje z. N.K., z. A.H., z. B.A.. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 75, datë 12.02.2020, ku ka përcaktuar specifikimet teknike dhe fondi limit në vlerën 700,000 lekë pa TVSH. Për përcaktimin e fondit limit janë administruar oferta nga 3 operatorë ekonomik.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 3, datë 12.02.2020, me objekt "Blerje karburant (Naftë)". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, jo në përputhje me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Ftesa për ofertë. Sipas të dhënave të sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë nuk u është dërguar të paktën 5 operatorëve ekonomik, në kundërshtim me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar. Në ftesën për ofertë nuk është cilësuar se si duhet të ofertojnë operatorët ekonomik (me çmim për njësi, vlerë absolute apo marzh fitimi).

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 7 operatorë.

Tabela nr. 85: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	A..... T.....	637,500
2	G....C...	637,500
3	K....	644,833
4	D... O..	675,000
5	K.....	694,000
6	K....	695,000
7	D.... J....	725,000

Nga auditimi rezulton se për vlerësimin e ofertave është përdorur oferta ekonomik e paraqitur nga operatorët ekonomik për 5,000 litra naftë me çmimin të pa ndryshuar përgjatë zbatimit të kontratës, në kundërshtim me nenin 31, pika 3 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku citohet se: *"Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në: a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni; c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje".* Rezulton se dy operatorët ekonomikë kanë paraqitur të njëjtën ofertë ekonomike. Komisionin i prokurimit ka mbajtur procesverbalin nr. 80, datë 14.02.2020 për hedhjen e shortit midis dy operatorëve ekonomikë. Pas hedhjes së shortit, operatori ekonomik A..... T..... SHA është kualifikuar. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me pikën 15 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar. Sa trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël me përbërje: j. D.Ll. , zj. E.C. dhe zj. R.B..

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur Kontratën e Furnizimit nr. 85, datë 17.02.2020 me operatorin ekonomik "A..... T....." SHA në vlerën 637,500 lekë pa TVSH. Me urdhër shpenzimin nr. 102, datë, datë 03.06.2020 është paguar fatura tatimore nr. 273, datë 17.02.2020, në vlerën 765,000 lekë, jashtë afatit 30 ditor, në kundërshtim me pikën 3.2 të Kontratës ku citohet se: *"Pagesa e mallit duhet bërë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e pranimit të faturës".*

9. Procedura e prokurimit "Blerje karburanti (naftë) 2021"

Urdhër Prokurimi Nr. 3, datë 17.05.2021,(nr.280, prot, datë 17.05.2021)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 1, datë 05.01.2021 (nr. 1 prot, datë 05.01.2021) Zj. D.Ll. Zj. E.C. Zj. R.B.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 287, datë 25.05.2021, në vlerën 670,500 lekë me TVSH
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 584,550 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "G. C." 558,750 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 25, 800 lekë
Data e hapjes së tenderit: 18.05.2021	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 7 OE b) Skualifikuar : 0 OE c) Kualifikuar: 7 OE

Argumentimi i fondit limit. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 278, datë 14.05.2021 "Për krijimin e komisionit për llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburant (naftë) 2021", me përbërje zj. V.E., z. A.H., z. B.S.. Komisioni ka mbajtur

procesverbalin nr. 279, datë 17.05.2021, ku ka përcaktuar specifikimet teknike dhe fondi limit në vlerën 584,550 lekë pa TVSH. Për përcaktimin e fondit limit janë administruar oferta nga 3 operatorë ekonomik.
Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 3, datë 17.05.2021, me objekt "Blerje karburant (Naftë)", 4500 litra. Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, jo në përputhje me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Ftesa për ofertë. Sipas të dhënave të sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatorëve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar. Në ftesën për ofertë nuk është cilësuar se si duhet të ofertojnë operatorët ekonomik (me çmim për njësi, vlerë absolute apo marzh fitimi).

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 7 operatorë.

Tabela nr. 86: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	G.C.	558,750
2	K...	566,00
3	A. T.	571,500
4	K.....	588,750
5	K....	594,000
6	M..M.	607,500
7	P. A.	625,500

Nga auditimi rezulton se për vlerësimin e ofertave është përdorur oferta ekonomik e paraqitur nga operatorët ekonomik për 4,500 litra naftë me çmimin të pa ndryshuar përgjatë zbatimit të kontratës, në kundërshtim me nenin 31, pika 3 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku citohet se: *"Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në: a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni; c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje".* Titullari i AK me shkresën nr. 286, datë 24.05.2021 ka njoftuar operatorin ekonomik "G.... C...." se është shpallur fitues.

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur Kontratën e Furnizimit nr. 287, datë 25.05.2021 me operatorin ekonomik "G.... C...." në vlerën 585,750 lekë pa TVSH. Me urdhër shpenzimin nr. 194, datë, datë 26.05.2021 është paguar fatura tatimore nr. 211, datë 25.05.2021, në vlerën 670,500 lekë, brenda afatit 30 ditor.

10. Procedura e prokurimit "Marrje makine me qera për vitin 2021"

Urdhër Prokurimi Nr. 1, datë 01.02.2021, (nr.67, datë 01.02.2021)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 1, datë 05.01.2021 (nr. 1 prot, datë 05.01.2021) Zj. D.Ll. Zj. E.C.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 74, datë 08.02.2021, në vlerën 936,000 lekë me TVSH
Lloji i Procedurës së Prokurimit		

"Blerje me vlerë të vogël"	Zj. R.B.	
Fondi Limit (pa tvsh) 791,333 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "G. A. A." 780,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 11,333 lekë
Data e hapjes së tenderit: 02.02.2021	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 10 OE b) Skualifikuar : 0 OE c) Kualifikuar: 10 OE

Argumentimi i fondit limit. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 65, datë 29.01.2021 "Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës, si dhe llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Marrje makine me qera për vitin 2021", me përbërje z. N.K., z. A.H., z. E.A.. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 66, datë 01.02.2021, ku janë hartuar specifikimet teknike si dhe është llogaritur fondi limit për të cilin janë administruar oferta nga tre operatorë ekonomik dhe fondi është përcaktuar në vlerë 791,333 lekë pa TVSH. Nga auditimi rezulton se nuk ka asnjë argumentim për vendosjen e specifikimeve teknike, jo në përputhje me pikën 2, neni 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku citohet se : *"Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre".* Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni i hartimit të specifikimeve teknike.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 1, datë 01.02.2021, me objekt "Marrje makine me qera për vitin 2021". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, jo në përputhje me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Ftesa për ofertë. Sipas të dhënave të sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatorëve ekonomik, në përputhje me pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018., i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 10 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 10 operatorë.

Tabela nr. 87: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	L. S.	730,000
2	V.O.	749,000
3	K.....	750,000
4	N.....	769,000
5	M..B.R.	770,000
6	G. A. A.	780,000
7	O.H.	794,400
8	R. P. A.	890,000
9	A.. O.	920,000
10	A. C. R.	980,000

Nga auditimi rezulton, se referuar procesverbalit të datës 02.02.2021, 03.02.2021, 04.02.2021 operatorët ekonomik "L.... S....", "V.... O" "N....." nuk janë kualifikuar pasi në fushën e veprimtarisë nuk kanë objektin e prokurimit. Sa më sipër mos skualifikim automatik dhe klasifikimi i ofertës së operatorëve ekonomik të mësipërm është jo në përputhje me pikën 14 të

Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, ku citohet se: "*Anëtarët e komisionit të prokurimet me vlerë të vogël pas hapjes së ofertave në orën dhe datën e caktuar, fillimisht do të verifikojë fushën e veprimtarisë së të gjithë ofertuesve pjesëmarrës në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Nëse pas verifikimit rezulton se, ndonjë nga operatorët ekonomik nuk ka si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, oferta e tyre do të refuzohet automatikisht*".
Sipas procesverbalit të mbajtur më datë 04.02.2021 dhe procesverbalit të mbajtur më datë 05.02.2021 operatori ekonomik "K..." dhe operatori "M.....B..... R..." janë s' kualifikuar për arsye të mos paraqitjes afate të ofertës.
Titullari i AK me shkresën nr. 73, datë 08.02.2021 ka njoftuar operatori ekonomik "G..... A..... A....." për shpallen fitues.

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Në ftesën për ofertë është përcaktuar si kritere kualifikimi paraqitja e dokumentit që vërteton se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Nga auditimi rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nr. T03534205, datë 08.02.2021 për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore. Konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e detyrimeve të tjera tatimore, të përcaktuar në pikën 4 të Kritereve për Kualifikim të Ftesës për Ofertë nr. 68, datë 01.02.2021.
Gjithashtu në pikën 6 dh) të Ftesës për ofertë është përcaktuar se ofertuesi duhet të dorëzojë vërtetim për konfirmon shlyerjen e të gjithë detyrimeve të matura të energjisë elektrike të kontratave të energjisë. Nga auditimi i dokumenteve rezulton se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka paraqitur asnjë dokument për të verifikuar shlyerjen e detyrimeve për energji elektrike. Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriterin për kualifikim nr. 4 dhe 6 dh) të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.
Sa trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël.

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur kontratën për merrje automjeti me qera nr. 74 prot., datë 08.02.2021 me operatorin ekonomik "G. A. A." SHPK, në vlerën 936,000 lekë me TVSH, me afat 12 muaj. Me urdhër shpenzimin nr. 83, datë 26.03.2021 është paguar fatura tatimore nr. 1, datë 23.03.2021, në vlerën e plotë, lekë, brena afatit 30 ditor.

11. Procedura e prokurimit "Marrje makine me qera për vitin 2022"

Urdhër Prokurimi Nr. 1, datë 27.01.2022	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 5, datë 05.01.2022 Zj. D.Ll. Zj. E.C. Zj. R.B.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 57, datë 08.02.2022, në vlerën 936,000 lekë me TVSH
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 810,000 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "G. A. A." 780,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 30,000 lekë
Data e hapjes së tenderit: 28.01.2022	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 9 OE b) Skualifikuar : 0 OE c) Kualifikuar: 9 OE

Argumentimi i fondit limit. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 1, datë 26.01.2022 "Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës, si dhe llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Marrje makine me qera për vitin 2022", me përbërje zj. V.E., z. A.H., z. B. Sala. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 40, datë 26.01.2022, ku janë hartuar specifikimet teknike si dhe është llogaritur fondi limit për të cilin janë administruar oferta nga tre operatorë ekonomik dhe fondi është përcaktuar në vlerë 810,000 lekë pa TVSH. Nga auditimi rezulton se nuk ka asnjë argumentim për vendosjen e specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 2, neni 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku citohet se: *"...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre…".* Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni i hartimit të specifikimeve teknike.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 1, datë 27.01.2022, me objekt "Marrje automjeti me qera copë 1". Rezulton se baza ligjore e përdorur në këtë Urdhër, konkretisht ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar kanë qenë të shfuqizuar në datën e daljes së tij.

Vlerësimi i ofertave.
Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 9 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 9 operatorë.

Tabela nr. 88: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	G. A.. A.	780,000
2	O. M. M.	805,000
3	J.	810,000
4	O.H.	818,400
5	R.. P.. A.	840,000
6	A.M.	897,600
7	M..M.	947,000
8	L.Xh.	968,000
9	B. H.	1,000,000

Titullari i AK me shkresën nr. 50, datë 01.02.2022 është njoftuar operatori ekonomik "G. A. A." për shpallen fitues.

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Në ftesën për ofertë është përcaktuar si kritere kualifikimi paraqitja e dokumentit që vërteton se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Nga auditimi rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nr. T05459022, datë 01.02.2022 për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe vërtetimin për likuidimin e detyrimeve vendore. Konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e detyrimeve të tjera tatimore, të përcaktuar në pikën 4 të Kritereve për Kualifikim të Ftesës për Ofertë nr. 44, datë 27.01.2022.
Gjithashtu në pikën 6 dh) të Ftesës për ofertë është përcaktuar se ofertuesi duhet të dorëzojë vërtetim për konfirmon shlyerjen e të gjithë detyrimeve të matura të energjisë elektrike të kontrate të energjisë. Nga auditimi i dokumenteve rezulton se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka

paraqitur asnjë dokument për të verifikuar shlyerjen e detyrimeve për energji elektrike. Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriterin për kualifikim nr. 4 dhe 6 dh) të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, në kundërshtim me pikën 18 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". Sa trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël.

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur kontratën për merrje automjeti me qera nr. 57 prot., datë 08.02.2022 me operatorin ekonomik "G. A. A." SHPK, në vlerën 936,000 lekë me TVSH, me afat 12 muaj. Me urdhër shpenzimin nr. 27, datë 16.02.2021.2021 është paguar fatura tatimore nr. 48, datë 16.02.2022, në vlerën e plotë, lekë, brena afatit 30 ditor.

12. Procedura e prokurimit "Blerje karburanti (naftë) 2022"

Urdhër Prokurimi Nr. 183, datë 27.05.2022	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Urdhër nr. 125, datë 04.04.2022 (nr. 1 prot, datë 05.01.2021) Zj. E.C. Zj. R.B. Zj. Xh.K.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 198, datë 26.05.2022, me vlerë 522,000 lekë me TVSH.
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 435,000 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "A. Z. D." SHPK (normë e pa ndryshuar fitimi 18 lekë për litër)	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 0lekë
Data e hapjes së tenderit: 18.05.2022	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 4 OE b)Skualifikuar : 0 OE c) Kualifikuar: 4 OE

Argumentimi i fondit limit. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 177, datë 16.05.2022 "Për krijimin e komisionit për llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburant (naftë) 2022", me përbërje zj. M.R., zj. E.M., z. D.A.. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 182, datë 16.05.2022, ku ka përcaktuar specifikimet teknike dhe fondi limit më vlerën 522,000 lekë me TVSH ose 435,000 lekë pa TVSH. Për përcaktimin e fondit limit është administruar çmimi i tavan prej 232 lekë/për litër (me TVSH), vendosur nga Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit, më datë 10.05.2022.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 183, datë 17.02.2022, me objekt "Blerje karburanti (naftë)" 2,250 litra në përputhje me formatin 2, bashkëlidhur Udhëzimit të APP-së nr. 5, 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me blerje të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Ftesa për ofertë. Ftesa për ofertë nr. 185, datë 17.05.2022 është përgatitur sipas formatit të standard nr. 3, në përputhje me pikën 9/a të Udhëzimit të APP nr. 05, datë 25.06.2021.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 4 operatorë.

Tabela nr. 89: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike
1	K.	11.4
2	A..&Z.D.	18

3	M. M.	20
4	P. A.	22

Nga auditimi rezultoi se OE "K." i renditur i pari me normë të pandryshuar fitimi 11.4 lekë për litër nuk është paraqitur pranë AK. Komisionin ka mbajtur procesverbal për kalimin tek operatori tjetër ekonomik "A.& Z. D.".
Titullari i AK me shkresën nr. 199, datë 26.05.2022 ka njoftuar operatorin ekonomik "A. & Z. D." SHPK për shpalljen fitues.

Zbatimi i kontratës. Titullari i AK ka lidhur kontratën e furnizimit nr. 1, datë 26.05.2022 me operatorin ekonomik "A. Z. D." SHPK në vlerën 522,000 lekë me TVSH, me normë të pandryshueshme fitimi 18 lekë për litër.
Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 200, datë 26.05.2022 "Për ngritjen e komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të punimeve/mallrave dhe shërbimeve". Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 275, datë 13.07.2022, sipas të cilit malli është blerë sipas specifikimeve te paraqitura në kontratë. Fatura elektronike tatimore nr. 399, datë 13.07.2020, është paguar në vlerën totale plotë, brenda afatit 30ditor në përputhje me pikën 3.2 dhe 3.3, nenin 3 i Kontratës.

Mbi shpenzimet për marrjen me qera të ambienteve për zyra. IIPP ka marrë ambiente me qira "zyra" për ushtrimin e aktivitetit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, procedurës të ndjekur për përzgjedhjen e ofertës fituese si dhe kontratave të lidhura me subjektin qiradhënëse konstatohet:
1. Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 855, datë 16.12.2019 është ngritur komisioni për studimin e çmimit të tregut "Për marrjen e zyrave me qera për vitin 2020", i përberë nga znj. V.E., zj. M.R., zj. M.A., zj. Xh.K.. Kriteret e vendosur në këtë urdhër janë: të jetë afër me zyrat ekzistues në mënyrë që të jetë lehtë i aksesushëm nga komiteti i të përndjekurve; të jetë afër Ministrisë së Financave; sipërfaqe e kërkuar 200-300 m^2.
Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 874, datë 24.12.2019, sipas të cilit komisioni ka vlerësuar tregun duke marrë oferta nga 3 shoqëri që operojnë në këtë fushën, konkretisht nga: subjekti "I. R. E. I." oferta 2500 euro në muaj; subjekti "L." oferta 2250 euro në muaj; subjekti "D. I." oferta 1830 euro në muaj. Komisioni pasi ka shqyrtuar ofertat ka vlerësuar si të vlefshme ofertën e paraqitur nga subjekti "D. I." në vlerën 1830 euro në muaj (222,500 lekë në muaj) për ambientin me sipërfaqe 276 m^2 të ndodhur në rrugën "N.T.".
Konstatohet se njoftimi për marrje me qera të ambienteve nuk është bërë në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe as në ndonjë media të shkruar ose vizive, duke sjellë mungesën e ofertuesve të tjerë në këtë shërbim. Asnjë nga ofertat e administruara nuk rezulton e protokolluar. Gjithashtu konstatohet se komisioni i ngritur me urdhrin e mësipërm ka vepruar në tejkalim të kompetencave, pasi në urdhër citohet se komisionin duhet të merret me studimin e tregut për të gjetur ambiente me qera dhe në asnjë pikë të tij nuk shprehet që komisioni i mësipërm duhet të vlerësojë ofertat dhe të shpallë fituesin për lidhjen e kontratës.
Titullari i Institucionit ka lidhur kontratën nr. 876, datë 26.12.2019, me afat përfundimi 31.12.2020. Me shkresën nr. 554, datë 18.11.2020 IIPP i ka kërkuar qiradhënësit shtyrje të afatit të kontratës deri më datë 31.12.2021.
2. Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 527, datë 20.10.2021 është ngritur komisioni për studimin e çmimit të tregut "Për marrjen e zyrave me qera për vitin 2022", i përberë nga znj. E.C. zj. E.M., zj R.B., zj. Xh.H.. Kriteret e vendosur në këtë urdhër janë: të jetë afër me zyrat ekzistues në mënyrë që të jetë lehtë i aksesushëm nga komiteti i të përndjekurve; të jetë afër Ministrisë së Financave; sipërfaqe e kërkuar 200-300 m^2.

Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 535, datë 29.10.2021, sipas të cilit ka vlerësuar tregun duke marrë oferta nga 3 shoqëri që operojnë në këtë fushë, konkretisht nga: subjekti "L." ofertën 302,500 lekë në muaj; 2 oferta nga subjekti "D. I.", ofertën 222,500 lekë në muaj dhe ofertën 471,900 lekë në muaj; subjekti "I. R. E. I." ofertën 284,350 lekë në muaj. Komisioni pasi ka shqyrtuar ofertat ka vlerësuar si të vlefshme ofertën e paraqitur nga subjekti "D. I." në vlerën 222,500 lekë në muaj për ambientin me sipërfaqe 276 m^2 të ndodhur në rrugën "N.T.".
Konstatohet se njoftimi për marrje me qera të ambienteve nuk është publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe as në ndonjë media të shkruar ose vizive, duke sjellë mungesën e ofertuesve të tjerë në këtë shërbim. Asnjë nga ofertat e administruara nuk rezulton e protokolluar. Gjithashtu konstatohet se komisioni i ngritur me urdhrin e mësipërm ka vepruar në tejkalim të kompetencave, pasi në urdhër citohet se komisionin duhet të merret me studimin e tregut për të gjetur ambiente me qera dhe në asnjë pikë të tij nuk citohet që komisioni i mësipërm duhet të vlerësojë ofertat dhe të shpallë fituesin për lidhjen e kontratës. Ambienti që ka rezultuar fitues është i njëjti me ambientet në të cilin zhvillonte aktivitetin IIPP që prej vitit 2020. Titullari i Institucionit ka lidhur kontratën nr. 7/1, datë 18.01.2022, me afat përfundimi 31.12.2022.

Subjekti i audituar, konkretisht, z. B.K., zj. D.Ll., zj. E.M., zj. R.B., zj. E.C., z. N.K., z. A.H., z. B.S., zj. V.E., z. E.A., zj. M.M. kanë paraqitur observacionet për Projekt Raportin me nr. 471/2 prot., datë 21.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 811/10, datë 22.12.2022.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen mbi zhvillimin e procedurave publike, sqarojmë se Autoriteti kontraktor IIPP, është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe për rrjedhojë i gjithë programi ekonomiko financiar, na vjen i miratuar nga ky institucion. Duke qenë se jemi institucion në varësi të MSHMS, regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, nuk mund të hartohet përpara se sa të na vihet në dispozicion buxheti i miratuar nga organi epror. Për vitin 2018, IIPP është njohur me buxhetin e miratuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me anë të shkresës nr. 5602/4, 22.01.2018, për vitin 2019, është njohur me buxhetin e miratuar me shkresën nr. 294, datë 16.01.2019, për vitin 2020, me shkresën nr. 247/2, datë 28.01.2020, për vitin 2021, me shkresën nr. 320/1, datë 20.01.2021, për vitin 2022, me shkresën nr. 5256/4, datë 11.01.2022. Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, është hartuar jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit.

Lidhur me gjetjen e KLSH, se në të gjitha komisionet e prokurimit me vlerë të vogël, për periudhën objekt auditimi ka qenë kryetare e komisionit nëpunësi zbatues sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar) dhe VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, i vetmi person që nuk lejohet të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla është titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar.

Gjithsesi theksojmë se nga muaji prill i vitit 2022, nëpunësi zbatues nuk është më pjesë e komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël dhe ky ndryshim është reflektuar në komisionin e blerjeve të vogla për vitin 2022, i cili zhvillon aktualisht procedurat e prokurimit.

Lidhur me qëndrimin e KLSH për pa rregullësitë që janë konstatuar në procedurat e zhvilluara në prokurimet publike 2018 - 2022, theksojmë se IIPP, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për shkak se janë edhe procedura me vlerë të vogël, i ka kushtuar me shumë rëndësi çmimit më të ulët dhe fushës së veprimtarisë së operatorëve ekonomik, duke i krijuar mundësi të barabarta të gjithë operatorëve ekonomik të interesuar. IIPP-ja, respektivisht gjatë kryerjes së këtyre procedurave respekton me rigorozitet tre parime, parimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe eficenës. Synimi ka qenë që të kualifikohet çdo operator që në objektin e veprimtarisë ka objektin e aktivitetit të prokurimit dhe

ka ofertën ekonomike me vlerë më të ulët. Lidhur me ndonjë mangësi të dokumentacionit, sqarojmë se në asnjë procedurë mungesa e një dokumenti nuk është përdorur për të skualifikuar një operator me ofertë të ulët për të kaluar tek një operator me vlerë më të lartë me synim mirë përdorimin e fondeve publike.

Lidhur me faktin se në një procedurë prokurimi është pranuar vërtetimi i OSHE, i muajit Nëntor, ndërkohë që procedura është realizuar në muajin Shkurt, nga autoriteti kontraktor është argumentuar me arsyetimin se në procedurat e prokurimit vërtetimet e paraqitura kanë vlefshmëri deri në tre muaj, dhe është konsideruar si e rregullt, gjithmonë duke qenë oferta me vlerën më të ulët dhe duke patur si synim mirë përdorimin e fondeve publike.

Lidhur me gjetjen e KLSH se në procedurat e prokurimit të viteve 2018 – 2021 nuk është pasqyruar fondi limit në urdhrin e prokurimit, sqarojmë se: Në mbështetje të regjistrit të parashikimit të prokurimit publik të miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, dhe në zbatim të nenit 59, Përllogaritja e vlerës limit të kontratës, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar , në çdo procedurë prokurimi është mbajtur procesverbali i Përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, është protokolluar dhe një kopje e këtij procesverbali është në protokollin e institucionit. Po kështu edhe në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) është hedhur vlera limit e kontratës. Mos pasqyrimi i vlerës limit të kontratës në urdhrin e prokurimit, është një gabim njerëzor, i cili ka ardhur pasi referuar Udhëzimit Nr. 3, Datë 8.01.2018 "Mbi Përdorimin e Procedurës së Prokurimit me Vlerë të Vogël dhe Zhvillimin e saj me Mjete Elektronik", theksohet që në Ftesën për Ofertë nuk duhet të publikohet vlera limit e kontratës, për interesi nuk është publikuar edhe në Urdhërin e Prokurimit.

Përsa i përket gjetjeve të KLSH se në tre procedurat e prokurimit "Blerje tonera dhe kancelari" viti 2018, 2019, 2020, operatorit ekonomik të kualifikuar i pari në sistem i janë kërkuar monstra të mallit në kundërshtim me rregullat e prokurimeve, theksojmë se arsyeja përse janë kërkuar këto mostra të mallit (konkretisht bojrat e printerit) është për shkak se pajisjet e institucionit tonë (fotokopje dhe printerat) janë të vjetra dhe është menduar e nevojshme që operatori ekonomik i shpallur fitues, të paraqesi paraprakisht disa monstra të mallit. Pra, IIPP i ka dhënë rëndësi këtij fakti në këto procedura prokurimi për blerje tonerash, pasi dëmi që mund t'i vinte institucionit tonë nga përdorimi i bojrave jocilësore, do të ishte tepër i lartë financiarisht. Kjo masë në vetvete, as ka paragjykuar as ka penguar procesin, pasi ka qenë në proporcion me nevojat e insitucionit.

Lidhur me gjetjen në procedurën e prokurimit "Blerje Karburanti" 2018, se operatori ekonomik fitues nuk i ka sjell të plota dokumentet e kërkuara të cilat vërtetojnë shlyerjen e energjisë elektrike deri në dhjetor 2017, sipas ftesës për ofertë, theksojmë se operatori ekonomik fitues ka sjell në institucion vërtetimin për shlyerjen e energjisë elektrike deri në nëntor të viti 2017. Nisur nga fakti që procedura e prokurimit është iniciuar në fillim të muajit shkurt për shkak të afatit të ngushtë kohor, operatori ekonomik ka arsyetuar se është brenda afatit kohor për të paguar pagesën e dhjetorit. Në këto kushte, për shkak të nevojave emergjentë të institucionit për karburant është parë e arsyshme nga KVO të vijoj me lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik fitues, pasi është vlerësuar që operatori ekonomik ka qenë i rregullt me shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike.

Lidhur me gjetjet e KLSH, në procedurat e prokurimit e "Marrje makine me qira" për vitin 2020, 2021, 2022, se operatori ekonomik fitues nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e detyrimeve, sipas përcaktimeve në ftesën për ofertë, theksojmë për KLSH së qëllimi i IIPP-së gjatë përpilimit të kritereve për kualifikim ka qenë që operatori ekonomik fitues të sillte si dokument vetëm vërtetimin për pagimin e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, së bashku me dokumentet e përcaktuara në pikat e tjera të ftesës për ofertë, te cilën operatori ekonomik e ka përmbushur.

Lidhur me gjetjet e KLSH, se në procedurat e prokurimit "Blerje karburanti" viti 2019, 2020, 2021 nuk është cilësuar në ftesën për ofertë sesi duhet të ofertojnë operatorët ekonomik me çmim njësi, vlerë absolute apo marzh fitimi, theksojmë se në të gjitha procedurat e prokurimit është vijuar me çmim për njësi. Gjithsesi, në procedurën e prokurimit "Blerje karburanti" 2022 është përcaktuar në ftesën për ofertë se operatori ekonomikë fitues duhet të ofertojë në vlerë absolute për litër. Gjithashtu, sqarojmë se në procedurën e prokurimit të vitit 2021 për "Blerje Karburanti", për shkak së IIPP ka zgjedhur të

vijojë procedurat me çmim të pandryshuar për njësi, buxheti i shtetit (IIPP-ja) ka përfituar një vlerë prej 200,000 lekë, pasi çmimi i bursës është rritur me 40 %- 50 % gjate kësaj periudhe.

Lidhur me konstatimet e KLSH, se në procedurat e prokurimit "Marrje makine me qira" për vitin 2019, 2020, 2021, 2022, nuk janë argumentuar specifikimet teknike sipas parashikimeve ligjore, IIPP thekson se të gjitha këto specifikime teknike janë parashikuar në mënyrë të plotë dhe të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Këto specifikime teknike janë hartuar përgjithësisht me terma funksionalë dhe me qëllim që të mundësojnë një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar. Theksojmë se specifikimet teknike për vitit 2019-2021 janë në përputhje të plotë ligjore me nenin 23 të ligjit 9643, 20.11.2006 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, pasi ndryshimet ligjore lidhur me hartimin dhe mbajtjen e procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike kanë hyrë në fuqi në maj të vitit 2021, bazuar në VKM-në nr. 285 datë 19.05.2021.

Lidhur me gjetjen të KLSH, theksojmë se gjatë vitit 2019, Instituti i Integrimit ish të Përndjekurve Politikë (IIPP-ja), ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim Mirëmbajtje Automjeti", me anë të së cilës ka dal fitues operatori ekonomik P. Shpk. Në përfundim të procedurës te dyja palët kanë lidhur kontratën e shërbimit Nr. 31 Prot., 25.02.2019.

Por, pasi janë kryer këto shërbime nga operatori ekonomik fitues P. Shpk, si pasojë e një difekti teknik në impiantin elektrik, automjeti tip M...me targa AA....RE ka marr flakë në lëvizje dhe ka pësuar dëme të konsiderueshme. Për këtë situatë, IIPP ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale ligjore me institucionet përkatëse si Komisariati Nr. 2, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Theksojmë për KLSH se, IIPP ka ndërmarrë të gjitha masat dhe në PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022, ka planifikuar blerjen e një makine tip fouristrade në vlerën 4,000,000 lekë, pavarësisht se ky investim nuk është miratuar nga organi epror. Ndërsa në PBA 2021-2023 i cili është hartuar ne vitin 2020 dhe PBA 2022- 2024 i është hartuar ne vitin 2021, nuk është parashikuar një investim i tillë, për shkak se prioritet i është dhënë rikonstruksionit të godinës të IIPP së ndodhur në Rrugën Xhorxh. Ë Bush, si pasojë dëmeve të konsiderueshme që iu shkaktuan nga tërmeti i nëntorit 2019, bazuar në Akt – Konstatimit e datës 06.12.2019 "Mbi vertifikimin në terren të subjekteve të dëmtuara nga tërmeti" të Institutit të Ndërtimit. Ndërkohë, në PBA 2023-2025, IIPP ka parashikuar një investim në shumën 4,000,000 lekë për blerjen e një automjeti në pronësi të IIPP, invenstim i cili është prerogativ e vendimmarrjes nga organi epror, MSHMS.

Lidhur me gjetjen 10 të KLSH, sqarojmë se në vitin 2018 nga ana e IIPP është dërguar pranë AKSHIT, kërkesa nr. 243 prot., datë 06.04.2018 me objekt "Kërkesë për blerje pajisje kompjuterike", duke qenë se bazuar në VKM nr. 673 datë 22.11.2017, pika 5 shkronja i, është institucioni kompetent që organizon, kryen prokurimet e qendërzuara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet softëare dhe hardëare, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe internetit me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, për institucionet në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, që janë nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

Sa më lart, duke qenë se kjo procedurë prokurimi zhvillohet nga AKSHI, IIPP në pamundësi për të pasur një informacion të saktë mbi të dhënat bazë të kësaj procedure prokurimi bazuar në paragrafin 5 pika 1 Kreu 1 të Udhëzimit të APP Nr. 4 datë 18.06.2018, të tilla si: lloj i procedurës së prokurimit, tipi i kontratës/marrëveshjes kuadër etj, nuk e ka parashikuar këtë procedurë prokurimi në regjistrin e prokurimeve. (të dhëna që janë të nevojshme për plotësimin e duhur të regjistrit të parashikimeve).

Për më tepër, bazuar në pikën 5 të Udhëzimit të APP nr. 4 datë 18.06.2018 parashikohet shprehimisht se: "Cdo autoriteti kontraktor, i cili do të luajë rolin e organit qendror blerës dhe/ose autoritetit të cilit i është deleguar e drejta për prokurim (nësë është rasti duhet të krijojnë një regjistër parashikimi për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen prej tyre, menjëherë me mbledhjen e të dhënave, por në çdo rast jo më vonë se 10 ditë nga marrja e tyre". Pra, organi qendror/blerës që do të zhvillojë prokurimin publik është autoriteti përgjegjës që do të parashikojë në sistemin e prokurimeve regjistrin e parashikimeve.

Lidhur me pretendimin e KLSH se IIPP nuk ka pasur fonde në dispozicion për të zhvilluar këtë procedurë prokurimi, theksojmë se IIPP ka pasur në dispozicion fonde, bazuar në shkresën nr. 201/3 prot., datë 15.02.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me objekt "Celje buxheti për vitin 2018

për shpenzime kapitale (art.230,231)" (të cilën e gjeni bashkëngjitur këtij observacioni). Duke qenë se fillimisht fondi për këtë procedurë prokurimi ka qenë i ngrirë, IIPP me anë të shkresës nr. 225 prot., datë 26.03.2018 me objekt "Kërkesë për çngurtësimin e fondit të investimeve" i është drejtuar AKSHIT dhe i ka kërkuar të bëhet shkrirja e fondit të investimeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit në vlerën 1.200.000 lekë, për blerjen e pajisjeve informatike të IIPP-së. Në përgjigje të kërkesës sonë, AKSHI me anë të shkresës nr. 1455/1 prot., datë 10.04.2018 me objekt "Mbi kërkesën për çngurtësim fondi investimesh" drejtuar IIPP-së, ka miratuar listën e pajisjeve informatike/kompjuterike që do të prokuroheshin dhe rrjedhimisht ky fond është bërë i përdorshëm.
Ndërkohë pasi IIPP dhe AKSHI kanë përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për zhvillimin e prokurimit publik si më sipër, MSHMS me anë të shkresës nr. 4773/8 prot., datë 21.09.2018, protokolluar me tonën nr. 624, datë 01.10.2018, na ka informuar mbi pakësimin e fondeve buxhetore në shpenzimet kapitale bazuar në Aktin Normativ nr. 1 prot., datë 26.07.2018 dhe shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 14875/111 datë 10.09.2018. Për këtë arsyeje është krijuar dhe ky detyrim i prapambetur, i cili është likuiduar plotësisht në vitin 2020.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Grupi i auditimi, pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur, arsyeton se:
Pretendimi në lidhje me miratimin e regjistrave të parashikimeve brenda afatit nuk merret në konsideratë pasi pavarësisht arsyeve apo përgjegjësive, regjistrat janë miratuar jashtë afateve të përcaktuara.
Pretendimi në lidhje me marrjen pjesë të nëpunësit zbatues në komisionet e prokurimit publik nuk qëndron, pasi është në kundërshtim me nenin 12, pika 3, germa e) dhe nenin 22, pika 3, grema b) të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Në lidhje me pretendimin e pranimit të vërtetimit për pagesën e detyrimeve të energjisë, të një muaji të ndryshëm nga ai i paraqitur në ftesën për ofertë si dhe pretendimi në lidhje me kriteret e plotësuara nga operatori ekonomik i shpallur fitues për procedurat e marrjes me qera të makinës nuk qëndrojnë, pasi janë shpallur fitues operatorë ekonomi të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë.
Në lidhje me vendosjen e kriterit të paraqitjes së mostrave, pavarësisht arsyesh apo qëllim që është përdorur, vendosja në ftesën për ofertë e kriterit të paraqitjes së mostrave të mallit objekt prokurimi është në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.
Në lidhje me pretendimet për procedurat e prokurimit për karburantin nuk merret në konsideratë pasi në VKM-në për procedurat e prokurimit është përcaktuar se kriteri i vlerësimit për furnizimin me karburant do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në: a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni; c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje" dhe në VKM e re për procedurat e prokurimit pika c) është ndryshuar duke u bërë c) norma e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.
Pretendimi në lidhje me specifikimet teknike nuk qëndron, pasi asnjë kritere specifik i vendosur nuk ka qenë i argumentuar.
Pretendimi për pasjen në dispozicion të fondeve për zhvillimi procedurës së prokurimit të zhvilluar nga AKSHI nuk qëndron pasi me AN nr. 1, datë 26.07.2018, IIPP-së i janë shkurtuar fondet për shpenzime kapitale.

Gjetja:	Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka caktuar Personat Përgjegjës për Prokurimin. Parregullsi në hartimin e regjistrave të parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit. Parregullsi gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit. Në 5 raste, në vlerën totale 3,341,822 lekë, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. Nëpunësi zbatues ka qenë edhe kryerat i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.
Situata:	Për vitin 2018 dhe vitin 2022, titullari i Autoritetit Kontraktor ka caktuar Personat Përgjegjës për Prokurimin, jashtë afatit të përcaktuar në pikën 1, neni 57 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe pikën 1, neni 74 të VKM-së nr. 285, 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ndërsa për vitin 2019, 2020 dhe 2021, titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për caktimin e personave përgjegjës për prokurimit, në kundërshtim me pikën 1, neni 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë miratuar jashtë afateve kohore të përcaktuara në nenin 4, pika 1, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar si dhe nenin 3, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Gjithashtu, regjistrat e realizimit të procedurave të prokurimit janë dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë afatit kohor. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua se në 5 raste, në vlerën totale 3,341,822 lekë pa TVSH, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në urdhrin e prokurimit dhe në ftesën për ofertë, *konkretisht*: - Në procedurën e prokurimit me objekt *"Blerje karburanti, për vitin 2018"*, me vlerë kontrate 585,822 lekë pa TVSH, operatori "D... O.." i shpallur fitues nuk ka dorëzuar vërtetim të pagesë së energjisë elektrike për muajin Dhjetor 2017. - Në procedurat e prokurimit me objekt *"Marrje makine me qira"*, për vitin 2019 me vlerë kontrate 389,000 lekë pa TVSH, për vitin 2020 me vlerë kontrate 780,000 lekë pa TVSH, për vitin 2021 me vlerë kontrate 780,000 lekë pa TVSH dhe për vitin 2022 me vlerë kontrate 780,000 lekë pa TVSH, operatori ekonomik "G. A. A." SHPK, nuk ka paraqitur vërtetim që ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar shlyerjen e detyrimeve për energji elektrike. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël është konstatuar se në procedurat e prokurimit blerje kanceri për vitin 2018, 2019, 2020, 2021, blerje karburanti për vitin 2019, marrje e makinës me qira për vitin 2019 nuk është përcaktuar fondi limit; në 3 procedurat e prokurimit për blerje tonera dhe kancelari në ftesën për ofertë nuk janë vendosur kriteret dhe specifikime teknike, si dhe është kërkuar paraqitja e mostrave për mallrat e prokuruar; në procedurën blerje tonera dhe kancelari për vitin 2019 nuk është mbajtur procesverbal për kalimin te operatori ekonomik i radhës, në 3 procedurat e prokurimit për blerje karburanti vlerësimi i oferta është bërë në bazë të çmimit të pandryshuar përgjatë zbatimit të kontratës; në 4 raste për procedurat e

	marrjes së makinës me qira komisioni nuk ka argumentuar specifikimet teknike. Nga auditimi është konstatuar se në të gjitha komisionet e prokurimit me vlerë të vogël, për periudhën objekt auditimi, ka qenë kryetare e komisionit Përgjegjësja e Financës dhe Shërbimeve, njëkohësisht nëpunësi zbatues i institucionit, veprime jo në përputhje me nenin 12, pika 3, germa e) dhe nenin 22, pika 3, grema b) të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Kriteri:	- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenin 12, pika 3, germa e) dhe nenin 22, pika 3, grema b); - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni, pika 3, neni 4, pika 1, neni 31, pika 3, neni 57, pika 1; - VKM nr. 285, 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; neni 74, pika 1; - Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1, - Udhëzimi i APP-së nr. 1, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik", Kreu 2, pika 3; - Udhëzimi i APP-së nr. 4, datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik" Kreu 2, pika 3; - Udhëzimi i APP-së nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, pika 6, 7/b, 8, 17 - Udhëzimit të APP-së nr. 5, 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me blerje të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 18.
Impakti:	Mangësi në përdorimin me efektivitet, efiçencës dhe ekonomicitet të fondeve publike.
Shkaku:	Mos njohje dhe mos zbatimi i legjislacionit, shoqëruar me neglizhencë te zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme për caktimin e personave përgjegjës për prokurimin, hartimin e saktë dhe brenda afateve kohore të regjistrave të parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit, si dhe trajnimin e zyrtarëve të prokurimit, me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, titullari i Autoritetit Kontraktor në vijimësi të mos caktojë Nëpunësin Zbatues/ Përgjegjësin e Financës dhe Shërbimeve në komisionet e prokurimeve, me qëllim uljen e riskut të mungesës së kontrollit mbi transaksionet e institucionit, si dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi kontrollin vertikal.

Gjetja:	Gjatë periudhës 2019-2022, IIPP ka shpenzuar 3,274,800 lekë për marrjen e automjetit me qera, në një kohë që mund të kishte blerë automjet dhe te ishte në pronësi të institucionit.
Situata:	Nga auditimi rezulton se prej vitit 2019 e në vijim, pra për një periudhë katërvjeçare, IIPP çdo vit kryen procedurën e prokurimit me objekt "Marrje me qera e automjetit", për të cilat janë lidhur dhe likuiduar kontrata në vlerën totale 3,274,800 lekë. Konstatohet se institucionin në PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022, ka planifikuar blerjen e një makinë tip fouristrade, në vlerën 4,000,000 lekë, e cila nuk rezulton të jetë pjesë e listë shoqërues të investimeve për miratimin në projekt buxhetet e viteve përkatëse. Ndërsa në PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, institucioni nuk ka planifikuar fonde për blerje automjeti.
Kriteri:	Udhëzimi 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", pika 4.
Impakti:	Shpenzime të larta për marrjen me qera të automjetit, pa arritur të ketë mjet ne pronësi institucioni.
Shkaku:	Mungesa e automjetit për përmbushjen e nevojave të institucionit, si rezultat i mungesës së përcaktimit në kërkesat e PBA.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politik të marrë masa për paraqitjen, argumentimin dhe planifikimin në PBA të nevojës për blerjen e një automjeti, me qëllim uljen e shpenzimeve për marrje me qira dhe menaxhimin me eficencë, efektivet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Gjetja:	Marrja e angazhimeve pa pasur fonde në dispozicion.
Situata:	Gjatë vitit 2018, AKSHI ka lidhur 4 kontrata, për procedurën e prokurimit të ndarë në lote blerje pajisje kompjuterike në vlerën totale 1,099,670 lekë. Rezulton se AK, nuk e ka parashikuar këtë procedurë prokurimi në regjistrin e parashikimit si dhe nuk e ka deklaruar në regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit, në kundërshtim me pikën 1, neni 4 si dhe pikat 1, 2, 5, neni 7 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Gjithashtu konstatohet se pavarësisht se me AN nr. 1, datë 26.07.2018, IIPP-së i janë shkurtuar fondet për shpenzime kapitale, AKSHI ka filluar procedurën e prokurimit për blerjen e pajisjeve kompjuterike dhe ka lidhur kontratat, duke marre angazhime pa fonde buxhetore dhe krijuar detyrime të prapambetura në vlerën totale 1,099,670 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKM nr. 185, datë 29.03.2018 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike".
Impakti:	Krijimi i detyrimeve të prapambetura.
Shkaku:	Fillimi i procedurës së prokurimit dhe lidhja e kontratës pa pasur më parë fondet në dispozicion.

Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për marrjen e angazhimeve pa pasur fonde në dispozicion, si dhe të shmangë praktikat e financimit të projekteve të investimit pa kaluar fazat e menaxhimit të investimeve publike.

6.2 Auditimi mbi shpenzimet e kryera nëpërmjet procedurave të prokurimit për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.

Në zbatim të pikës nr. 6, të programit të auditimit nr. 811/3, datë 09.09.2021 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Regjistri i parashikimit dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2019 (gjashtë mujori i dytë), 2020, 2021 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.
2. Planifikimi buxhetor i prokurimeve.
3. Dosjet e procedurave të prokurimeve.
4. Aksesi në sistemin e prokurimeve publike në faqen e APP (http://ŵŵŵ.app.gov.al/).

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në lidhje me procedurat e prokurimit është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën e aktivitetit deri më datë 30.05.2019.

Për vitin 2019, regjistri i parashikimeve të prokurimeve, është miratuar me shkresën nr. 10, datë 22.01.2019, jashtë afateve kohore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 4, pikës 1, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. ISKK nuk ka përgatitur regjistër të realizimit të prokurimeve, në kundërshtim me Kreun 2, pika 3 të Udhëzimit të APP-së nr. 1, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik".

ISKK, për vitin 2019, ka parashikuar të zhvillojë 12 procedura prokurimi në shumën totale 7,091,667 lekë nga të cilat 10 procedura "Blerje me vlerë të vogël". ISKK ka realizuar 6 procedura në vlerën totale 2,028,709 lekë, çka tregon për një planifikim të dobët, pasi ISKK ka realizuar 29 % të vlerës së planifikuar.

Tabela nr. 90: "Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2019" *lekë*

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera pa TVSH	Numri	Vlera me TVSH
1	Blerje me Vlerë të Vogël	10	4,100,000	5	712,042
2	Kërkesë për propozim	2	2,991,667	1	1,316,667
SHUMA		**12**	**7,091,667**	**6**	**2,028,709**

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit në sistem e APP

Për vitin 2020, regjistri i parashikimeve të prokurimeve, është miratuar me shkresën nr. 10, datë 27.01.2020, jashtë afateve kohore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 4, pikës 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. ISKK nuk ka përgatitur regjistër të realizimit të prokurimeve, në kundërshtim me Kreun 2, pika 3 të Udhëzimit të APP-së nr. 1, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik".

ISKK, për vitin 2020, ka planifikuar të zhvillojë 35 procedura prokurimi në vlerën totale 6,295,000 lekë nga të cilat 23 procedura me vlerë nën 100,000 lekë. ISKK ka realizuar 6 procedura në vlerën totale 2,553,830 lekë, çka tregon për mangësi planifikimi.

Për vitin 2021, regjistri i parashikimeve të prokurimeve është miratuar me shkresën nr. 19, datë 29.01.2021, jashtë afateve kohore, jo në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. ISKK nuk ka përgatitur regjistër të realizimit të prokurimeve, jo në përputhje me Kreun 2, pika 3 të Udhëzimit të APP-së nr. 1, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik".
ISKK, për vitin 2021, ka planifikuar të zhvillojë 9 procedura prokurimi në vlerën totale 4,607,033 lekë nga të cilat 8 procedura me vlerë të vogël.

Për vitin 2022, regjistri i parashikimeve të prokurimeve, është miratuar me shkresën nr. 15, datë 04.02.2022, jashtë afateve kohore, jo në përputhje me kërkesat e nenit 3, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Për vitin 2022, janë planifikuar të realizohen 25 procedura prokurimi në vlerën totale 4,502,233 lekë dhe deri në fund të gjashtë mujorit të parë janë realizuar 2 procedura prokurimi në vlerën totale 368,990 lekë. Nga auditimi i regjistrave të printuara nga sistemi i APP rezulton se ISKK nuk ka publikuar në regjistrin e realizimit për vitin 2019, 2020 dhe 2021 blerjet e vogla me vlerë nën 100,000 lekë në kundërshtim me pikën 2, neni 8 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 3, neni 11 i VKM nr. 285, datë19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku citohet se: *"... Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të prokurimit publik..."*
Nga auditimi i pagesave të kryera në muajin Dhjetor 2020 rezulton se me urdhër shpenzimin nr. 189, datë 24.12.2020 është paguar fatura tatimore nr. 642, datë 10.12.2020 e personit fizik "Edmon Vishka" në vlerën 40,000 lekë për blerjen e tabelë informacioni (material pegsiclas 1.2*1 m). Gjithashtu rezulton se me urdhër shpenzimin nr. 190, datë 30.12.2020 është paguar fatura tatimore nr. 388003312, datë 17.12.2020 e subjektit "M." në shumën 119,625 lekë për blerje karrige zyrash. Sa më sipër, konstatohet se të dy pagesat e mësipërme kanë të njëjtin objekt, konkretisht "Blerje pajisje për zyra", në vlerën totale 159,625 lekë dhe ndarja e tyre në dy blerje shmang përdorimin e procedurës së prokurimit me blerje të vogël.

Nga auditimi rezulton se të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim jo në përputhje me nenin 36 "Arkivat e numerizuar", të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat".
Nga auditimi me zgjedhje i procedura të prokurimit u konstatua si në vijim:

1. Procedura e prokurimit "Shërbim interneti 40 Mps i dedikuar dhe simetrik", 2019

Urdhër Prokurimi	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël**	Vlera kontratës ose faturës:
Nr. 13, datë 14.11.2019,(nr. 294/1, prot. datë 15.11.2019)	Urdhër nr. 24, datë 17.07.2019 (nr. 220/3 prot, datë 17.07.2019)	Kontrata nr. 294/2, datë 25.11.2019, në vlerën 130,000

Lloji i Procedurës së Prokurimit “ Blerje me vlerë të vogël”	Zj. F.S. Zj. D.R Zj. J.K.	lekë pa TVSH ose 156,000 lekë me TVSh
Fondi Limit (pa tvsh) 150,000 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** “K.” SHPK 130,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 20,000 lekë
Data e hapjes së tenderit: 22.11.2019	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 6 OE b) Skualifikuar : 2 (OE) c) Kualifikuar: 4 (OE)

Argumentimi i fondit limit. Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nga komisionin i prokurimit me vlerë të vogël, nuk është mbajtur procesverbal për llogaritjen e fondit limit apo testimin e tregut, në kundërshti me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet se: “*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”.*

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 13, datë 14.11.2019, me objekt “Shërbim interneti 40 Mps i dedikuar dhe simetrik”, me fond limit 150,000 lekë pa TVSH. Urdhri i prokurimit është hartuar sipas formatit nr. 2, në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Ftesa për ofertë. Nga auditimi i dosjes së prokurimit dhe sistemit elektronik të APP rezulton së Ftesa për ofertë u është dërguar 5 operatorëve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 4 operatorë, ndërsa 2 operatorë ekonomike janë skualifikuar pasi oferta ekonomike e paraqitur ka rezultuar më e lartë se fondi limit.

Tabela nr. 91: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	A.....	85,000
2	A.....	126,000
3	K....	130,000
4	A... S.... C....	150,000

Nga auditimi i dokumenteve ne sistemin e APP rezulton se komisioni i prokurimit më datën 21.11.2019 i ka dërguar operatorit ekonomik të renditur i pari “A.....” njoftim për shpallje fituesi, më datën 22.11.2019 i ka dërguar njoftimin për shpallje fitues operatorit “A.....” dhe më datën 25.11.2019 i ka dërguar operatorit ekonomik “K....” njoftim për shpalljen fitues. Konstatohet se në sistemin e prokurimeve nuk ka asnjë dokument për arsyen e kalimit te operatori tjetër fitues. Gjithashtu konstatohet se komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk ka mbajtur procesverbal me qëllim dokumentimin e kalimin te operatori tjetër ekonomik, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të APP-së nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura nga operatori ekonomik "K." SHPK rezulton se të gjitha dokumentet e paraqitura janë fotokopje të pa noterizuara, jo në përputhje me pikën 15 të Udhëzimit të APP-së nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" si dhe pikën 3 të Ftesës për Ofertë nr.294/2, datë 15.11.2019. Në Ftesën për ofertë citohet se ofertuesi duhet të dorëzojë një dokument që vërteton se nuk është në proces falimentin. Nga auditimi rezulton se nuk ka asnjë dokument të dorëzuar në lidhje me procesin e falimentit. Gjithashtu në Ftesën për Ofertë citohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë e shoqërisë për shërbimin e internetit nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka dorëzuar Liçencën nr. 992/0408, datë 16.04.2008 "Për ofrimin e shërbimit të internetit", nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit, me afat vlefshmëri deri më datë 16.04.2013. Pra licenca e paraqitur nga operatorin ekonomik "K." SHPK, nuk ka qenë e vlefshme për periudhën kur është zhvilluar procedura e tenderit. Rezulton se OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në Ftesën për Ofertë. Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi Komisioni i Prokurimit, i përbërë nga zj. F.S., zj. D.R dhe zj. J.K..

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur Kontratën e Shërbimit nr. 294/2, datë 25.11.2019 (numri i protokolli i njëjtë me numrin e Ftesës për Ofertë") me operatorin ekonomik "K." SHPK, në vlerën totale 130,000 pa TVSH, me afat 12 muaj. Nga auditim rezulton se pagesat janë kryer, çdo muaj në vlerën 13,000 lekë, brenda 30 ditëve nga data e faturës së operatorit ekonomik.

2. Procedura e prokurimit "Realizimi i performancës publike (Ekspozitë) "Komunizmi shqiptar: propaganda dhe realiteti", 2019

<table>
<tr><td>Urdhër Prokurimi
Nr. 10, datë 07.11.2019,(nr. 291/1, prot, datë 07.11.2019)</td><td rowspan="2">Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël
Urdhër nr. 24, datë 17.07.2019 (nr. 220/3 prot, datë 17.07.2019)
Zj. F.S.
Zj. D.R
Zj. J.K.</td><td rowspan="2">Vlera kontratës ose faturës:
Kontrata nr. 291/7, datë 18.11.2019, në vlerën 150,000 lekë pa TVSH ose 180,000 lekë me TVSH</td></tr>
<tr><td>Lloji i Procedurës së Prokurimit
" Blerje me vlerë të vogël"</td></tr>
<tr><td>Fondi Limit (pa tvsh)
333,000 lekë</td><td>Oferta fituese (pa tvsh)
"E.M.", (G. H.) 150,000 lekë</td><td>Diferenca me fondin limit (pa tvsh)
183,000 lekë</td></tr>
<tr><td>Data e hapjes së tenderit:
13.11.2019</td><td>Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>Operatoret Ekonomike
Pjesëmarrës në tender: 5 OE
b) Skualifikuar : 1 (OE)
c) Kualifikuar: 4 (OE)</td></tr>
</table>

Argumentimi i fondit limit. Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nga komisionin i prokurimit me vlerë të vogël, më datë 07.11.2019 është mbajtur procesverbal për testimin e tregut, ku janë administruar oferta nga tre operatorë ekonomike dhe bazuar në to, fondi limit është përcaktuar në vlerën 333,000 lekë pa TVSH. Nga auditimi rezultoi se ofertat e administruara nga operatori ekonomik "E. P." dhe "D. P. A." janë të pa firmosura dhe të pa vulosura.

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 10, datë 07.11.2019, me objekt "Realizimi performancës publike "Komunizmi shqiptar: propaganda dhe realiteti". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, veprime jo në

përputhje me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Ftesa për ofertë. Nga auditimi i dosjes së prokurimit dhe sistemit elektronik të APP rezulton së Ftesa për ofertë nuk u është dërguar të paktën 5 operatorëve ekonomik (dërguar 3 operatorëve ekonomik), në kundërshtim me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 4 operatorë, ndërsa 1 operator ekonomik është skualifikuar pasi oferta ekonomike e paraqitur ka rezultuar më e lartë se fondi limit.

Tabela nr. 92: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, Lekë pa TVSH
1	E.M..	150,000
2	J.G.	275,000
3	O. T.	300,000
4	G.C.	322,000

Me shkresën nr. 291/4, pa datë, Titullari i Autoritetit Kontraktor i ka dërguar operatorit ekonomi të renditur i pari, formularin e njoftimit të fituesit.

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura nga operatori ekonomik "E.M." rezulton se një pjesë e dokumenteve të paraqitura si: fatura tatimore, diplomë universiteti, librezë e pagesës së energjisë elektrike, kontratë qeraje, janë fotokopje të pa noterizuara, veprime jo në përputhje me Shtojcën 2 të Ftesës për Ofertë nr. 291/2, datë 11.11.2019 ku citohet se: *"Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre".*

Në Shtojcën 1, kërkohet një dokument të lëshuar nga Administrata Tatimore, që vërteton se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet dhe sigurimet shoqërore. Në dosjen e paraqitur për auditimin mungon ky dokument.

Në Shtojcën 1, kërkohet një deklaratë që operatori ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit. Në dosjen e paraqitur për auditim mungon ky dokument.

Në Shtojcën 2, kërkohet që subjekti kontraktues duhet të këtë përvojë mbi 2 vjet në këtë fushë dhe të provojë eksperiencat e mëparshme me kontrata apo fatura tatimore. Rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur 3 fatura tatimore, konkretisht faturën nr. 360, datë 02.09.2019 në vlerën 40,409 lekë, faturën 361, datë 02.09.2019 në vlerën 918 lekë dhe faturën 262, datë 02.09.2019 në vlerën 26,975 lekë. Konstatohet se faturat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk provojnë eksperiencën 2 vjeçare të kërkuar.

Në kriteret e veçanta të Shtojcës 2 kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë një projekt ide të qartë, realiste si dhe konceptimin artistik të ekspozitës; të promovojë metoda bashkëkohore në realizimin e promocionit; të paraqesë punët e deritanishme në katalog apo ŵebsiten e kompanisë. Në dosjen e paraqitur për auditimi mungojnë këto dokumente. Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi Komisioni i Prokurimit, i përbërë nga zj. F.S., zj. D.R dhe zj. J.K..

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur Kontratën e Shërbimit nr. 291/7, datë 18.11.2019 me operatorin ekonomik "E.M." në vlerën totale 150,000 lekë pa TVSH, me afat nga data 18.11.2019 deri më datën 03.12.2019. Me shkresën nr. 291/5, datë 04.12.2019 (rezulton se

numri i protokollit 291/5, ka datë më të hershme se numri i protokollit 291/7), Drejtoria e Studimeve ka kërkuar shtyrjen e afatit të kontratës deri më datë 10.12.2019, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar nga tërmeti. Më datën 10.12.2019, është mbajtur proces verbalin nr. 291/6, për konfirmimin e ofrimit të shërbimit për realizimin e ekspozitës "Komunizmi Shqiptar propaganda dhe realiteti". Fatura tatimore nr. 382, datë 10.12.2019, në shumën 180,000 lekë me TVSH është paguar më Urdhër shpenzimin nr. 200, datë 13.12.2019, brenda afati 30 ditor.

3. Procedura e prokurimit me objekt "Shtypshkrimi i kolanës për vitin 2020".

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Shtypshkrimi i kolanës për vitin 2020. (REF -778976-11-06-2020)</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi
Nr. 5, ,datë 05.10.2020
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit
" Kërkesë për propozim"</td><td>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit
Urdhër nr. 48/1 , dt. 02.10.2020
Z. L.N.
Zj. F.S.
Z. GJ.J.</td><td>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 49/1, dt.02.10.2020
Zj. A.H.
Z. K.K.
Zj. L.S.</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa tvsh)
1,249,000 lekë</td><td>6.Oferta fituese (pa tvsh)
"I." SHPK ,oferta prej: 1,073,000 lekë</td><td>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)
176,000 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
25.11.2020</td><td>9.Burimi Financimit
Buxheti i shtetit
Lidhja e kontratës 25.02.2021</td><td>10.Operatoret Ekonomike
Pjesëmarrës në tender: 3 OE
b)Skualifikuar : 0 OE
c) Kualifikuar: 3 OE
Pas Vendimit të KPP:
b)Skualifikuar : 1 OE
c) Kualifikuar: 2 OE</td></tr>
<tr><td>11.Ankimime
Ankim në lidhje me DST nga 1 OE.
Ankim në lidhje me vendimin e KVO nga 1 OE</td><td>12. Përgjigje Ankesës nga AK
Kthyer përgjigje ankesës në lidhje me DST, me shkresën nr. 79/11, datë 18.11.2020.
Kthyer përgjigje ankesës në lidhje me vendimin e KVO, me shkresën nr. 79/20, datë 09.12.2020.</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga KPP
Për vendimin e KVO: Vendimi nr. 19/2021, datë 14.01.2021</td></tr>
</table>

Dokumentet e tenderit. Procedura e prokurimit ka qenë e planifikuar në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, me fond të përllogaritur në vlerën 1,249,333 lekë.
Me urdhrin 47, datë 25.09.2020, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për argumentimin e fondit limit, me përbërje z. P.A., zj. L.A. dhe zj. J.U.. Referuar procesverbalit nr. 79/2, datë 05.10.2020 grupi i punës ka testuar tregun duke marr oferta nga 3 operatorë ekonomik të ndryshëm dhe bazuar në to, fondi i vlerës limit pa TVSH është përcaktuar 1,249,000 lekë.
Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 5, datë 05.10.2020, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës "Shtypshkrim i librave të kolanës për vitin 2020", me procedurë "Kërkesë për propozim" me fond limit 1,249,000 lekë dhe njësi prokurimi të përbërë nga z. L.N., zj. F.S. dhe z. GJ.J..
Me Urdhrin nr. 49/1, datë 02.10.2020, titullari i AK ka përcaktuar Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, të përbërë nga: zj. A.H., Z. K.K. dhe znj. L.S..
Për hartimin e specifikimeve teknike është hartuar relacioni nr. 79/5, datë 23.10.2020 nga eksperti z. GJ.L.. Nga auditimi konstatohet se për specifikimet shtesë të shtypshkrimit si: letër Somoa Ivory me peshë 80 gr; kopertinë 350 gram me 4 ngjyra, mat e celefonuar dhe me llakun Uv për zonat para-mbrapa; katroni për lidhjen speciale të jetë 1800-2000 gr/m^2, nuk janë të argumentuara. Mos argumentimi i kritereve të vendosura bie në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Neni 23 Specifikime teknike, Neni 46

"Kualifikimi i ofertuesve", pika 1 dhe pika 3, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", Neni 27 "Kontratat e mallrave", pika 3, në të cilën përcaktohet se: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*", neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2 paragrafi 2. Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi grupin e hartimit të specifikimeve teknike, z. GJ.L..
Njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbalin nr.79/6, datë 26.10.2020 për hartimin dhe miratimin e dokumenteve të procedurën e prokurimit. Nga auditimi rezulton se Dokumentet Standarde të Tenderit nuk janë të firmosura.
Në lidhje me kriteret e vendosura operatori ekonomik "I." SHPK ka bërë ankesë, konkretisht për kriterin 2.3.2 "Kapacitetet teknike" shtojca 8 "minimumi një pajisje për rrumbullakimin e librit".
Titullari i AK me Urdhrin nr. 55, datë 16.11.2020 ka pezulluar procedurën e prokurimit dhe ka ngarkuar Komisionin e Vlerësimit të Ofertave për shqyrtimin e ankesës. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 79/10, datë 18.10.2020, ku ka pranuar ankesën e bërë nga OE. Komisioni ka marrë vendimin nr.79/11, datë18.11.2020 për pranimin e ankesës së OE "I." SHPK.
Njësia e prokurimit, me procesverbalin nr. 79/13, datë 18.11.2020 ka miratuar ndryshimet në kriteret e DST-ve sipas vendimit të marrë pas shqyrtimit të Ankesës.

Zhvillimi i procedurës. Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave nr. 79/16, datë 25.11.2020, konstatohet se kanë ofertuar 3 OE si më poshtë vijon:
- OE "K. KH" SHPK me ofertë 795,613 lekë;
- OE "I" SHPK me ofertë 1,073,000 lekë;
- OE "A" SHPK me ofertë 1,242,500 lekë.

Me shkresën nr. 136, datë 26.11.2020, KVO i ka kërkuar OE "K.KH" SHPK shpjegime në lidhje me paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, në përputhje me nenin 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar.
Pas dorëzimit të shpjegimeve dhe dokumenteve, KVO ka mbajtur procesverbalin nr. 79/17, datë 02.12.2020, për shqyrtimin e ankesës, ku ka vendosur të kualifikojë operatorin ekonomik "K..KH" SHPK pasi është në gjendje të përmbushë kushtet teknike dhe financiare për realizimin e shtypshkrimit të librave.
OE ka dërguar ankesën nr. 141, datë 07.12.2020, sipas të cilës OE "K.KH" SHPK ka paraqitur anomalisht të ulët dhe nuk duhet të kualifikohet.
Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin nr. 59, datë 07.12.2020 për pezullimin e procedurës dhe shqyrtimin e ankesës, nga grupi me përbërje: zj. L.LL, z. M.B., zj. B.D.. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr.79/19, datë 09.12.2020, ku nuk ka pranuar ankesën e bërë nga OE "I." SHPK.
OE është ankuar në Komisionin e Prokurimit Publik, i cili ka marr Vendimin nr. 1736/1, datë 21.12.2020 ku ka vendosur pezullim të procedurës së prokurimit dhe shqyrtimin në themel të ankesës. KPP ka marrë vendimin nr. 19/2021, datë 14.01.2021 për anulimin e vendimit të KVO-së për kualifikim e operatorit ekonomik "K. KH" SHPK, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 7, datë 25.01.2021 për zbatimin e vendimit të KPP-së. KVO ka mbajtur procesverbalin nr. 79/24, datë 02.02.2021 për skualifikimin e OE "K. KH" SHPK dhe shpallur fitues OE "I" SHPK.
Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura nga operatori ekonomik fitues "I" SHPK, rezulton se ky operatorë plotëson kriteret e vendosura në Dokumentet Standarde të Tenderit.

AK ka lidhur kontratën nr.79/27, datë 25.02.2021 me operatorin ekonomik, me afat lëvrimi 10 dhjetë ditëve pune nga momenti i lidhjes së kontratës.

Zbatimi i kontratës. Titullari ka nxjerrë Urdhrin nr. 10, datë 08.03.2021 për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të Kolanës së Librave të vitit 2020, sipas specifikimeve të kërkuara ne DST dhe Kontratë, me përbërje z. L.N., z. M.B., zj. J.U., zj. L.A., zj. L.S.. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr.79/29, datë 16.03.2021, sipas të cilit më datën 11.03.2021, operatori ekonomik "I." SHPK më datë 11.03.2021 ka dorëzuar 3,100 kopje librash, më datën 16.03.2021 ka dorëzuar 1,000 kopje ndërsa më datë 16.03.2021 ka dorëzuar 1,900 kopje librash. Nga auditimi konstatohet se subjekti "I." SHPK ka dorëzuar me vonës të gjithë sasinë e mallrave.
Mallrat janë bërë hyrje në magazinë në fletë hyrjen nr.1, datë 16.03.2021.
Fatura tatimore nr. 388, datë 16.03.2021, e lëshuar nga subjekti "I." SHPK, në vlerën 1,287,600 lekë është paguar në vlerë të plotë me urdhër shpenzimin nr. 33, datë 29.03.2021, brenda afatit 30 ditor. Nga auditimi rezulton se Autoriteti Kontraktor nuk ka llogaritur penalitetet për dorëzimin me vonesë të mallit, në kundërshtim me pikën 10.3, neni 10 të Kontratës nr. 79/27, datë 25.02.2021, ku citohet se: *"Tarifa ditore e dëmit të likuiduar për dorëzim të vonuar do të jetë 4/1000 e vlerës korrespodentë të mbetur pa zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës*". Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi i Sektorit të Financës.

4. Procedura e prokurimit "Blerje karburanti (naftë) për automjetin, me shërbim furnizimi nëpërmjet kartës elektronike", 2020

Urdhër Prokurimi Nr. 1, datë 27.01.2020,(nr. 14/1, prot, datë 27.01.2020) **Lloji i Procedurës së Prokurimit** " Blerje me vlerë të vogël"	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Z. M.B. Zj. B.D. Zj. F.S.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 14/3, datë 07.02.2020, në vlerën 414,000 lekë pa TVSH ose 496,800 lekë me TVSH
Fondi Limit (pa tvsh) 496,800 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "A. T." 414,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 82,800
Data e hapjes së tenderit: 05.02.2020	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 6 OE b) Skualifikuar : 1 (OE) c) Kualifikuar: 5 (OE)

Argumentimi i fondit limit. Nga auditimi u konstatua se komisionin i prokurimit me vlerë të vogël, më datë 30.01.2020 ka mbajtur procesverbal për argumentimin e fondit limit ku janë administruar oferta nga tre operatorë ekonomike dhe bazuar në to, fondi limit është përcaktuar në vlerën 496,800 lekë me TVSH. Konstatohet se përllogaritja e fondit limit është bërë pas daljes së urdhrit të prokurimit për këtë procedurë, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 5 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", ku citohet se: "*Përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të këtë hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, përllogarit fondin...*" Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi Komisioni i Prokurimit, i përbërë nga z. M.B., zj. B.D. dhe zj. F.S..

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 1, datë 27.01.2020, me objekt "Blerje karburant (naftë) për automjetin, me shërbim furnizimi nëpërmjet kartës elektronike". Rezulton se në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar fondi limit, veprime jo në përputhje me formatin nr. 2 dhe pikën 6 të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Ftesa për ofertë. Sipas të dhënave të sistemit elektronik të APP rezulton së ftesa për ofertë u është dërguar të 5 operatorëve ekonomik, në përputhje me pikën 5, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 9 të udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018. Konstatohet se ftesa për ofertë e protokolluar me nr. 14/2, datë 30.01.2020 është publikuar në sistemin e APP-së më datë 03.02.2020.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 5 operatorë, ndërsa 1 operator ekonomik është skualifikuar pasi oferta ekonomike nuk është paraqitur me marzh fitimi të shprehur në përqindje.

Tabela nr. 93: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike
1	A. T.	7.49
2	D. O.	9.95
3	K.	11.00
4	T.	11.00
5	D. J.	15.00

Me shkresën nr. 14/4, datë 06.02.2020, Titullari i Autoritetit Kontraktor i ka dërguar operatorit ekonomi të renditur i pari "A. T.", formularin e njoftimit të fituesit.

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues. Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura rezulton se operatori ekonomik "A. T." SHA ka lidhur kontratë bashkëpunimi me shoqërinë "O." SHPK nr. 1176 Rep., nr. 309 Kol., datë 11.05.2018, Amenduar me kontratën nr. 280 Rep., nr. 65 Kol, datë 30.01.2020, sipas të cilës, shoqëria "O." SHPK merr përsipër të pranojë dhe të kthejë në lëng tollonat/kartat elektronike B. O. të shitura nga shoqëria "A. T." SHA në të gjithë stacionet e furnizimit me karburant me logo B. O. ku ushtron aktivitete.
Konstatohet se operatori ekonomik fitues "A. T." SHA, për plotësimin e kritereve ka dorëzuar dokumente që i përkasin shoqërisë "O." SHPK, konkretisht: leje mjedis të tipit C; Vërtetim teknik "Për respektimin e normave dhe kushteve teknik në instalimet teknologji në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të tyre"; Autorizim nga komuna Kashar për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe lendeve djegëse", kontrata qereje; Vërtetim teknik "Për respektimin e normave dhe kushteve teknike në stacionet e trëgtimit të karburanteve". Nga auditimi rezulton se vërtetimi teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike nr. 69/7, datë 25.01.2019 ka afat vlefshmërie deri më datën 25.01.2020 (me të drejtë rinovimi), pra në momentin e paraqitjes së dokumenteve ka qenë i pavlefshëm. Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi Komisioni i Prokurimit.

Zbatimi i kontratës. Autoriteti Kontrakor ka lidhur Kontratën e Shërbimit nr. 14/3, datë 07.02.2020 me operatorin ekonomik "A. T." SHA në vlerën totale 414,000 lekë pa TVSH. Me urdhër shpenzimin nr. 44, datë 08.05.2020 është paguar fatura tatimore nr. 851, datë 18.02.2020, në vlerën 496,800 lekë, jashtë afatit, në kundërshtim me neni 4 të kontratës ku citohet se: *"Pagesa*

e mallit duhet të behët 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës nga Kontraktori, në të kundërt Kontraktori ka të drejtë të ndërpresë furnizimin si dhe të aplikojë kamatvonesat".

5. Procedura e prokurimit me objekt "Përgatitja dhe botimi i librave për vitin 2021"

Urdhër Prokurimi Nr. 8, datë 23.11.2021,(nr. 89/17, prot., datë 23.11.2021)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Zj. D.R Zj. B.L. Zj. F.L.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 89/20, datë 06.12.2020, me vlerë 1,079,400 lekë me TVSH.
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 998,900 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "I." SHPK 899,500 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 89,400 lekë
Data e hapjes së tenderit: 24.11.2021	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 6 OE b) S' kualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 5 OE

Argumentimi i fondit limit. Nga auditimi u konstatua se komisionin i prokurimit me vlerë të vogël, ka mbajtur procesverbal nr. 89/16, datë 23.11.2021 për argumentimin e fondit limit duke u bazuar tek metoda e çmimeve të tregut ku ka administruar oferta nga tre operatorë ekonomike dhe bazuar në to, fondi limit është përcaktuar në vlerën 998,900 lekë pa TVSH, në përputhje me pikën 7 të Udhëzimit të APP-së nr.5, 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 8, datë 23.11.2021, me objekt "Përgatitje dhe botimi i librave për 2021", në përputhje me formatin 2 bashkëlidhur Udhëzimit të APP-së nr. 5, 25.06.2021.

Ftesa për ofertë. Në dosjen e prokurimit gjendet Ftesa për ofertë nr. 89/19, datë 23.11.2021, sipas të cilës data e zhvillimit të tenderit do të jetë 24.11.2021, ora 12. Rezulton se në sistemin e APP-së, më datë 24.11.2021 është publikuar procedura e prokurimit dhe në ftesën për ofertë të publikuar data e zhvillimit të tenderit është përcaktuar 26.11.2021 ora 10.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 5 operatorë, ndërsa 1 operatorë ekonomike është skualifikuar pasi oferta e paraqitur ka rezultuar në tejkalimi të fondit limit.

Tabela nr. 94: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, lekë pa TVSH
1	O. T.	833,333
2	I.	899,500
3	G. L.	950,000
4	O.	980,000
5	A. p.	989,000

Rezulton se 2 operatorë ekonomik "O. T." i renditur i pari është tërhequr nga procedura e prokurimit për arsye të mosplotësimit në kohë të kërkesave të specifikuara në ftesën për ofertë. Komisioni i prokurimit ka mbajtur procesverbal për kalimin te operatori ekonomik i radhës.
Titullari i AK me shkresën nr. 89/19, datë 01.12.2021 ka njoftuar operatorin ekonomik "I." SHPK për shpalljen fitues. Nga auditimi i dosjes së dokumenteve të paraqitura nga operatori ekonomik i shpallur fitues rezulton se operatori përmbush kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë.

Zbatimi i kontratës. Titullari i AK ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 89/20, datë 06.12.2022 me operatorin ekonomik "I." SHPK, në vlerën 1,079,400 lekë me TVSH, me afat 15 ditë kalendarike. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 32, datë 13.12.2021 "Për krijim e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve". Komisioni ka mbajtur procesverbal nr. 89/24, datë 29.12.2021, për dorëzimin e mallit, jashtë afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë dhe kontratë. AK ka llogaritur penalitetet për dorëzimin me vonesë. Fatura tatimore nr. 133, datë 20.12.2021 është paguar me urdhër shpenzimin nr. 208, datë 30.12.2021 në vlerën 1,059,031 lekë, brenda afati 30 ditor.

6. Procedura e prokurimit me objekt "Blerje pajisje kompjuterike", 2021

Urdhër Prokurimi Nr. 4, datë 14.07.2021	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Z. M.B. Zj. B.D. Zj. L.A.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 43/8, datë 26.07.2021, me vlerë 616,800 lekë me TVSH.
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) 633,836 lekë	**Oferta fituese (pa tvsh)** "E.H." 514,000 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 119,836 lekë
Data e hapjes së tenderit: 16.07.2021	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 24 OE b) S' kualifikuar : 7 OE c) Kualifikuar: 17 OE

Argumentimi i fondit limit. Nga auditimi u konstatua se komisionin i prokurimit me vlerë të vogël, më datë 15.06.2021 ka mbajtur procesverbal për argumentimin e fondit limit duke u bazuar tek metoda e çmimeve të tregut ku ka administruar oferta nga tre operatorë ekonomike dhe bazuar në to, fondi limit është përcaktuar në vlerën 633,836 lekë pa TVSH, në përputhje me pikën 7 të Udhëzimit të APP-së nr.5, 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 4, datë 14.07.2021, me objekt "Blerje pajisje kompjuterike", në përputhje me formatin 2 bashkëlidhur Udhëzimit të APP-së nr. 5, 25.06.2021.

Ftesa për ofertë. Ftesa për ofertë nr. 43/7, datë 14.07.2021 është hartuar sipas Formatit nr.3, bashkëlidhur Udhëzimit të APP-së nr.5, 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". Specifikimet teknike janë hartuar sipas standardeve teknike për pajisje elektronike të publikuara nga AKSHI. Ftesa për ofertë është publikuar në sistemin e APP më datë 14.07.2021.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 24 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 17 operatorë, ndërsa 7 operatorë ekonomike janë skualifikuar, 1 operator është s' kualifikuar pasi nuk pa pasur objektin e prokurimit të regjistruar në QKB, ndërsa 6 oferta janë s' kualifikuar pasi kanë rezultuar në tejkalimi të fondit limit.

Tabela nr. 95: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, lekë pa TVSH
1	E.H.	494,000
2	E.H.	514,000

3	F.	582,500
4	O. T.	583,333
5	P. S.	589,400
6	R.. K..	589,900
7	A..	591,360
8	J.. g.	600,000
9	E..Sh..	602,000
10	E.	612,500
11	E..I.	612,900
12	O..M...s	618,400
13	T.	619,890
14	S.R.	620,000
15	R.. N. M	622,500
16	P.	624,000
17	J.	626,800

Rezulton se operatori ekonomik "E.H." i renditur i pari është tërhequr nga procedura e prokurimit për arsye të mosplotësimit në kohë të kërkesave të specifikuara në ftesën për ofertë. Komisioni i prokurimit nuk ka mbajtur procesverbal për kalimin te operatori ekonomik i radhës, jo në përputhje me pikën 18 të Udhëzimit të APP-së nr. 5, 25.06.2021, ku citohet se: *"... Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim..."* Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi Komisioni i Prokurimit.
Titullari i AK me shkresën nr. 89/19, datë 01.12.2021 ka njoftuar operatorin ekonomik "I." SHPK për shpalljen fitues. Nga auditimi i dosjes së dokumenteve të paraqitura nga operatori ekonomik i shpallur fitues rezulton se operatori përmbush kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë.

Zbatimi i kontratës. Titullari i AK ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 43/8, datë 26.07.2021 me operatorin ekonomik "E.H." në vlerën 616,800 lekë me TVSH, me afat 5 ditë kalendarike.
Titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin nr. 32, datë 13.12.2021 "Për krijim e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve". Komisioni ka mbajtur procesverbal nr. 43/9, datë 26.07.2021, për dorëzimin e mallit sipas specifikimeve teknike të përcaktuar në ftesën për ofertë, brenda afatit. Kompjuterat janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 3, datë 26.07.2021. Fatura tatimore nr. 50, datë 26.07.2021 është paguar me urdhër shpenzimin nr. 925, datë 28.07.2021, brenda afatit 30 ditor.

7. Procedura e prokurimit "Mirëmbajtje dhe pastrim i zyrave për vitin 2022"

Urdhër Prokurimi Nr. 1, datë 02.03.2022,(nr. 23/2, prot., datë 02.03.2022)	**Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** Zj. B.L. Zj. A.I. Zj. F.L.	Vlera kontratës ose faturës: Kontrata nr. 23/5, datë 11.03.2022, me vlerë 221,998 lekë me TVSH.
Lloji i Procedurës së Prokurimit " Blerje me vlerë të vogël"		
Fondi Limit (pa tvsh) **190,000 lekë**	**Oferta fituese (pa tvsh)** "S.L.M." SHPK 184,990 lekë	**Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 5,010 lekë
Data e hapjes së tenderit: 04.03.2022	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**Operatoret Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: 20 OE b) Skualifikuar : 11 OE c) Kualifikuar: 9 OE

Argumentimi i fondit limit. Nga auditimi u konstatua se komisionin i prokurimit me vlerë të vogël, më datë 01.03.2022 ka mbajtur procesverbal për argumentimin e fondit limit duke u bazuar tek metoda e çmimeve të tregut ku ka administruar oferta nga tre operatorë ekonomike dhe bazuar në to, fondi limit është përcaktuar në vlerën 190,000 lekë pa TVSH, në përputhje me pikën 7 të

Udhëzimit të APP-së nr.5, 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Urdhri i prokurimit. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 1, datë 02.03.2022, me objekt "Mirëmbajtje dhe pastrimi i zyrave për vitin 2022", në përputhje me formatin 2 bashkëlidhur Udhëzimit të APP-së nr. 5, 25.06.2021.

Ftesa për ofertë. Ftesa për ofertë nr. 23/3, datë 02.03.2022 është përgatitur sipas formatit të standard nr. 3, në përputhje me pikën 9/a të Udhëzimit të APP nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike. Ftesa për ofertë është publikuar në sistemin elektronik më datë 02.03.2022.

Vlerësimi i ofertave. Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 20 operatorë ekonomik, ku janë kualifikuar 9 operatorë, ndërsa 11 operatorë ekonomike janë s kualifikuar pasi oferta e paraqitur ka rezultuar në tejkalimi të fondit limit.

Tabela nr. 96: Renditja e operatoreve ekonomik të kualifikuar.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike, lekë pa TVSH
1	E.	180,000
2	T.K.	180,000
3	S.L.M.	184,990
4	T.K.	185,000
5	O. M.	186,000
6	O.H.	189,996
7	M.M	190,000
8	J.	190,000

Rezulton se 2 operatorë ekonomik (E. dhe T.K.), kanë ofertuar me të njëjtën vlerë. Nga auditimi konstatohet se komisioni i prokurimit nuk ka zhvilluar procedurën e hedhjes së shortit, por me datë 04.03.2022 ka njoftuar në sistem operatorin "E." për shpalljen fitues, veprime në kundërshtim me pikën 16 të Udhëzimit të APP-së nr. 5, 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", ku citohet se: *"... Në rast se, gjatë vlerësimit të ofertave rezultojnë se janë paraqitur oferta ekonomike në vlerë të barabartë, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël duhet të njekë parashikimet ligjore për hedhje e shortit ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilit kanë rezultuar me vlerë ekonomike të njëjtë. Procesi i hedhjes së shorit duhet të dokumentohet nëpërmjet mbajtjes së procesverbalit..."*
OE "E." i renditur i pari është tërhequr nga procedura e prokurimit, për shkak të angazhimeve në kontrata të tjera. Komisioni i prokurimit ka mbajtur procesverbal për kalim te operatori tjetër. Sipas procesverbalit të datës 08.03.2022 operatori ekonomik "T.K." është s' kualifikuar sepse nuk përmbushte kriteret e përcaktuar në ftesën për ofertë si: kontratë të ngjashme; pagesat e kontributeve dhe sigurimeve shoqërore, data e deklaratës së gjendjes gjyqësore dhe deklaratën e përmbushjes së specifikeve teknike.

Dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues (S. SHPK). Në ftesën për ofertë është përcaktuar si kritere kualifikimi paraqitja e dokumentit që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Nga auditimi rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nr. T05737627, datë 09.03.2022, ku citohet se subjekti ka për të paguar detyrime në shumën 58,634 lekë. Konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur dokument që të vërtetoje që ka paguar të gjithë detyrimet tatimore. Sa më sipër operatori ekonomik "S." SHPK, i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriterin për kualifikim

të përcaktuar në Ftesën për Ofertë nr. 22/3, datë 02.03.2022. Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi Komisioni i Prokurimit i përbërë nga zj. B.L., zj. A.I., zj. F.L..

Zbatimi i kontratës. Titullari i AK ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 23/5, datë 11.03.2022 me operatorin ekonomik "S." SHPK, në vlerën 221,988 lekë me TVSH, për 12 muaj, me pagesë 18,499 lekë me TVSH në muaj. Rezulton se për periudhën objekt audtimi, pagesat janë kryer brenda afati 30 ditor të përcaktuar në kontratë, konkretisht: Fatura tatimore nr. 226, datë 05.04.2022, në shumën 18,499 lekë është paguar më urdhër shpenzimin nr. 50, datë 21.04.2022; fatura tatimore nr. 281, datë 04.05.2022 është paguar me urdhër shpenzimin nr. 60, datë 06.05.2022, fatura tatimore nr. 361, datë 08.06.2022 është paguar me urdhër shpenzimin nr. 77, datë 14.06.2022, brenda afati 30 ditor.

Mbi shpenzimet për marrjen me qera të ambienteve për zyra

Për vitin 2022, ISKK ka marrë ambiente me qira "zyra" për ushtrimin e aktivitetit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, procedurës të ndjekur për përzgjedhjen e ofertës fituese si dhe kontratave të lidhura me subjektin qiradhënëse konstatohet:

Drejtorit Ekzekutiv ka nxjerrë urdhrin nr. 15, datë 21.06.2022 për nxjerrjen e njoftimit për gjetjen e ambienteve "zyra me qera për ISKK". Njoftimi është publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Konstatohet se njoftimi për marrje me qera të ambienteve nuk është bërë në ndonjë media të shkruar ose vizive, duke sjellë mungesën e ofertuesve të tjerë në këtë shërbim.

Drejtori Ekzekutiv ka nxjerrë Urdhrin nr. 05.07.2022 për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ofertave të qerave të paraqitura pas njoftimit të dalës 21.06.2022, i përbërë nga zj. F.L., zj. A.I., zj. D.R. Komisioni ka mbajtur procesverbalin nr. 70/6, datë 13.06.2022, ku janë vlerësuar ofertat e paraqitura në protokollin e ISKK për 3 ambiente, konkretisht: ambiente në rrugën "A.T." me ofertë 2150 Euro në muaj; ambiente në rrugën "Dritan H." me ofertë 2080 Euro në muaj, ambiente te Selvia më ofertë 200,000 lekë në muaj. Komisioni pasi ka shqyrtuar oferta ka vendosur të zgjedhë ofertën me vlerë më të ulët.

Drejtori Ekzekutiv ka lidhur kontratën e qerasë nr. 70/7, datë 15.07.2020 me çmim bruto 200,000 lekë në muaj, me afat deri në 23 Korrik 2023.

Gjetja:	Parregullsi në hartimin e regjistrave të parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit. Parregullsi në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Në 3 raste, në vlerën totale 464,900 lekë, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e vendosura në ftesën për ofertë si dhe në 1 rast nuk është llogaritur e penaliteti për dorëzimin me vonesë të mallit.
Situata:	Për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë miratuar jashtë afateve kohore të përcaktuara në nenin 4, pika 1, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar si dhe nenin 3, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Për vitin 2019, 2020, 2021 ISKK nuk ka përgatitur regjistër të realizimit të prokurimeve, në kundërshtim me Kreun 2, pika 3 të Udhëzimit të APP-së nr. 1, datë 05.01.2018, ndërsa nga auditimi i regjistrave të printuara nga sistemi i APP rezulton se ISKK nuk ka publikuar në regjistrin e realizimit për vitin 2019, 2020 dhe 2021 blerjet e vogla me vlerë nën 100,000 lekë, në kundërshtim me pikën 2, neni 8 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe pikën 3, neni

	11 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Nga auditimi i pagesave të kryera në muajin Dhjetor 2020 rezulton se janë kryer 2 pagesa për blerje nën 100,000 lekë për të njëjtin objekt "Blerje pajise zyrash", konkretisht është paguar fatura në vlerën 40,000 lekë për blerjen e tabelë informacioni dhe fatura në shumën 119,625 lekë për blerje karrige zyrash, duke shmangur përdorimin e procedurës së prokurimit me blerje të vogël. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua se në 3 raste, në vlerën totale 464,900 lekë pa TVSH, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në urdhrin e prokurimit dhe në ftesën për ofertë, konkretisht: - Në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi interneti 40 mps i dedikuar dhe simetrik", me vlerë kontrate 130,000 lekë pa TVSH, operatori ekonomik i shpallur fitues "K." nuk ka dorëzuar dokument që vërteton se nuk është në proces falimenti, si dhe ka paraqitur licencën lëshuar nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit nr. 992/0408, datë 16.04.2008, e cila në periudhën e zhvillimit të tenderit nuk ka qenë e vlefshme. - Në procedurën e prokurimit me objekt "Realizmi i performancës publike (ekspozitë) "Komunizmi shqiptar: Propaganda dhe realiteti", me vlerë kontrate 150,000 lekë pa TVSH, operatori ekonomik i shpallur fitues "E.M." nuk ka paraqitur dokumente që vërtetojnë se ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, nuk ka provuar përvojën 2 vjeçare, si dhe nuk ka paraqitur projekt ide. Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar se në 2 raste, për procedurën "Blerje karburanti për vitin 2020" dhe procedurën "Realizmi ekspozite", urdhri i prokurimit ka dalë para llogaritjes së fondit limit; në procedurat "Blerje pajise kompjuterike për vitin 2021" dhe "Shërbim interneti për vitin 2019" nuk është mbajtur procesverbal për kalimin te operatori tjetër; në procedurën "Realizim ekspozite" ftesa për ofertë nuk i është dërguar të paktën 5 operatorëve ekonomikë; në procedurën e prokurimit "Shtypshkrimi i kolanës për vitin 2020" nuk janë argumentuar specifikimet teknike; në procedurën e prokurimit mirëmbajtje dhe pastrim zyrash për vitin 2022 nuk është hedhur shorti midis operatorëve ekonomikë që kanë paraqitur të njëjtën vlerë oferte. Ndërsa, për zbatimin e kontratës "Shtypshkrimi i kolanës për vitin 2020" rezulton se operatori ekonomik "I." SHPK ka dorëzuar me vonesë, pas datës 10.03.2021 sasinë e mallit dhe AK nuk i ka llogaritur penalitetet, konkretisht janë dorëzuar 3,100 kopje më datë 11.03.2021, 1,000 kopje më datë 15.03.2022 dhe 1,000 kopje më datë 16.03.2021.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 4, pika1, neni 8, pika 2, neni 27, pika 3 ,neni 40 pika 5, neni 59, neni 61 Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1.

	Udhëzimi i APP-së nr. 1, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik", Kreu 2, pika 3; Udhëzimi i APP-së nr. 4, datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit publik të procedurave të prokurimit publik dhe krijimit të tyre në sistemin e prokurimit elektronik" Kreu 2, pika 3; Udhëzimi i APP-së nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, pika 5, 6, 9; Udhëzimit të APP-së nr. 5, 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me blerje të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 7, 16, 18.
Impakti:	Mangësi në përdorimin me efektivitet, efiçencës dhe ekonomicitet të fondeve publike.
Shkaku:	Mos njohje dhe mos zbatimi i legjislacionit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme për hartimin e regjistrit të parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit brenda afateve kohore, në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e ISKK, me qëllim parashikimin e saktë të nevojave të institucionit, si dhe trajnimin e zyrtarëve të prokurimit për eliminimin e praktikave të konstatuara në shkelje të legjislacionit.

III. 2. 7: MBI MENAXHIMIN DHE ADMINISTRIMIN E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS

7.1: Mbi menaxhimin dhe administrimin e marrëdhënieve të punës në Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politik.

Instituti i të Përndjekurve Politikë ka funksionuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 244, datë 06.10.2014, me 24 punonjës si në vijim:

Tabela nr 97: Struktura organizative e IIPP, sipas Urdhrit nr. 244, datë 06.10.2014

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Numri
I	**Drejtor i Përgjithshëm**		**1**
	Sekretar		**1**
II	**Sektori i Ligjshmërisë dhe Statusit**		**(5)**
	Përgjegjës Sektori	III - a/1	1
	Specialist	IV - a	2
	Specialist	IV - b	2
III	**Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit**		**(7)**
	Përgjegjës Sektori	III - a/1	1
	Specialist	IV - a	2
	Specialist	IV - b	4
IV	**Sektori i Gjetjes së të Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit**		**(3)**
	Përgjegjës Sektori	III - a/1	1
	Specialist	IV - a	1
	Specialist	IV - b	1
V	**Sektori i Financës dhe Shërbimeve**		**(7)**
	Përgjegjës Sektori	III - a/1	1
	Specialist IT	IV - a	1
	Specialist Finance	IV - a	1
	Arkivist/Protokollist		1
	Nëpunës Informacioni		1

	Shofer/Korrier Punonjës Pastrimi		1 1
	Gjithsej		**24**

Burimi: IIPP

Për periudhën objekt auditimi, kjo strukturë ka ndryshuar 2 herë, konkretisht:
- Me Urdhrin nr. 62, datë 01.11.2018 "Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 244, datë 06.10.2014 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë", Sektori i Financës dhe Shërbimeve është bërë me 6 punonjës (nga 7 punonjës më parë), ku është shkurtuar pozicioni i specialistit të IT-së dhe numri totali i punonjësve është caktuar 23 punonjës.
- Ndërsa me Urdhrin e Kryeministrit nr. 104, datë 27.06.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr. 244, datë 27.06.2022", është shtuar pozicioni i zv. Drejtorit të Përgjithshëm dhe një pozicion, specialist IT në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve, si dhe është shkurtuar një pozicion specialist, kategoria IV-a në Sektorin e Çështjeve Sociale dhe Koordinimit, duke e çuar në 24, numrin total të punonjësve të institucionit

Nga auditimi rezulton se pozicioni i zv/Drejtorit të Përgjithshëm është plotësuar me emërimin e z. P. P., në zbatim të vendimit të gjykatës për rikthim në punë pas largimin të padrejtë nga Ministria e Shëndetësisë.

Për periudhën objekt auditimit plotësimin i strukturës organizative, numri i vendeve vakante në fillim dhe në fund të secilit vit, emërtimet si dhe largimet nga puna për çdo vit paraqitën si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 98: Lëvizja e stafit të IIPP për periudhën 2018-2022

Viti	Nr. i punonjësve (Plan fillestar)	Nr. i punonjësve (Plan i ndryshuar)	Vende Vakante, më datën 01 Janar	Emërime	Largime	Gjendja në fund të periudhës 31 dhjetor	Nr. i punonjësve në fund të vitit (Fakt)
2018	24	23	3	0	1	3	20
2019	23	23	3	4	2	1	22
2020	23	23	0	1 (Lëvizje Paralele	0	1	22
2021	23	23	1	0	1	2	21
2022	23	24	2	Shtuar zv/ Drejtor + 2	1	0	24

Burimi: IIPP

Gjatë vitit 2018, nuk ka pasur rekrutime të reja. Një punonjës është larguar nëpërmjet procedurës së transferim në Ministrin e Mjedisit dhe një punonjës është transferuar te AKSHI, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 162, datë 01.11.2018.

Në fund të vitit 2018, kanë rezultuar 3 vend vakante, konkretisht në pozicionet: Specialist, Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve IV-a; Specialist, Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve IV-b; Specialist IT Sektori i Financës dhe Shërbimeve IV-a.

Në fillim të vitit 2019, 1 është punonjës është larguar nga puna pasi ka mbushur moshën për pension pleqëri dhe 1 punonjës është larguar pasi është vlerësuar për 2 periudha 6 – mujore, "Jo kënaqshëm". Punonjësi i larguar nuk ka kërkuar rivlerësim si dhe nuk ka bërë ankimim.

Gjatë vitit 2019, janë kryer 4 emërime, konkretisht për pozicionet: Specialist, Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve IV-a; Specialist, Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve IV-b; Specialist, Sektori i Ligjshmërisë dhe Statusit IV-a; Specialist, Sektori i Ligjshmërisë dhe Statusit IV-b. Rezulton se plotësimi i vendeve vakante është bërë me studentë të ekselencës, të cilët në vitin 2020 kanë fituar konkursin në DAP dhe janë emëruan nëpunës civil në periudhë prove dhe në vitin 2021 kanë morën statusin e nëpunësit civil. Në fund të vitit, rezulton 1 vend vakant.

Gjatë vitit 2020, nuk ka pasur punësime të reja si dhe nuk ka pasur largime. Në gusht të vitit 2020, pozicioni vakant në Sektorin e Financës u plotësua me lëvizje paralele nga brenda stafit, konkretisht specialistja e Sektorit të Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve IV-b kalon me lëvizje paralele në pozicionin Specialisti i Financës dhe Shërbimeve me IV-a.
Gjatë vitit 2021, nuk ka pasur punësime të reja, ndërsa 1 punonjës është larguar nga puna pasi ka mbushur moshën për pension pleqërie. Në fund të vitit rezultojnë 2 vende vakante.
Në maj të vitit 2020 me procedurë rekrutimi nga DAP-i janë plotësuar vendet e vakande, konkretisht: Specialist, Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve IV-b; Specialist, Sektori i Gjetjes së të Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit IV-b. Aktualisht struktura e IIPP rezulton e plotësuar.

Mbi përshkrimet e punës. Me Vendimin nr. 601, datë 04.12.2002 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve" është miratuar rregullorja e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politik. Nga auditimi konstatohet se kjo Rregullore është e pa përditësuar dhe nuk përmbush funksionin për strukturën aktuale të këtij Institucioni, veçanërisht në Kreun V, ku përshkruhen strukturat dhe detyrat për çdo njësi, të cilat nuk përputhen me organigramën dhe strukturën e IIPP-s për periudhën objekt auditimi.

Dosjet e personelit. Marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Nga auditimi u konstatua se në dosjet e personelit mungonte:
- Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit (sipas lidhjes nr. 2);
- Fleta e inventarit të dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes (sipas lidhjes nr. 2);
- certifikatat personale dhe certifikata e gjendjes familjare;
- raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor;
- dëshmia e penalitetit.

Veprime në kundërshtim me pikën 1, 2 dhe 3 të lidhjes nr. 1 të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Vlerësimet e rezultateve në punë. Konstatohet se vlerësimet e rezultateve në punë të punonjësve janë bërë në përputhje me Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë".

Mbi shpenzimet gjyqësore për largim të padrejtë të punonjësve nga puna. Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit përkatës të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve, rezulton se për periudhën objekt auditimi Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politika ka kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën totale **4,311,922 lekë,** vlerë e cila rezulton **efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit,** nga të cilat për vitin 2018 janë kryer likuidime në vlerën 2,500,644 lekë, për vitin 2019 janë kryer likuidime në vlerën 1,286,818 lekë dhe për vitin 2020 është kryer 1 likuidim në vlerën 524,440 lekë. Tabela në vijimi paraqet likuidimet e bëra për periudhën 2018- 2022.

Tabela. nr. 99: Pagesa për vendime gjyqësore për largimet nga puna *lekë*

Viti	Nr. rastesh	Pagesa për vendime gjyqësore për largim nga puna
2018	5	2,500,664
2019	2	1,286,818
2020	1	524,440
TOTALI		**4,311,922**

Burimi: IIPP

Nga auditimi nuk rezulton të jenë nxjerr përgjegjësi apo të jenë marrë masa administrative në lidhje me vendimet gjyqësore për largimet nga puna, veprime jo në përputhje me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", ku citohet: "*Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e masave administrative*".

Titulli i gjetjes:	Gjatë periudhës 2018-2020, Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politik ka paguar 4,333,922 lekë vendime gjyqësore për largim të padrejtë nga puna, për 8 raste.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit përkatës të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve, rezulton se për periudhën 2018-2020 Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politika ka kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën totale 4,311,922 lekë, vlerë e cila rezulton efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit, nga të cilat për vitin 2018 janë kryer likuidime në vlerën 2,500,644 lekë, për vitin 2019 janë kryer likuidime në vlerën 1,286,818 lekë dhe për vitin 2020 është kryer 1 likuidim në vlerën 524,440 lekë. Nga auditimi nuk rezulton të jenë nxjerr përgjegjësi apo të jenë marrë masa administrative në lidhje me vendimet gjyqësore për largimet nga puna, veprime jo në përputhje me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.
Kriteri:	- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 60.
Impakti:	Efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Largime të padrejta nga puna.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për të gjitha rastet e vendimeve të gjykatës së formës së prerë për shpërblime financiare për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës, si dhe të marrë masa për eliminimin e efekteve negative për buxhetin e shtetit në të ardhmen.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e dokumenteve në dosjet e personelit.

Situata:	Nga auditimi i dosjeve të personelit, konstatohet se mungojnë: Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit (sipas lidhjes nr. 2); Fleta e inventarit të dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes (sipas lidhjes nr. 2); Certifikatat personale dhe certifikata e gjendjes familjare; Raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor; Dëshmia e penalitetit, në kundërshtim me pikat 1, 2 dhe 3 të lidhjes nr. 1 të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".
Kriteri:	Pika 1, 2 dhe 3 e lidhjes nr. 1 të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit". Rregullorja "Për funksionimin e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve".
Impakti:	Dosje personeli me mungesë në dokumentacion.
Shkaku:	Mos njohja e legjislacionit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm së bashku me Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të marrin masat për plotësimin e dosjeve të personelit, duke parandaluar shfaqjen e mangësive të tilla në të ardhmen.

7.2: Mbi menaxhimin dhe administrimin e marrëdhënieve të punës në Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit

Institutit i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit ka funksionuar me vendimit nr. 191, datë 23.02.2011, me 15 punonjës si në vijim:

Tabela nr. 100: Struktura organizative e ISKK, sipas Vendimit nr. 191, datë 23.02.2011

Funksioni		Kategoria	Nr. i punonjësve
I	**Drejtor Ekzekutiv**	I-B	1
	Sekretar/Protokoll	IV-B	1
II	**Drejtoria e Arkivës**		
	Zv.Drejtor Ekzekutiv dhe Drejtor i Arkivës	II-B	1
	Specialist i mbledhjes dhe inventarizimit të dokumenteve)	III-B	1
	Specialist i botimeve shkencore	III-B	1
	Specialist	IV-A	1
III	**Drejtoria e Studimeve**		
	Drejtor	II-B	1
	Specialist studimet shkencore	III-B	1
	Specialist i analizës dhe projekteve	III-B	1
	Specialist për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe marrëdhënieve ndërkombëtare	III-B	1
	Specialist	IV-A	1
IV	**Sektori i shërbimeve mbështetëse**		
	Përgjegjës sektori i Financës dhe Buxhetit	III-A	1
	Specialist jurist	IV-A	1
	Specialist IT	IV-A	1
	shofer	Klasa IV	1
Punonjës gjithsej			**15**

Burimi: ISKK

Për periudhën objekt auditimi, kjo strukturë ka ndryshuar 2 herë, konkretisht: Drejtori Ekzekutiv me shkresën nr.171, datë 22.12.2020 ka dërguar për mendim propozimin në Departamentin e Administratës Publike për shtesë të strukturës organizative me 4 punonjës. Me shkresën nr.6840/1, datë 24.12.2020 Departamenti i Administratës Publike ka shprehur miratimi për organikën dhe strukturën e re.
Në vijim me Vendimin nr.11/2021, datë 01.02.2021 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri (ISKK) është miratuar struktura dhe organika e re me 19 punonjës, konkretisht: është shkurtuar pozicioni i sekretar/protokoll; Drejtoria e Arkivës nga 4 punonjës është bërë me 5 punonjës ku është shkurtuar pozicioni i specialistit të mbledhjes dhe inventarizimit të dokumenteve dhe pozicioni i specialistit të botimeve shkencore dhe janë shtuar 2 pozicione për specialist katalogimi, inventarizimi dhe përpunim dokumenti dhe 1 pozicion specialist katalogimi, invenatrizmi për fondin e bibliotekës; Drejtoria e Studimeve nga 5 punonjës është bërë me 7 punonjës, ku është shtuar Sektori i Edukimit dhe Informimit të Publikut; Sektori i Shërbimeve me 4 punonjës ka kaluar Drejtori Finance dhe Shërbimesh Mbështetëse ku është shtuar pozicioni i specialistit të financës dhe buxhetit si dhe pozicioni i specialistit të burimeve njerëzore dhe sekretari/protokoll.

Mbi procedurën e ristrukturimit të institucionit. Me shkresën nr. 14,datë 08.02.2021, Drejtori Ekzekutiv i është drejtuar znj. Z.G., përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse me qëllim nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, për fillimin e procedurës së transferimit të përhershëm të nëpunësve civil për shkak të ristrukturimit të institucionit. Ky veprim është në përputhje me Vendimin nr. 125, datë 17.02.2016 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë", Kreu II "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit", pika 28, ku citohet se: *"Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, njësia përgjegjëse merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga eprori direkt dhe vendos për transferimin e nëpunësit brenda institucionit dhe pikës f, nenit 4, të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" që citon: "Njësi përgjegjëse" është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore* ***dhe njësia e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.***

Me urdhrin nr.1, datë 10.02.2021 (nr 14/1 prot, datë 10.02.2021) përgjegjësja e Buxhetit/Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (njësia përgjegjëse e Burimeve Njerëzore) ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit me përbërje si vijon:
- Znj. A.H., Nëndrejtor ekzekutiv/Drejtoresha e Arkivës,
- Znj. L.LL, Drejtore e Drejtorisë së Studimeve,
- Znj. Z.G., përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit/Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ky veprim është në përputhje me pikë 17 të Kreut II të VKM nr.125 datë 17.02.2016, ku citohet se: "*Komisioni përbëhet nga tre anëtarë dhe krijohet nga njësia përgjegjëse sipas rastit".*

Rezulton se më datën 11.02.2021 punonjësit e Institutit për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit janë njoftuar për fillimin e procedurës së Ristrukturimit. Me shkresën nr.14/15, datë 11.02.2021, Drejtori ekzekutiv është bërë me dije për shtyrjen e fillimit të procedurës mesatarisht me 3 javë kalendarike duke qenë se 2 prej 3 anëtarëve të Komisionit të Ristrukturimit kanë rezultuar me covid-19.
Sipas shkresën nr. 14/16, datë 19.03.2021 ka dal vendimi nr.1 i Komisionit të Ristrukturimit, ku ka propozuar te njësia e burimeve njerëzore sistemimin e 9 punonjësve. Sipas shkresës nr. 14/17,

datë 19.03.2021 ka dalë vendimi nr. 2 i Komisionit të Ristrukturimit, ku i është propozuar njësisë së burimeve njerëzore përfundimin i marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit znj. F.S., në pozicionin specialist jurist në sektorin e Financës/Buxhetit dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria IV-a, argumentuar kjo me faktin se në strukturën e re pozicioni specialist jurist ka si kërkesë të lidhur me arsimin Diplomë "Master Shkencor" ndërkohë znj. F.S. zotëron diplomën "Bachelor". **Grupi i ristrukturimit ka konstatuar se transferimi i nëpunëses në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori, në të cilën plotëson kriteret specifike brenda institucionit, është i pamundur.**
Me shkresën nr.14/18 datë 23.03.2021 punonjësit janë lajmëruar për transferimet për shkak të ristrukturimit të ISKK, ku dhe kanë dakortësuar brenda afatit 5-ditor që parashikohet në VKM nr.125 datë, 17.02.2016, me përjashtim të znj. F.S. e cila ka shprehur mos-dakordësinë me vendimin.
Me shkresën nr. 14/27, datë 23.03.2021 njësia përgjegjëse i është drejtuar Drejtorit Ekzekutiv mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve civil në kuadër të ristrukturimit të ISKK.
Me shkresën nr.14/28, datë 23.03.2021 njësia përgjegjëse i është drejtuar Drejtorit Ekzekutiv për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjëses znj. F.S., duke i dhënë dhe dëmshpërblim në përputhje me vjetërsinë në punë sipas pikës 7, nenit 50 të Ligjit nr. 152/2014 "Për nëpunësin civil". Me shkresën nr. 53/1, datë 21.04.2021, është bërë shqyrtimi i ankimimit administrativ të shkresës nr.53, datë 02.04.2021 të znj. F.S., trajtuar nga njësia përgjegjëse e BNJ të ISKK, duke lënë në fuqi vendimin nr.2 datë 19.03.2021 të Komisionit të Ristrukturimit.

Lista e punonjësve të larguar dhe të pranuar 2019-2022. Gjatë vitit 2019 nuk ka punësime të reja, ndërsa janë larguar 3 punonjës, nga të cilët 2 me dorëheqje dhe 1 punonjës me komision disiplinor.
Gjatë vitit 2020 janë emëruar 4 punonjës të rinj dhe 1 punonjës është larguar me dorëheqje. Gjatë vitit 2021 janë emëruar 4 punonjës të rinj dhe 1 punonjës është larguar për shkak të ristrukturimit. Përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022 është emëruar 1 punonjës i ri dhe nuk ka largime nga puna. Duke qenë se largimet janë me dorëheqje nuk vlerësohen risk.
Për largimin me Komision Disiplinor të z. D.M., konstatohet se nga ana e këtij të fundit është bërë ankimim në gjykatë.
Është fituar në shkallë të parë nga ana e Institucionit dhe aktualisht është në proces në Gjykatën e Apelit. Nga auditimi i emërimeve të reja nuk konstatohen mospërputhje me kriteret e pozicionit.

Vlerësimet e punës. Për periudhën objekt auditimi konstatohet se nuk janë bërë vlerësimet e rezultateve në punë për punonjësit e Drejtorisë së Studimeve, veprim në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë".

Rregullorja e Brendshme. Nga auditimi konstatohet se ky institucion e zhvillon veprimtarinë e tij duke u bazuar në Rregulloren e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Studimit të Krimeve të Komunizmit", e miratuar me Vendimin e Bordit Drejtues nr. 615/1, datë 08.05.2018. Për sa më sipër evidentohet se kjo rregullore është e pa përditësuar duke qenë se Instituti i Studimeve për Studimet dhe Pasojat e Komunizmit ka kalur në proces Ristrukturimi.

Vendimet Gjyqësore. Nga auditimi konstatohet se nuk ka vendime të formës së prerë për largime nga puna për periudhën objekt auditimi dhe si rrjedhojë as pagesa.

Titulli i gjetjes:	Rregullorja e brendshme nuk është përditësuar me procesin e ristrukturimit, si dhe nuk është kryer vlerësimi për të gjithë punonjësit.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se ISKK e zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në Rregulloren e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Studimit të Krimeve të Komunizmit", miratuar me Vendimin e Bordit Drejtues nr. 615/1, datë 08.05.2018, e cila është e pa përditësuar duke qenë se Instituti i Studimeve për Studimet dhe Pasojat e Komunizmit ka kalur në proces ristrukturimi. Gjithashtu konstatohet se nuk janë kryer vlerësimet e rezultateve në punë për punonjësit e Drejtorisë së Studimeve, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë".
Kriteri:	-VKM nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", pikën 2, të Kreut II; - Rregulloren e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Studimit të Krimeve të Komunizmit", e miratuar me Vendimin e Bordit Drejtues nr. 615/1, datë 08.05.2018.
Impakti:	Mungesa e përcaktimit të detyrave dhe vlerësimit, ul performancën e punonjësve dhe atë institucionale.
Shkaku:	Kalimi i institucionit në proces ristrukturimi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masat për rishikimin e rregullores së institucionit, ku të përcaktohen qartë, struktura organizative, funksionet dhe përshkrimi i punës për çdo pozicion pune me qëllim rritjen e performancës institucionale, si dhe të merren masa për vlerësimin e rezultateve në punë të të gjithë nëpunësve civil.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

IV.I. GJETJE DHE REKOMANDIME PËR INSTITUTIN E INTEGRIMIT TË ISH TË PËRNDJEKURVE POLITIK

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bazës ligjore dhe nënligjore që rregullon veprimtarinë e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politik është konstatuar se ende nuk janë bërë përditësimet përkatëse në ligj lidhur me varësinë e institucionit, duke rezultuar institucion varësi i një ministrie që nuk ekziston më (ish Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë). Gjithashtu ende nuk është miratuar rregullorja e re funksionale pas ndryshimit të ligjit të institutit në 2014 dhe strukturës organizative, duke sjellë mos rregullim të detyrat funksionale të punonjësve në përputhje dhe koherencë me ndryshimet e bëra për një hark kohor prej 20 vitesh, nga miratimi i rregullores së fundit, aktualisht në fuqi.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të ngrejë grupin e punës për hartimin e një rregulloreje të re për funksionimin e institucionit me objektiva konkret e të matshëm sipas pozicioneve dhe ta përcjell në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për miratim, së bashku me propozimet për përditësimin e ligjit nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", lidhur me varësinë e institucionit.

Brenda gjashtëmujorit të I të vitit 2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë për shpërndarjen e fondit të ndihmave në IIPP është konstatuar se në aktet administrative dhe në rregulloren nr. 356, datë 12.04.2018 "Për funksionimin e komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" nuk përcaktohen procedurat: a. për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të shpërndarjes së fondeve dhe monitorimit të tyre; b. për veprimtarinë e komisionit të shpërndarje së ndihmave në shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave; c. për veprimtarinë e komisionit të monitorimit si dhe dokumentacionin justifikues të domosdoshëm mbi të cilën do bazohet monitorimi; d. si dhe format kërkesa tip të miratuara për ndihmë ekonomike të hartuara nga sektorët përkatës. Këto mangësi krijojnë hapësira dhe kushte për një vendimmarrje të pa standardizuar, subjektive dhe të pa mbështetur në kritere të qarta dhe të mirë përcaktuara.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të ngrejë grupin e punës për hartimin e një rregulloreje të re, në plotësim të rregullores nr. 356, datë 12.04.2018 "Për funksionimin e komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike" në të cilën të përcaktohet qartësisht procedura administrative e shqyrtimit, miratimit dhe monitorimit të kërkesave për ndihma dhe financim që duhet të ndjekë komisioni i shpërndarjes dhe komisioni i monitorimit të fondit, dokumentacioni i domosdoshëm dhe ai i nevojshëm në këto procedura, përbërja e komisioneve, duke shmangur konfliktin në vendimmarrje sipas pozicionit, si dhe të miratojë format kërkesat tip për ndihmë ekonomike të hartuara nga sektorët përkatës.

Brenda gjashtëmujorit të I të vitit 2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë miratuar planet vjetore të punës, si dhe raportet e veprimtarisë së institucionit për periudhën 2018-2022, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 8, pika

‘a’ dhe neni 9, pika ‘4’, duke cenuar kështu eficencën dhe efektivitetin në punë të strukturave dhe objektivitetin në matjen e performancën së tyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizoje dhe te nxjerre përgjegjësinë për letë mangësi, si dhe të kërkojë nga sektorët hartimin e planeve të punës dhe t’i miratojë në vijim, të cilët duhet të përmbajnë objektiva dhe veprimtari konkrete dhe të matshme për secilin pozicion pune, si dhe raportet e veprimtarisë vjetore në zbatim të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhrave të titullarit u konstatua se edhe pse janë miratuar modelet standarde të dokumenteve administrative në përputhje me ligjin, rezulton se këto urdhra janë hartuar e zbatuar në formate të ndryshme, të cilët nuk përmbajnë të gjithë elementët e domosdoshëm identifikues, bazën ligjore të plotë si dhe vendimet e komisionit në zbatim të të cilit del urdhri.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë situatën në hartimin e dokumenteve administrative dhe së bashku me gjithë strukturat të marrin masa për hartimin dhe përpilimin e urdhrave me përmbajtje të të gjithë elementëve identifikues dhe bazës ligjore të akteve mbështetës të urdhrit të plotë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit me Shoqatat u konstatua se, nuk është bërë një studim i nevojave imediate dhe të perspektivës, si dhe një raport për gjendjen e të përndjekurve politik sikurse përcaktohet në Rregulloren nr. 601, datë 04.12.2002 për “Funksionimin e IIPP”, Kreu V, pika III.1 dhe 2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1. Rekomandimi: Sektori i Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit me Shoqatat të marrë masa për studimin e nevojave imediate dhe të perspektivës, identifikimin e tyre sipas kategorive dhe nën kategorive, trendit ndër vite dhe atij aktual, të dokumentojë këtë veprimtari nëpërmjet hartimit të raportit përkatës, t’ia përcjell për miratim Drejtorit të Përgjithshëm dhe ta publikojë në website-n zyrtar për publikun.

Brenda tremujorit të I 2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të ndihmës ekonomike dhe atyre me informacion për personat e zhdukur është konstatuar se, kërkesat e dorëzuara sipas formateve tip për ndihmë ekonomike dhe për informacion mbi familjarët, bazuar në të cilat nisin procedurat respektive administrative në institucion, nuk janë protokolluar dhe regjistruar nga zyra e protokoll-arkivës, duke cenuar plotësinë e evidencës dhe gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Zyra e protokoll-arkivës të marrin masa për regjistrimin dhe evidentimin në protokoll të të gjitha kërkesave për ndihmë ekonomike, informacionit për personat e zhdukur dhe çfarë do lloj kërkese tjetër, në bazë të së cilës institucioni nis një procedurë administrative në vijim.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se për periudhën 2018-2021, Komisioni i Monitorimit nuk ka administruar dokumentacion të mjaftueshëm justifikues mbi shpenzimin e kryer nga përfituesit e projekteve, si dhe nuk i ka të organizuar apo të grumbulluar në një dokument të gjithë informacionin për të dhënat e përfituesve, duke sjellë për pasojë mungesë evidencash të mjaftueshme mbi përdorimin e fondit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 49-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Komisioni i monitorimit të marrë masa për plotësimin e praktikës me dokumente të mjaftueshëm, me qëllim justifikimin e shpenzimit të bërë nga përfituesit e ndihmës ekonomike, si edhe të krijojë një sistem për të menaxhuar informacionin e të dhënave mbi përfituesit e fondeve (databazë).

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018 dhe vitin 2022, titullari i Autoritetit Kontraktor ka caktuar Personat Përgjegjës për Prokurimin, jashtë afatit të përcaktuar në pikën 1, neni 57 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe pikën 1, neni 74 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ndërsa për vitet 2019 - 2021, titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për caktimin e personave përgjegjës për prokurimit, në kundërshtim me pikën 1, neni 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

Për periudhën 2018 - 2022, regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë miratuar jashtë afateve kohore të përcaktuara në nenin 4, pika 1, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar si dhe nenin 3, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Gjithashtu, regjistrat e realizimit të procedurave të prokurimit janë dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë afatit kohor.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua se në 5 raste ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në urdhrin e prokurimit dhe në ftesën për ofertë.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël është konstatuar se në procedurat e prokurimit blerje kanceri për vitin 2018, 2019, 2020, 2021, blerje karburanti për vitin 2019, marrje e makinës me qira për vitin 2019 nuk është përcaktuar fondi limit; në 3 procedurat e prokurimit për blerje tonera dhe kancelari në ftesën për ofertë nuk janë vendosur kriteret dhe specifikime teknike, si dhe është kërkuar paraqitja e mostrave për mallrat e prokuruar; në procedurën blerje tonera dhe kancelari për vitin 2019 nuk është mbajtur procesverbal për kalimin te operatori ekonomik i radhës, në 3 procedurat e prokurimit për blerje karburanti vlerësimi i oferta është bërë në bazë të çmimit të pandryshuar përgjatë zbatimit të kontratës; në 4 raste për procedurat e marrjes së makinës me qira komisioni nuk ka argumentuar specifikimet teknike.

Nga auditimi është konstatuar se në të gjitha komisionet e prokurimit me vlerë të vogël, për periudhën objekt auditimi, ka qenë kryetare e komisionit Përgjegjësja e Financës dhe Shërbimeve, njëkohësisht nëpunësi zbatues i institucionit, veprime jo në përputhje me nenin 12, pika 3, germa e) dhe nenin 22, pika 3, grema b) të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 77-123 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme për caktimin e personave përgjegjës për prokurimin, hartimin e saktë dhe brenda afateve kohore të regjistrave të parashikimit dhe realizimit të procedurave të

prokurimit, si dhe trajnimin e zyrtarëve të prokurimit, me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, titullari i Autoritetit Kontraktor në vijimësi të mos caktojë Nëpunësin Zbatues/ Përgjegjësin e Financës dhe Shërbimeve në komisionet e prokurimeve, me qëllim uljen e riskut të mungesës së kontrollit mbi transaksionet e institucionit, si dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi kontrollin vertikal.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se prej vitit 2019 e në vijim, IIPP çdo vit kryen procedurën e prokurimit me objekt "Marrje me qira e automjetit", për të cilin janë lidhur dhe likuiduar kontratat në vlerën totale 3,274,800 lekë. Konstatohet se, institucioni në PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022, ka planifikuar blerjen e një makinë tip fouristrade, në vlerën 4,000,000 lekë, e cila nuk rezulton të jetë pjesë e listës shoqëruese të investimeve për miratimin në projekt buxhetet e viteve përkatëse, ndërsa në PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, institucioni nuk ka planifikuar fonde për blerje automjeti.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 77-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politik të marrë masa për paraqitjen, argumentimin dhe planifikimin në PBA të nevojës për blerjen e një automjeti, me qëllim uljen e shpenzimeve për marrje me qira dhe menaxhimin me eficencë, efektivet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Brenda gjashtëmujorit të I të vitit 2023

10. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2018, AKSHI ka lidhur 4 kontrata, për procedurën e prokurimit "Blerje pajisje kompjuterike" në vlerën totale 1,099,670 lekë, të ndarë në lote. Rezulton se AK, nuk e ka parashikuar këtë procedurë prokurimi në regjistrin e parashikimit si dhe nuk e ka deklaruar në regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit, në kundërshtim me pikën 1, neni 4 si dhe pikat 1, 2, 5, neni 7 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Gjithashtu, konstatohet se pavarësisht se me AN nr. 1, datë 26.07.2018, IIPP-së i janë shkurtuar fondet për shpenzime kapitale, AKSHI ka filluar procedurën e prokurimit për blerjen e pajisjeve kompjuterike dhe ka lidhur kontratat, duke marre angazhime pa fonde buxhetore dhe krijuar detyrime të prapambetura në vlerën totale 1,099,670 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 77-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për marrjen e angazhimeve pa pasur fonde në dispozicion, si dhe të shmangë praktikat e financimit të projekteve të investimit pa kaluar fazat e menaxhimit të investimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit, konstatohet se mungojnë: Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit (sipas lidhjes nr. 2); Fleta e inventarit të dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes (sipas lidhjes nr. 2); Certifikatat personale dhe certifikata e gjendjes familjare; Raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor; Dëshmia e penalitetit, në kundërshtim me pikat 1, 2 dhe 3 të lidhjes nr. 1 të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 123-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm së bashku me Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të marrin masat për plotësimin e dosjeve të personelit, duke parandaluar shfaqjen e mangësive të tilla në të ardhmen.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit përkatës të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve, rezulton se për periudhën 2018-2020 Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politika ka kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna në vitin 2014, në vlerën totale 4,311,922 lekë, vlerë e cila rezulton efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit, nga të cilat për vitin 2018 janë kryer likuidime në vlerën 2,500,644 lekë, për vitin 2019 janë kryer likuidime në vlerën 1,286,818 lekë dhe për vitin 2020 është kryer 1 likuidim në vlerën 524,440 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 123-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa e nevojshme për eliminimin dhe shmangien në të ardhmen te efekteve negative për buxhetin e shtetit që vijnë si rezultat i largimeve të padrejta nga puna.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politik, mbështetur në nenet 57, 58, 59 të ligjit nr. 153/2013 "Për nëpunësin civil" dhe pikën 11, kreu II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civili" pas vlerësimit të përgjegjësisë të nëpunësve të cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore "vërejtje" deri në "pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë".

IV.2 GJETJET DHE REKOMANDIMET PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK) nuk ka raportuar për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të KLSH të lëna me shkresën nr. 360/7 prot., datë 21.08.2019, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".
Nga shqyrtimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se nga 11 rekomandime gjithsej të dhëna dhe të pranuara, 1 masë organizative rezulton e pazbatuar, 4 masa organizative rezultojnë të zbatuara pjesërisht, 4 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht dhe 1 masë organizative rezulton në proces zbatimi.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 11-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i ISKK të marrë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të të gjitha rekomandimeve të konstatuara të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe të përshpejtojë realizimin e atyre në proces zbatimi, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike dhe pasurisë publike.

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nuk ka një procedurë të miratuar për përzgjedhjen e drejtorit ekzekutiv, ku të përfshihet detajimi i procedurës, si dhe kriteret që duhen plotësuar nga aplikantët. Në procedurën e parë të ndjekur, nuk rezulton të ketë patur shpallje, por është vijuar me shprehjen e anëtarëve *pro – kundra* për rizgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv, ndërkohë që në procedurën e dytë të ndjekur, është kryer votim për të gjithë kandidatët që kishin aplikuar. Duke qenë se në Rregulloren e Brendshme të ISKK, Kreu III "*Struktura organizative*", nuk përcaktohet një procedurë të qartë të zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv nga ana e Bordit Drejtues, procesi i zgjedhjes ka rezultuar kompleks dhe i diskutueshëm, duke bërë që të humbasë transparenca dhe potencialisht të konsiderohet si proces me mangësi. Referuar Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri*", neni 11 nen i cili nuk detajon në mënyrë të qartë kriteret që duhet të plotësojë kandidati, si dhe procedurën e votimit deri në shpalljen e fituesit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 16-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Bordi Drejtues të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti të veçantë, duke përcaktuar procedurën e emërimit të Drejtorit Ekzekutiv, përcaktimin e kritereve që duhet të plotësojnë aplikantët, procedurën e votimit dhe deri në shpalljen e fituesit, për të garantuar një proces transparent, të barabartë dhe efektiv.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Referuar Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Shkencor të Institutit (KSHI) të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, ka për detyrë të shqyrtojë dhe vlerësojë punimet e paraqitura për botim, bazuar në metodologjinë e miratuar paraprakisht prej tij dhe të konfirmuar nga Bordi Drejtues. Nga auditimi rezultoi që KSHI nuk e ka miratuar këtë metodologji, në kundërshtim me kërkesat e nenit 5 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KSHI, miratuar në vitin 2018 dhe nenit 6 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KSHI, miratuar në vitin 2021.
Për periudhën 2018-2022 nuk ka një databazë të plotë mbi procedurat e dorëzimit të dorëshkrimeve për botim, e cila të specifikojë aplikimet në thirrje, veprat e përzgjedhura dhe vlerat që kanë përfituar autorët, në mospërputhje me pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 16-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në bashkëpunim me Këshillin Shkencor të marrin masa për standardizimin dhe formalizimin e procesit të botimit, duke paracaktuar metodologjinë për vlerësimin e punimeve të paraqitura për botim dhe të gjithë procesin që nga shpallja deri në botimin e veprave dhe miratimin e saj nga Bordi Drejtues, si dhe të krijojë dhe administrojë një databaze të plotë në lidhje me botimet, me qëllim dokumentimin e plotë të procesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për mënyrën e organizimit të konferencave ISKK nuk ka një akt nënligjor ku të bazohet ky proces, mungon metodologjia për vlerësimin e artikujve të dorëzuar për pjesëmarrje në konferencë dhe botim, kjo me qëllim garantimin e barazisë, drejtësisë dhe transparencës së procesit. Përgjatë periudhës së audituar konstatohet se, nuk ka patur një praktikë unifikuese të shpalljes së konferencave nga Drejtoria e Studimit me

qëllim shpalljen publike, përcaktimin e anëtarëve të grupit të punës, ndarjen e detyrave të tyre, e në vijim deri në përfundim të shpërblimit të kumtesave, veprime në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 "*Aktivitetet e Kontrollit*".
Referuar procedurës së dorëzimit të abstrakteve për pjesëmarrje në konferencë, në asnjë nga vitet objekt auditimi nuk ka një databazë të plotë, e cila të specifikojë aplikimet në thirrje, kumtesat e përzgjedhura dhe vlerat që kanë përfituar autorët, veprime jo në përputhje me pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 "*Aktivitetet e kontrollit*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1. Rekomandimi: Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti nënligjor që detajon procedurën e organizimit të konferencave, ku të përfshihet procedura e ndjekur për përcaktimin e temave, shpallja, mënyra e aplikimit, metodologjia e vlerësimit, pagesa e pjesëmarrësve, si dhe çdo hallkë tjetër që do ta bënte më transparent procesin, si dhe krijimin dhe administrimin e një databaze të plotë në lidhje me konferencat, ku për secilën thirrje të mëtejshme të evidentohen aplikimet me të dhënat përkatëse të nevojshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, thirrjet për botime/ konferenca nuk trajtohen si praktika në vetvete, duke bërë kështu të vështirë ndjekjen e praktikës nga fillimi (vendimmarrja për thirrjen) e deri në përfundim të praktikës, kjo referuar nenit 19 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.
Sa më sipër, do të mundësonte ndjekjen me rrjedhë kronologjike të procedurave kryesore të veprimtarisë së ISKK, sikurse janë botimet dhe konferencat, duke nisur me urdhrin e titullarit për fillimin e punës për hartimin e shpalljes, e duke vijuar progresivisht me fraksion çdo dokumentacion i lidhur me atë shpallje, në çdo formë hyrëse në institucion (*përfshirë dokumentet që hyjnë elektronikish*t), deri në mbylljen e praktikës me vendimmarrjen përfundimtare me shpalljen e fituesve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 28-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1. Rekomandimi: Titullari i ISKK të marrë masa mbi ngarkimin e njësisë përgjegjëse për regjistrimin e dokumenteve që formojnë një praktikë duke vijuar me të njëjtin numër rendor progresivisht me fraksion për çdo dokumentacion hyrës në institucion deri në mbylljen e praktikës me vendimmarrjen përfundimtare, si dhe përcaktimin e kësaj njësie për sa më sipër në aktet nënligjore që përcaktojnë detyrat funksionale të punonjësve të ISKK.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit përkatës të vënë në dispozicion, rezulton se për periudhën objekt auditimi totali i shpenzimeve për vitin 2019 është realizuar në vlerën 26,001 mijë lekë, nga 36,537 mijë lekë të planifikuara, me një mosrealizim prej 10,536 mijë lekë, ose realizuar në masën 71.2% kundrejt planit vjetor.
Për vitin 2020, totali i shpenzimeve është realizuar në vlerën 22,802 mijë lekë, nga 31,700 mijë lekë të planifikuara ose realizuar në masën 72% kundrejt planit vjetor, me një mosrealizim prej 8,898 mijë lekë.

Për vitin 2021, totali i shpenzimeve është realizuar në vlerën 30,402 mijë lekë, nga 33,100 mijë lekë të planifikuara ose realizuar në masën 91% kundrejt planit vjetor, me një mosrealizim prej 2,698 mijë lekë.
Nga auditimi rezulton se shpenzimet buxhetore për 6-mujorin e parë të vitit 2022 janë realizuar në masën 36.4 %**,** ose 13,077 mijë lekë nga 35,842 mijë lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit.
Rezulton se peshën më të madhe e zë mos realizimi i shpenzimeve korrente, konkretisht zëri "*Shpenzime personeli*" dhe "*Mallra dhe Shërbime*", të cilat janë ndikuar nga disa faktorë si vonesa në miratimin e strukturës nga KM dhe mos realizim i konferencave dhe botimeve të planifikuara për shkak të kufizimeve nga situata pandemike.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 31-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masat e nevojshme për planifikimin sa më real, duke përfshirë identifikimin dhe argumentimin e nevojave të çdo drejtorie\sektori, si dhe monitorimin e kujdesshëm të buxhetit ndaj realizimit të produkteve në përputhje me planet e parashikuara, me qëllim ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese për alokimin e burimeve financiare.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën vitet 2019 - 2022, regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë miratuar jashtë afateve kohore të përcaktuara në nenin 4, pika 1, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si dhe nenin 3, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.
Për vitet 2019 - 2021 ISKK nuk ka përgatitur regjistër të realizimit të prokurimeve, në kundërshtim me Kreun 2, pika 3 të Udhëzimit të APP-së nr. 1, datë 05.01.2018, ndërsa nga auditimi i regjistrave të printuara nga sistemi i APP rezulton se ISKK nuk ka publikuar në regjistrin e realizimit për vitin 2019, 2020 dhe 2021 blerjet e vogla me vlerë nën 100,000 lekë, në kundërshtim me pikën 2, neni 8 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar si dhe pikën 3, neni 11 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
Nga auditimi i pagesave të kryera në muajin Dhjetor 2020 rezulton se janë kryer 2 pagesa për blerje nën 100,000 lekë për të njëjtin objekt "*Blerje pajise zyrash*", të cilat e tejkalojnë këtë vlerë duke shmangur përdorimin e procedurës së prokurimit me blerje të vogël.
Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua se në 3 raste operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në urdhrin e prokurimit dhe në ftesën për ofertë, konkretisht:
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi interneti 40 mps i dedikuar dhe simetrik", operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka dorëzuar dokument që vërteton se nuk është në proces falimenti, si dhe ka paraqitur licencën lëshuar nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit nr. 992/0408, datë 16.04.2008, e cila në periudhën e zhvillimit të tenderit nuk ka qenë e vlefshme.
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Realizmi i performancës publike (ekspozitë) "Komunizmi shqiptar: Propaganda dhe realiteti*", operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka paraqitur dokumente që vërtetojnë se ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, nuk ka provuar përvojën 2 vjeçare, si dhe nuk ka paraqitur projekt ide.
Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar se në 2 raste, për procedurën "*Blerje karburanti për vitin 2020*" dhe procedurën "*Realizmi ekspozite*", urdhri i prokurimit ka dalë para llogaritjes së fondit limit; në procedurat "*Blerje pajise kompjuterike për vitin 2021*" dhe "*Shërbim interneti për vitin 2019*" nuk është mbajtur procesverbal për kalimin te operatori tjetër; në

procedurën "*Realizim ekspozite*" ftesa për ofertë nuk i është dërguar të paktën 5 operatorëve ekonomikë; në procedurën e prokurimit "*Shtypshkrimi i kolanës për vitin 2020*" nuk janë argumentuar specifikimet teknike; në procedurën e prokurimit mirëmbajtje dhe pastrim zyrash për vitin 2022 nuk është hedhur shorti midis operatorëve ekonomikë që kanë paraqitur të njëjtën vlerë oferte.
Ndërsa, për zbatimin e kontratës "*Shtypshkrimi i kolanës për vitin 2020*" rezulton se operatori ekonomik "I." SHPK ka dorëzuar me vonesë, pas datës 10.03.2021 sasinë e mallit dhe AK nuk i ka llogaritur penalitetet, konkretisht janë dorëzuar 3,100 kopje më datë 11.03.2021, 1,000 kopje më datë 15.03.2022 dhe 1,000 kopje më datë 16.03.2021.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 42-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme për hartimin e regjistrit të parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit brenda afateve kohore, në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e ISKK, me qëllim parashikimin e saktë të nevojave të institucionit, si dhe trajnimin e zyrtarëve të prokurimit për eliminimin e praktikave të konstatuara në shkelje të legjislacionit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se ISKK e zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në Rregulloren e Brendshme "*Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Studimit të Krimeve të Komunizmit*", miratuar me Vendimin e Bordit Drejtues nr. 615/1, datë 08.05.2018, e cila është e pa përditësuar duke qenë se Instituti i Studimeve për Studimet dhe Pasojat e Komunizmit ka kalur në proces ristrukturimi.
Gjithashtu konstatohet se nuk janë kryer vlerësimet e rezultateve në punë për punonjësit e Drejtorisë së Studimeve, në kundërshtim me pikën 2, të Kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 58-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masat për rishikimin e rregullores së institucionit, ku të përcaktohen qartë, struktura organizative, funksionet dhe përshkrimi i punës për çdo pozicion pune me qëllim rritjen e performancës institucionale, si dhe të merren masa për vlerësimin e rezultateve në punë të të gjithë nëpunësve civil.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE
Drejtori Ekzekutiv i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, mbështetur në nenet 57, 58, 59 të ligjit nr. 153/2013 "Për nëpunësin civil" dhe pikën 11, kreu II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civili" pas vlerësimit të përgjegjësisë të nëpunësve të cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore "vërejtje" deri në "pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë".

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

V. ANEKSE

Viti 2018

Data	PV	Vendim	Përshkrimi	Pjesëmarrës	Nr. Pjesëmarrës		Prezenca	Firma	Komente
					Bordi	ISKK			
05.02.2018	X		Hartim Raporti Vjetor 2017 dhe dorëzim në Kuvend Diskutim mbi konf e kolanës së re më 20.12.2018 Diskutim mbi testimin e punonjësve status civil për 2018 Informim mbi zgjedhjen së shpejti të anëtarëve të rinj të Bordit Mbikëqyrës i ISKK-së	K. T. A. L. U. B. G. P. N. Ç. A. Ç.	5	1	Fizike	Jo	Kryetar Bordi K. T.
15.03.2018	X		Zgjedhja e kryesisë së Bordit të ri, Kryetar dhe Nënkryetar Zgjedhja e Drejtorit të ri Ekzekutiv	K. T. U. B. G. P. E. Sh. E. P. V. T. J. G. A. Ç.	7	1	Fizike K. T. (telefon) G. P. (Skype)	Jo	Zgjidhet Kryetar Bordi U. B. (6 vota pro) Zgjidhet Nënkryetar J. G. (4 vota pro) Zgjidhet Drejtori Ekzekutiv A. Ç. (7 vota pro)
15.03.2018		1/2018	Për zgjedhjen e Kryetarit, Nënkryetarit, Drejtorit Ekzekutiv të ISKK						
13.04.2018	X		Përditësimi i faqes zyrtare të ISKK dhe Facebook Përgatitja e Kalendarit të Kujtesës	U. B. J. G. E. P. V. T. A. Ç. Ç. H.	4	2	Fizike	5	Merret vendimi për të kërkuar shpalljen "Ansambël monument kulture" i territorit të Kampit të Tepelenës Merret vendimi për krjimin e arkivës digjitale Mbledhja e radhës datë 26.04.2018
13.04.2018		3/2018	Për krijimin e Arkivit Elektronik/Dixhital në ISKK						
08.05.2018	X		Diskutime rreth Rregullores së botimeve dhe Rregullores së Brendshme të ISKK Zgjedhja e KSHI	U. B. J. G. E. P. V. T. E. Sh. A. Ç. Ç. H.	5	2	Fizike	Jo	Merret vendimi për miratimin e Rregullores së Botimeve Merret vendimi që Drejtoria Shkencore e ISKK të kryejë dhe korrektime tekstesh kur të ketë nevojë për to Merret vendimi për miratimin e Rregullores së Brendshme Anëtarët e Bordit votojnë për anëtarët e KSHI: V. K., V.G., A. H. A. B., K. D., I. I., E. K.
08.05.2018		4/2018	Për zgjedhjen e Anëtarëve të KSHI në ISKK						
08.05.2018		7/2018	Miratimi i Rregullores së Brendshme dhe i Rregullores së Botimeve të ISKK						
29.06.2018	X		Diskutim mbi Projekt-Rregulloren për KSHI Të ndryshme	U. B. J. G. E. Sh. G. P. E. P. A. H. V.G. E. K. K. D.	Bordi - 5 KSHI - 5	2	Fizike G. P. (Skype)	Jo	Zgjidhet Kryetar i KSHI E. K. me të gjitha votat pro Mbledhja e radhës më datë 01.10.2018
29.06.2018	X		Prezantimi i KSHI Diskutime për kolanën e librave të ISKK për 2018 Të tjera	U. B. J. G. V. T.	Bordi - 4 KSHI - 5	1	Fizike G. P. (Skype)	Jo	

				G. P. A. H. A. B. V.G. E. K. K. D.					
01.10.2018		Pa numër	Vendim i Bordit dhe KSHI për natyrën e botimeve						Përmes vendimit, ISKK prioritizon dëshmitë, memuaristika, albume, studime arkivore, dëshmuese, duke shtyrë botimet e librave fiction
01.10.2018		8/2018	Për miratimin e listës së librave të kolanës që do të botohen me fondet e ISKK për vitin 2018						Miratohen librat: Sh. A. - Spaçi L. T. - Grabiani midis K.ve T. K. - Krimet e komunizmit: një histori e plotë për Mirditën 1944-1950 N. L.- Dom Shtjefën Kurti F. S. - Saga e Dhimbjes K. T. - Një jetë me brenga R. K. - Mos harroni, jemi dhe ne L. N. - Komiteti ushtarak i Delvinës Zërat e Kujtesës V K. D. - Histori të retushuara të komunizmit A. L. - Krahë të këputur (II)
01.10.2018		Pa numër	Vendim i Bordit dhe KSHI						Vendoset si jo e ngutshme botimi: S. Shyti - Përtej misterit (roman) I. Spahia - Kënga e shpirtrave (antologji me përkthime nga lirika botërore)

Viti 2019

Data	PV	Vendim	Përshkrimi	Pjesëmarrës	Nr. Pjesëmarrës		Prezenca	Firma	Komente
					Bordi	ISKK			
18.02.2019	X		Rendi i ditës	U. B. E. P. V. T. E. SH. A. L. E. K. A. B.	Bordi - 5 KSHI - 2	-	Fizike	Jo	Prezantohet anëtari i ri i Bordit A. L. Miratohet Raporti Vjetor 2018
18.02.2019		1/2019	Për miratimin e Raportit Vjetor të ISKK për vitin 2018						
21.03.2019	X		Rendi i ditës	U. B. E. P. E. SH. A. L.			Fizike	Jo	Miratohet Plani Vjetor i Punës 2019
21.03.2019		2/2019	Për miratimin e Planit Vjetor të Punës 2019						
18.04.2019	X		Diskutim në lidhje me sulmet mediatike dhe situatën e krijuar ndaj ISKK dhe Drejtorit Ekzekutiv	U. B. E. P. J. G. A. L. E. K.	Bordi - 4 KSHI - 3	-	Fizike	Jo	

				A. B. K. D.					
10.09.2019	X		Diskutim mbi Raportin Përfundimtar të KLSH Ndryshimi i Temës së Konferencës që do të zhvillohet në Dhjetor Marrja në punë e ekspertëve të jashtëm	U. B. J. G. A. L. G. P. E. Sh. E. P. A. Ç. Ç. H. L. Ll. Z. G.	6	4	Fizike	5	Mungon firma: G. P. V. T.
16.09.2019		3/2019	Për Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH dhe të tjera						Vendoset: 1. Miratimi i procedurave standarde të pranimit dhe kriteret për vendin vakant specialist/jurist 2. Miratimi i marrjes së masave konkrete për raportin e KLSH 3. Tema e konferencës: Komunizmi dhe feminizmi, format e trajtimit të grave gjatë regjimit komunist në Shqipëri 4. Numri i librave të prodhuar dhe botuar nga ISKK pjesë e biblioteksë duhet të mbahen 20 kopje 5. Miratimi i një sërë rregullash për të marrë ekspertë të jashtëm
18.10.2019		4/2019	Për miratimin e Kolanës së Librave për vitin 2019 dhe të tjera						Diskutim për pagën e autorëve që botojnë në ISKK **Miratimi i kolanës për vitin 2019:** R. K. - Mos harroni, jemi dhe ne, vëll. II D. G.- S. B.Maliqi, Gjineshtra në vullkanin e kuq V. Zh. - Panteoni i nëndheshëm I. S. - Karuseli i totalitarizmit V. B. – R.Gj. një jetë për një tjetër kohë Zërat e Kujtesës Vëll. VI K. D. - Doracak termash të diktaturës komuniste I lumi Dom Shtjefën Kurti, Dëshmitar i Kishës Martire, vëll. II K. T. - Unë dhe 8 të dënuarit e familjes sime L. D. - Partia Komuniste Shqiptare gjatë Luftës së II Botërore Kryengritja e Zhapokikë - Luftinjës S. R. - Në kërkim të ditëve premtuese E. M. – H.Sh. luftëtari antifashist që ra nga plumbat e komunistëve Q. Veliaj - S. H., një jetë e burgosur Fjalor i shtjelluem e gjuhës shqipe, At Benedikt Dema, vëll. III Katalogu i botimeve të ISKK 2011-2018 (foto)
			Nr. 243/4 Prot,datë 30.10.2019 KSHI i propozon Bordit Drejtues honoraret e autorëve si në vijim, duke përdorur metodologjinë e vlerësimit më shumë të librave studimorë në varësi të hulumtimit dhe sasisë së përmbajtjes						R. K. - 70,000 lekë (465) D. G.- 70,000 lekë (115) V. Zh. - 100,000 lekë (200) I. S. - 70,000 lekë (140) V. B. - 100,000 lekë (839)

									Zërat e Kujtesës Vëll. VI (300) - 0 lekë K. D. - 0 lekë (45) N. L. N. K., A. D. – I lumi Dom Shtjefën Kurti, Dëshmitar i Kishës Martire, vëll. II - 100,000 lekë (400) K. T. - 80,000 lekë (200) L. D. - 100,000 lekë (400) Xh. C. - Kryengritja e Zhapokikë - Luftinjës - 70,000 lekë (125) S. R - 0 lekë E. M. - 70,000 lekë (200) Q. V. - 70,000 lekë (190) Fjalor i shtjelluem e gjuhës shqipe, At Benedikt Dema, vëll. III - 0 lekë Katalogu i botimeve të ISKK 2011-2018 - 0 lekë Almanaku i kumtesave të konferenës mbi kampet e internimit - 0 lekë
03.12.2019	X		Shqyrtimi i dorëheqjes së Drejtorit Ekzekutiv A. Ç.	U. B. J. G. A. L. E. SH. E. P.	5		Fizike	Jo	Pranohet kërkesa për dorëheqje e Drejtorit Ekzekutiv A. Ç.
23.12.2019	X		Dëgjesa e kandidatëve për postin e Drejtorit Ekzekutiv Zgjedhja e Drejtorit të ri	U. B. J. G. A. L. E. P. E. SH. V. T. G. P.	7		Fizike G. P. (Skype)	Jo	Kandidatura: Ç. H., E. K., M. H. L.N., R. P. Ngrihet Komisioni i administrimit të procesit të votimit me J. G.; E. SH.; J. I. (sekretare) Bordi vendos për votim të fshehtë dhe miraton formatin e fletës së votimit. Votohet sipas rendit alfabetik Komisioni verifikon vlefshmërinë e fletëve dhe numëron votat. Shpall rezultatin: 4 vota - Ç. H. 3 vota - E. K.
23.12.2019		6/2019	Mbi zgjedhjen e Drejtorit të ri Ekzekutiv të ISKK						

Viti 2020

Data	PV	Vendim	Përshkrimi	Pjesëmarrës	Nr. Pjesëmarrës		Prezenca	Firma	Komente
					Bordi	ISKK			
13.01.2020	X		Miratimi i Planit Vjetor të Punës 2020 Të ndryshme	U. B. J. G. G. P. V. T. A. L. E. P. E. SH.	7	1	Fizike	Jo	Miraton Planin Vjetor 2020
13.01.2020		1/2020	Për miratimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2020						Miratohet plani me ndryshimet e sugjeruara: Përgatitjen e Vëllimi Zërat r Kujtesës Vëll. II; si dhe organizimin e një takimi jubilar me rastin e 10 vjetorit të krijimit të ISKK
27.02.2020	X		Miratimi i Raportit Vjetor të Punës 2019 Miratimi i disa shtesave në Rregulloren e Brendshme të ISKK	U. B. J. G. E. SH.	7	3	Fizike G. P. (Skype)	Jo	Miratohet Raporti Vjetor i Punës 2019 Miratohen kriteret për punonjësit e rinj bashkëlidhur

			Diskutim mbi detyrimet që rrjedhin nga pika "g" e nenit 11, të Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 Të ndryshme	G. P. E. P. A. L. V. T. Ç. H. L. A. D. R.					Autorizohet Drejtori Ç. H. për raportimin e raportit vjetor në parlament
28.02.2020		2/2020	Për miratimin e Raportit Vjetor të Punës për vitin 2019 dhe miratimin e shtesave në rregulloren e brendshme në ISKK						Miratohet Raporti Vjetor i Punës 2019 Miratohen kriteret për punonjësit e rinj bashkëlidhur Autorizohet Drejtori Ç. H. për raportimin e raportit vjetor në parlament
09.03.2020	X		Mbledhje KSHI	V. G. A. H. E. K. K. D. A. B. Z. G. L. A.	5	2	Fizike	Jo	Diskutohen rekomandimet për procesverbalet Diskutohet draftimi i një rregulloreje botimesh Diskutohet buxheti për libër (28,000 lekë)
14.05.2020	X		Miratimi i shkurtimeve të shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për projekte Të ndryshme	U. B. J. G. G. P. V. T. A. L. E. P. E. SH. Ç. H.	7	1	Online	Jo	Shpenzime operative të shkurtuara në masën 3,000,000 lekë
08.05.2020		3/2020	Për miratimin e shkurtimit të shpenzimeve operative dhe shpenzimet për projekte						Shkurtim shpenzime administrative për paga 1,000,000 lekë Shkurtim shpenzime operative dhe për projekte 3,000.000 lekë
16.07.2020	X		Raportimi dy mujor për veprimtarinë e ISKK Përcaktimi përfundimtar i listës së librave që do të botohen për vitin 2020 Propozim për modelin e shpërblimit të autorëve të botimeve vjetore Të ndryshme	U. B. J. G. G. P. E. P. E. SH. A. L. V. T. Ç. H.	7	1	Online	Jo	Dre Ekzekutiv propozon për modelin e shpërblimit të autorëve bazuar në: Ligji nr. 10242/2010, Ligjit nr. 35/2016, VKM nr. 120/1997: Botimet shkencore: Mbi 400 faqe - 100,000 lekë 300-400 faqe - 90,000 lekë 200-300 faqe - 80,000 lekë 100-200 faqe - 70,000 lekë deri në 100 faqe - 60,000 lekë Botimet prozë e lirë: Mbi 400 faqe - 90,000 lekë 300-400 faqe - 80,000 lekë 200-300 faqe - 70,000 lekë 100-200 faqe - 60,000 lekë deri në 100 faqe - 50,000 lekë Për albumet pagesë fikse mesatare 75,000 lekë Në skemën e honorareve të përfshihen autorët punonjës të

									ISKK kur vërtetojnë që është realizuar jashtë orarit të punës
17.07.2020		4/2020	Për miratimin përfundimtar të listës së librave për botim për vitin 2020						Miratohet lista dhe ngarkohet Drejtori Ekzekutiv në mbështetje të nenit 13, pika 4 për përcaktimin e ndarjes së honorarit/dëshpërblimit të autorëve: R. K. - Mos harroni, jemi dhe ne, vëll. II (433 faqe) D. G.- S.B.M., Gjineshtra në vullkanin e kuq (131 faqe) V. Zh. - Panteoni i nëndheshëm (423 faqe) I. S. - Karuseli i totalitarizmit (113 faqe) V. B.- Ramize Gjebrea, një jetë për një tjetër kohë (491 faqe) Zërat e Kujtesës Vëll. VI (355 faqe) K. D. - Doracak termash të diktaturës komuniste (51 faqe) N. L., N. K., A. D.– I lumi Dom Shtjefën Kurti, Dëshmitar i Kishës Martire, vëll. II (415 faqe) K. T. - Unë dhe 8 të dënuarit e familjes sime (220 faqe) L. D.- Partia Komuniste Shqiptare gjatë Luftës së II Botërore (390 faqe) Kryengritja e Zhapokikë - Luftinjës (128 faqe) S. R. - Në kërkim të ditëve premtuese (392 faqe) E. M. – H.Sh., luftëtari antifashist që ra nga plumbat e komunistëve (219 faqe) Q. V. - S. H., një jetë e burgosur (244 faqe) Xh. C. - Fjalor i shtjelluem e gjuhës shqipe, At Benedikt Dema, vëll. III (584 faqe)
16.07.2020	X		Mbledhje KSHI diskutim për draftin e rregullores	V. G. E. K. K. D. A. B.	4	-	Fiizk A. B. (Skype)	Vetëm nga Kryetari i KSHI	
31.08.2020	X		Mbledhje KSHI diskutim për draftin e rregullores	V. G. E. K. K. D. A. B.	4	-	Online	Vetëm nga Kryetari i KSHI	
28.09.2020	X		Mbledhje KSHI diskutim për draftin e rregullores	V. G. E. K. K. D. A. B.	4	-	Online	Vetëm nga Kryetari i KSHI	
03.11.2020	X		Mbledhje KSHI diskutim për draftin e rregullores	V. G. E. K. K. D. A. B. I. I.	4	-	Online	Vetëm nga Kryetari i KSHI	Votohet varianti përdundimtar i projekt-rregullores dhe ngarkoi Kryetarin për ta dorëzuar tek anëtarët e Bordit Drejtues
26.10.2020	X		Diskutim mbi miratimin e ndryshimeve të Ligjit të IPKK nr. 10242 në datën 22.10.2020	U. B. J. G. G. P. E. P. E. SH. A. L. V. T. Ç. H.	Bordi - 7 KSHI - 5	2	Online	Jo	

				A. K. V. G. I. I. E. K. K. D. A. B.					
26.10.2020		5/2020	Për deklaratën e ISKK mbi ndryshimin në Ligjin nr. 10242, datë 10.05.2010						Shpërndarje deklarate
27.11.2020		6/2020	Për ndryshime në rregulloren e botimeve dhe hartimin e rregullores për KSHI						Ngritjen e grupit të punës për rishikimin dhe ndryshimin e rregullores së botimeve dhe për hartimin e një rregulloreje të re për funksionimin e KSHI
27.11.2020	X		Diskutim mbi Projekt-Rregulloren e Botimeve	U. B. J. G. G. P. E. P. V. T. E. SH. A. L. Ç. H. A. K. E. K. A. B. V. G. I. I. K. D.	Bordi - 7 KSHI - 5	2	Online	Jo	
27.11.2020			Diskutim në mbledhjen e Bordit, 27 Tetor 2020						Dilet në vendimin se projekt-Rregullorja "Për procedurat e planifikimit, vlerësimit dhe miratimit të botimeve të ISKK" e propozuar nga KSHI nuk duhet të miratohet.

Viti 2021

Data	PV	Vendim	Përshkrimi	Pjesëmarrës	Nr. Pjesëmarrës		Prezenca	Firma	Komente
					Bordi	ISKK			
12.01.2021	X		Miratimi i strukturës së re të ISKK Diskutim mbi çështjen e ankimimit të ligjit në Gjykatën Kushtetuese Të ndryshme	U. B. J. G. E. P. E. SH. A. L. G. P. V. T. Ç. H. Z. G. L. A.	7	3	Online	Jo	Vendoset miratimi i strukturës së re të ISKK Vendoset të mos ankimohet ligji në Gjykatën Kushtetuese Vendoset të dërgohet një shkresë nga Drejtori për emërtim rruge
12.01.2021		1/2021	Për miratimin e strukturës së re të organikës së ISKK						
01.02.2021	X		Prezantimi për miratim i Projekt-Planit për vitin 2021 Të ndryshme	U. B. J. G. E. P. E. SH. A. L. G. P.	7	4	Online	Jo	Miratohet projekt-plani 2021

				V. T. Z. G. L. A. A. K. L. LL.					
01.02.2021		2/2021	Për miratimin e projekt-planit vjetor të punës në ISKK						
01.03.2021	X		Mbledhje KSHI mbi diskutimin e disa artikujve shkencorë të dorëzuar nga disa studiues në konferencën shkencore të organizuar nga ISKK gjatë muajit nëntor	V. G. E. K. K. D. A. B.	4		Online	Kryetari	Artikujt u lexuan përgjtaë muajit shkurt nga anëtarët e KSHI dhe disa mendime rreth cilësisë bashkë me disa kërkesa për ndryshime, iu nisën me shkrim nëndrejtoreshës së ISKK
07.04.2021	X		Mbledhje KSHI mbi punime dhe studime për botim	V. G. E. K. K. D. A. B.	4		Online	Kryetari	U diskutuan mbi 7 punime dhe studime të paraqitura për botim. U vendos të bëhet një ndarje për secilin prej punimeve për të hrtuar një vlerësim të përmbajtjes së tyre. Në fund të muajit KSHI do të paraqesë raportet përkatëse për secilin prej punimeve të propozuara.
04.05.2021	X		Mbledhje KSHI mbi punime dhe studime për botim	V. G. E. K. K. D. A. B. I. I.	5		Online	Kryetari	U diskutuan mbi 7 punime dhe studime të paraqitura për botim. Anëtarët e KSHI diskutuan dhe dorëzuan një mendim për secilin nga veprat. Propozimet e KSHI iu përcollën ISKK për secilin prej punimeve të dorëzuara.
16.07.2021	X		Mbledhje KSHI mbi veprat për botim	V. G. E. K. K. D. A. B. I. I. V. K.	6		Online	Kryetari	Veprat e mëposhtme janë ripunuar nga autorët dhe kanë reflektuar ndryshimet në tekstet e tyre bazuar në rekomandimet e KSHI: F. G. - Dromca kujtimesh K. H. - Tokë e bukur, kohë e shëmtuar I. P. - Jeta e një fëmije "kulaku" në diktaturë Xh. S. – Z.V. A. S. - Dokumente mbi cënimin e pronës në periudhën komuniste 1944-1946 Ndërkohë u ndihmua në redaktim nga K. D.: Y. T.- Arratisja Po përfundohet doreshkrimi: Zërat e Kujtesës L. N. Punimet e Konferencës Shkencore "Ligjshmëria gjatë regjimit komunist" janë gati për botim pasi janë bërë rregullimet e rekomanduara nga kSHI, të clat do të botohen një pjesë në revistën shkencore të ISKK dhe një pjesë përmbledhje me aktet e konferencës.
27.10.2021	X		Mbledhje KSHI mbi titullin e revistës shkencore që do të botohet nga Instituti	V. G. E. K. K. D. A. B. I. I. V. K.	6		Online	Jo	I përcillet ISKK mendimi për titullin e revistës shkencore "Ad Memorandum" ose "Studime për krimet e komunizmit".
16.03.2021	X		Miratimi i Raportit Vjetor 2020	U. B. J. G. E. P. E. SH.	7	2	Online	Jo	Miratohet raporti vjetor 2020 U përgëzua për Konferencën e vitit 2020

				A. L. G. P. V. T. Ç. H. A. K.					
16.03.2021		3/2021	Për miratimin e Raportit Vjetor të punës në ISKK						
02.04.2021	X		Diskutimi dhe miratimi i projekt-rregullores për funksionimin e Bordit Drejtues	U. B. J. G. E. P. E. SH. A. L. G. P. V. T. Ç. H.	7	1	Online	Jo	
09.04.2021		4/2021	Për miratimin e Rregullores së Bordit Drejtues të ISKK						Miratohet Rregullorja e Bordit Drejtues ISKK të shprehë me shkrim qëndrim institucional në lidhje me dekorimet nga Presidenti i Republikës
05.05.2021			6 propozime për mbledhje Bordi iniciuar nga Drejtori Ekzekutiv Datë: 05.05.2021, 05.05.2021, 03.03.2021. 19.01.2021, 07.01.2021						
			7 Relacione nga Dr Ekzekutiv i ISKK						
23.05.2021	X		Miratimi i Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e KSHI Miratimin e Rregullores për Procedurat e Planifikimit, Vlerësimit dhe Miratimit të Botimeve Miratimin e kritereve për vende vakante Të ndryshme	U. B. J. G. E. P. E. SH. A. L. G. P. V. T. A. H. L. LL. Z. G.	7	3	Online	Jo	Kundërshtime për rregulloren e re
23.05.2021		5/2021	Për miratimin e kritereve të kualifikimit për pozicionet e reja të punës sipas strukturës dhe organikës së ISKK						
07.07.2021	X		Miratimi i Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e KSHI Miratimin e Rregullores për Procedurat e Planifikimit, Vlerësimit dhe Miratimit të Botimeve Të ndryshme	U. B. J. G. E. P. E. SH. A. L. G. P. V. T. A. H. L. LL. Ç. H.	7	3	Online	Jo	Miratohet rregullorja me shumicë votash
07.07.2021		6/2021	Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e KSHI						
07.09.2021	X		Miratimi i Rregullores së Botimeve Miratimi i Botimeve 2021	U. B. J. G. E. P.	7	2	Online	Jo	Lista e librave: A. S. - Dokumente mbi cënimin e pronës në periudhën komuniste 1944-1946

			Miratimi i kritereve të punës për pozicionin specialist/jurist	E. SH. A. L. G. P. V. T. L. LL. Ç. H.					F. G. - Dromca kujtimesh K. H. - Tokë e bukur, kohë e shëmtuar I. P. - Jeta e një fëmije "kulaku" në diktaturë Xh. S.- Z.V., intelektual i madh nga një qytet i vogël Y. T. - Arratisja L. N. – N.D., mes përkthimit dhe përndjekjes L. LL. - Zërat e Kujtesës ISKK - Revista shkencore: Studime për krimet e komunizmit L. LL. - Përmbledhje aktesh të konferencës shkencore "Ligjshmëria gjatë regjimit komunist 1944-1990"
07.09.2021		7/2021	Për miratimin e Rregullores së Botimeve, miratimin e botimeve 2021 dhe miratimin e kritereve të punës për pozicionin Specialist/Jurist						Miratohet Rregullorja e Botimeve, Botimet 2021, kriteret e pozicionit
14.10.2021	X		Diskutim mbi mënyrën e shpërblimit të autorëve	U. B. E. P. E. SH. A. L. G. P. V. T. L. LL. Ç. H. Z. G.	6	3	Online	Vetëm Kryetari	Bordi vendos për miratimin e një shpërblimi honorifik prej 100,000 lekë për secilin prej autorëve
12.10.2021		8/2021	Për miratimin e pagesës së autorëve të jashtëm për kolanën e librave 2021						Miratohet pagesa për të drejtën e autorit në shumën 100,000 lekë për autorët: A. S. I. P. K. H. Y. T. Xh. S. F. G.
19.11.2021			Relacion për projekt-kodi etik i ISKK						Drejtori Ekzekutiv i dërgon Kryetarit të Bordit relacionin lidhur me rëndësinë e një Kodi Etik për institucionin, duke cituar dhe bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur hartimi i këtij Kodi.
09.12.2021	X		Diskutim i projekt-kodit të etikës	U. B. J. G. E. P. E. SH. A. L. G. P. V. T. Ç. H. Z. G.	7	2	Online	Jo	Bordi është parimisht dakord me Kodin, por do të rishikohet.

Deri më 30.06.2022

Data	PV	Vendim	Përshkrimi	Pjesëmarrës	Nr. Pjesëmarrës		Prezenca	Firma	Komente
					Bordi	ISKK			
Propozime dhe relacione të Drejtori Ekzekutiv									

01.02.2022	Nr. 12 Prot		Propozim për mbledhje të Bordit me rend dite: miratimi i Planit Vjetor të ISKK dhe të ndryshme						
01.02.2022	Nr. 12/1 Prot		Relacion për Planin Vjetor të Punës 2022						Plani vjetor është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e ISKK parashikuar në ligjin organik të institutit. Për vitin 2022, ISKK parashikon realizimin e një sërë projektesh të ndryshme. Në themel janë veprimtaritë dhe projektet e vazhdueshme si: Enciklopedia, konferenca shkencore, kolana e librave, seria Zërat e Kujtesës, muzetë virtualë të kampeve të punës.
27.03.2022	Nr. 12/2 Prot		Propozim për mbledhje të Bordit me rend dite: miratimi i Raportit Vjetor 2021, miratimi i Planit Strategjik 2022-2025, miratimi i Kodit Etik, të ndryshme						
27.03.2022	Nr. 12/2-1 Prot		Relacion për Raportin Vjetor 2021 të ISKK						Raporti vjetor është një përshkrim i realizimit të planit vjetor 2021, ku ISKK është përqendruar kryesisht në: 1. Studimin e çështjeve ekonomike gjatë regjimit komunist, legjislacioni, reformat, abuzimi i shtetit me pronën private, izolimi i ekonomisë, ngurrimi për hapejn e ekonomisë në dekadën e fundit. 2. Dokumentimin, botimin dhe informimin e publikut për ndjekjen dhe eleminimin e elementëve dhe grupeve natikomuniste brenda vendit nga struktura të paligjshme të armatosura 3. Studimin e ligjshmërisë së internimeve adminstrative, përpunimin e të dhënave për internimin e të miturve, evidentimin statistikor të tyre. 4. Mbledhjen e dëshmive të të dënuarve për arsye politike, botimin e tyre dhe informimin e publikut për jetën në burgje, internim, dëbim dhe forma të tjera persekutimi 5. Studimin e jetës së personave të kthyer në Shqipëri me vullnetin për t'i shërbyer vendit, të cilët u trajtuan si armiq dhe përjetuan kalvarin e persekutimit. 6. Rritjen e aksesit në publik mbi historinë e komunizmit në Shqipëri 7. Pasurimin e databazës me të dhëna statistikore dhe cilësore të viktimave të komunizmit në Shqipëri, etj.
27.03.2022	Nr. 12/2-2 Prot		Relacion për Planin Strategjik të ISKK 2022-2025						Në përmbushje të një prej rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për ISKK në vitin 2021, ishte përgatitja e një plani strategjik për vitet në vijim. Qëllimet strategjike të vendosura që në origjinë të ISKK janë: 1. Identifikimi i viktimave të regjimit komunist, si elementi kryesor në vërtetimin e ekzistencës së veprimtarisë kriminale të kryer gjatë regjimit komunist 2. Mbledhja e informacionit për krimet e komunizmit nga burime parësore, dëshmitarët okularë, të cilat nuk gjenden ne dokumenta zyrtare 3. Analizimi i vlerësimit të krimeve të regjimit komunist përmes studimeve shkencore të thelluara 4. Informimi i publikut

06.05.2022	Nr. 12/3 Prot.		Propozim për mbledhje të Bordit me rend dite: diskutim për mungesën e mjediseve të punës për ISKK dhe qëndrimit të institucioneve të tjera lidhur me këtë çështje, si dhe të ndryshme.						
06.05.2022	Nr. 12/3-1 Prot.		Relacion për çështjen e mjediseve të punës së ISKK në prag të restaurimit të godinës						Më 24 Mars 2022, ISKK është ëvnë në dijeni nga UNOPS, e ngarkuar nga Ministria e Kulturës, për restaurimin e godinës ku ISKK është vendosur. ISKK i ka dërguar Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave njoftimin për situatën dhe institucionet janë përgjigjur se nuk kanë hapësira të lira për momentin. Bazuar në Ligjin e ISKK, pajisja e institucionit me mjedise pune është detyrim i Këshillit të Ministrave.
09.06.2022	Nr. 12/4 Prot.		Propozim për mbledhje të Bordit me rend dite: miratimin e librave dhe artikujve shkencorë të planifikuar për botim për vitin 2022, informacion mbi restaurimin e ndërtesës dhe lëvizja e ISKK në mjedise të reja, si dhe të ndryshme.						
09.06.2022	Nr. 12/4-1 Prot.		Relacion mbi librat dhe artikujt shkencorë për botim për vitin 2022						Kolana e botimeve të vitit 2022 përfshin 13 tituj, nga ku 10 janë zhanre librash, 2 janë revista shkencore e ISKK dhe aktet e konferencës vjetore të zhvilluar vitin e kaluar dhe një zë është broshurë promovuese (përfshirë në kolanën e librave për arsye teknike). Enciklopedia 11 është në rpoces redaktimi dhe financohet nga jashtë, jo nga buxheti i ISKK. Revista dhe përmbledhja e konferencës konsistojnë në 14 artikuj shkencorë.
09.06.2022	Nr. 12/4-2 Prot.		Projekt-lista e librave për botim 2022						
25.01.2022	Nr. 11 Prot		Mbledhje KSHI	E. K. V. G. K. D. A. B. I. I. V. K.			Online	Kryetari	Kryetari propozoi kërkesën për të vlerësuar 5 propozime botimiesh të reja. Botimet u ndanë për vlerësim te anëtarët të cilët do të sjellin një raport vlerësimi për secilin nga propozimet.
17.03.2022	Nr. 11/1 Prot		Mbledhje KSHI	E. K. V. G. K. D. A. B. I. I. V. K.			Online	Kryetari	KSHI u njoh me 5 artikuj të ardhur për thirrjen e fundit për të botuar në revistën shkencore Memorja 2022. B. S., Xh. S., K. K., I. M., L. M.
04.04.2022	Nr. 11/2 Prot		Mbledhje KSHI	E. K. V. G. K. D. A. B. I. I. V. K.			Online	Kryetari	Kryetari propozoi kërkesën për të vlerësuar 4 propozime botimiesh të reja. Botimet u ndanë për vlerësim te anëtarët të cilët do të sjellin një raport vlerësimi për secilin nga propozimet.
09.05.2022	Nr. 11/3 Prot		Mbledhje KSHI	E. K. V. G. K. D. A. B.			Online	Kryetari	KSHI u njoh me disa draft-propozime për botim nga ana i ISSKK dhe me 8 artikuj të rinj shkencorë të ardhur për thirrjen e fundit për të botuar në revistën shkencore si dhe dy botime të tjera nga autorët E. M. dhe F. Z..

				I. I. V. K.					
03.02.2022	Nr. 14 Prot.		Mbledhje Bordi Drejtues	U. B. J. G. G. P. E. P. V. T. E. SH. A. L. Ç. H. L. LL. Z. G.	Bordi – 7 ISKK – 3		Online	Jo	Bordi Drejtues miraton Planin Vjetor të Punës 2022
03.02.2022		1/2022	Për miratimin e Planit të Punës 2022						
28.03.2022	Nr. 14/1 Prot.		Mbledhje Bordi Drejtues	U. B. J. G. G. P. E. P. V. T. E. SH. A. L. Ç. H. A. H. Z. G.	Bordi - 7 ISKK - 3		Online	Jo	Bordi Drejtues mblidhet për të miratuar Raportin Vjetor 2022, Planin Strategjik të ISKK 2022-2025, Kodit Etik të ISKK. Gjithashtu, diskutohet performanca për vitin 2021.
28.03.2022		2/2022	Për miratimin e Raportit Vjetor të Punës, miratimin e Planit Strategjik të ISKK 2022-2025, miratimin e Kodit Etik						
16.05.2022	Nr. 14/2 Prot.		Mbledhje Bordi Drejtues	U. B. J. G. G. P. E. P. V. T. E. SH. A. L. Ç. H.	Bordi - 7 ISKK - 1		Online	Jo	Bordi Drejtues mblidhet për të diskutuar mbi gjetjen e ambienteve të reja me qira. Diskutohet se ISKK do të dërgojë shkresë drejt institucioneve si Kuvendi, Kryeministria, etj., për ambiente të cilat mund të jenë në pronësi shtetërore. Gjithashtu të vihet në dijeni edhe Ministria e Financës.
15.06.2022	Nr. 14/3 Prot.		Mbledhje Bordi Drejtues	U. B. J. G. G. P. E. P. V. T. E. SH. A. L. Ç. H. Z. G.	Bordi - 7 ISKK - 2		Online	Jo	Bordi Drejtues mblidhet për të miratuar librat dhe artikujt shkencorë të planifikuar për botim për vitin 2022, për të diskutuar mbi restaurimin e ndërtesës dhe lëvizjen e ISKK-së në ambiente të reja.

Aneksi: Vendimet e marra gjatë vitit 2018 për shpërndarjen e fondit në mijë lekë

Vendime	Ndihma Ekonomike	Sponsor	Shoqata	Rikonstruksion	Totali
Vendimi nr.1	105	-	500		**605**
Vendimi nr.2	330	-	1,200		**1,530**

Vendimi nr.3	390	-	620		**1,010**
Vendimi nr.4	180	597	700		**1,477**
Vendimi nr.5	260	-	780		**1,040**
Vendimi nr.6	390	-	700		**1,090**
Vendimi nr.7	-	-	1		**1**
Vendimi nr.8	70	-	700	1,300	**2,070**
Vendimi nr.9	65	-	600		**665**
Vendimi nr.10	95	150	1,200	1,350	**2,795**
Vendimi nr.11	400	-	1,200		**1,600**
Vendimi nr.12	220	450	-	1,350	**2,020**
Vendimi nr.13	365	-	1,450	1,350	**3,165**
Vendimi nr.14	20	150	300		**470**
Vendimi nr.15	185	54	1,600	1,350	**3,189**
Vendimi nr.16	535		840	1,350	**2,725**
Vendimi nr.17	510	31	970	1,350	**2,861**
Vendimi nr.18	315	100	-		**415**
Vendimi nr.19	1,545		700	1,350	**3,595**
Vendimi nr.20	75				**75**
Totali	*6,040*	*1,532*	*15,060*	*10,750*	*33,382*

Aneksi: Vendimet e marra gjatë vitit 2019 për shpërndarjen e fondit në mijë lekë

Vendime	**Ndihma Ekonomike**	**Sponsor**	**Shoqata**	**Rikonstruksion**	**Totali**
Vendimi nr.1	530		1,700	2,050	4,280
Vendimi nr.2	740		2,300	4,100	7,140
Vendimi nr.3	270		2,700	4,100	7,070
Vendimi nr.4	620		2,600	4,100	7,320
Vendimi nr.5	830	95	2,600	4,050	7,575
Vendimi nr.6	410	225	-	-	635
Vendimi nr.7	270		2,750	3,400	6,420
Vendimi nr.8	515	98	3,130	2,600	6,343
Vendimi nr.9	370	90	3,200	3,250	6,910
Vendimi nr.10	90		3,050	1,300	4,440
Vendimi nr.11	450		1,300	-	1,750
Vendimi nr.12	345		3,920	1,300	5,565
Vendimi nr.13	130		3,540	650	4,320
Vendimi nr.14	100		250	-	350
Vendimi nr.15	1,810		3,500	700	6,010
Totali	**7,480**	**508**	**36,540**	**31,600**	**76,128**

Aneksi: *Vendimet e marra gjatë vitit 2020 për shpërndarjen e fondit në mijë lekë*

Vendime	Ndihma Ekonomike	Sponsor	Shoqata	Rikonstruksion	Totali
Vendimi 1	310	-	2,800	2,700	5,810
Vendimi 2	530	75	4,530	4,050	9,185
Vendimi 3	715	-	-	2,700	3,415
Vendimi 4	620	-	2,800	2,700	6,120
Vendimi 5	-	-	800	-	800
Vendimi 6	300	-	3,100	4	7,400
Vendimi 7	695	-	3,700	2,700	7,095
Vendimi 8	370	-	3,600	3,400	7,370
Vendimi 9	30	-	2,400	2,050	4,480
Vendimi 10	20	-	1,600	2,050	3,670
Vendimi 11	5	80	1	-	1,085
Vendimi 12	85	-	2,600	3,350	6,035
Vendimi 13	175	-	2,600	4,050	6,825
Vendimi 14	945	-	2,600	4,700	8,245
Totali	**4,800**	**155**	**34,130**	**38,450**	**77,535**

Aneksi: *Vendimet e marra gjatë vitit 2021 për shpërndarjen e fondit në mijë lekë*

Vendime	Ndihma Ekonomike	Sponsor	Shoqata	Rikonstruksion	Totali
Vendimi 1	370	-	2,800	4,700	7,870
Vendimi 2	300	-	2,800	4,050	7,150
Vendimi 3	430	-	2,700	3,350	6,480
Vendimi 4	350	-	3,550	4,050	7,950
Vendimi 5	230	-	3,400	4,700	8,330
Vendimi 6	340	-	3,620	5,450	9,410
Vendimi 7	160	-	2,250	1,400	3,810
Vendimi 8	270	40	3	1,350	4,660
Vendimi 9	390	-	3,150	1,350	4,890
Vendimi 10	150	-	2,060	1,350	3,560
Vendimi 11	25	-	1	-	1,025
Vendimi 12	-	-	2,250	-	2,250
Vendimi 13	-	-	2,150	1,350	3,500
Vendimi 14	-	-	800	-	800
Vendimi 15	1,260	-	1,800	1,350	4,410
Vendimi 16	70	-	-	-	70
Totali	**4,345**	**40**	**37,330**	**34,450**	**76,165**

Aneksi: *Vendimet e marra gjatë vitit 2022 për shpërndarjen e fondit në mijë lekë*

Vendime	Ndihma Ekonomike	Sponsor	Shoqata	Rikonstruksion	Totali
Vendimi 1	560	226	-		786
Vendimi 2	635	100	200		935
Vendimi 3	240	258	70		568
Vendimi 4	260	-	1,250		1,510
Totali	**1,695**	**584**	**1,520**		**3,799**